

VENDIM
Nr. 583, datë 22.7.2020

**PËR MIRATIMIN E PLANIT TË MENAXHIMIT TË INTEGRUAR TË PARKUT
KOMBËTAR TË BUTRINTIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të shkronjës “a”, të pikës 2, të nenit 47, të ligjit nr.27/2018, “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”, me propozimin e ministrit të Kulturës dhe të ministrit të Turizmit dhe Mjedisit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e planit të menaxhimit të integruar të Parkut Kombëtar të Butrintit, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Ngarkohet Ministria e Kulturës, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Ministria e Brendshme, Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama



Parku Kombëtar i Butrintit
**Plani i Menaxhimit të Integruar
(2020-2030)**

Plani i Menaxhimit të Integruar të Parkut Kombëtar të Butrintit (2020-2030)

Ministria e Kulturës
Prill 2020

Hartuar me asistencën e

PRINCE+PEARCE

A 35a The High Street, Potters Bar, EN6 5AJ, Mbretëri e Bashkuar
T +44 (0) 7973 691 927
E dprince@princeandpearce.co.uk
W www.princeandpearce.co.uk

në bashkëpunim me

Qendrën për Arkeologjinë e Aplikuar, Institutin e Arkeologjisë, University College London
dhe

Trashëgiminë Kulturore pa Kufij, Shqipëri

Drejtuesi i ekipit: **Dr. David Prince**

Financuar nga

AADF - Fondacioni Shqiptaro-Amerikan për Zhvillim

Tabela e përmbajtjes

1.0 PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

2.0 HYRJE

2.1 Kuadri ligjor.

2.1.1 Konventa për Trashëgiminë Botërore

2.1.2 Përfshirja e Butrintit dhe e Parkut Kombëtar të Butrintit në listën e UNESCO-s

2.1.3 Konventa e Ramsarit dhe shpallja e zonës Ramsar të Parkut

2.1.4 Konteksti ligjor shqiptar

2.2 Zhvillimi i Zonave të Mbrojtura që prej vitit 1992

2.3 Qasja dhe çështjet kyçe

2.4 Parimet orientuese

2.5 Një strukturë e re menaxhuese

2.6 Konsultimi

2.6.1 Menaxhimi i procesit të konsultimit me palët e interesit

2.6.2 Grupet e nënpërfaqësuar dhe ato të vështira për t'u arritur

2.7 Praktikrat më të mira

2.7.1 Modelet e aplikuara në hartimin e Planit të Menaxhimit të Integruar

3.0 PARKU KOMBËTAR I BUTRINTIT

3.1 Vlera e Jashtëzakonshme Universale

3.1.1 Integriteti

3.1.2 Autenticiteti

3.1.3 Kërkesat aktuale të mbrojtjes dhe menaxhimit

3.2 Ndryshime të mundshme në Zonat e Mbrojtura të Parkut Kombëtar në të ardhmen

3.3 Statusi i "Sitit Miks"

3.3.1 Rezultatet e menaxhimit

3.4 Peizazhi

4.0 BURIMI KULTUROR

4.1 Rëndësia e pasurisë arkeologjike

4.1.1 Larmia e kulturave dhe periudhave

4.1.2 Monumente të jashtëzakonshme

4.1.3 Vlera grupore

4.1.4 Potenciali i burimit arkeologjik

4.1.5 Lidhjet historike

4.2 Përvojat e mëparshme

- 4.2.1 Periudha midis luftërave
- 4.2.2 1945-1992
- 4.2.3 Butrinti në vitin 1993
- 4.2.4 Periudha e Fondacionit Butrinti
- 4.3 Mësimet e nxjerra
- 4.3.1 Angazhimi i komunitetit
- 4.3.2 Trajnimi
- 4.3.3 Konservimi
- 4.3.4 Kërkimi
- 4.3.5 Ndikime më të gjera
- 4.4 Konservimi i monumentit

5.0 BURIMI NATYROR

- 5.1 Parku Kombëtar i Butrintit
- 5.1.1 Liqeni i Butrintit
- 5.2 Rëndësia e Burimeve Natyrore
- 5.2.1 Vlera ndërkombëtare
- 5.2.2 Vlera kombëtare
- 5.2.3 Vlera kulturore
- 5.2.4 Vlera estetike
- 5.2.5 Vlera ekonomike vendore
- 5.2.6 Vlera e mundshme
- 5.3 Parimet orientuese
- 5.4 Rekomandime për menaxhimin
- 5.4.1 Zonimi dhe veprimtaritë e lejuara
- 5.4.2 Zonimi dhe veprimtaritë e lejuara në zonimin e ri të propozuar

6.0 TURIZMI dhe INFRASTRUKTURA

- 6.1 Numri i vizitorëve
- 6.2 Menaxhimi i përdorimit të zonës nga vizitorët
- 6.2.1 Një qendër e re vizitorësh
- 6.2.2 Orientime
- 6.2.3 Akomodimi i stafit, strukturat në hyrje dhe rrethimi i sitit
- 6.2.4 Interpretimi i ri në Kalanë Veneciane
- 6.2.5 Interpretim i ri i Fortesës Trekëndore
- 6.2.6 Lundra ...
- 6.2.7 Shtëpia e Doganës
- 6.2.8 Interpretimi i ri i sitit

- 6.2.9 Varkat e pasagjerëve, platformat lundruese dhe skelat
- 6.2.10 Shtigjet e ecjes në natyrë, shtegkalimet dhe sinjalet
- 6.3 Potenciali edukues dhe argëtues i Parkut Kombëtar
- 6.4 Rekomandime për menaxhimin
 - 6.4.1 Edukimi.
 - 6.4.2 Aktivitete dhe organizime të ndryshme në natyrë
 - 6.4.3 Aktivitete kulturore lokale
 - 6.4.4 Turizëm me interes të veçantë
 - 6.4.5 Aktivitete sezonale dhe aktivitete të tjera

7.0 ZHVILLIMI I KOMUNITETIT

- 7.1 Konteksti socio-ekonomik
 - 7.1.1 Komunitetet brenda Parkut Kombëtar
- 7.2 Angazhimi i komunitetit
- 7.3 Qëndrueshmëria mjedisore
- 7.4 Rekomandime për menaxhimin
 - 7.4.1 Zhvillimi i komunitetit
 - 7.4.2 Përfaqësimi vendor dhe rajonal
 - 7.4.3 Koordinimi i palëve të interesit
 - 7.4.4 Qëndrueshmëria
 - 7.4.5 Kujdesi me burimet
 - 7.4.6 Edukimi dhe të nxënit

8.0 DREJTIMI dhe MENAXHIMI

- 8.1 Parametrat
- 8.2 Parqet Kombëtare
- 8.3 Autoritetet aktuale përgjegjëse në Butrint
 - 8.3.1 Në nivel ndërkombëtar
 - 8.3.2 Në nivel kombëtar
- 8.4 Analiza e menaxhimit
- 8.5 Nevoja për ndryshim
- 8.6 Nevoja për fuqizimin e Komitetit të Menaxhimit të Parku Kombëtar
- 8.7 Komiteti i Menaxhimit të Parkut Kombëtar – Kompetencat e përgjithshme
- 8.8 Menaxhimi i Zonës A3
- 8.9 Parimet e delegimit
 - 8.9.1 Llojet e delegimit
 - 8.9.2 Përfitimet e përgjithshme nga delegimi
 - 8.9.3 Risqet e delegimit

- 8.10 Fondacioni i Ri.
- 8.10.1 Fluksi i fondeve dhe përgjegjësia për sitin
- 8.11 Menaxhimi i riskut
- 8.11.1 Plani i Menaxhimit të Riskut

9.0 VIZIONI

- 9.1 Qëllimet dhe Objektivat
- 9.1.1 Burimi Kulturor
- 9.1.2 Burimi Natyror
- 9.1.3 Drejtimi
- 9.1.4 Turizmi dhe Infrastruktura
- 9.1.5 Zhvillimi i komunitetit

10.0 PLANI I VEPRIMIT

- 10.1 Vrojtimet dhe vlerësimet arkeologjike

11.0 ZBATIMI dhe MONITORMI

- 11.1 Zbatimi
- 11.2 Monitorimi

SHTOJCA A Konventa e Trashëgimisë Botërore

SHTOJCA B Zhvillimi i Zonave të Mbrojtura

SHTOJCA C Konservimi i Zonës A3 dhe i monumenteve përreth

SHTOJCA D Habitatet dhe llojet kryesore

SHTOJCA E Fauna dhe flora

SHTOJCA F Censusi mbi shpendët e ujit të regjistruar në Shqipëri gjatë IWC 2020

Figurat

Figura 1: Harta e kufijve të zonave të mbrojtura brenda dhe përreth Shtetit të Trashëgimisë Botërore

Figura 2: Fokusi i Planit të Menaxhimit të Integruar dhe Planit të Biznesit siç përcaktohet në TeR

Figura 3: Harta e kufijve të zonave të mbrojtura brenda dhe përreth Shtetit të Trashëgimisë Botërore

Figura 4: Zgjerimi i mundshëm i STB-së për të përfshirë të gjithë Liqenin e Butrintit

Figura 5: Karakteristikat e peizazhit sipërfaqësor

Figura 6: Zonat ekzistuese të Parkut Kombëtar

Figura 7: Nënzonat ekzistuese të Parkut Kombëtar

Figura 8: Nënzonat e propozuara të Parkut

Kombëtar

Figura 9: Harta e Mbulesës bimore në PK Butrint

Figura 10: Nënzonat e propozuara të Parkut Kombëtar

Figura 11: Rritja e numrit vjetor të vizitorëve dhe të muajve të pikut

Figura 12: Rritja e parashikuar e numrit të vizitorëve 2018-2025

Figura 13: Skema e siteve kryesore të adresuar në këtë Plan të Menaxhimit të Integruar

Figura 14: Vendet kryesore të përmendura në tekst

Figura 15: Fazat e propozuara për qendrën e vizitorëve (Faza 1= e gjelbër; Faza 2= rozë)

Figura 16: Mundësitë që paraqiten në mbarë shtetin dhe itineraret e transportit

Figura 17: Shtigje të mundshme për shëtitje

Figura 18: Një strukturë menaxhimi e vetme e unifikuar?

Figura 19: Propozimet fillestare për Komitetin të Menaxhimit të ri të Parkut Kombëtar

Figura 20: Analiza kryesore krahasuese e strukturave të menaxhimit

Figura 21: Fondacioni i Ri, propozimet për anëtarët themelues

Figura 22: Fondacioni i Ri - përshtatjet kryesore

Figura 23: Fluksi kryesor i fondeve kapitale dhe të ardhurave

Figura 24: Përgjegjësia e përgjithshme dhe lëvrimi

Figura 25: Analiza e çështjeve për Butrintin e qëndrueshëm

Lista e shkurtesave kyçe

AAOF	Fondacioni Shqiptaro-Amerikan për Zhvillim
AdZM	Administrata Rajonale e Zonave të Mbrojtura
AKZM	Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura
CHwB	Trashëgimia Kulturore pa Kufij, Shqipëri
IA	Instituti i Arkeologjisë
ICCROM	Qendra Ndërkombëtare për Studimin e Ruajtjes dhe Restaurimit të Pasurisë Kulturore
ICOMOS	Këshilli Ndërkombëtar për Monumentet dhe Sitet
IKTK	Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore
IUCN	Unioni Ndërkombëtar për Konservimin e Natyrës
MBZHR	Ministria e Bujqësisë dhe e Zhvillimit Rural
MIE	Ministria e Infrastrukturës dhe Eneurgjisë
MK	Ministria e Kulturës
MTM	Ministria e Turizmit dhe e Mjedisit
P+P	Prince + Pearce Ltd
PMI	Plani i Menaxhimit të Integruar
Ramsar	Konventa Ramsar për Ligatinat me Rëndësi Ndërkombëtare
STB	Siti i Trashëgimisë Botërore
TeR	Termet e Referencës
UCL	University College London
UNESCO	Organizata e Kombeve të Bashkuara për Arsimin, Shkencën dhe Kulturën
VIU	Vlerë e Jashtëzakonshme Universale

1.0 PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Parku Kombëtar i Butrintit, i cili ndodhet 18 kilometra në jug të Sarandës, qytet në jug të Shqipërisë, zë një sipërfaqe të përgjithshme prej 9,424 hektarësh¹, e përbërë nga kodra, liqene, ligatina, kënetat të kripura, fusha të gjera, moçalishte dhe ishuj. Brenda tij është konfirmuar ekzistenca e 1,200 specieve të ndryshme kafshësh dhe bimësh. Në këtë sipërfaqe të Parkut Kombëtar përfshihet edhe Siti arkeologjik i Trashëgimisë Botërore të Butrintit. Veçoria e këtij Parku është kombinimi unik i pasurive kulturore dhe natyrore.



Figura 1: Harta e kufijve të zonave të mbrojtura brenda dhe përreth Siti të Trashëgimisë Botërore.

Parku Kombëtar përfshin Siti e Trashëgimisë Botërore. Të dy këto zona janë të ekspozuara ndaj dëmtimeve dhe, nëse keqmenaxhohen, integriteti i tyre mund vihet në rrezik në terma afatgjatë.

¹ Sipërfaqja i referohet kufijve ekzistues të Parkut Kombëtar të Butrintit sipas në VKM Nr. 495 datë 22.07.2014, "Për disa shtesa dhe ndryshime në VKM Nr. 693 datë 10.11.2005 për shpalljen e Kompleksit Ligatinor të Butrintit "Park Kombëtar".

Monitorimi dhe vënia nën kontroll i rreziqeve që mund të dëmtojnë këtë park janë objektivi kryesor i hartimit të Planit të Menaxhimit të Integruar.

Për shkak të natyrës mikse të Parkut, territorit ku shtrihet dhe përmasave të tij, gjatë viteve janë hasur vështirësi të ndryshme si të natyrës teknike, ashtu edhe asaj administrative.

Përsa i përket komponentit kulturor, proceset e konservimit, gërmimit arkeologjik në Zonën A3² duhet të ndjekin metodat dhe standardet e përcaktuara, siç është rekomanduar dhe nga Fondacioni Butrinti³, parimi kryesor i së cilave është mosçenimi i integritetit nga ndërhyrje të papërshtatshme apo të pakujdesshme. Përparësi është fakti që ekspertiza teknike dhe burimet akademike që disponohen janë prezent si në nivel vendor, ashtu edhe në atë kombëtar.

Për komponentin natyror, e rëndësishme është përmirësimi i kapaciteteve menaxhuese, shtimi i financimit të konservimit ekologjik për rritjen e performancës së Parkut Kombëtar të Butrintit. Megjithatë edhe për këtë komponent ka ekspertizë të gjerë dhe njohuri të konsoliduara lidhur me vlerat natyrore të parkut në nivel vendor edhe në atë kombëtar.

Vlera e Zonës A3 rrezikohet edhe gjatë muajve të verës, kur numri i vizitorëve arrin rreth 58.000 vetë. Për të mbajtur nën kontroll fluksin e vizitorëve dhe për të ofruar ambiente pritëse, orientuese dhe gjeneruese të ardhurash, në raport me rëndësinë e Sitit të Trashëgimisë Botërore, propozohet që, krahas rrugës hyrëse në Ksamil, të ndërtohet një qendër e re vizitorësh. Qendra e re do ofrojë edhe mundësi të tjera, siç është koordinimi për ecjet në natyrë dhe lundrimin me varkë në gjithë Parkun Kombëtar. Gjithashtu, propozohet dhe risia e përdorimit të transportit ekologjik, i cili do të mundësojë lëvizjen nga qendra e vizitorëve në hyrje të sitit, duke lehtësuar flukset e lëvizjes dhe duke shmangur shqetësimet e tjera të lidhura me shëndetin dhe sigurinë. Ndërhyrjet e tjera që propozohen për Zonën A3 do të përmirësojnë infrastrukturën ekzistuese dhe do të ofrojnë ambientet e reja të shërbimit.

Ligji i ri për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë Nr. 27/2018 parashikon mënyra të reja për administrimin e siteve kulturore në pronësi publike. Modeli i ri që propozohet për administrimin indirekt të Zonës A3, është themelimi i një fondacioni të posaçëm ndërmjet Ministrisë së Kulturës dhe partnerit strategjik, ku pasuria mbetet në pronësi të shtetit.

Fondacioni i Ri⁴, së bashku me anëtarët e Bordit të tij, pjesë e të cilës janë dhe autoritetet qeveritare, do të mundësojnë zbatimin e një programi të ri zhvillimi, i cili do të përmirësojë ndjeshëm mbrojtjen dhe promovimin e Zonës A3 dhe të gjithë Parkut Kombëtar. Me strukturën e re të menaxhimit, do të kemi një rritje trefish të stafit teknik, administrativ, mbështetës (rangers) për ruajtjen dhe monitorimin e veprimtarisë brenda Zonës A3. Strukturë tjetër e propozuar është Komiteti i ri i Menaxhimit të Parkut Kombëtar, një organ ndërministror nën drejtimin e ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore dhe mjedisin, dhe me anëtarë nga ministritë përgjegjëse për turizmin,

² Zona A3 i referohet nënzonave A3 të përcaktuara në VKM Nr. 495 datë 22.07.2014, "Për disa shtesa dhe ndryshime në VKM Nr. 693 datë 10.11.2005 për shpalljen e Kompleksit Ligatinor të Butrintit "Park Kombëtar".

³ Fondacioni Butrinti u themelua në vitin 1993 nga Lord Rothschild dhe Lord Sainsbury i Preston Candover, të cilët vazhdojnë të kontribuojnë në mënyrë aktive. Fondacioni synon të konservojë, ruajë dhe zhvillojë sitin e Butrintit dhe ka ofruar kontribut domethënës në ruajtjen e tij, si dhe në natyren e kërkimeve pas rënies së komunizmit në Shqipëri në vitin 1992.

⁴ Për qëllime të këtij punimi dhe për ta ndarë atë nga Fondacioni ekzistues i Butrintit, titulli i përkohshëm "Fondacioni i Ri" do të përdoret gjatë gjithë këtij dokumenti. Jemi të ndërgjegjshëm se nevojitet një emër më i përshtatshëm të paktën për qëllime të njohjes dhe markës në aspektin afatgjatë.

arsimin, punëve të jashtme, bujqësinë dhe zhvillimin rural, Fondacioni i Ri, përfaqësues të bashkive dhe komuniteteve lokale.

Së bashku, këto struktura do të kenë përgjegjësinë kolektive për përmbushjen e detyrave që rrjedhin nga vizioni i mëposhtëm:

Parku Kombëtar i Butrintit do të njihet si një model i menaxhimit të qëndrueshëm të siteve me elemente kulturore dhe natyrore, duke u bërë qendra e ofertës turistike rajonale, duke iu ofruar vizitorëve një përvojë unike, nëpërmjet angazhimit të komuniteteve lokale dhe institucioneve financiare duke shërbyer si model për parqe të tjera në Shqipëri.

Komunitetet lokale do të përfitojnë si në aspektin social edhe në atë ekonomik, falë ngritjes së kapaciteteve, trajnimit dhe mundësive të punësimit. Prodhimet artizanale duhet të tregtohen në pikat e reja të shitjes, ndërkohë që fshatrat e Vrinës, Shëndellisë dhe Xarës duhen vlerësuar për potencialin e tyre për të ofruar struktura të ndryshme turistike akomoduese dhe lehtësira të tjera, për krijimin e të ardhurave.

Ndër nismat e tjera që duhen ndërmarrë është ngritja e një grupi kërkimor të Butrintit që do të shërbejë në çuarjen përpara të dijes dhe kërkimit në të gjitha aspektet e trashëgimisë natyrore dhe kulturore, që lidhen me Parkun Kombëtar në tërësi.

Nisur nga arsyet e parashtruara më sipër, Fondacioni i Ri do të duhet të përfshihet në procesin e vendimmarrjes që prek Parkun Kombëtar të Butrintit.

Në mënyrë të përmbledhur, parimet kryesore që propozohen në Planin e Menaxhimit të Integruar mbështeten në 5 shtylla kryesore:

Burimi kulturor

- Ruajtja e integritetit dhe autenticitetit të vendit, nëpërmjet drejtimit të duhur, bazuar në praktikat më të mira, në mënyrë që vlerat e tij të qenësishme dhe ato me interes shkencor të ofrojnë një burim të qëndrueshëm për edukimin dhe turizmin, dhe një burim të krenarisë kombëtare.
- Zhvillimi më tej i potencialit turistik dhe edukues të sitit përmes programeve të vazhdueshme të kërkimit, gërmimit dhe konservimit.

Burimi natyror

- Hartimi dhe zbatimi i një programi të vazhdueshëm të monitorimit dhe restaurimit ekologjik, aty ku është e realizueshme dhe e përshtatshme, me qëllim gjetjen e të dhënave të domosdoshme për informimin e vendimmarrjes në të ardhmen.
- Vendosja e praktikave të qëndrueshme bujqësore dhe ato të akua-kulturës brenda Parkut Kombëtar të Butrintit. Për të siguruar përputhshmërinë dhe monitorimin e këtyre praktike, nevojitet hartimi i sërë nismash dhe rregulloresh.

Drejtimi dhe menaxhimi

- Ngritja dhe mbajta funksionale e një strukture të konsoliduar menaxhimi, me qëllim koordinimin efikas të të gjitha veprimtarive që ndikojnë në VJU-në e Sitit.
- Sigurimi i burimeve të mjaftueshme, për të mundësuar zbatimin e efektshëm të PMI-së.

Turizmi dhe infrastruktura

- Promovimi i formave të qëndrueshme të turizmit me bazë komunitetin lokal, që janë të ndjeshme ndaj mjedisit, të realizueshme në aspektin ekonomik dhe të drejta në aspektin social.
- Planifikimi dhe zhvillimi i territorit brenda Parkut Kombëtar në të ardhmen të marrin certifikimin e duhur për turizmin ekologjik, nga TIES (Shoqata Ndërkombëtare e Ekoturizmit) apo organe të ngjashme, që krahas praktikave të qëndrueshme operationale, i japin përparësi përdorimit të materialeve tradicionale vendase.

Zhvillimi i komunitetit

- Nxitja e ndërgjegjësimit, vlerësimit dhe kujdesit që duhet të tregojnë komunitetet lokale për burimet e Parkut Kombëtar.
- Shndërrimi i Parkut Kombëtar në një mjedis që nxit mësimin dhe edukimin për të gjitha moshat, duke ofruar përvoja reale për edukimin e thelluar mbi një shumëllojshmëri temash.
- Angazhimi i komuniteteve lokale dhe grupeve të interesit në një strategji të unifikuar të zhvillimit të komunitetit dhe në planin përkatës të veprimit.
- Rritja e përfaqësimit dhe përfshirjes efikase të bashkive dhe njësive administrative si dhe Këshillin e Qarkut në proceset e menaxhimit dhe vendimmarrjes.
- Forcimi i komunikimit me grupet e interesit rreth objektivave, strategjive, dhe planeve të zhvillimit.

Realizimi i vizionit që Qeveria Shqiptare ka për Butrintin, duke u mbështetur në parimet e mësipërme, do të arrihet përmes zbatimit të suksesshëm të tyre, të cilat janë të konkretizuara në një sërë aktiviteteve për secilën nga kategoritë, të përfshira në Kapitullin 10 - Plan i Veprimit.

2.0 HYRJE



2.0 HYRJE

Ministria e Kulturës (MK) nënshkroi një Memorandum Mirëkuptimi (MM) me Fondacionin Shqiptaro-Amerikan për Zhvillim (AADF) me qëllim që ky i fundit t'i ofronte asistencë MK-së në përgatitjen e një Planit Menaxhimi të Integruar (PMI) për Parkun Kombëtar të Butrintit.

Në kuadër të MM-së, Ministria dhe AADF-ja punuan së bashku në hartimin e PMI-së. Termat e Referencës (TeR) për PMI-në u hartuan nga MK dhe AADF dhe u miratuan nga organet kolegjiale në MK në zbatim të ligjit të ri për trashëgiminë kulturore. Termat e Referencës u konsultuan nga Qendra e Trashëgimisë Botërore përmes njërës prej organeve këshillimore të ICOMOS (Këshilli Ndërkombëtar i Monumenteve të Siteve) përpara shpalljes së tenderit të hapur ndërkombëtar.

Në tetor të vitit 2018, PRINCE+PEARCE Ltd (P+P), në bashkëpunim me Qendrën për Arkeologjinë e Aplikuar pranë Institutit të Arkeologjisë, në University College London (UCL) dhe Trashëgiminë Kulturore pa Kufij, Shqipëri (CHwB), u kontraktua nga Fondacioni Shqiptaro-Amerikan për Zhvillim (AADF), me miratim të Ministrisë së Kulturës, për të hartuar një Plan Menaxhimi të Integruar (PMI) për Parkun Kombëtar të Butrintit pas përfundimit të punës kërkimore⁵.




Figura 2: Fokus i Planit të Menaxhimit të Integruar dhe Planit të Biznesit siç përcaktohet në TeR⁶

⁵ Ekipi i konsulentëve i P+P përbëhej nga: Dr. David Prince (drejtues i ekipit), Simon Pearce (koordinatori i projektit) Dr. Richard Hodges (përgjegjës për konservimin arkeologjik), Dr. Daniel Laven (përgjegjës për konservimin ekologjik dhe biodiversitetin), Oliver Gilkes (përgjegjës për turizmin dhe infrastrukturën), Dr. Gai Jorayev (përgjegjës për hartëzimin digjital), Mirian Bllaci (përgjegjëse për angazhimin dhe edukimin e komunitetit), Lejla Hadzic (përgjegjëse për arkitekturën e konservimit), dhe Dr. Sarah McCarthy (përgjegjëse për mbështetjen e kërkimit).

⁶ Kjo hartë është vetëm treguese. Një nga qëllimet e punës aktuale është të paraqesë një përvijim të saktë të të gjithë kufijve, dhe rrjedhimisht të zonave, si pjesë e PMI-së.

Në mënyrë më të detajuar, objektivat e PMI-së synojnë sa më poshtë:

1. Paraqitjen e propozimeve për udhëzime, politika dhe procedura të qarta për menaxhimin efikas dhe të efektshëm të Parkut Kombëtar Butrint.
2. Krijimin e organit të ri menaxhues referuar ligjit për trashëgiminë kulturore për Zonën A3, duke përfshirë rekomandime për përfaqësim në Bord, kufizimet e Parkut lidhur me financimin e tij bazë, përshkrimin e burimeve të të ardhurave dhe investimeve të pritshme kapitale.
3. Hartimin e udhëzimeve dhe politikave, bazuar në praktikat më të mira për menaxhimin e integruar të vlerave kulturore dhe natyrore të Parkut.
4. Paraqitjen e propozimeve për mundësi të zhvillimit ekonomik brenda Parkut, duke përfshirë veprimtari turistike dhe çlodhëse, që i përshtaten më së mirë natyrës së sitit, Vlerës së tij të Jashtëzakonshme Universale (VJU) dhe vlerave të zonës Ramsar.
5. Propozimin e një strukture menaxhimi për funksionimin e Parkut Kombëtar Butrint.

Ky Plan është në përputhje me legjislacionin shqiptar, konventat e ndryshme ndërkombëtare të ratifikuara nga shteti shqiptar, si dhe bazuar në planet e mëparshme të menaxhimit të Butrintit; Plani i Menaxhimit (2007-2012) dhe raportit nga Shoqata për Ruajtjen e Shpendëve dhe Gjitarëve të Shqipërisë (SHRSHGJSH, 2010). Ky Plan identifikon fushat në të cilat nevojitet të punohet mbi bazën e prioritetit. Krahas çështjeve dhe politikave të reja të propozuara në këtë PMI, Plani i Veprimit evidenton edhe fushat ku nevojitet të bëhet ende progres.

Qëllimi i këtij Plani është shqyrtimi dhe dhënia e rekomandimeve për aspekte të ndryshme, si drejtimi, menaxhimi dhe mbrojtja e Parkut Kombëtar, peisazhi dhe veçanërisht Siti i Trashëgimisë Botërore të Butrintit, duke identifikuar nevojat e komunitetit lokal.

2.1 Kuadri ligjor

Hartimi i Planit të Menaxhimit të Integruar është bazuar në kuadrin e:

- Konventës për Trashëgiminë Botërore
- Përfshirjes së Butrintit dhe Parkut Kombëtar të Butrintit në listën e Trashëgimisë Botërore (UNESCO)
- Konventa për Ligatinat me Rëndësi Ndërkombëtare Veçanërisht si Habitata të Shpendëve Ujor (Konventa e Ramsarit)
- Legjislacionit shqiptar për Zonat e Mbrojtura mjedisore dhe trashëgiminë kulturore
- Zhvillimin e Zonave të Mbrojtura brenda Parkut Kombëtar të Butrintit që prej vitit 1992

2.1.1 Konventa për Trashëgiminë Botërore

Më 10 korrik 1989, Shqipëria ratifikoi Konventën për mbrojtjen e Trashëgimisë Botërore kulturore dhe natyrore. Detyrimet që burojnë si shtet palë në këtë Konventë përfshijnë edhe:

- Propozimin e pasurive të saj për t'u përfshirë në Listën e Trashëgimisë Botërore
- Monitorimin dhe mbrojtjen e Vlerës së Jashtëzakonshme Universale të objekteve të përfshira në listë, dhe monitorimin periodik të tyre
- Raportimin për gjendjen e konservimit të siteve pasuri botërore.

2.1.2 Përfshirja e Butrintit dhe e Parkut Kombëtar të Butrintit në listën e Trashëgimisë Botërore (UNESCO)

Rrethi i Sarandës, Qarku i Vlorës, Republika e Shqipërisë

N 390 45' 4" E 200 1' 34"

Data e përfshirjes: 1992

Zgjerimi: 1999

Viti i miratimit të modifikimit të kufijve: 2007

Kriteret: (iii)

Zona mbrojtëse: 8.591 ha

Ref: 570ter

2.1.3 Konventa e Ramsarit dhe shpallja e zonës Ramsar të Parkut

Në mars 2003 Butrinti shpallet "Zonë Ramsar" si pjesë e Konventës RAMSAR (nr. 1290 Wetlands International Reference: Nr. 3 AL002); zona totale e sitit 13 500 ha. Zona e Butrintit paraqet një larmishmëri dhe biodiversitet me vlera unike duke u bërë rajoni i dytë në Shqipëri, pas lagunës së Karavastasë, e përfshire në listën e Konventës së Ramsarit, ku vendi ynë është anëtar që nga viti 1995.

Zona e Butrintit përmbush në menyrë të veçantë katër kritere të përcaktuara në listën "Ramsar" që janë:

- karakteri unik i ligatinës
- numri i llojeve "globalisht të rrezikuar"
- niveli i lartë të biodiversitetit
- rëndësia e zonës për rezervat peshkore.

2.1.4 Konteksti ligjor shqiptar

Të gjitha politikat dhe rekomandimet në përmbajtje të këtij plani menaxhimi janë në përputhje me parimet e sundimit të ligjit në Republikën e Shqipërisë. Gjithashtu, legjislacioni i mëposhtëm përcakton kontekstin ligjor përkatës:

- Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim për periudhën 2015–2020 (SKZHI-II) (2015)
- Dokumenti i Politikave Strategjike për Mbrojtjen e Biodiversitetit në Shqipëri, Ministria e Mjedisit (2015)
- Strategjia Kombëtare për Kulturën për periudhën 2019–2025, Ministria e Kulturës
- Strategjia Kombëtare e Transportit dhe Plani i Veprimit, për periudhën 2016–2020, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (2016)
- Plani Kombëtar i Veprimit për Burimet e Energjisë së Rinovueshme për periudhën 2015–2020 (2016)
- Plani i Përgjithshëm Kombëtar – Shqipëri 2030, Ministria e Zhvillimit Urban, Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit (2016)
- Plani i Integruar Ndërsektorial për Bregdetin, Ministria e Zhvillimit Urban, Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit (2016)
- Strategjia Kombëtare për Zhvillimin e Turizmit 2017-2022 (draft), Ministria e Turizmit dhe Mjedisit (2018)
- Ligji Nr. 8905/2002 "Për mbrojtjen e mjedisit detar nga ndotja dhe dëmtimi" i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 30/2013"

- Ligji Nr. 9385/2005 "Për pyjet dhe shërbimin pyjor"
- Ligji Nr. 9587/2006, "Për mbrojtjen e biodiversitetit" i ndryshuar me Ligjin Nr. 37/2013
- Ligji Nr. 10006/2008 "Për mbrojtjen e faunës së egër"
- Ligji Nr. 10431/2011 "Për mbrojtjen e mjedisit"
- Ligji Nr. 10448/2011 "Për lejet mjedisore"
- Ligji Nr. 10463/2011 "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve"
- Ligji Nr. 111/2012 "Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore"
- Ligji Nr. 64/2012 "Për peshkimin"
- Ligji Nr. 10390/2011 "Për përdorimin e plehrave për bimët"
- Ligji Nr. 106/2016 "Për prodhimin biologjik, etiketimin e produkteve biologjike dhe kontrollin e tyre"
- Ligji Nr. 93/2015 "Për turizmin"
- Ligji Nr. 103/2016 "Për akuakulturën"
- Ligji Nr. 81/2017 "Për Zanat e Mbrojtura" (në veçanti nenet 42-50)
- Ligji Nr. 27/2018 "Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë"
- Vendim i Këshillit të Ministrave (VKM) Nr. 450, datë 01.07.1998 "Për administrimin e qytetit antik të Butrintit"
- VKM Nr. 82 datë 02.03.2000 "Për shpalljen Park Kombëtar në mbrojtje të shtetit të zonës arkeologjike të Butrintit"
- VKM Nr. 531 datë 31.10.2002 "Për shpalljen e kompleksit ligatinor të Butrintit dhe territorit përreth tij zonë natyrore në mbrojtje të veçantë dhe përfshirjen e tij në listën e ligatinave me rëndësi ndërkombëtare, në veçanti si habitat për shpendët ujorë"
- VKM Nr. 857 datë 19.12.2003 "Për miratimin e rregullores së funksionimit të Zyrës së Administrimit dhe Koordinimit të Parkut Kombëtar të Butrintit"
- VKM Nr. 693 datë 10.11.2005 "Për shpalljen e kompleksit ligatinor të Butrintit "Park Kombëtar"
- VKM Nr. 134 datë 20.02.2013, si shtesë e Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 693 datë 10.11.2005 "Për kufijtë e rinj të Parkut Kombëtar të Butrintit"
- VKM Nr. 495 datë 22.07.2014, "Për disa shtesa dhe ndryshime në VKM Nr. 693 datë 10.11.2005 për shpalljen e Kompleksit Ligatinor të Butrintit "Park Kombëtar"
- VKM Nr. 593 datë 09.10.2018 "Për përbërjen, funksionet, detyrat dhe përgjegjësitë e komiteteve të menaxhimit të zonave të mbrojtura"
- VKM Nr. 57 datë 06.02.2019 "Për kriteret dhe modalitetet për zonimin territorial brenda zonave të mbrojtura mjedisore"
- VKM Nr. 302 datë 10.05.2019 "Për kriteret e ushtrimit, miratimit dhe monitorimit të veprimtarive kërkimore-shkencore në zonat e mbrojtura mjedisore"
- Urdhër Nr. 148 datë 21.02.2013, "Për miratimin e strukturës së standardizuar të Planit të Menaxhimit të Zonës së Mbrojtur"

Planet e Përgjithshme Vendore për Konispolin dhe Sarandën (2017).

2.2 Zhvillimi i Zonave të Mbrojtura që prej vitit 1992

Qyteti Antik i Butrintit u shpall Siti i Trashëgimisë Botërore në vitin 1992, me Vendim Nr. 570 të Komitetit të UNESCO-s për Trashëgiminë Botërore (Figura 1). Siti me rrënojat e tij të periudhës klasike dhe periudhave të mëvonshme, të cilat ende qëndrojnë, shtrihet në vetëm 16 hektarë të gadishullit qendror. Harta e mëposhtme tregon gjendjen aktuale të zonave të mbrojtura brenda dhe përreth Sitit të Trashëgimisë Botërore. (Shtojca B "Zhvillimi i Zonave të Mbrojtura që prej vitit 1992")



Figura 3: Harta e kufijve të zonave të mbrojtura brenda dhe përreth Sitit të Trashëgimisë Botërore

2.3 Qasja dhe çështjet kyçe

Është vertetë e lehtë të mrekullohesh nga një sit si Butrinti. Ai është piktoresk në mënyrën më të përsosur, i pozicionuar në një peizazh madhështor natyror dhe detar, dhe plotësisht i aksesueshëm nga njeriu. Kjo e bën atë njëkohësisht tërheqës dhe të cënueshëm.

Për rrjedhojë, thelbi i çdo plani të suksesshëm menaxhimi është që siti të vazhdojë të jetë tërheqës, duke minimizuar në të njëjtën kohë rreziqet për cënimin e tij.

Kjo është qasja që është testuar në diskutimet e organizuara me grupet e shumta të interesit në nivel kombëtar, rajonal dhe vendor, si dhe me të gjithë anëtarët e ekipit të konsulentëve, për përcaktimin e vizionit të PMI-së. (referuar në nënseksion 2.5).

Të gjitha sitet historike, të çfarëdolloj madhësie apo natyre, përballen me çështje kontradiktore lidhur me aksesin dhe konservimin, veçanërisht kur fluksi i vizitorëve përqendrohet në pak muaj, siç është rasti i Butrintit. Ky problem është sa i thjeshtë, aq edhe i ndërlikuar: si të mbrojmë pasuritë kryesore të sitit, jo vetëm nga zhvillimet e shpejta, por edhe nga vetë vizitorët.

Njëkohësisht edhe problematika e rritjes së nivelit të detit nga ndryshimet klimatike globale, krahas shqetësimeve për ndotjen detare me mbetje plastike, megjithëse nuk është objekt i qëllimit të këtij Plani, reagimet ndaj këtyre sfidave në nivel vendor duhet të merren në konsideratë gjatë zbatimit të tij.

Ka ende debat ndërmjet ruajtjes së asaj që ekziston, që është e njohur, e pranuar dhe e kuptuar dhe asaj çka është akoma për t'u zbuluar, dhe nevojës për ta shfrytëzuar këtë burim për përfitime socio-ekonomike të komuniteteve lokale.

Një faktor tjetër, që vihet re në site të tjera si këto përgjatë Mesdheut Lindor dhe në vende të tjera, është ai i konservimit të asaj që ekziston ... në gjendjen që është ... me një formë të qasjes ndërhyrëse 'rindërtuese' ndaj monumentit dhe dhe peizazhit përreth. Kjo çështje kërkon studim të kujdesshëm dhe plane realiste, të zbatueshme dhe të qëndrueshme për të ardhmen.

Një plan menaxhimi që nuk merr në konsideratë të gjithë faktorët, mund të sjellë pasoja, që mund të shkaktojnë humbjen e vlerave kulturore dhe të identitetit, rënien ekonomike dhe shkatërrim të monumentit dhe mjedisit përreth. Këto pasoja janë parë edhe në site të tjera të ngjashme, dhe duhen shmangur në rastin e Butrintit.

Aktualisht, shumica e Siteve të Trashëgimisë Botërore janë të rrezikuara nga mirëmbajtja e pamjaftueshme ose e paplanifikuar mirë dhe ndërhyrjet e papërshtatshme, të cilat i izolojnë banorët lokal nga toka e tyre dhe kontribuojnë në shkatërrimin e sitit; shpesh, këta faktorë shoqërohen me mungesën e të menduarit strategjik dhe burimet e pamjaftueshme, si financiare ashtu edhe njerëzore.

Qasja për hartimin e Planit të Menaxhimit të Integruar për Sitin është bazuar gjerësisht në qëndrimin se pasuritë e trashëgimisë mund dhe duhet të jenë një faktor i rëndësishëm në mbështetjen e zhvillimit dhe prosperitetit, duke nxitur investimet dhe sipërmarrjen lokale.

Kjo kërkon që Plani të sigurojë mbrojtjen afatgjatë të sitit dhe pasurive të tij kulturore dhe natyrore si dhe një të ardhme dinamike, konkurruese dhe tërheqëse. Gjithashtu, kjo nënkupton se planet duhet të kenë ndikim të madh, të jenë krijues dhe të guximshëm në qasjen e tyre.

Prandaj, fokusi i këtij plani qëndron në gjetjen e ekuilibrit mes nevojave të dukshme të sitit, lidhur me konservimin e tij, dhe nevojave e aspiratave afatgjata të njerëzve që do të kujdesen për të.

Përfundimisht, në mënyrë që Plani i Menaxhimit të Integruar të arrijë të japë rezultatet e pritshme, nevojitet angazhimi i të gjitha palëve: komuniteteve lokale, turistëve, financuesve të tij, drejtuesve të rinj dhe agjencive qeveritare, të cilat janë ngarkuar me përgjegjësinë për të punuar bashkërisht me mirëkuptim drejt arritjes së qëllimit të përbashkët.

2.4 Parimet orientuese

Vizioni, synimet dhe objektivat përfshihen në Kapitulli 9.0, dhe paraprijnë Planin e Veprimit (Kapitulli 10.0), me të cilin lidhen në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe specifike. Shkurtimisht, parimet orientuese mbi të cilat është mbështetur hartimi i Planit të Menaxhimit të Integruar janë si më poshtë:

- Mbrojtja dhe ruajtja e Vlerës së Jashtëzakonshme Universale të Sitit të Trashëgimisë Botërore dhe strukturës së saj, për brezat e sotëm dhe të ardhshëm.
- Mbrojtja dhe ruajtja e vlerave natyrore të Parkut Kombëtar për brezat e sotëm dhe të ardhshëm.
- Mbështetja dhe menaxhimi i mirë i STB-së.
- Ofrimi i një përvoje të sigurt dhe të kënaqshme për vizitorët, e cila nuk e cenon Vlerën e Jashtëzakonshme Universale të Sitit.
- Ndërgjegjësimi i publikut për Parkun Kombëtar të Butrintit dhe statusin e tij si STB.
- Përfshirja e komuniteteve lokale për t'iu mundësuar gëzimin e përfitimeve më të mëdha nga STB-ja dhe Parku Kombëtar.
- Shndërrimi i Parkut Kombëtar në një mjedis që nxit mësimin dhe edukimin për të gjitha moshat, duke ofruar përvoja për të studiuar në mënyrë të thelluar mbi një shumëllojshmëri temash dhe të bazuar në realitet.

Qëllimi i këtyre synimeve dhe objektivave është në përputhje me vizionin:

Parku Kombëtar i Butrintit do të njihet si lider botëror në menaxhimin e qëndrueshëm të siteve me elemente kulturore dhe natyrore, duke u bërë qendra e ofertës turistike rajonale, duke iu ofruar vizitorëve një përvojë unike, nëpërmjet angazhimit të komuniteteve vendase dhe institucioneve financiare për të vepruar si model për parqe të tjera në Shqipëri.

2.5 Një strukturë e re menaxhuese

Menaxhimi i trashëgimisë kulturore dhe i siteve arkeologjike, si dhe mënyra se si të bëhen të aksesueshme për publikun, veçanërisht për Sitet e Trashëgimisë Botërore, ka pësuar shumë ndryshime gjatë dy dhjetëvjeçarëve të fundit.

Nga një qasje e orientuar kryesisht nga konservimi, ka ndryshuar në një qasjeje ku vlerat që lidhen me peizazhin, historinë, trashëgiminë kulturore materiale dhe jomateriale, luajnë rolin e tyre kryesor në çështjet mjedisore dhe modelet e planifikimit. Këto ndryshime kanë mundësuar krijimin e një grupi përfituesish dhe palësh interesimi më të gjerë.

Për herë të parë, ndikimet në popullsinë vendase konsiderohen padyshim po aq të rëndësishme sa edhe ndikimet në vetë sitin historik.

Të gjitha planet e menaxhimit dhe ato të biznesit kanë nevojë për orientim dhe mbështetje, për financime dhe elemente të tjera, dhe mënyra e zotërimit dhe realizimit është mjete kryesor për garantimin e zbatimit dhe vijimësisë së këtyre planeve në terma afatgjatë. Prandaj, integrimi i elementeve të mësipërm është një aspekt themelor i propozimeve për Butrintin.

Duke marrë parasysh sa më sipër, lind nevoja për një strukturë të re drejtimi dhe menaxhimi, të mbështetur nga rojtarë (rangers) të sitit të pajisur me mjetet e duhura, ekspertë të mjedisit dhe komunitetit. Të gjithë këta persona janë në dispozicion dhe shumë prej tyre kanë dëshirë të angazhohen. Gjatë punës kërkimore, anëtarët e ekipit janë takuar me shumë prej tyre.

Butrinti mundet dhe duhet të jetë modeli që do të frymëzojë projekte të tjera të ngjashme. Ky duhet të jetë qëllimi dhe trashëgimia e tij për brezat e ardhshëm. Për ta siguruar një gjë të tillë, qeveria ka miratuar legjislacionin kombëtar përkatës.

2.6 Konsultimi

Në kuadrin e hartimit të Planit të Menaxhimit të Integruar të Parkut Kombëtar të Butrintit, janë organizuar takime këshillimi me një sërë grupesh interesi dhe palësh të interesuara. Gjatë procesit të konsultimit me të gjitha palët e interesit, vëmendje e veçantë iu kushtua përfshirjes së një sërë bashkëbiseduesish me formime dhe me interesa të ndryshme lidhur me Butrintin, të gatshëm për të diskutuar në mënyrë transparente dhe konstruktive mbi përvojat, opinionet dhe aspiratat e tyre.

Aktiviteti i parë u përqendrua në prezantimin e qasjes së propozuar nga konsulenti për përgatitjen e Planit të Menaxhimit të Integruar, gjatë paraqitjes publike të projektit në Tiranë, më 3 tetor 2018. Më 6 tetor 2018, në Sarandë, u organizua një seminar me palët e interesit. Të dyja këto aktivitete mundësuan përgatitjen e një liste fillestare me palët kombëtare dhe lokal të interesit, ku u shtuan edhe persona të tjerë që ishin përfshirë në planet e mëparshme të menaxhimit dhe në dokumentet e tjera strategjike për Butrintin.

Përgatitja e këtij Plani Menaxhimi u mundësua falë kontributeve të shumë individëve. Gjithsej, mbi shtatëdhjetë e pesë persona ofruan njohuri dhe përvojën e tyre. Rëndësi të veçantë pati diskutimi me agjencitë qeveritare dhe ministrinë si më poshtë:

- Zyra për Administrim dhe Koordinim të Parkut Kombëtar të Butrintit
- Ministria e Kulturës
- Ministria e Turizmit dhe Mjedisit
- Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural
- Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë
- Instituti i Monumenteve Kulturore
- Instituti i Arkeologjisë
- Universiteti i Tiranës
- AKZM – Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura
- AdZM Vlorë – Administrata Rajonale e Zonave të Mbrojtura Vlorë

U zhvilluan seminare, takime dhe intervista me përfaqësues të bashkive të Sarandës, Konispolit dhe Finiqit, kryeqendër të fshatrave të Vrinës, Shëndellit, Xarrës dhe Mursit, si dhe grupe të tjera. Do të nevojiten edhe takime të tjera në të ardhmen për të:

- Informuar ata për mundësitë dhe çështjet e mbartura lidhur me Parkun Kombëtar në periudhën afatmesme dhe afatgjatë

- Nxitur të kuptuarit e nevojave dhe interesave të tyre
- Identifikuar rolet dhe përgjegjësitë përkatëse
- Vlerësuar kërkesat për ngritjen e kapaciteteve
- Planifikuar programet e nevojshme për edukimin dhe trajnimin.

2.6.1 Menaxhimi i procesit të konsultimit me palët e interesit

Në vijim të një analize të thelluar të interesave të palëve të interesuara për projektin, u organizuan rregullisht takime individuale me përfaqësues të organeve të qeverisjes qendrore, që janë përgjegjëse për Parkun Kombëtar të Butrintit, duke përfshirë Ministrinë e Kulturës, Institutin Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore si dhe Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit së bashku me Agjencinë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura (AKZM).

U organizuan takime edhe me përfaqësues të bashkive, të cilat u përqendruan kryesisht në angazhimin e personave lokal me ndikim, kryepleqve dhe vendimmarrësve në fushën e turizmit të qëndrueshëm, mjedisit dhe zhvillimit ekonomik në këtë proces. Vëmendje e veçantë iu kushtua edhe angazhimit në dialog të komuniteteve lokale, që jetojnë përreth ose brenda Parkut Kombëtar, nëpërmjet takimeve të drejtpërdrejta me banorët ose takimeve me kryepleqtë e fshatrave dhe/ose administratorët e njësive.

Qëllimi i këtij procesi është përfshirja e një game sa më të gjerë përfituesish të drejtpërdrejtë dhe atyre personave me ekspertizë të veçantë lokale (shoqëri turistike dhe udhërrëfyes turistikë, që kanë lidhje me burimet kulturore dhe natyrore, fermerë lokal, aktivistë të mjedisit dhe zejtarë lokal), për t'iu kërkuar këshilla mbi identifikimin e problematikave aktuale dhe zgjidhjeve të mundshme. Gjithashtu, ky proces synonte që të gjitha palët të kuptonin në të njëjtën mënyrë dhe të binin dakord me parimet e përgjithshme dhe mekanizmat e koordinimit, të propozuara për Planin e Menaxhimit të Integruar.

Procesi i konsultimit të palëve të interesit përfshinte edhe përfaqësues të universiteteve dhe akademikëve të spikatur në fushat e arkeologjisë, menaxhimit të trashëgimisë kulturore, ekologjisë dhe mjedisit, që kontribuuan në identifikimin e problematikave parësore dhe zgjidhjeve që duheshin marrë parasysh.

2.6.2 Grupet e nënpërfaqësuar pjesërisht dhe ato të vështira për t'u arritur

Pjesëmarrja dhe përfshirja e palëve dhe grupeve të interesit ishte mjaft e dobishme dhe e frytshme. Megjithatë, ky proces nxori në pah nevojën për konsolidimin e pjesëmarrjes së komuniteteve lokale në fazën e zbatimit të Planit të Menaxhimit të Integruar.

Ky grup heterogjen palësh përbëhet kryesisht nga banorë lokal të fshatrave Shëndelli, Vrinë, Xarrë dhe Ksamil. Megjithëse janë organizuar konsultime me personat përgjegjës nga bashkitë përkatëse dhe përfaqësuesit vendorë, siç janë kryepleqtë e fshatrave, duhet të synohet pjesëmarrje më aktive e banorëve lokal në konsultimet me publikun e gjerë gjatë fazës së zbatimit.

Me qëllim trajtimin e suksesshëm të këtyre nevojave, shihet si i nevojshëm caktimin e një personi përgjegjës për ndërlidhjen me komunitetin, i cili do të përfaqësojë dhe do të ndërveprojë me komunitetet lokale gjatë dhe ndërmjet takimeve që do të mbahen rregullisht me to.

Identifikimi i përfaqësuesve të subjekteve private, që ushtrojnë veprimtari ose janë licensuar për aktivitetet e peshkimit dhe akuakulturës në Parkun Kombëtar, ka qenë e vështirë. Kjo për shkak se skema aktuale e licencimit për peshkimin për të gjithë Parkun Kombëtar të Butrintit është në fazë

rivlerësimi nga Qeveria e Shqipërisë. Për të shmangur rrezikun e nënvlerësimit të nevojave dhe potencialit të këtij grupimi specifik, u ndërmor një dialog me përfaqësuesit e lartë të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe Drejtorisë së saj të Peshkimit.

Palët e interesit, që do të preken ose që kanë detyrime që rrjedhin nga politikat dhe rekomandimet e kësaj PMI-je, do të konsultohen para fazës së zbatimit. Një rekomandim për drejtuesit është hartimi i një Strategjie të Zhvillimit të Integruar të Komunitetit, si dhe caktimin e një personi përgjegjës për angazhimin e komunitetin si pjesë e ekipit të menaxhimit për koordinimin dhe nxitjen e marrëdhënieve me komunitetet.

Mekanizmat e angazhimit do të përfshijnë:

- një program të informimit publik,
- një program tremujor takimesh me komunitetin, i cili më vonë do të kthehet në mjet dhe forum për shkëmbimin e pikëpamjeve dhe ndarjen e informacioneve.

2.7 Praktikak më të mira

Në përgjithësi 'praktikat më të mira', mund të përkufizohen duke njohur aftësinë e organizatës për të ekuilibruar cilësitë dhe praktikak e saj unike, me çka ka të përbashkët me organizata të ngjashme. Rrjedhimisht, është më se e arsyeshme që të merren në konsideratë shembuj të praktikës më të mirë nga vende të tjera ('standard bazë') në mënyrë që sipërmarrjet dhe ndërhyrjet e tyre të suksesshme të mund të frymëzojnë procesin në fjalë. Në rastin e Butrintit, ato mund të përfshijnë konservimin arkeologjik, menaxhimin e vizitorëve, menaxhimin mjedisor, interpretimin dhe angazhimin e komunitetit.

2.7.1 Modelet e aplikuara në hartimin e Planit të Menaxhimit të Integruar

Shpallja e Butrintit si Sit i Trashëgimisë Botërore, Park Kombëtar dhe Zonë Ramsar do të thotë që menaxhimi dhe zhvillimi i ardhshëm i tij duhet të respektojë disa standarde të pranuar ndërkombëtarisht. Ku ndër të tjera përmendim: Konventën e UNESCO-s (1972) për mbrojtjen e trashëgimisë botërore natyrore dhe kulturore, Konventën e Ramsarit për Ligatinat, rekomandimet e Qendrës së Trashëgimisë Botërore (UNESCO) përmes organeve këshillimore të saj ICOMOS, ICCROM, IUCN. Këto, jo vetëm që theksojnë domethënien dhe rëndësinë ndërkombëtare të Butrintit, por njëkohësisht ofrojnë një sërë parimesh udhëzuese që përdoren si modele për mbrojtjen, konservimin, prezantimin dhe shfrytëzimin e qëndrueshëm të vendeve të tilla në mbarë botën.

Udhëzimet Operacionale për Sitet e Trashëgimisë Botërore është një dokument orientues për zbatimin e Konventës së Trashëgimisë Botërore të UNESCO-s, të cilën Shqipëria e ka ratifikuar në vitin 1989.

Krahas këtij dokumenti dhe planeve të mëparshëm të menaxhimit të Butrintit, jemi bazuar në planet strategjike të siteve të mëposhtme:

- STB Stounhenxh, MB
- STB Qyteti i Bath, MB
- STB Giants Causeway, MB
- STB Muri i Hadrianit, MB
- Parku Kombëtar Detar Karaburun-Sazan, Shqipëri

- STB Manastiri Gelati, Gjeorgji
- STB Qendra historike e Napolit, Itali.

Këto standarde kanë ofruar parimet mbi të cilat jemi mbështetur për të gjitha propozimet për Parkun Kombëtar të Butrintit, siç janë parashtruar në Planin e Menaxhimit të Integruar, si dhe në strukturën e vetë Planit, duke përfshirë dhe formatin e Planit të Veprimt dhe kuadrin e monitorimit, në veçanti. Për të gjitha aspektet, ekipi është bazuar në shembuj të praktikës më të mirë nga mbarë bota, duke përfshirë dhe konservimin e rrënojave arkeologjike dhe peizazheve ekologjike, menaxhimin e vizitorëve brenda dhe rreth Parkut dhe mënyrën se si do të drejtohet, menaxhohet dhe financohet.

Site të Trashëgimisë Botërore me vlera të integruara kulturore dhe natyrore

Ndërkohë që STB e Parkut Kombëtar të Butrintit njihet për vlerat e veta kulturore të jashtëzakonshme, ekziston mundësia që të shpallet si një "Sit Miks", i cili do të njihte edhe vlerat e tij të jashtëzakonshme natyrore. Kjo do ta vendoste Butrintin në të njëjtën kategori me site mikse, të njohura në rang botëror të tilla si:

- Meteora dhe Mali i Atosit, Greqi
- Mali Perdu, Pirene, Francë
- Qyteti Antik i Majave dhe Pyjet e Mbrojtura Tropikale të Çalakmulit, Kampeçe, Meksikë
- Trashëgimia Kulturore dhe Natyrore e Rajonit të Ohrit, Maqedoni e Veriut
- Ibiza, Biodiversitet dhe Kulturë, Spanjë
- Parku Kombëtar Göreme dhe Sitet Shkëmbore të Kapadokias, Turqi
- Tempulli Historik i Maçu Piçus, Peru.

Drejtimi

Lidhur me aspektin e drejtimit, janë përdorur modele të Siteve të Trashëgimisë Botërore në pronësi të përbashkët (private, publike dhe jofitimprurëse) në kontekstin e krijimit dhe financimit të një organizate të re jofitimprurëse, që do të marrë përsipër menaxhimin dhe zhvillimin e sitit, ku shteti mban pronësinë e sitit. Shembuj specifikë përfshijnë:

- **Stounhenxh** (një vlerë kulturore shtetërore, për të cilën janë bërë marrëveshje të shumta mbi pronësinë e tokës, duke përfshirë dhe organizatën jofitimprurëse "National Trust" (Autoriteti Kombëtar për Ruajtjen e Vendeve me Interes Historik dhe Bukuri Natyrore))
- **Kulla e Londrës** (një pasuri e Kurorës, që ruhet në mirëbesim nga Madhëria e saj, Mbretëresha, në emër të kombit, dhe që menaxhohet nga organizata jofitimprurëse Historic Royal Palaces charity (Pallatet Historike Mbretërore)
- **Versajë** (një Monument Historik në pronësi të Shtetit Francez dhe i mbikëqyrur nga Ministria e Kulturës, me administrim dhe menaxhim financiar të pavarur)
- **Qyteti romak i Pompeit** (në pronësi të Shtetit Italian; objekt i një projekti konservimi afatgjatë në mbarë sitin, i mbështetur nga një konsorcium financuesish privatë, universitetesh dhe shoqërisht, dhe që ofron një program vjetor për shkolla verore rreth teknikave të konservimit arkeologjik)
- **Shërbimi Kombëtar i Parqeve të SHBA-së** ka ofruar modelet e praktikave më të mira të menaxhimit të parqeve kombëtare, duke përfshirë dhe rolin dhe përgjegjësitë e rojtarëve, menaxhimit të vizitorëve dhe teknikave të interpretimit, partneriteteve publike-private (për

hotele, hostele, restorante dhe kampe) dhe rolin, pozicionimin dhe përdorimin e qendrave të vizitorëve.

Konservimi

Konservimi ka për qëllim të nxjerrë në pah rëndësinë e trashëgimisë kulturore, duke ruajtur sa më shumë të jetë e mundur historinë e plotë të sitit, nëpërmjet konsolidimit të stratigrafisë së tij. Parimet e konservimit që janë zbatuar në Butrint, synojnë konservimin dhe konsolidimin e rrënojave në sit pa ndërmarrë ndërhyrje rikonstruktuese apo restauruese, me përjashtim të disa ndërhyrjeve të vogla për të ruajtur qëndrueshmërinë e strukturave dhe për të garantuar sigurinë e vizitorëve, duke përdorur sa më shumë që të jetë e mundur elemente origjinale arkitekturore.

Aspekt i rëndësishëm i planit të konservimit ishte dhënia përparësi e detyrave të mëposhtme:

- përfundimi i punimeve të prapambetura, për shkak të mungesës së ndërhyrjeve të konservimit gjatë viteve të fundit
- hartimi i një kalendarit të qëndrueshëm mirëmbajtjeje dhe me kosto të mirëpërcaktuara për të gjitha elementet e sitit, duke përfshirë dhe ato që mund të lindin nga ndërhyrjet e konservimit.

Bazë për qasjen e propozuar të konservimit përbëjnë:

- Parimet e përcaktuara nga Konventa për Mbrojtjen e Trashëgimisë Arkeologjike të Evropës (e rishikuar) (Valea, 1992); të cilën Shqipëria e ka ratifikuar në vitin 2008.
- Zbatimi i një plani plotësisht të integruar dhe plani konservimi të ndarë në faza, siç sugjerojnë parimet e konservimit të ICOMOS (karta të ndryshme), dhe i përgatitur nga arkitekti i konservimit të projektit, me mbështetjen e arkeologut dhe konservuesit të sitit.
- Parimet, Politikat dhe Udhëzimet e Konservimit nga *Historic England* (e cila parashton gjashtë qasje kyçe).

Menaxhimi i vizitorëve dhe kapaciteti mbajtës

Menaxhimi i vizitorëve është aspekt thelbësor për qëndrueshmërinë e Butrintit si një destinacion ndërkombëtar turizmi. Të gjitha Sitet e Trashëgimisë Botërore duhet të arrijnë të gjejnë një ekuilibër midis aksesit të publikut dhe ruajtjes së burimeve arkeologjike dhe natyrore, që përbën sfidë të madhe. Propozimet për menaxhimin e vizitorëve në Butrint përfshijnë një qendër të re vizitorësh, transport ekologjik si autobusët dhe varkat elektrike, si dhe shtigje (duke përfshirë dhe shtegkalimet) dhe tabela informuese. Këto propozime janë bazuar në ndërhyrjet infrastrukturore për vizitorët të ndërmarra nga Sitet më të vizituara të Trashëgimisë Botërore, të cilat vetë autorët e PMI-së i kanë vizituar, si më poshtë:

- STB Stounhenxh, MB
- STB Muri i Hadrianit, MB
- Zonat Arkeologjike të Pompeit dhe Herkulaneum, Itali
- Parku Kombëtar Everglades, Florida
- Parku Kombëtar Yosemite, Kaliforni

Zhvillimi i komunitetit, menaxhimi ekologjik, edukimi dhe trajnimi

Komunitetet që jetojnë brenda dhe rreth Siteve të Trashëgimisë Botërore kanë një interes të ngushtë lidhur me vlerat natyrore dhe kulturore, ndaj zhvillimi shoqëror dhe ekonomik duhet të mbështetet nga drejtuesit me pikësynim mirëqenien, edukimin, trajnimin dhe punësimin. Praktikave qëndrueshme bujqësore në Butrint duhen nxitur dhe forcuar, për të mundësuar rivendosjen e rendit ekologjik dhe të biodiversitetit. PMI-ja është mbështetur në disa nga shembujt botërorë të praktikave më të mira në sitet e mëposhtme, të administruara nga Shërbimi Kombëtar i Parqeve të SHBA-së (ku një prej autorëve të këtij Plani ka punuar më parë):

- Parku Kombëtar Historik Marsh-Billings-Rockefeller, Vermont
- Zona e Trashëgimisë Kombëtare të Lumit Cane, Luiziana
- Korridori i Partneritetit të Trashëgimisë Kombëtare *Delaware-Lehigh*, Delaueer
- *Blackwater Heritage State Trail* (Shtegu i Trashëgimisë Shtetërore), Florida.

Procesi i identifikimit të praktikës më të mirë nuk mbaron kurrë. Megjithatë, me arritjen e disa standardeve, organizata duhet të jetë e gatshme të vendosë synime të reja, duke bërë përpjekje të vazhdueshme për t'u përmirësuar. Për shembull, standardet e përcaktuara për Butrintin lidhur me konservimin arkeologjik duhet ta kthejnë atë në një model të praktikës më të mirë, veçanërisht në rajonin e Mesdheut Lindor. Por, drejtuesit e Butrintit duhet të përpiqen të vendosin standarde të reja, siç është synimi për arritjen e nivelit neutral të karbonit, ose ndoshta nëpërmjet regjistrimit të peizazheve të tij antike me mjete dhe mënyra jondërrhyrëse, të cilat i bëjnë këto peizazhe reale dhe kuptimplota për turistët dhe banorët lokal.

Koncepti i praktikës më të mirë është përdorur gjerësisht në fushën e menaxhimit mjedisor, dhe është me shumë rëndësi për Butrintin. Për shembull, ky koncept është përdorur në akuakulturë, me rekomandimin e vazhdueshëm për përbërës ushqimorë me nivel të ulët fosfori, në pylltarinë për menaxhimin dhe ruajtjen e zonave mbrojtëse bregdetare, dhe në menaxhimin e bagëtive dhe kullotave për rregullimin e normave të kullotjes.

Më konkretisht, ky koncept është përqendruar në cilësinë e ujit dhe ajrit, si reduktimi i plehrave kimike dhe identifikimi e miratimi i praktikës më të mirë për kontrollimin e krupësisë, si dhe reduktimi i shkarkimeve të dëmshme të automjeteve.

Megjithatë, këto qasje, ashtu si në rastin e Butrintit, janë gjithmonë të veçanta për kontekstin dhe shpesh shoqërohen me polemika, për shkak të mungesës së njohurive të thelluara dhe të dhënave sasiore. Në raste të tilla, mbase do të ishte më e dobishme që praktikën më të mirë ta mendojmë si një proces nga i cili do të mësojmë, dhe jo si një sërë rregullash apo udhëzimesh. Kjo qasje, e rekomanduar për Parkun Kombëtar, përqendrohet në nxitjen e përmirësimeve graduale të cilësisë në të gjitha fushat, dhe në promovimin e të nxëniet të vazhdueshëm; rrjedhimisht, theksi në këtë PMI vendoset mbi angazhimin dhe përfshirjen e komunitetit.

Në mbështetje të të gjitha këtyre përpjekjeve për krijimin e praktikës më të mirë, duhet të informohemi për nisma dhe metoda që kanë rezultuar të suksesshme në vende të tjera. Kjo nënkupton që Fondacioni i Ri edhe Komiteti i Menaxhimit i propozuar i Parkut Kombëtar duhet të angazhohen në mënyrë aktive në programin e vazhdueshëm dhe të qëndrueshëm të mbledhjes së të dhënave dhe informacionit, për të gjithë faktorët që lidhen me Zonën A3 dhe mbarë Parkun Kombëtar. Sigurisht, Grupi Kërkimor i Butrintit mund të ndihmojë në këtë aspekt, por rolin udhëheqës duhet ta kenë organizatat e menaxhimit të përfshira.

Strategjia e Ngritjes së Kapaciteteve të Trashëgimisë Botërore, e miratuar nga Komiteti i Trashëgimisë Botërore, në vitin 2011, harton materiale burimore si raste studimore të praktikës më të mirë dhe mjete komunikimi, si dhe shtypa për organizatat qeverisëse dhe menaxherët e sitit, për të reflektuar mbi praktikën e tyre të menaxhimit dhe për të parë mundësi të reja për përmirësim. Praktikën e suksesshme dhe të qëndrueshme të menaxhimit mund të përfshijnë gjithçka, që nga angazhimi i banorëve lokal në menaxhimin e sitit deri në hartimin e politikave të reja dhe rregullimin e turizmit.

Lidhur me rekomandimet specifike, në seksionet përkatëse të këtij Plani Menaxhimi jepen shembuj të parqeve të tjera kombëtare dhe Siteve të Trashëgimisë Botërore si praktikë më të mira.

2.0 Hyrje – Pika kyçe

- Në vitin 1992, Qyteti Antik i Butrintit u shpall Sit i Trashëgimisë Botërore.
- Thelbi i çdo plani të suksesshëm menaxhimi është që siti të vazhdojë të jetë tërheqës, duke minimizuar në të njëjtën kohë edhe rreziqet për çënimin e tij.
- Pasuritë e trashëgimisë mundet, dhe duhet, të jenë një faktor domethënës në mbështetjen e rritjes dhe prosperitetit ekonomik duke nxitur si investimet, ashtu edhe sipërmarrjen lokale.
- Të gjitha planet e biznesit dhe menaxhimit kanë nevojë për pronësi, orientim dhe mbështetje për të siguruar që këto plane do të zbatohen dhe mirëmbahen në terma afatgjatë.
- U realizuan takime dhe seminare konsultative me një numër të madh aktorësh dhe palësh interesi gjatë fazës së punës kërkimore për Planin e Menaxhimit të Integruar.
- Janë shqyrtuar shembujt e praktikës më të mirë lidhur me drejtimin, vlerat e trashëgimisë kulturore, konservimin arkeologjik, menaxhimin e vizitorëve, menaxhimin mjedisor, interpretimin dhe angazhimin e komunitetit.
- Butrinti duhet të jetë modeli që do të frymëzojë projekte të tjera të ngjashme dhe për ta siguruar një gjë të tillë, qeveria ka miratuar legjislacionin kombëtar përkatës.

3.0 PARKU KOMBËTAR I BUTRINTIT



3.0 PARKU KOMBËTAR I BUTRINTIT

"Më lër të të them se Butrinti është për Korkyrën (Korfuzin), ashtu siç është Antiumi për Romën – vendi më i qetë, më i këndshëm dhe më i bukur në botë" -Letër e Ciceronit drejtuar Atikusit 4.8.1 (viti 56 para Krishtit).

Butrinti është një ndër peizazhet botërore të jashtëzakonshme, siç dëshmohet nga përcaktimet e tij si Siti i Trashëgimisë Botërore (1992; 1992), si Park Kombëtar (2000; 2005; 2013) dhe si Zonë Ramsar (2003).

Përmendur për herë të parë në filozofinë perëndimore në poemën epike Eneida, të Virgjilit, rreth vitit 25 para Krishtit, Butrinti është banuar për të paktën 12,000 vjet, ose për rreth 500 breza. Siti është një perlë e padiskutueshme e mozaikut të siteve arkeologjike të rëndësishme në nivel ndërkombëtar, i cili kontribuon në përcaktimin e historisë së Mesdheut dhe të botës perëndimore.

Si i tillë, siti ka qenë për vite me radhë në qendër të një sërë studimesh arkeologjike, historike dhe ekologjike, të cilat së bashku kanë ndërtuar një literaturë të pasur, të besueshme dhe të vërtetuar nga studiues të tjerë për sitin dhe zonën rreth tij.

3.1 Vlera e Jashtëzakonshme Universale

I pozicionuar në jug të Shqipërisë, rreth 20 km nga qyteti i Sarandës, Butrinti ofron një mjedis të veçantë, të ngritur midis arkeologjisë, monumenteve dhe natyrës mesdhetare. Së bashku me zonën rreth tij, përbën një peizazh kulturor të jashtëzakonshëm, që është zhvilluar organikisht për shekuj të tërë. Butrinti i ka shpëtuar zhvillimit të pakontrolluar, që në rajonin e Mesdheut ka ulur vlerën e trashëgimisë së peizazheve më historike. Butrinti është vendi ku bashkekzistojnë arkeologjia dhe natyra. Ky aset është një mikrokozmos i historisë mesdhetare, ku sipas të dhënave më të hershme, popullimi i tij daton që nga vitet 50,000 para Krishtit, dhe vijon deri në shekullin XIX pas Krishtit.

Janë identifikuar site parahistorike brenda qendrës së Butrintit, kodrës së vogël të rrethuar nga ujërat e Liqenit të Butrintit dhe Kanalit të Vivarit, si dhe në mbarë territorin e tij. Duke filluar nga viti 800 para Krishtit deri në mbërritjen e romakëve, Butrinti qe nën ndikimin e kulturës greke, duke ruajtur elementet e një qyteti tipik "polis", i banuar nga fiset e kaonëve. Në vitin 44 para Krishtit, Butrinti u kthye në koloni romake dhe territori i tij u zgjerua ndjeshëm deri në moçalishten e bonifikuar, fillimisht deri në jug përtej Kanalit të Vivarit, ku u ndërtua edhe ujësjellësi. Në shekullin V pas Krishtit, Butrinti u bë qendër peshkopate; në të njëjtën periudhë, u fortifikua dhe u ngritën strukturat e hershme kryesore të krishtera. Pas një periudhe braktisjeje, Butrinti u rindërtua në shekullin IX nën sundimin bizantin. Butrinti dhe territori i tij ranë nën sundimin e Anzhuinëve dhe më pas, në shekullin XIV, nën atë të venedikasve. Disa sulme nga dhespotët e Epirit, dhe më vonë nga osmanët, çuan në forcimin dhe zgjerimin e fortifikimeve të Butrintit. Në fund të shekullit XIX, në sistemin e mbrojtjes së Butrintit u shtua një kala e re buzë Kanalit të Vivarit. Ajo u ndërtua nga Ali Pasha, sundimtar shqiptar, që administroi Butrintin dhe zonën përreth deri sa u braktis përfundimisht.

Muret rrethuese dëshmojnë për fazat e ndryshme kur janë ndërtuar, që nga periudha e kolonisë greke deri në Mesjetë. Monumenti antik më interesant është teatri, që është ruajtur në gjendje mjaft të mirë. Dëshmia më e madhe e epokës paleokristiane janë rrënojat e pagëzimore, një monument antik, i përshtatur sipas nevojave kulturore të krishterimit. Dyshemeja e saj e bukur është

në formë mozaiku. Bazilika paleokristiane u rindërtua në shekullin IX dhe rrënojat e saj janë ruajtur në gjendje mjaft të mirë, gjë që mundëson një analizë të strukturës (tre nefe me një transept dhe një absidë poligonale të jashtme).

Kriteri (iii): Evoluimi i mjedisit natyror të Butrintit solli braktisjen e qytetit në fund të Mesjetës, dhe për pasojë ky sit arkeologjik ofron dëshmi të çmuara për qytetërimet antike dhe mesjetare në territorin modern shqiptar.

3.1.1 Integriteti

Sipërfaqja e këtij aseti paraqet shumë elemente që diktojnë Vlerën e tij të Jashtëzakonshme Universale. Sitet arkeologjike të pa gërmuara, rrënojat që qëndrojnë në këmbë dhe ndërtesat historike janë gjerësisht të paprekura. Megjithëse Butrinti, si objekt i Trashëgimisë Botërore, nuk është ndikuar shumë nga efektet negative të zhvillimit apo të neglizhencës, është ende i cenueshëm në kuptimin e rritjes së nivelit të ujërave sezonale, nevojës për koordinim më të mirë të punimeve konservuese dhe gërmimeve arkeologjike, rritjes së bimësisë dhe qëndrueshmërisë strukturore e disa monumenteve. Gjithashtu, ka edhe disa shqetësime për shkak të zhvillimeve bashkëkohore, duke përfshirë ndërtimin e rrugëve dhe zgjerimin e qytetit përreth sitit. Megjithatë, Butrinti mbetet një shembull i shkëlqyer i ruajtjes së popullimit urban antik dhe mesjetar. Peizazhi përreth tregon se çfarë ndryshimesh urbane janë bërë në të shkuarën në Butrint.

3.1.2 Autenticiteti

Si objekt i Trashëgimisë Botërore, autenticiteti i Butrintit lidhet me ruajtjen e shkëlqyer të tij në një sit, ku ndërveprimi i vazhdueshëm i njeriut me mjedisin mund të vihet re në monumentet e mbijetuara, në arkeologjinë nëntokësore dhe në peizazhin rrethues. Cilësia e punimeve restauruese dhe konservuese, të kryera që prej vitit 1924, ka qenë mjaft e mirë. Edhe ndërhyrjet e mëvonshme janë realizuar në përputhje me standardet bashkëkohore, të përcaktuara në Kartën e Venecias të vitit 1964 dhe në kartat e konventave të mëvonshme.

3.1.3 Kërkesat aktuale të mbrojtjes dhe menaxhimit

Butrinti u përfshi në Listën e Trashëgimisë Kombëtare të Monumenteve të Mbrojtura në vitin 1948, si Monument Kulture i Kategorisë I. Aktualisht, mbrojtja dhe konservimi i monumenteve arkeologjike parashikohet në Ligjin për Trashëgiminë Kulturore. Vlerat natyrore të Ligatinave të Butrintit u njohën nga Konventa Ramsar në vitin 2003. Ndërsa, në vitin 2005, bazuar në Ligjin për Zonat e Mbrojtura, Butrinti u shpall Park Kombëtar me një sipërfaqe prej 86 km². Parku Kombëtar, i cili shërben edhe si zonë mbrojtëse për Sitin e Trashëgimisë Botërore, përfaqësohet nga një Bord të kryesuar nga Ministri i Kulturës dhe staf profesionist, që është përgjegjës për menaxhimin e objektit të Trashëgimisë Botërore. Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore dhe Instituti i Arkeologjisë janë përgjegjës për kërkimin, gërmimet dhe konsolidimin e rrënojave arkitekturore dhe arkeologjike.

Butrinti paraqet edhe disa aspekte të cenueshmërisë të cilat mund të vënë në rrezik integritetin e objektit në një të ardhme afatgjatë. Për të shmangur kërcënimet ndaj integritetit dhe autenticitetit, monitorimi dhe kontrollimi i cenueshmërive janë paraqitur si çështje themelore në Planin e

Menaxhimit të Butrintit për Arkeologjinë dhe Monumentet. Plani i Menaxhimit duhet të harmonizohet me plane të tjera për sitin dhe Parkun Kombëtar.⁷

Gjithashtu, Butrinti paraqet një ndërthurje shumë të rrallë të arkeologjisë dhe natyrës, duke qenë se rrënojat arkeologjike të Buthrotumit ndodhen mes pyjeve natyrore me një ekosistem kompleks, i cili ushqehet nga ujërat e ëmbla të Liqenit të Butrintit dhe Kanalit të Vivarit, që derdhen në Detin Jon.

Qyteti antik është i mbuluar me shtresa dheu dhe bimësie, gjë që e ka mbajtur të mbrojtur. Është pikërisht kjo ndërthurje e monumenteve historike dhe mjedisit natyror që e bën Butrintin një vend unik, një peizazh me monumente të çmuara, fama e të cilit u përhap nga turistët fisnikë të shekujve XVIII dhe XIX. Në shumicën e rasteve, ndërhyrjet e njeriut kanë qenë në harmoni me natyrën dhe nuk e mbizotërojnë atë. Shfrytëzimi i tokës dhe aktivitetet ekonomike lokale reflektohen në peizazh. Sot, Parku Kombëtar i Butrintit paraqet një ndërthurje unike të peizazheve kulturore dhe natyrore, të cilat ilustron më së miri marrëdhënien e njeriut me natyrën përgjatë më shumë se tre mijëvjeçarëve.

Veçantia e Butrintit përcaktohet jo vetëm nga ballafaqimi i mjedisëve, qoftë natyrore apo të krijuara nga njeriu, ose i vendndodhjeve të tij topografike që padyshim janë thelbësore, por nga fakti që ky është një vend zbulimi, epiqendra e magjisë, që tërheq interesin dhe kërkimin. Kjo është bërthama e siteve të këtij lloji, pasi ajo çfarë është zbuluar këtu mund të përcillet në mënyrë të përgjithësuar, duke ndërtuar profilin dhe duke tërhequr interesin e publikut.

3.2 Ndryshime të mundshme në Zonat e Mbrojtura të Parkut Kombëtar në të ardhmen

Hartat, që gjenden në Shtojcën B, tregojnë një rritje të qartë dhe të vazhdueshme të sipërfaqes së zonës(ave) së mbrojtur, krahasuar me përcaktimin fillestar të sitit si Trashëgimi Botëror: nga 16 hektarë në vitin 1992 në 9,424 hektarë në vetëm njëzet vjet; që në vetvete është arritje.

Pikë së pari, ky është një pasqyrim i punës së Fondacionit Butrinti dhe partnerëve vendorë dhe kombëtarë nga viti 1993 deri në vitin 2012, për promovimin e rëndësisë së sitit, jo vetëm në aspektin arkeologjik, por edhe për ekologjinë, angazhimin e komunitetit, ngritjen e kapaciteteve vendore dhe njohjen e përgjegjësisë së përbashkët.

Për më tepër, puna e Fondacionit Butrinti (Fondacioni gjithmonë ka kombinuar ekspertizën vendase me atë ndërkombëtare) për nxjerrjen në pah të vlerave të veçanta të tij, pasqyrimin e të gjithë peizazhit, manifestimin e *domethënies* së tij që është më e rëndësishme në aspektin kulturor sesa në kontekstin e gjetjeve specifike historike, i ka rritur pritshmëritë.

Ndryshe nga sitet e ngjashme përgjatë Mesdheut Lindor, Butrinti përbën përjashtim për faktin se mund të bëjë më shumë dhe mund të ketë më shumë sukses në realizimin e këtij qëllimi.

Butrinti i ka të gjitha burimet për ta bërë diçka të tillë, pasi ka:

1. Bërë një punë thelbësore, që ende vazhdon, dhe është pranuar në nivel ndërkombëtar,
2. Një qeveri të vullnetshme për të zgjeruar kufijtë gjeografikë në dobi të burimeve historike dhe natyrore,

⁷ Burimi: Lista e Trashëgimisë Botërore të UNESCO-s

3. Një komunitet lokal të gatshëm për t'u angazhuar,
4. Mundësi financiare për të ofruar atë që nevojitet përmes Fondacionit të Ri.

Për rrjedhojë, Fondacioni i Ri do të jetë në një pozitë ku ai mund dhe duhet ta mbikëqyrë dhe ta menaxhojë ndryshimin, jo vetëm në Zonën A3 të Butrintit, por edhe në peizazhin e tij rrethues dhe mbështetës, i cili do të ekzistojë për breza të tërë.

Në vitin 2005, një Mision i UNESCO-s rekomandoi që duhet të konsiderohet ndryshimi i statusit nga Siti i Trashëgimisë Botërore të Butrintit në "peizazh kulturor", për të përfshirë të gjitha burimet natyrore dhe burime të tjera që ofron vendi, falë përcaktimit si zonë Ramsar në vitin 2003 dhe zgjerimit të kufijve të Parkut Kombëtar. Kjo do të thotë se në cilësinë e Sitit të Trashëgimisë Botërore mund të kërkohet zgjerimi i përkufizimit të tij, nga 'kulturor' në një përkufizim më të gjerë 'miks', që do të merrte në konsideratë burimet e rëndësishme natyrore të sitit dhe gjerësisht të peizazhit të tij⁶.

Për shembull, kufiri aktual i Sitit të Trashëgimisë Botërore përkufizon Liqenin e Butrintit (Shihni Shtojcën B). Ky përkufizim arbitrar jo vetëm që është i papërputhshëm me gjetjet arkeologjike të pritshme në të ardhshmen dhe sitet gjatë bregut të liqenit, por dëmton edhe ndikimin e Sitit të Trashëgimisë Botërore lidhur me menaxhimin e kushteve hidrologjike dhe të cilësisë së ujit në të ardhmen, të cilat aktualisht përbëjnë shqetësime madhore për Zonën A3.

Rrjedhimisht, zgjerimi i kufijve të Sitit të Trashëgimisë Botërore, siç tregohet më poshtë dhe në Shtojcën B, do të garantonte trajtim të njëjtë të sipërfaqes së Liqenit të Butrintit, dhe do të kërkonte një regjim më strikt për mbrojtjen e Sitit të Trashëgimisë Botërore.



Figura 4: Zgjerimi i mundshëm i STB-së për të përfshirë të gjithë Liqenin e Butrintit.

⁶Siç theksohet edhe më sipër, në vitin 2007, kufijtë e Parkut Kombëtar u miratuan si Zonë Bufërike e Sitit të Trashëgimisë Botërore të Butrintit. Megjithatë, kufijtë e Parkut Kombëtar ndryshuan në vitin 2013, duke u zgjeruar nga 8,500 hektarë në 9,500 hektarë. Për rrjedhojë, ndryshimi në Zonën Bufërike nuk është njohur ende nga Komiteti i Trashëgimisë Botërore.

3.3 Statusi i "Sitit Miks"

Lidhur me mundësinë e marrjes së statusit "Sit miks", Udhëzimet Operacionale të STB-së i përkufizojnë pasuritë mikse si objekte që përmbushin një pjesë ose të gjitha kriteret e trashëgimisë kulturore dhe natyrore, parashikuar në nenet 1 dhe 2 të Konventës për Trashëgiminë Botërore.

Duke qenë se Butrinti është shpallur tashmë si pasuri kulturore për Vlerën e tij të Jashtëzakonshme Universale, mund të depozitohet një kërkesë për përfshirjen e vlerave të tij natyrore, me qëllim forcimin e pozicionit ndërkombëtar dhe sigurimit të politikave, planeve dhe materialeve për menaxhimin, që janë plotësisht të integruara për të ardhmen.

Plan i Menaxhimit i vitit 2010 për Parkun Kombëtar përmban deklaratën e mëposhtme të unikalitetit:

"Kombinimi i arkeologjisë dhe natyrës i jep Butrintit një "shpirt" të vërtetë autentik. Kombinimi i pyjeve të përzierë, të mbizotëruar në mënyrë të fragmentuar nga lisi me gjelbërim të përhershëm është një habitat në zhdukje në Shqipëri. Pikërisht ky fakt e bën këtë zonë njëkohësisht më të zakonshmen dhe më uniken në vend".

Kjo deklaratë e bërë në Planin e Menaxhimit të vitit 2010, e cila shërbeu si bazë për vendimin e Këshillit të Ministrave për zgjerimin e kufijve të Parkut Kombëtar, bëri që të njohim disa vlera të rëndësishme që mund të kontribuojnë në përpilimin e një deklaratë të Vlerës së Jashtëzakonshme Universale për pasurinë mikse si më poshtë:

1. Butrinti është shpallur i tillë sipas kriterëve 1, 2,3 dhe 8 të Konventës Ramsar për Ligatinat
2. Parku Kombëtar i Butrintit është i njohur për shumëllojshmërinë e habitateve të tij, ku njëzet e gjashtë konsiderohen si Habitata Evropiane, nga të cilat pesë konsiderohen si Habitata Evropiane Prioritare
3. Rreth 140 specie bimore dhe shtazore janë vlerësuar me rëndësi për t'u mbrojtur; nga të cilat 35 specie shtazore janë vlerësuar me rëndësi mbrojtjeje në nivel botëror
4. Habitatet në Ligatinat e Butrintit paraqesin një humbje të madhe të biodiversitetit: 16 specie janë zhdukur, ndërsa 58 specie konsiderohen si 'të rralla' ose si 'shumë të rralla'; fatkeqësisht, kjo është një veçori tipike në shumë vende evropiane
5. Butrinti është habitat i specieve "të kërcënuara" për zhdukje, si rosa kokëbardhë, rosa pikaloshë, shqiponja bishtbardhë, shqiponja mbretërore, shqiponja e madhe e rosave dhe pula me mjekër
6. Butrinti njihet si një habitat ushqimi për dy nga speciet më të kërcënuara në botë: shqiponjën bishtbardhë dhe shapkën
7. Sipas inventarit të specieve në rrezik (*Red Book*) të IUCN-së, 13 specie shpendësh që gjenden në Butrint konsiderohen si të kërcënuara në nivel global
8. 95 nga speciet në Butrint (duke përfshirë 38% të specieve të shpendëve të vëzhguara) konsiderohen si të kërcënuara në Evropë.

Prandaj, jemi të bindur që vlerat natyrore të Butrintit duhen shtuar në përcaktime në të ardhmen, gjë që përvijohet edhe në tre kriteret për përkufizimin e trashëgimisë natyrore, sipas nenit 2 të Konventës për Trashëgiminë Botërore:

1. Tipare natyrore që përbëhen nga formacione fizike dhe biologjike ose grupe të këtyre formacioneve, të cilat janë me vlerë të jashtëzakonshme universale nga pikëpamja estetike ose shkencore;
2. Formacione gjeologjike dhe fiziko-grafike dhe zona të përcaktuara saktë të cilat përbëjnë vendbanimet e specieve të kërcënuara kafshësh dhe bimësh me vlerë të jashtëzakonshme universale nga pikëpamja e shkencës ose konservimit;
3. Site natyrore ose zona natyrore të përcaktuara saktë me vlerë të jashtëzakonshme universale nga pikëpamja e shkencës, konservimit ose bukurisë natyrore.

Në këtë kontekst, duhet të bashkepunohet me Unionin Ndërkombëtar për Konservimin e Natyrës (IUCN)⁹ për marrjen e këshillave rreth problematikave të qëndrueshmërisë në lidhje me burimet natyrore dhe statusin e konservimit të specieve që gjenden në Parkun Kombëtar. Këshillimi me IUCN-në duhet të bëhet edhe në rast të aplikimit pranë UNESCO-s në mënyrë që STB e Butrintit të shpallet "Sit Miks".

3.3.1 Rezultatet e menaxhimit

Është pranuar fakti që arkeologjia përfiton nga një bimësi e dendur dhe e përhapur. Për shembull, po zbulohen rregullisht struktura të reja nëpërmjet teknikave moderne jo agresive, të cilat po na ndihmojnë të kuptojmë më mirë evoluimin e rrënojave antike brenda mjedisit të peizazhit të tyre, pikërisht sepse rrënojat ndodhen brenda një peizazhi kryesisht rural dhe 'natyror', gjë që e bën Butrintin një vend unik.

Nga ana tjetër, ka shumë shembuj të siteve arkeologjike në dhe përreth Mesdheut Lindor, ku kjo marrëdhënie simbiotike 'arkeologji-natyrë' ka humbur me kalimin e viteve. Një shembull i mirë është Siti i Trashëgimisë Botërore (Kulturore) të *Herculaneum*, afër Napolit. Shumë nga rrënojat e dukshme të këtij qyteti bregdetar romak të shekullit I, tashmë ndodhen poshtë komunës moderne të Ercolano-s, dhe për rrjedhojë marrëdhënia e sitit historik me Vezuvin dhe peizazhet e gjera bujqësore dhe vinikulturore që ekzistonin dikur në shpatet e tij, dhe të cilat dikur ishin në pronësi dhe menaxhoheshin nga komuna, ka humbur.

Megjithatë, me Butrintin nuk ndodh kështu, sepse ai shtrihet përgjatë Kanalit të Vivarit në rrethinat romake dhe në peizazhet bujqësore dhe akuakulturore që e rrethojnë atë. Rrjedhimisht, Butrinti të jep mundësinë që përtëj rrethinave romake të përshkosh një peizazh plot me vija kufitare, shtigje antike dhe vila të izoluara romake, dhe të gjitha këto përbëjnë peizazhin arkeologjik, ku janë mbjellë bimë ose ka dalë bimësi natyrore, shumë prej të cilave kanë arritur gjatësinë maksimale.

Për këto arsye, Butrinti mundëson zbatimin e mënyrës së trajtimit 'të arkeologjisë së peizazhit' për kërkimin dhe menaxhimin në të ardhmen. Arkeologjia e peizazhit është një disiplinë e zhvilluar

⁹ IUCN-ja është një organizatë ndërkombëtare që punon në fushën e konservimit të natyrës dhe përdorimit të qëndrueshëm të burimeve natyrore. Misioni i IUCN-s është të "ndikojë, nxisë dhe ndihmojë shoqëritë në mbarë botë për të konservuar natyrën dhe për të siguruar se çdo përdorim i burimeve natyrore është i drejtë dhe ekologjikisht i qëndrueshëm".

vullshëm që përdoret për të studiuar të kaluarën. Qëllimi i saj është të shqyrtojë në detaje të gjitha mënyrat që kanë përdorur njerëzit për të ndërtuar dhe shfrytëzuar mjedisin përreth tyre, dhe mënyrat se si u zhvilluan bashkëveprime të tilla ndër shekuj. Rrjedhimisht, ajo është në thelb shumëdisiplinore dhe mbulon fushat më tradicionale të vrojtimit arkeologjik, të klasikes, historisë, dhe i kombinon ato me psikologjinë e evolucionit, studimet mjedisore dhe ekologjinë. Tipari kryesor që e dallon atë nga qasjet e ngjashme akademike është theksi i vendosur mbi marrëdhëniet ndërmjet kulturës materiale dhe ndryshimit të tokës nga njeriu, pra modifikimi kulturor, ose krijimi i peizazhit brenda mjedisit të tij natyror.

Fakti që gjatë komunizmit Butrinti dhe e gjithë kjo pjesë e Shqipërisë ishte një vend relativisht i izoluar dhe i vështirë për t'u depërtuar, ka bërë të mundur mbijetesën e shumë ekosistemeve vendase, të cilat ose janë unike për Butrintin ose janë nën ndikim të madh nga ndërtimet, ndërtimin e rrugëve dhe ndërhyrjet e tjera shkatërruese në pjesën tjetër të Shqipërisë.

Për rivendosjen e plotë të rregullave në sit, aspektet arkeologjike dhe ekologjike duhet të jenë mbi të njëjtat baza, prandaj sugjerohet një përcaktim miks.

Kjo qasje ka një sërë avantazhesh:

1. Ajo shton rëndësinë e ndërveprimit unik midis peizazheve kulturore dhe natyrore të vendit, që kanë mbijetuar gjatë shumë mijëvjeçarëve.
2. Për të kuptuar kompleksitetin e tij, mund të përdoren një sërë metodash akademike të mirënjohura dhe pranuar ndërkombëtarisht, të cilat mund të mbështesin vendimmarrjen në të ardhmen, duke marrë në konsideratë edhe rëndësinë e pasurive arkeologjike dhe natyrore të vendit.
3. Të njëjtat teknika monitorimi dhe ndërhyrje mund të zbatohen për pasuritë arkeologjike dhe natyrore të vendit.
4. Vendimet lidhur me të ardhmen e pasurive arkeologjike dhe natyrore të vendit duhet të marrin plotësisht parasysh pasojat e vendimmarrjes.
5. Në vitet e ardhshme, do të krijohet një kuadër për një vendimmarrje të dakordësuar, ose forum, i cili do të marrë vendime lidhur me konservimin e një monumenti të veçantë ose ruajtjen e specieve me vlerë.
6. Ndikimet (pozitive apo negative) të ndërhyrjeve të reja (ndërtesa, rrugë, përshtatje strukturore për vizitorët, etj.) mbi gjithë territorin mund të vlerësohen lehtësisht.
7. Nga shumë pikëpamje, i gjithë siti (Parku Kombëtar, Zona A3, zona Ramsar, etj.) do të konsiderohet si njësi e vetme me vlerë të veçantë.
8. Të gjitha palët e përfshira, Fondacioni i Ri, ministrinë e ndryshme dhe institucione të ngjashme, do të punojnë për një qëllim të përbashkët dhe të dakordësuar, që është mirëqenia e Parkut të Butrintit në të ardhmen, në të gjitha aspektet e tij: natyrore, arkeologjike, historike dhe kulturore si një peizazh i vetëm, kompleks dhe i një rëndësie ndërkombëtare.

Kjo mënyrë trajtimi do t'i tregojë UNESCO-s dhe agjencive të tjera ndërkombëtare se Butrinti është njohur pikërisht për vlerat që mbart ... duke qenë një nga peizazhet kulturore dhe natyrore më të rëndësishme të botës, të cilat kanë evoluar së bashku përgjatë mijëra viteve dhe që mbeten ngushtësisht të lidhur, duke na treguar në ditët e sotme veçantinë e këtij vendi.

3.4 Peizazhi

Parku Kombëtar paraqet një larmi peizazhesh sipërfaqësore, nga ujërat e hapura (të ëmbla, të kripura dhe detare) të pyjet gjethegjera, pemëtoret dhe shqopishtat. Këto paraqiten në mënyrë treguese në këtë hartë. Për t'i zërthyer më mirë këta faktorë, Parku është ndarë në zona të ndryshme kryesore dhe nënzona.






Figura 5: Karakteristikat e peizazhit sipërfaqësor



Legjenda

- | | |
|--|---|
|  Kufiri i Pasurisë së Trashëgimisë Botërore |  ZONA A - ZONA BËRTHAMË |
|  Kufiri i Parkut Kombëtar Butrint |  ZONA B - ZONA REKREATIVE |
| |  ZONA C - ZONA E PËRDORIMIT TRADICIONAL |
| |  ZONA D - ZONA E PËRDORIMIT TË GËNDRUESHËM |

Figura 6: Zonat ekzistuese të Parkut Kombëtar



Legjenda

- | | | |
|--|---|---|
| Kufiri i Pezorisë së Trashëgimisë Botërore | ZONA A1 - ZONA E RUAJTIES SË VEÇANTË | ZONA C1 - PESHKIMI TRADICIONAL |
| Kufiri i Parkut Kombëtar Butrint | ZONA A2 - NËNZONA MËDËSORE NATYRORE | ZONA C2 - KULLOTJA DHE BURGËSIA |
| | ZONA A3 - NËNZONA E TRASHËGIMISË NATYRORE | ZONA D - ZONË E PËRQORIMIT TË GËNDRUESHËM TRADICIONAL |
| | ZONA B - ZONA REKREATIVE | |

Figura 7: Nënzonat ekzistuese të Parkut Kombëtar

Nga pikëpamja e hapësirës, këto zona dhe nënzona përshkruajnë, në vija të përgjithshme, se si bëhet menaxhimi i Parkut Kombëtar aktualisht, duke marrë në konsideratë se një pjesë e madhe e tij është shpallur Sit i Trashëgimisë Botërore.

Për shembull, Zona A1 (që rrethon Zonën A3) është 'zonë me mbrojtje të veçantë', ndërsa Zona A2 (që rrethon Zonën A1 dhe A3) është "nënzona natyrore dhe mjedisore". Natyrisht, fokusi vihet te përpjekja për vendosjen e barrierave kundrejt zhvillimit të mundshëm dëmtes dhe shkatërrues, veçanërisht në Ksamil (Zona B), i përcaktuar si 'zonë argëtimi'.

Në hartë tregohet edhe Zona D si zonë ku mund të realizohen 'zhvillime të qëndrueshme', që përmendet edhe në një pjesë tjetër të këtij Plani.

Në vija të përgjithshme, kjo është një qasje mjaft pragmatike dhe e vlefshme për konservimin e këtij peizazhi me rëndësi botërore.

Megjithatë, një çështje me shumë rëndësi në këtë pikë lidhet me Ksamilin dhe zgjerimin e tij tërësisht të pakontrolluar dhe shkatërrues gjatë viteve të fundit, që vihet re në përpjekjet e bëra nga disa për të 'pushtuar' ishujt që janë afër tokës, të cilët tashmë janë përcaktuar si pjesë e Zonës A3.

Derisa të trajtohet përfundimisht zgjerimi i pakontrolluar dhe i pamonitoruar i Ksamilit, ai do të vijojë të shtrihet gradualisht brenda sipërfaqes së Parkut, në dëm të një vendi me karakteristika unike, dhe çka ka më rëndësi, në dëm të kapacitetit të tij për të tërhequr dhe mbajtur vizitorët e huaj, që i shërben kryesisht rolit të tij si një nga shtytat kryesore ekonomike në Shqipërinë e Jugut.

Nëse dëshirojmë që Butrinti të bëhet model menaxhimi për Zonat e Mbrojtura në vende të tjera të Shqipërisë, atëherë kjo është çështja kyçe duhet zgjidhur.

Prandaj, rekomandohet që e gjithë sipërfaqja aktuale e Ksamilit të hiqet nga Parku Kombëtar, dhe të vendoset një 'Rrip i Gjelbër' përreth tij, për të ndaluar zgjerimin e mëtejshëm. Kjo mund të rregullohet nga një sërë aktesh nënligjore.

Megjithëse sipas kësaj do të hiqet një pjesë e vogël e bregdetit dhe prapatoka e tij direkte (ndoshta 100-150 hektarë), ajo do të siguronte dhe do të konsolidonte parimin e moszgjerimit të mëtejshëm në pjesën tjetër prej 9,000 hektarësh të Parkut Kombëtar.

Për këtë arsye, propozohet rishikimi i kufijve ekzistues të nënzonave të Parkut Kombëtar të caktuara sipas VKM Nr. 495 datë 22.07.2014, "Për disa shtesa dhe ndryshime në VKM Nr. 693 datë 10.11.2005 për shpalljen e Kompleksit Ligatinor të Butrintit "Park Kombëtar".

Parku kombëtar i Butrintit propozohet të ndahet në katër nënzona me qëllim menaxhimit e tyre sipas rëndësisë së habitateve dhe të ekosistemeve që bëjnë pjesë në to:

1. Nënzona Qendrore (ZQ)
2. Nënzona e Përdorimi Tradicional dhe Zhvillimit të qëndrueshëm (ZPTZHQ) ku zbatohet niveli i dytë i mbrojtjes.
3. Nënzona e Rekreacionit (ZR), ku zbatohet niveli i tretë i mbrojtjes.
4. Nënzona e Trashëgimisë dhe Peizazhit Kulturor (ish Zona A3).




Figura 8: Nënzonat e propozuara të Parkut Kombëtar

Nënzona Qëndrore

Nën zona qendrore e një zone të mbrojtur zbaton shkallën e parë të mbrojtjes dhe ka për qëllim krijimin e një territori pak ose aspak të shqetësuar nga aktivitetet njerëzore. Nën zona përfshin disa nga habitatet natyrore dhe nën zonat fito-klimatike, pyjet e vjetër dhe ata natyrore mesdhetare me ilqe (*Quercus ilex*), dafinë (*Laurus nobilis*) dhe valanidh (*Quercus macrolepis*), karakteristika gjeologjike dhe gjeomorfologjike të veçanta, shkëmbinj detarë, livadhe detare me posidonia

(Posidonia oceanica), estuaret, kënetat ujë-ëmbël, të njelmëta dhe të kripura si dhe habitatet riparine (pyjet aluvionale).

Nënzona e Përdorimit Tradicional dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm

Në zonën e përdorimit tradicional dhe të qëndrueshëm (B) zbatohet shkalla e dytë e mbrojtjes sipas ligjit për zonat e mbrojtura. Kjo zonë ka për qëllim të mundësojë jetesën e banorëve brenda PKB, në mënyrë të përhershme apo sezonale, të vazhdojnë të ruajnë mënyrën e tyre të jetesës me mjete tradicionale. Nën zona lejon subjektet publike hyrëse, të respektojnë kufijtë tokësore rezidenciale dhe veprimtaritë e tyre ekonomike. Vizitorët mund të shijojnë të njëjtat aktivitete dhe vlera si në Zonën Rekreative por gjithashtu të mësojnë edhe rreth bujqësisë tradicionale, kullotjes, metodave tradicionale të peshkimit dhe mënyrave të jetesës.

Nënzona e Rekreativitetit

Nën zonat të cilat mund të ofrojnë një edukim në shkallë të gjerë, mundësi të argëtimit në natyrë (tokë dhe det) dhe lehtësi të tjera në mënyrë të tillë që respekton funksionet e parkut, vlerat e tij ekologjike dhe ato të peizazhit natyror e kulturor.

Në këtë zonë zbatohet shkalla e tretë e mbrojtjes sipas ligjit për zonat e Mbrojtura.

Nënzona e Trashëgimisë dhe Peizazhit Kulturor

Mbrojtja e vlerave të veçanta kulturore, natyrore dhe arkeologjike. Lejohen vizitat e përcaktuara në përputhje me ruajtjen e vlerave të veçanta kulturore dhe natyrore të zonës. Zbatohet shkalla e parë e mbrojtjes, niveli B. Kjo zonë do të jetë në menaxhim të Fondacionit të Ri sipas standarteve dhe kërkesave që lindin nga përfshirja e sitit në UNESCO dhe i referohet ish nënzonave A3.

3.0 Parku Kombëtar i Butrintit – Pika kyçe

- Parku Kombëtar funksionon edhe si Zona Mbrojtëse e Sitit të Trashëgimisë Botërore.
- Ky plan menaxhimi i integruar propozon zonimin e ri të parkut dhe rishikimin e kufirit të tij.
- Mirëqenia e ardhshme e Parkut dhe e njerëzve që jetojnë aty dhe rreth tij janë të ndërlidhura.
- Ekspertiza teknike dhe burimet akademike disponohen si në nivel vendor, ashtu edhe në atë kombëtar.
- Aplikimi i aftësive teknike dhe veprimeve për mbrojtjen nuk kanë arritur rezultatet e duhura për shkak të drejtimit, kapaciteteve menaxhuese dhe mungesës së financimit.
- Ngritja e një organi të posaçëm kërkimor-shkencor, Grupi Kërkimor Butrinti, të përkushtuar në avancimin e njohurive kërkimore.
- Burimet e rëndësishme natyrore të Butrintit mund të kontribuojnë në krijimin e një deklaratë për Vlera të Jashtëzakonshme Universale të një pasurie mikse.

4.0 BURIMI KULTUROR



4.0 BURIMI KULTUROR

Butrinti ofron një pamje të veçantë të krijuar nga kombinimi shumë i rrallë i arkeologjisë, monumenteve dhe natyrës në vijën bregdetare shqiptare përgjatë detit Jon. Së bashku me mjedisin perreth tij, ai përbën një peizazh kulturor të jashtëzakonshëm, që është zhvilluar organikisht për shekuj të tërë.

Autenticiteti i pasurisë së Trashëgimisë Botërore të Butrintit lidhet me ruajtjen e shkëlqyer të një siti ku bashkëveprimi i njeriut me natyrën mund të vërehet në monumentet e mbijetuara, në arkeologjinë e nëndheshme dhe në peizazhet përreth. Cilësia e punimeve restauruese dhe konservuese, të kryera që prej vitit 1924, ka qenë mjaft e mirë. Ndërhyrjet e mëvonshme përgjithësisht kanë përmbushur standardet bashkëkohore të përcaktuara në Kartën e Venecias, e vitit 1964.

4.1 Rëndësia e pasurisë arkeologjike

Sikundër është përshkruar edhe në planet e mëparshme dhe referenca të ndryshme, siti brenda mureve të Butrintit është pa dyshim siti arkeologjik më i rëndësishëm në Shqipëri dhe atraksioni kulturor më i madh. Sipas kërkimeve, ky qytet Antik dhe Mesjetar nuk ka rrënoja vetëm brenda mureve në krahun verior të Kanalit të Vivarit, por edhe një zonë të madhe në fushën e Vrinës. Krahas kësaj, Butrinti është i vendosur mbi një peizazh historik të pasur në site arkeologjike, shumë prej të cilave nuk janë eksploruar ende.

Ky kombinim i arkeologjisë dhe natyrës, ende i paprekur nga zhvillimi modern, i jep Parkut Kombëtar të Butrintit një identitet të veçantë dhe autenticitet, çka është identifikuar si vlera kryesore e qenësishme. Nga ana tjetër, vlerat shkencore të arkeologjisë në Butrint si Siti i Trashëgimisë Botërore, mund të përmbledhen si vijon:

4.1.1 Larmia e kulturave dhe periudhave

Jetëgjatësia e arkeologjisë së Butrintit dhe larmia e ndërhyrjeve kulturore luajnë një rol kyç në përcaktimin e rëndësisë së Butrintit. Grekët, romakët, bizantinët, anzhuinët, venecianët dhe osmanët kanë lënë secili gjurmën e tyre.

4.1.2 Monumente të jashtëzakonshme

Monumentet e Butrintit janë të jashtëzakonshme në kuptimin e rëndësisë historike, shkencore dhe estetike. Shembulli kryesor i kësaj është dyshemeja e Pagëzimit me mozaik, e fillimit të shek. VI, që është dyshemeja më e madhe dhe me ikonografinë më komplekse që ka mbijetuar nga të gjitha pagëzimet e antikitetit të vonë.

4.1.3 Vlera në grup

"Vlera e elementeve në grup" të sitit ka rëndësi të veçantë. Ato ofrojnë një mundësi të jashtëzakonshme për të studiuar modelet e vendbanimeve në periudha të ndryshme të historisë.

4.1.4 Potenciali i burimit arkeologjik

Potenciali për zbulime të reja arkeologjike është shumë i madh. Gërmimet arkeologjike kanë qenë të pakta në Butrint dhe shumica e tyre janë përqendruar në zonën brenda mureve. Me zbulimin e

zonës jashtë mureve të sitit (Hodges 2006, Hansen dhe Hodges 2007), u kuptua se njohim në detaje vetëm rreth 5% të qytetit. Stratigrafia e sitit është e pasur, ndërkohë që të dhëna të rralla në lidhje me fazat e pushtimeve të lëndëve drusore mbeten ende të paprekura. Krahas kësaj, sipas vrojtimeve nënujore të kohëve të fundit në gjirin e Ksamilit, në kanalën e Vivarit dhe në gjirin e Butrintit shihet prania e disa anijeve dhe siteve arkeologjike të fundosura.

Trashëgimia nënujore ishte objekt i një vrotimi në vitin 2000-2001 të financuar nga Fondacioni Butrinti. Asokohe u vendos se nuk ishte praktik zhvillimi i një programi zyrtar nënujor, pasi kostot e konservimit do të ishin tepër të larta. Dr. Jeffrey Royal³⁰ arriti në të njëjtin përfundim pasi kreu një vrotim më të thelluar në vitin 2008-2009. Fondacioni Butrinti mbështeti Dr. Royal duke ofruar këshilla mbi datimin e qeramikës të enëve të gjetura nga anijet e fundosura në Gjirin e Butrintit.

Plani i Veprimit në PMI konfirmon nevojën për të ekzaminuar rrugën e duhur për kërkimin, konservimin, publikimin dhe shfaqjen afatgjatë të disa gjetjeve të mundshme të rrënojave arkeologjike nënujore, nëse do të gjykohet e arsyeshme. Si rrjedhojë, veprime të caktuara të ardhshme në këto rrënoja do të përcaktohen sipas rezultateve kyçe të këtyre studimeve. Është e vërtetë se projektet arkeologjike nënujore, kudo që të ndërmerren (Mary Rose në MB, Vasa në Suedi, Port Royal Xhamajka, Aleksandria në Egjipt, projektet e Detit të Zi, nëndetësja e konfederatës H L Huntly Karolina e Jugut, SHBA) janë tepër interesante për publikun, ndaj dhe ofrojnë mundësi të spikatura me qëllim që projekti i Butrintit të mbështesë aktivitete dhe veprime të ardhme të marrëdhënieve me publikun, dhe si rrjedhojë të përftojë mbështetje mbarëbotërore.

4.1.5 Lidhjet historike

Në historinë e Butrintit mund të gjenden lidhje historike me vendet e tjera që pasqyrojnë vetë historinë e tij. Këtu përfshihet:

- Ideja se Butrinti është themeluar nga trojanët e dëbuar, Helenusi dhe Andromaka (e veja e Hektorit), e bërë e njohur nga Virgjili në interpretimin e tij epik të rrugëtimit të Eneas për të themeluar Romën
- Letrat e Ciceronit drejtuar Atikut, një pronar lokal në Butrint, e afrojnë botën e senatit romak me Butrintin
- Kryqëzata e Katërt qëndroi në Butrint dhe Korfuz në vitin 1204, gjatë rrugës për në Kostandinopojë
- Jeta dhe oborri i Ali Pashës me çështjen e problemeve midis Francës, Anglisë dhe Rusisë gjatë luftërave të Napoleonit, tërhoqi diplomatë, artistë dhe shkrimtarë drejt Butrintit
- Arkivat me dokumente të Butrintit kanë rëndësi madhore. Si arkivat e Republikës së Venedikut ashtu edhe ato të Perandorisë Osmane, ato ofrojnë një burim të pasur historik për të vlerësuar arkeologjinë e Butrintit
- Një arkivë mjaft e pasur ekziston edhe për gjurmimet, duke hedhur dritë jo vetëm mbi historinë e gjatë të gjurmimeve në Butrint, por edhe mbi rolin e tij në historinë e Shqipërisë.

³⁰ Dr. Royal është një arkeolog nënujor i njohur dhe me shumë përvojë, i specializuar në mjediset nënujore të Mesdheut, duke përfshirë vlerësimin e anijeve luftarake, strategjive dhe taktikave të lashta në Mesdheun lindor gjatë periudhës romake, dhe vendbanimeve dhe tregtisë greko-romake duke u fokusuar në veçanti në detet e Adriatikut dhe Jonit nga shek. III para Krishtit deri në shek. IV pas Krishtit.

Këto vlera universale të jashtëzakonshme janë ato që e bëjnë Butrintin një burim të rëndësishëm për edukimin, kërkimin, turizmin dhe krenarinë kombëtare. Për rrjedhojë, mbrojtja dhe konservimi i duhur i Zonës A3 dhe zonës mbrojtëse së STB-së janë me rëndësi të jashtëzakonshme.

4.2 Përvojat e mëparshme

Mënyra se si historia dhe arkeologjia shihen, komunikohen dhe mësohen janë pasqyrim thelbësor i mënyrës se si një komb e sheh veten, dhe se si popullsia lidhet me atë komb. Nëse arrijmë të kuptojmë se si një vend i përdor sitet e tij arkeologjike, atëherë do të kemi një udhëzues në lidhje me natyrën e vendit dhe aspiratat e popullit. Të dyja këto ndryshojnë në varësi të rrethanave politike.

Ky është veçanërisht konteksti në Shqipëri, e rrjedhimisht në Butrint, sikundër e tregon historia e të qenit pjesë e Perandorisë Osmane deri në vitin 1913, principatë dhe republikë (1914-1928), mbretëri (1928-1939), subjekt i pushtimit fashist (1939-1944), komunizmit (1944-1992) deri në një demokraci (1992 e në vijim).

4.2.1 Periudha midis luftërave

Historia e Butrintit si pasuri e menaxhuar arkeologjike fillon në vitet 1930. Misioni Arkeologjik Italian, në vitet ndërmjet luftërave, mori fonde për të investuar në sit si destinacion turistik. Kjo ishte qasje standarde, e ndjekur në shumë site arkeologjike dhe historike në Mesdheun e dominuar nga italianët, por pjesërisht ishte edhe justifikim për politikën e arkeologjisë gjeopolitike, që finançohej kryesisht nga Ministria e Jashtme Italiane. Për rrjedhojë, u caktua një kujdestar dhe vizitorëve iu ofroheshin ture me anije ose nga ato anije që udhëtonin nga Korfuzi.

Midis vitit 1928 dhe 1936, arkeologu italian, Luigi Maria Ugolini, gërmoi në një pjesë të madhe të Zonës A3. Kjo për shkak të dëshirës së Musolinit për të shkrirë historinë e Italisë moderne me historinë e Romës perandorake, e përfaqësuar nga personalitete si Çezari dhe Augusti. Si rrjedhojë, puna e Ugolinit u përdor nga qeveria italiane për të promovuar mbetjet romake mbi ato helene,¹¹ dhe u përdor gjerësisht për të justifikuar pushtimin italian të Shqipërisë në prill të vitit 1939: ajo që dikur ishte romake, tani është italiane.

4.2.2 1945-1992

Pas Luftës së Dytë Botërore dhe largimit të forcave pushtuese, Shqipëria u zhvillua si një vend kryesisht Marksist-Leninist nën kontrollin e ish-udhëheqësit antifashist të partizanëve, Enver Hoxha. Midis vitit 1945 dhe rënies së komunizmit në Shqipëri në vitin 1992, arkeologë dhe historianë të arsimuar në Bashkimin Sovjetik bënë përpjekje për të treguar përmes historisë së Butrintit, si dhe shumë siteve të tjera historike, se shqiptarët kishin jetuar dhe kishin mbrojtur tokën e tyre që nga kohët e lashta, si një mënyrë për të hedhur poshtë pretendimet nga vendet fqinje, si Greqia, Italia dhe Jugosllavia (asokohe).

Në periudhën e pasluftës, Butrinti kishte nevojë të konsiderueshme të rikonstruktohej, dhe sistemi italian u rivendos me efektshmëri. Në atë kohë, Butrinti mund të aksesohet nga uji, ndërsa nga toka, rruga ishte thjesht një shteg për mushkat dhe udhëtimi zgjaste tri orë nga Saranda. Në vitin 1952 u

¹¹ Hodges, R (2017) *The Archaeology of Mediterranean Placemaking: Butrint and the global heritage industry*. Bloomsbury Academic, London. Në të vërtetë, puna e Ugolinit ishte thelbësore për krijimin e atraksionit të parë të trashëgimisë kulturore në Shqipëri.

vendos një roje, i cili filloi të angazhonte grupe punëtorësh lokal për të pastruar bimësinë nga monumentet dhe për të sistemuar disi Kalanë në Akropol. Kjo punë praktikisht e restauroi pamjen italiane të sitit, sikundër qe parashtruar nga Ugolini dhe pasardhësit e tij, duke përfshirë të gjitha shtigjet nëpër pyll. Në vijim, ky sistem u vendos si itinerar standard për vizitorët, i cili ekziston edhe sot.

Rruga e parë nga Saranda për në Butrint u ndërtua në vitin 1959. Ajo mbeti rruga e vetme e aksesit deri në rindërtimin e saj në fund të viteve 1970. Kjo rrugë e ngushtë, me kthesa mbeti itinerari kryesor i aksesit deri në vitin 2008, kur u ndërtua rruga e re, më e zgjeruar për të përballuar rritjen e madhe të volumit të trafikut, që në verë bëhej disa kilometra i gjatë.

Në vitet 1970, në Shqipëri u ndërmor një nismë e re turistike, me shumë gjasa si rezultat i përkeqësimit të lidhjeve me Kinën (e cila ishte përfshirë në shumë projekte infrastrukturore në vend asokohe, duke përfshirë edhe disa në Butrint), si dhe i nevojës për të gjetur burime të reja të ardhurash¹². Kjo ishte periudha kur filluan të vinin vizitorë të huaj në Shqipëri gjatë sezonit zyrtar turistik, gjatë periudhës prill-tetor. Në atë kohë, turistët përzgjidheshin nëpërmjet operatorëve turistikë individualë të huaj, që vepronin si agjentë për organizatën Albturist me seli në Tiranë dhe menaxhonin grupe të vogla të kontrolluara turistësh, dhe kontakti me shqiptarët ishte tejet i kufizuar. Krahas kësaj, filloi një projekt për ndërtim hotelesh, me rezultat ndërtimin e 11 hoteleve të reja për turistë, veçanërisht në Sarandë, ku për shembull, ngjitur me Hotelin e vjetër, Epirus Palace, u ngrit në mënyrë madhështore Hotel Butrinti, i cili që u hap në vitin 1979.

Turistëve që vizitonin Butrintin përgjithësisht iu bënte përshtypje arkeologjia dhe mirëmenaxhimi i mjedisit rrethues. Në vitin 1978, u shtrua rruga nga Saranda dhe ferma shtetërore e frutave në Ksamili ishte plotësisht funksionale, sistemi i kullimit ofronte një peizazh të gjelbëruar dhe me lulëzim e me fruta të pjekura të stinës¹³.

Turi në Butrint gjithnjë përfshinte një vizitë në Kalanë e Akropolit. Fillimisht e rikonstruktuar nga italianët, ku në vitin 1940 kishte një oborr me skulptura dhe mozaikë dhe një dhomë e vogël me hapësira me objekte më të vogla. Hyrja për te muzeu kalonte drejtpërsëdrejti përmes portës së madhe veriperëndimore të kalasë. Muzeu u hap zyrtarisht në vitin 1950, duke përfshirë oborrin dhe një pjesë të kullës.

4.2.3 Butrinti në vitin 1993

Me rënien e komunizmit në vitin 1992, Butrinti u bë i cenueshëm ndaj ndikimeve perëndimore, duke përfshirë qasjet ndaj arkeologjisë dhe konservimit.

Kur Fondacioni Butrinti filloi veprimtarinë e tij në vitin 1993, zona ishte një peizazh 'homerik' i pa zhvilluar. Rruga nga Ksamili për në Sarandë deri tek Hotel Butrinti nuk ishte në gjendje të mirë. Në Butrint, nga kanali i Vivarit një lundër e vogël bën itinerarin, me një kapacitet shumë më të vogël sesa ai i lundrës së sotme.

Asokohe, në sit ekzistonin dy lokale të vogla. Njëri gjendej në anë të vendit ku aktualisht është Hotel Livia dhe ishte një restorant i ndërtuar në anë të rrugës që do të përshkonin turistët gjatë viteve 1980. Tavolinat prej betoni mund të shihen ende. Një barakë dhe një kafene e vogël gjendeshin

¹² Hall (1984) *Albania and the Albanians*

¹³ Dawson (1989) *Albania: Guide and Illustrated Journal*

jashtë portës kryesore, poshtë zonës tashmë të rezervuar për vendparkim. Rrënojat e skelës mund të shihen edhe sot.

Elementi fizik më i dallueshëm kur i afroheshe hyrjes së sitit ishte gardhi prej betoni dhe porta që tregonin zonën e brendshme të ruajtur të sitit. Natyrisht, Butrinti i lashtë shtrihej përtej këtij kufiri, por ky gardh kishte pasur një ndikim, dhe ende ndikon fort në interpretimin e asaj që përbënte Butrintin, dhe në shumë mënyra është edhe metaforë për të gjitha vështirësitë që do të ndikonin përpjekjet për të krijuar një infrastrukturë moderne në mbarë Parkun.

4.2.4 Periudha e Fondacionit Butrinti

Objektivat e Fondacionit Butrinti ishin:

1. Realizimi i një hulumtimi arkeologjik interesant, novator dhe modern
2. Trajnimi i arkeologëve shqiptarë mbi teknikat arkeologjike moderne
3. Asistencë për konservimin e monumenteve të sitit
4. Asistencë për ngritjen dhe zhvillimin e një parku arkeologjik me një strukturë të modeluar sipas shembujve perëndimorë të kohës, që të vepronte si shtysë e rigjenerimit ekonomik lokal dhe model për zhvillime të ngjashme në vende të tjera.

Që në fillimet e veta, Fondacioni provoi të sillte ide dhe koncepte të reja në Shqipëri. Një nga qëllimet kryesore ishte zhvillimi i një projekti model madhor, që merrte përsipër përgjegjësinë e realizimit të projekteve kërkimore në fushat e konservimit, interpretimit dhe paraqitjes. Burimet e disponueshme mundësonin qasjen me një mënyrë të caktuar për arritjen e këtij qëllimi. Megjithatë, drejtimi i veprimtarisë ishte hedhja poshtë e modelit të "gërmimit dhe lënies", që shpeshherë është një nga kritikrat më të mëdha për ndërhyrjet arkeologjike të huaja në Mesdhe dhe gjetkë.

Pavarësisht qasjes pozitive dhe të përparuar, vitet e para të projektit të Fondacionit Butrinti u karakterizuan nga tensione midis Fondacionit dhe autoriteteve përgjegjëse lokale. Kjo ndodhi kryesisht me Institutin e Arkeologjisë, që asokohe ishte një organ kërkimor i pavarur, përgjegjës për arkeologjinë e nëndheshme. Monumentet ishin nën mbrojtjen e Institutit të Monumenteve Kultures, në varësi të Ministrisë së Kulturës, ndërsa pylli menaxhohej nga Ministria e Mjedisit. Burimi i këtij tensioni ishte qasja kryesisht britanike e Fondacionit ndaj gërmimit, regjistrimit dhe konservimit që binin ndesh me atë shqiptare. Kjo nuk ishte befasuese, duke marrë parasysh metodën e izoluar me të cilën ishin aplikuar qasjet shqiptare ndaj arkeologjisë gjatë pesëdhjetë viteve të komunizmit. Përpos këtyre, tensioni lindi edhe së brendshmi, midis ministrive dhe drejtorive përgjegjëse në Shqipëri.

Megjithatë, zgjidhja e pazakontë që i dha bashkëpunimi anglo-shqiptar ishte e suksesshme. Kjo periudhë shërbeu si mësim për të dyja palët, dhe Fondacioni e kuptoi se modeli perëndimor i zhvillimit dhe menaxhimit nuk mund të përcillej pa modifikime¹⁴. Pikëpamja shqiptare për Butrintin, mjedisin dhe arkeologjinë e tij kishte baza të forta, ndërsa qasja britanike mund të konsiderohej si tepër e përqendruar dhe tepër specifike.

¹⁴ Elementi i të nxënit, për shembull, përqendrohej në parimet më bazike, diçka që në Evropën Perëndimore do të shihej si qesharake, por asokohe në kontekstin e Shqipërisë ishin ideale.

Shkurtimisht, Fondacioni Butrinti ra në një farë mënyrë viktimë e paradoksit të përjetshëm të projekteve të ndihmës: 'dëshira për të ndihmuar kthehet në nevojë për të kontrolluar'¹⁵. Përpjekja e Fondacionit për ngritjen e një strukture perëndimore mbi një mjedis të huaj do të haste padyshim pengesa. Projekti arriti ta realizonte premtimin e tij vetëm në fillim të shekullit 21 kur e kishte marrë këtë mësim.

Nuk ka shumë dyshime se në disa aspekte, projekti Fondacioni Butrinti qe i suksesshëm, pasi solli ide dhe koncepte të reja, që u pranuan në shkallë kombëtare, si dhe i bëri "vend" vetes me anë të punës kërkimore dhe asaj në terren¹⁶.

Fakti që ekzistojnë të dhëna rreth Parkut Kombëtar të Butrintit është pjesërisht rezultat i drejtpërdrejtë i punës së Fondacionit. Me kalimin e viteve u krijua një arkivë e madhe, e cila është e disponueshme në formën e botimeve, por edhe në formën e bazës së të dhënave, dhe mbulon shumë aspekte shkencore, duke filluar nga menaxhimi i ujit, flora dhe fauna e egër, teknikat bujqësore, arkeologjia e deri te menaxhimi i vizitorëve. Për shembull, Fondacioni Butrinti ishte përgjegjës për kryerjen e një sërë ndërhyrjesh të regjistruara, cilësore dhe parimore, në të cilat mbështetet edhe ky Plan i Menaxhimit të Integruar për Parkun Kombëtar.

Krahas kësaj, qasja e Fondacionit ndaj konservimit të arkeologjisë, pra ruajtja e sa më shumë të dhënave në formë fizike të konservuar dhe të gërmuar më parë, tekta ruhet identiteti i vendit me kaq rëndësi si monument unik, qe fokusi i punës dhe la një trashëgimi të madhe. Koncepti i ndërhyrjeve të kujdesshme në strukturë dhe ruajtja e kuptimit thelbësor të vendit është zbatuar plotësisht nga ky Plan Menaxhimi të Integruar.

Megjithatë, Fondacioni nuk ishte përgjegjës vetëm për punimet arkeologjike, por shqyrtoi dhe zbatoi një sërë programesh, trajnimesh dhe mundësish edukimi për mbarë Parkun Kombëtar. Të njëjtat gjëra vlejnë edhe sot.

4.3 Mësimet e nxjerra

Përvoja e Fondacionit Butrinti solli një sërë mësimesh të rëndësishme që gjetën zbatim në mbarë Parkun Kombëtar. Ato mund të përmbliken në katër fusha kryesore:

4.3.1 Angazhimi i komunitetit

Një pengesë kryesore në suksesin e projektit të Fondacionit Butrinti ishte pikërisht mosangazhimi i komunitetit lokal. Në teori, qasja ndiqte rrjedhën nga poshtë-lart, por si pasojë e burokracive në të shkuarën, në praktikë interesat e autoriteteve të centralizuara shkonin përtej opinionit të vendasve. Gjatë hartimit të planit të parë të menaxhimit (2001-2005) për Butrintin, u zhvilluan një sërë tryezash me palë lokale interes.

Përgjithësisht, palët e vërteta të interesit nuk përfaqësoheshin plotësisht dhe shqetësimet e tyre pragmatiste dhe të ngutshme nuk trajtoheshin asnjëherë¹⁷. Si rrjedhojë, ata nuk e patën mundësinë për të vjelë përfitimet praktike të ekzistencës së planit apo të vetë Parkut.

¹⁵ Maren (2002) *The Road to Hell: The Ravaging Effects of Foreign Aid Projects*

¹⁶ Hodges 2016 *The Archaeology of Mediterranean Placemaking*. Bloomsbury Academic.

Kjo çështje mbetet thelbësore për hartimin e strategjive për trajtimin e rritjes së numrit të vizitorëve në Butrint. Vizitorët mund të nxiten që të vizitojnë mbarë territorin e Parkut vetëm me bashkëpunimin e komunitetit.

Pra, ndërveprimi më i mirë me komunitetin është thelbësor për suksesin e Fondacionit të Ri. Duhet të ofrohen zgjidhje në nivel vendor, dhe jo të krijohen probleme, sidomos në kuptimin e hierarkisë së marrëdhënies. Me këtë qëllim, mund të nevojitet të bëhen kompromise, veçanërisht për të trajtuar shqetësimet e mundshme të UNESCO-s, dhe sigurisht për të përmbushur nevojat e konservimit të arkeologjisë të mbarë Parkut, si dhe të komunitetit lokal.

Gjithashtu, angazhimi proaktiv më efikas me komunitetet lokal është një aspekt, të cilit i duhej kushtuar më shumë rëndësi që në planin fillestar të menaxhimit, por edhe nga ana e stafit të Parkut, të cilët ishin vetë të patrajnuar për një rol të tillë. Një sërë mbledhjesh me stafin e parkut, dhe në rastin më të mirë, me përfaqësues të institucioneve në Tiranë, të mbajtura në fshatrat përreth, do të kishin kontribuar në gjetjen e një rruge komunikimi.

4.3.2 Trajnimi

Natyrisht, trajnimi i duhur dhe intensiv ka rëndësi madhore edhe për të gjithë stafin e parkut. Çështja më madhore e nxjerrë në pah që në vitet 1990 ishte mungesa e përvojës dhe proaktivitetit dhe mendësia e përbashkët e stafit të parkut. Ndonëse kjo mund të jetë një çështje sistematike, ajo duhet që të trajtohet në të gjitha aspektet. Problemet nuk lindin vetëm gjatë vendimmarrjeve të rëndësishme, por ato janë të dukshme edhe në nivelet më të ulëta të hierarkisë vendimmarrëse, dhe simptomat e tyre mund të jenë shmangia e përgjegjësisë, dhe mbështetja tek autoriteti më i centralizuar.

Regjimi i duhur i trajnimit mund të ndikojë shumë në shmangien e pasivitetit, dhe të qenit aktiv do t'iu kërkohet si kusht punësimi të gjithë punonjësve të Fondacionit të Ri. Trajnimi teknik do të rrisë nivelin e besimit. Dhënia e përgjegjësisë për të marrë vendime, veçanërisht për alokimin e fondeve të projektit, i mbështetur nga një ekip i mirë menaxhimi, do të konsolidonte aftësinë për të kuptuar dhe për të vënë në lëvizje menaxhimin e duhur, sigurisht për ata që do të tregojnë vullnetin e duhur.

Një program mentorimi do të ishte një alternativë e mirë në vend të trajnimit bazë, gjë që vlen për periudhën e tranzicionit. Specialistët e huaj mund të mbikëqyrin dhe të ofrojnë përvojën e tyre përmes kontratave me afat të përcaktuar. Rreziku që duhet shmangur, është krijimi i varësisë nga kjo ndihmë, ndërkohë që struktura e menaxhimit duhet të jetë tërësisht shqiptare që punon dhe zhvillon bazuar brenda një kuadri të përcaktuar prej saj.

4.3.3 Konservimi

Pavarësisht kësaj, ose mbase për shkak të saj, ndërhyrjet konservuese dhe restauruese nga Fondacioni Butrinti kanë qenë në një nivel minimal dhe këto ndërhyrje të lehta përfshinin menaxhimin e pyjeve dhe konservimin e disa ndërtesave. Projekte madhore të mëparshme kanë rikonstruktuar një pjesë të "*scenae frons*" (ndërtesë për skenën) të teatrit dhe Portën e Luanit, në vitet 1960 dhe 1970.

¹⁷ Natyrisht që ky është problem i përgjithshëm në mbarë botën kur merren parasysh organet ndërkombëtare, si parqet dhe rezervatet <https://www.theguardian.com/environment/2009/apr/08/south-downs-national-park>. Ndonëse njihen gjerësisht, këto problematika rrallëherë trajtohen.

Këto punime kanë kërkuar ndërhyrje të mëdha inxhinierike, dhe gjatë kohës së Fondacionit Butrinti, është ushtruar trysni nga ana e qeverisë për të ndërmarrë projekte, veçanërisht në lidhje me konsolidimin e murit rrethues të qytetit, që ose ishin të panevojshme ose shumë të tepruara. Ky ka qenë pjesërisht rezultat i disponueshmërisë së fondeve, ndaj Fondacioni i Ri duhet të tregohet i kujdesshëm në këtë aspekt. Krahas kësaj, projektet kishin prirjen të trajtonin probleme të dukshme dhe me pak rëndësi (restaurimi i afreskut dhe elementeve të ngjashme), dhe shpërfillnin problemet e mëdha, si konsolidimi i murit rrethues të qytetit.

4.3.4 Kërkimi

Butrinti është një sit që ofron mundësi shumëdisiplinore. Për disa nga kërkimet kërkohen ndërhyrje minimale, ndërsa për disa të tjera kërkohen ndërhyrje më të thella.

Qasja perëndimore është në mbështetje të ndërhyrjeve minimaliste, dhe veçanërisht në fushën e arkeologjisë, është mbajtur një qëndrim që kundërshton çdo lloj ndërhyrjeje e cila nuk është e nevojshme për të shpëtuar objektin, pra ndërtesat dhe punimet e tjera zhvillimore. Megjithatë, ky skenar është i panjohur në traditën arkeologjike të Mesdheut.

Veçantia e Butrintit nuk vjen vetëm falë ndërthurjes së mjediseve njerëzore dhe natyrore ose vendndodhjes topografike, ndonëse këto janë elemente kyçe, por falë faktit që është vend ku ka shumë për të zbuluar, një qendër magjie që ngjall interes dhe ngre pyetje. Kjo është bërthama e siteve të këtij lloji, pasi ajo çfarë është zbuluar këtu mund të përcillet në mënyrë të përgjithësuar, duke ndërtuar profilin dhe duke tërhequr interesin e publikut. Ndonëse të vogla, dhe siç rezultoi të gabuara, zbulimet nxisin shkrimin e artikujve për Sitin e Trashëgimisë Botërore¹⁸.

Prandaj, rëndësia e Grupit Kërkimor të Butrintit dhe e veprimtarive të tij duhet të shihet si pjesë e pandashme e motorit të Fondacionit të Ri, që duhet të ketë një interes proaktiv për funksionimin, veprimtaritë, nxitjen e risive, projekteve të vyera dhe promovuese, si dhe bashkëpunimit në nivelin botëror.

4.3.5 Ndikime më të gjera

Plani për Menaxhimin e Butrintit për vitet 2001-2005¹⁹ parashikonte hartimin e një udhërrëfytyesi për Butrintin. Përfundimet e tij kyçe vlejné ende sot:

... zbatimi është kyç. Menaxhimi i Parkut Kombëtar të Butrintit duhet të ketë në dispozicion burimet dhe instrumentet ligjore për të përmbushur detyrat thelbësore. Këto detyra përfshijnë konservimin dhe përmirësimin e sitit të Butrintit, në mënyrë që të mbetet pjesë jetike e trashëgimisë së Shqipërisë dhe njëkohësisht të kthehet në burim për rigjenerimin ekonomik të rajanit.

Parimet e konservimit, përmirësimit dhe zhvillimit të burimeve njihen dhe janë aplikuar tërësisht në këtë Plan Menaxhimi të Integruar, dhe të gjitha ofrojnë bazën për zbatim të efektshëm.

Problematika me Butrintin nuk qëndron te mungesa e ideve parimore, pasi thuhetse çdo material akademik apo raport i referohet atij, por tek mungesa e menaxhimit të efektshëm, për t'i mundësuar Sitit dhe mbarë Parkut Kombëtar të funksionojë në mënyrë të efektshme dhe efikase.

¹⁸ Një shembull është Guri i shahut, i gjetur në Butrint <http://news.bbc.co.uk/1/hi/world/europe/2155916.stm>

¹⁹ Martin S (2001) Plani i Menaxhimit të Butrintit. Fondacioni Butrinti.

Ky konstatim nuk është pasqyrim i punës së stafit, pasi të gjithë punonjësit dëshirojnë më të mirën për sitin. Në fakt, është konstatim i përgjegjësive të paqarta, mbase të nënfinancuara, por në thelb të mbivendosura të agjencive të përfshira në mirëqenien afatgjatë të Sitit, shoqëruar kjo me paqartësinë e përgjegjësive për mbikëqyrjen e Zonës A3 dhe mbarë Parkut Kombëtar.²⁰

Idetë dhe nismat dashamirëse të ndërmarra nga Fondacioni Butrinti në vitin 1993 (dhe veçanërisht ndërmbet vitëve 2000 dhe 2012) janë penguar nga mungesa e drejtimit të qartë dhe të përqendruar, dhe mbi të gjitha, nga mungesa e mekanizmave për ndërmarrjen dhe vazhdimësinë e ndërhyrjeve në mbarë Parkun, si në shkallë kombëtare ashtu edhe vendore. Ndaj, problematika nuk lidhet me mungesën e ideve ose të vullnetit, por me menaxhimin dhe realizimin.

Mësimet që duhen marrë parasysht në lidhje me qëndrueshmërinë janë si vijon:²¹

1. Nevoja për një gjuhë të përbashkët dhe të qëndrueshme lidhur me koncepte të përbashkëta për konservimin e vendeve kulturore dhe natyrore, në mbarë vendin.
2. Njohja e ndikimeve ekonomike (dhe sociale) të punës nga ana e arkeologëve (dhe specialistëve të tjerë).
3. Njohja e rolit të rëndësishëm që luajnë vlerat joekonomike në konservimin e pasurive kulturore (dhe natyrore), si dhe përshtatshmërisë së tyre afatgjatë në të mirë të njerëzimit.
4. Nevoja për një qasje gjithëpërfshirëse ndaj [realizimit] të të gjitha planeve të menaxhimit.
5. Drejtuesit duhet të punojnë me efektshmëri në të gjitha nivelet, duke ofruar mundësi për ngritjen e kapaciteteve në të gjitha aspektet e menaxhimit të trashëgimisë kulturore (dhe natyrore).
6. Krijimi i shenjës dalluese (markë) të Butrintit dhe promovimi i saj tek audienca të ndryshme [si brenda dhe jashtë sitit].
7. Investimi në mbështetje teknike që nevojiten për të realizuar (dhe vijuar me) raportim të saktë të elementeve arkeologjike (dhe natyrore) të Parkut.
8. Investimi në konservimin përmes praktikave më të mira, duke përfshirë kthimin në gjendjen e mëparshme.
9. Trajnimi dhe ngritja e kapaciteteve në të gjitha aspektet e menaxhimit të trashëgimisë, duke përfshirë reklamimin, interpretimin, kërkesa për grante dhe pjesëmarrjen e komunitetit.

Këto nuk janë vetëm pikëpamje me vlerë. Realizimi i tyre në kuadrin e këtij Plani Menaxhimi të Integruar, është thelbësor për garantimin e mirëqenies së Zonës A3 dhe mbarë Parkut Kombëtar në planin afatgjatë.

Tri parimet më të rëndësishme që rrjedhin nga kjo analizë janë:

1. Qëllimi kryesor duhet të jetë kryerja e ndërhyrjeve të lehta dhe ndjekja e qasjeve të kthyeshme të konservimit, që në çdo rast ruajnë identitetin e vendit përgjatë Zonës A3 dhe mbarë Parkut Kombëtar;

²⁰ Hodges, R (2017) *The Archaeology of Mediterranean Placemaking: Butrint and the global heritage industry*. Bloomsbury Academic, London.

²¹ Hodges, R (2017) *The Archaeology of Mediterranean Placemaking: Butrint and the global heritage industry*. Bloomsbury Academic, London, drawing on the work of Linn J (2014): Koment: koncepte të arkeologjisë dhe zhvillimit ekonomik; *Public Archaeology*, 13: 85-90.

2. Nxitja dhe mirëmbajtja e programeve të trajnimit për të gjitha veprimtaritë në lidhje me sitin, pa përjashtuar menaxhimin e trashëgimisë, reklamimin, interpretimin, kërkesa për grante, pjesëmarrjen e komunitetit dhe punimet për konservimin;
3. Njohja e dobisë dhe vlerës së angazhimit të komuniteteve lokale në realizimin e synimeve të Parkut në planin afatgjatë. Mbështetja e tyre është jetike.

Mirëqenia e ardhshme e Parkut dhe e njerëzve që jetojnë aty dhe rreth tij janë të ndërlidhura: Parku ka nevojë për mbështetjen e të gjitha palëve për të lulëzuar, dhe nga ana tjetër, njerëzit duhet të përfitojnë nga zhvillimet në Park, të cilat duhet të jenë të dukshme.

4.4 Konservimi i monumentit

Është e qartë se qasja modeste është rruga e duhur drejt mirëmbajtjes së Zonës A3 dhe monumenteve të tjera brenda Parkut. Megjithatë, kjo nuk duhet të pengojë ndërhyrjet në dy fusha si më poshtë:

- Zona pyjore kërkon menaxhim proaktiv dhe të konsoliduar. Pastrimi i rregullt i barit dhe shkurreve, mbajtja pastër e zonës rreth monumenteve dhe rritja e pyllit me një kurorë, kërkojnë veprime pozitive.
- Ndonëse shumica e monumenteve brenda Zonës A3 kërkojnë pastrim dhe konsolidim të përshtatshëm, ekzistojnë disa probleme që kanë kosto të konsiderueshme dhe kërkojnë ndërhyrje të menjëhershme. Ato përshkruhen në Planin e Konservimit, në përmbajtje të Shtojcës C.

Qasja e ndjekur nga Fondacioni Butrinti për mirëmbajtjen dhe mbështetjen afatgjatë të sitit, ka garantuar që "identiteti e vendit" të konsiderohet përparësi absolute. Kjo përshkruhet në hollësi në punimin "Archaeology of Mediterranean Placemaking: Butrint and the Global Heritage Industry"²² dhe ka qenë tejet bindëse në përcaktimin e qasjes për menaxhimin dhe zhvillimin e qytetit antik dhe mbarë parkut kombëtar.

Ekzistojnë shumë shembuj të "restaurimeve" tërësisht të papërshtatshme brenda dhe rreth qyteteve antike në Mesdheun lindor. Kjo nuk është kurrësi rruga që duhet të ndjekë Butrinti.

Kanë lindur debate në lidhje me përkufizimet e "restaurimit" dhe "konservimit", të cilat janë kyçe për të ardhmen e Butrintit. Dallimi kryesor qëndron në faktin që "konservimi" mbron strukturën e sitit për të mundësuar brezat e ardhshëm të vrojtojnë çdo fazë të zhvillimit të sitit, ndërsa "restaurimi" e fikson monumentin në një datë të supozuar në të kaluarën, duke mos mundësuar kërkimet dhe vrojtimit në të ardhmen.

Nëse synohet që Butrinti të bëhet model për pjesën tjetër të Shqipërisë, Ballkanin dhe Mesdheun lindor, duhet të bëjmë përpjekje për ruajtjen e integritetit të vendit, për orientimin e brezave të ardhshëm, për angazhimin e komuniteteve lokale, për ruajtjen e ndërthurjes së vendit antik dhe peizazhit modern, në mënyra domethënëse.

Ndaj, qasja e rekomanduar për konservimin e arkeologjisë duhet të synojë ruajtjen e sa më shumë informacioneve, në formë fizike të gërmuar më parë, për brezat e ardhshëm, ndërkohë që ruhet "identiteti i vendit" si një monument unik.

²² Hodges, R. (2017) *The Archaeology of Mediterranean Placemaking*, Bloomsbury Academic, London

Politikat specifike dhe rekomandimet për menaxhimin në lidhje me burimet kulturore të Butrintit detajohen në *Konservimin e Zonës A3 dhe Monumenteve përreth*, të përfshira në Shtojcën C të Planit të Menaxhimit të Integruar.

4.0 Burimi kulturor – Pika kyçe

- Së bashku me zonën përreth tij, Butrinti përbën një peizazh kulturor të jashtëzakonshëm, që është zhvilluar në mënyrë të natyrshme për shekuj të tërë.
- Potenciali për zbulime të reja arkeologjike është tepër i madh, pasi shumë pak nga arkeologjia e Butrintit është gërmuar përtej zonës brenda mureve.
- Eksperiencia e Fondacionit Butrinti ka rezultuar në një sërë mësimesh të rëndësishme me ndikime për mbarë Parkun Kombëtar.
- Konservimi, gërmimi i vazhdueshëm dhe promovimi i Zonës A3 duhet të ndjekë metodat dhe standardet e vendosura që në vitin 1993 nga Fondacioni Butrinti.
- Trajnimi i duhur dhe intensiv në terren dhe në bashkëpunim me stafin është tejet i rëndësishëm.
- Integriteti dhe autenciteti i vendit do të ruhet nëpërmjet praktikave më të mira të drejtimit dhe menaxhimit në mënyrë që të optimizohen vlerat e tij shkencore dhe të qenësishme
- Potenciali turistik dhe edukativ i Parkut Kombëtar do të zgjerohet nëpërmjet një programi kërkimi, gërmimi, konservimi dhe monitorimi.

5.0 BURIMI NATYROR



5.0 BURIMI NATYROR

Kompleksi ligatinor i Butrintit përfaqëson një nga zonat ligatinore bregdetare më të rëndësishme në Shqipëri, që përdoren si vende strehimi për një numër të madh shpendësh shtegtarë ujorë. Krahas kësaj, është një nga habitatet pyjore përherëblierta përgjatë bregdetit shqiptar që mbizotërohet nga ilqet (*Quercus ilex*).

Ekosistemi ligatinor i Butrintit është një zone me biodiversitet të pasur, me larmi habitatesh dhe llojesh. Mjafton të përmendim se në të gjenden rreth 247 lloje shpendësh, prej të cilëve 70% janë shpendë ujorë; 9 lloje amfibësh dhe 25 lloje reptilësh që përfaqësojnë rreth 60-75% të herpetofaunës së vendit tonë; rreth 39 lloje gjitarësh, ose afro 60 % e mamalofaunës së vendit tonë. Ujërat e ëmbla dhe të njelmëta të kompleksit ligatinor të Butrintit janë të populluara nga një numër llojesh me rëndësi të veçantë, ndër të cilët veçojmë lundërzën (*Lutralutra*), ndërsa habitatet detare janë mjedise të përshtatshme për breshkat e detit (*Carettacaretta*), delfinët turishkurtër (*Tursiopstruncatus*) dhe ndonjëherë edhe fokën e Mesdheut, e cila është globalisht e kërcënuar (*Monachusmonachus*).

Rreth 140 lloje bimësh dhe kafshësh të PKB-së janë me Rëndësi për Ruajtje, ndërsa 35 lloje kafshësh kanë interes ruajtjeje globale (IUCN, 2001). Mosfunksionimi i sistemit kullues të periudhës së komunizmit gjatë dekadës së fundit ka krijuar në mënyrë të paqëllimshme ligatina në pjesën perëndimore të fushës së Vrinës, duke shtuar vlerat e biodiversitetit të të gjithë zonës Ramsar.

Mirëmbajtja e këtyre ligatinave të reja është me rëndësi kritike për ruajtjen e integritetit ekologjik të gjithë kompleksit ligatinor të zonës Ramsar të Butrintit.

Rritja e pemëve ngjitur me muret rrethuese kërkon trajtim dhe mirëmbajtje të vazhdueshme pasi paraqesin një tjetër kërcënim për Zonën A3 në aspektin e bimësisë dhe hidrologjisë, pa anashkaluar rrezikun e zjarrit, që përbën shqetësim kryesor për menaxhimin. Niveli i ujit është i ndryshueshëm dhe shkakton përmbytje, erozion dhe trysni mbi dyshemetë me mozaikë, dhe për pasojë nevojitet trajtim për parandalimin e formimit të algave dhe zhvillimin e larvave të mushkonjave.

5.1 Parku Kombëtar i Butrintit

Statusi ekologjik i Parkut Kombëtar të Butrintit është kyç për ruajtjen e vlerave të biodiversitetit natyror dhe shërben edhe për mbrojtjen dhe qëndrueshmërinë e Siti të Trashëgimisë Botërore, si dhe habitatit ligatinor, i njohur nga Konventa e Ramsarit. Ekziston nevoja e domosdoshme për të bindur qeverinë që të zbatojë praktikat akuakulturore dhe bujqësore të qëndrueshme për qëllime tregtare, që do të sjellin fitime ekonomike të vërteta, si për komunitetet lokale, ashtu edhe për vendin në tërësi.

Lagunat bregdetare janë ekosistemet më të ndjeshme dhe më të rëndësishme në Shqipëri. Ato janë zona me vlera dhe përdorime të shumta ekologjike dhe ekonomike, ofrojnë habitate të jetës së egër, mbështetin biodiversitetin dhe mundësojnë hapësira me vlera të mëdha estetike.

Pavarësisht rëndësisë së tyre ekologjike, rreth 50% e zonave lagunore kombëtare në Shqipëri kanë humbur si pasojë e projekteve të landfilleve dhe të kullimit, që prej viteve 1950, ndërkohë që zhvillimet industriale, urbane dhe bujqësore vënë më tej në rrezik cilësinë dhe natyrën e rrjedhave të ujit përmes këtyre ligatinave unike.

Parku kombëtar i Butrintit përfaqëson një zonë me habitate të rëndësishme pyjore, detare dhe lagunore, me rëndësi kombëtare dhe ndërkombëtare, ku përmenden vecanërisht Lista e habitateve të pranishme në zonë (sipas listës së habitateve me rëndësi për komunitetin Evropian):

- Brigje ranore të mbuluara lehtësisht nga ujrat detare gjatë gjithë kohës
- Livadhe të Posidonieve (*Posidonion oceanicae*)
- Laguna bregdetare
- *Salicornia* dhe lloje të tjera njëvjeçare që kolonizojnë toka argjilore dhe ranore
- Livadhe të kripura mesdhetare (*Juncetalia maritimi*)
- Formacione shkurrëzash halofitike Mesdhetare dhe Termo-Atlantike (*Sarcocornetea fruticosi*)
- Shkorretë me *Laurus nobilis*
- Pyje të përzier riparianë të *Quercus robur*, *Ulmus laevis* dhe *Ulmus minor*, *Fraxinus excelsior* ose *Fraxinus angustifolia*, përgjatë lumenjve të mëdhenj (*Ulmion minoris*)
- Galeri apo breza shkurre ripariane Jugore (*Nerio-Tamaricetea* dhe *Securinegion tinctoriae*)




Figura 9: Harta e Mbulesës bimore në PK Butrint

5.1.1 Liqeni i Butrintit

Ndryshe nga shumica e lagunave bregdetare në Shqipëri, Butrinti i rrethuar nga shpate të thepisura me gurë dhe, është unik për arsye se ka një thellësi mesatare prej 11 metrash dhe thellësi maksimale prej 22 metra dhe përfaqëson një mjedis fizik të qëndrueshëm. Laguna e Butrintit është tejet e jashtëzakonshme falë popullatës së peshqve, e shtuar nga akuakultura e kultivimit të midhjeve.

Cilësia e ujit të Liqenit të Butrintit ndikohet nga prurja e ujërave nga lumi Bistrica, përmes një kanali të lidhur me lumën, gjatë muajve të pikut, prill-gusht, gjë që favorizon kushtet për kultivimin e midhjeve. Në liqen ose lagunë rrjedhin ujëra të kripura përmes Kanalit të Vivarit. Ndër pasojat afatgjatë të mungesës së kullimit është favorizimi i kushteve eutrofike në liqen, që mund përshpejtojë vdekjen e gjallesave të tij. Kushtet e mira të liqenit janë kritike për ekosistemin ligatinor dhe biodiversitetin e Parkut, dhe rrjedhimisht për tërheqjen e turistëve në Butrint.

Në vitin 1994, pas shpërthimit epidemik të kolerës, Bashkimi Evropian (BE) ndaloi të gjitha eksportet e produkteve të gjalla nga peshkimi, gjë që shkatërroi prodhimin e midhjeve në Shqipëri. Duke filluar nga vitet 1960, midhjet prodhoheshin për tregti, kryesisht në lagunën e Butrintit, kur prodhimi vjetor varionte nga 2,000 tonë deri në 5,000 tonë maksimumi, në vitin 1989. Prodhimi aktual është rreth 1,000 tonë. Tashmë kanë kaluar 20 vjet që ndalimi i BE-së për eksportin e midhjeve është në fuqi.

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dëshiron ta ndryshojë këtë situatë, duke eliminuar kufizimet e eksportit të hasura nga industria e akua-kulturës në përgjithësi, dhe industria e midhjeve, në veçanti. Fondet e BE-së kanë mundësuar ngritjen e një sistemi për testime dhe inspektime të besueshme, në mënyrë që të vlerësohet përputhshmëria me standardet rregullatore, që mbështeten në monitorimin dhe përmirësimin ekologjik.

Heqja e ndalimit të eksportit të produkteve të gjalla nga BE-ja dhe rigjallërimi i prodhimit të midhjeve në Butrint kërkon investime në praktika më të qëndrueshme bujqësore dhe akuakulturore. Në këtë mënyrë, cilësia e midhjes së Butrintit mund të shihet si barometër i efektshëm i mirëqenies së ekologjisë në të gjithë Parkun Kombëtar.

Një ndryshim i tillë duhet të jetë i gjithanshëm, të përvetësojë një frymë të zhvillimit dhe përmirësimit të ekosistemeve, të trajtojë problematikat lidhur me monokulturën, të zbatojë kullotjen ekologjike dhe ndër të tjera, të heqë dorë nga mbetjet plastike. Në mbështetje të këtij qëllimi, duhet të ndërmerren nisma për ngritjen e kapaciteteve, trajnimin dhe menaxhimin e qëndrueshëm, të mirinformuar, të efektshëm në të gjitha nivelet, duke i dhënë Butrintit potencialin për t'u bërë "Qendër Ekselence" në këto fusha.

5.2 Rëndësia e Burimeve Natyrore

Sikundër e kanë përshkruar planet e mëparshme dhe materialet e tjera referuese, vlera e Parkut Kombëtar të Butrintit si burim natyror është me rëndësi madhore. Megjithatë, zona përreth Butrintit është në rrezik nga shfrytëzimi i skajshëm i tokës për projekte zhvillimore (kërkesat për struktura turistike dhe banesa të vendasve janë shtuar), për qëllime rekreative (turizëm) dhe për qëllime bujqësore (tregje të reja të mundshme). Është paradoksale, por vlen të themi se këto rreziqe që i kanosen Parkut Kombëtar do të rritin rëndësinë e sitit si vend i mbrojtur në të ardhmen.

Rëndësia shkencore e burimit natyror përshkruhet më poshtë, duke marrë në konsideratë sa të rralla dhe të cenueshme janë speciet, dhe duke kaluar nga niveli ndërkombëtar në atë vendor:

5.2.1 Vlera ndërkombëtare

- Vlera ndërkombëtare e zonës së Butrintit është e mirënjohur edhe nga vetë fakti që përfshihet në listën e habitateve të shpendëve të rëndësishëm në Evropë (Grimmet dhe Jones 1989). Kjo për arsye të ekzistencës së popullatës dimëruese të karabullakëve të vegjël, dhe vërejtje e vetëm një kojliku sqepbollë. Ndër speciet e tjera të cenueshme në nivel

ndërkombëtar, që janë vrojtuar në Butrint, përmendim shqiponjën e detit, lundërzën dhe breshkën e zakonshme. Krahas këtyre, breshkujca evropiane dhe breshkujca qafëshiritore renditen si specie në rrezik në Evropë.

- Gjithashtu, Parku Kombëtar i Butrintit ka habitate të rrezikuara, që njihen në rang ndërkombëtar. Këtu përfshihet kënetat ujëmbël në grykë të kanalit të liqenit Bufi, si dhe ishujt nën nivelin e detit të mbuluar nga kënetat ujëkripur në grykë të Kanalit të Vivarit dhe liqenit Alinura.

5.2.2 Vlera kombëtare

- Zona e Butrintit renditet si një nga 13 ligatinat më të rëndësishme për shpendët në Shqipëri (Grimmet dhe Jones 1989). Ky status i është dhënë pjesërisht për numrin e specieve të renditura, të njohura si specie në rrezik në nivel ndërkombëtar;
- Në rastin e zvarranikëve dhe amfibëve, Butrinti renditet si zona më e pasur në Shqipëri (Grimmet dhe Jones 1989). Prania e lundërzës, dhe një larmi e madhe specimesh bimore, që konsiderohen të rralla në Shqipëri, i shton më tepër vlerën;
- Habitati i përbërë nga pyje me lisa, ndonëse i fragmentuar, është kryesisht në zhdukje në Shqipëri, ndaj ka rëndësi kombëtare.

5.2.3 Vlera kulturore

Vlera kulturore e burimit natyror përcaktohet në kuptimin e rëndësisë estetike dhe historike të peizazhit dhe vlerës së tij ekonomike për komunitetet lokale.

- Marrëdhënia simbiotike midis njeriut dhe mjedisit i jep rëndësi më të madhe peizazhit, historisë dhe arkeologjisë së vendbanimit të Butrintit
- Lidhjet historike janë një aspekt i rëndësishëm i vlerës historike të peizazhit. Ato përfshijnë nga hartat veneciane të shek. 16 me përshkrimet e peizazhit të shek. 19 e deri te tregimi i Plutarkut se si krijesat dhe nimfat e liqenit të Butrintit (Pelodes) qanë me dënësë kur morën lajmin e vdekjes së Panit (Plutarch: Moralia V);
- Shfrytëzimi i tokës dhe ekonomia lokale pasqyrohen në historinë e peizazhit. Burimet historike tregojnë për rëndësinë e pyjeve të Butrintit si lëndë drusore që përdoren për ndërtimin e anijeve dhe për eksport. Po ashtu, të dhënat për eksportin e peshkut dhe bagëtisë tregojnë ekzistencën e gjatë të rrjetave të peshqve dhe përdorimit të tokës për kullotje. Kasollet dhe vathët që i përkasin traditës së barinjve sezonalë nomadë i shtojnë një dimension ndërhyrjeve të njeriut për formimin e peizazhit (Hammond 1967; Winnifrieth 1987).

5.2.4 Vlera estetike

- Parku Kombëtar i Butrintit mbulon një zonë me një bukuri të jashtëzakonshme natyrore. Peizazhi është i mrekullueshëm me veçoritë e tij të larmishme, duke filluar nga malet e larta, fushat, kënetat, liqenet deri te bregu i detit. Mungesa e jetës gjatë shek. 20 është mbase veçoria më domethënëse e Parkut (Marchini Camia: 1999). Vizitorët i tërheq peizazhi krejtësisht "i zbrazët", ku nuk mbizotërojnë ndërhyrjet e njeriut, por janë në harmoni me natyrën. Ende përdoren metodat tradicionale në bujqësi dhe e kthejnë vëzhguesin pas në kohë për t'i kujtuar një mënyrë jetese që tashmë është harruar në pjesën më të madhe të Evropës.

5.2.5 Vlera ekonomike vendore

- Territori brenda Parkut Kombëtar të Butrintit ofron një burim të pasur për peshkim dhe bujqësi për komunitetet lokale. Mjedisi i vjen në mbështetje industrisë së vogël të peshkimit, kullotjes së tufave, kultivimit të pemëve frutore dhe ullishtave.

5.2.6 Vlera e mundshme

- Biodiversiteti i Parkut Kombëtar të Butrintit, ndonëse i pasur, mund të përmirësohet me kthimin në gjendjen e mëparshme dhe zgjerimin e habitateve pyjore dhe kënetore.

Qasja e mbështetur në parime do të ofrojë udhëzimet afatgjata për menaxhim efikas të integruar të burimeve natyrore të Parkut Kombëtar të Butrintit. Është e rëndësishme të garantohet që drejtimi e ardhshëm i Parkut do të jetë në gjendje t'i zbatojë këto parime.

Në këtë mënyrë, Parku Kombëtar i Butrintit mund të shërbejë si model zhvillimi i qëndrueshëm, duke vendosur një ekuilibër të përgjegjshëm të përdorimit dhe ruajtjes së burimeve të Parkut.

5.3 Parimet orientuese

Gjashtë parimet e mëposhtme, të cilat janë marrë në mënyrë të përmbledhur nga Plani i Menaxhimit ekzistues (raporti i SHMSHGj -së 2010), dokumente të tjera referuese dhe intervista me palët e interesit, konsiderohen si tepër të rëndësishme:

Monitorimi ekologjik

- Zhvillimi dhe zbatimi i një programi të vazhdueshëm të monitorimit ekologjik (ndoshta mund të përfshihet në detyrat e Grupit Kërkimor të Butrintit). Të dhënat që dalin nga monitorimi janë kyçe për vendimmarrjen në të ardhmen.

Drejtimi i përshtatur, që merr në konsideratë elementet ekologjike:

- Duke pasur një protokoll të vazhdueshëm monitorimi, Parku Kombëtar i Butrintit mund të përfshijë edhe faktorët ekologjikë në menaxhimin e ardhshëm të parkut, në një mënyrë objektive dhe të mbështetur në shkencë.

Restaurimi ekologjik:

- PMI-ja propozon ndërhyrje të restaurimit ekologjik, aty ku shihen si të realizueshme dhe të përshtatshme.

Bujqësia dhe akuakultura e qëndrueshme:

- Praktikave të qëndrueshme bujqësisë dhe akuakulturës duhet të zbatohen brenda dhe përgjatë kufijve të Parkut Kombëtar. Kjo parashikon një fazë tranzicioni (rreth 3 deri në 5 vjet), kërkon shtysa dhe rregullore, krahas monitorimit të pavarur për të garantuar përputhshmërinë.

Nxitja e praktikave dhe etikës së kujdesit komunitar:

- Trajtimi i problematikave të qëndrueshmërisë në komunitetet që kufizohen me parkun shihet si nevojë e qartë dhe e ngutshme. Komuniteteve lokale do t'iu duhet ta mbështesin këtë, që do të thotë se periudha e tranzicionit duhet të sjellë përfitime për të gjithë. Kjo është e ndërlikuar dhe ka gjasa të paraqesë vështirësi në nivel politikash, por duhet trajtuar.

Përpjekja për të arritur fiksimin e karbonit:

- Të gjitha ndërtimet dhe operacionet e ardhshme në Park do të duhet të plotësojnë kushtet e një certifikimi të përshtatshëm për ekoturizmin, si TIES apo certifikime të ngjashme, i cili i jep përparësi përdorimit të materialeve lokale shoqëruar me praktika operacionale të qëndrueshme, me qëllim arritjen e fiksimit të karbonit.

5.4 Rekomandime për menaxhimin

Në përputhje me këto politika udhëzuese, propozohen rekomandimet e mëposhtme për menaxhimin:

1. Ndalimi i degradimit dhe përkeqësimit të mëtejshëm të ekosistemeve dhe habitateve bregdetare dhe ligatinore nga veprimtaritë e parregulluara dhe të pakontrolluara të njeriut brenda dhe përreth Parkut Kombëtar
2. Garantimi i konservimit të habitateve dhe specieve brenda Parkut Kombëtar, nga pikëpamja e konservimit
3. Zbatimi i një projekti për restaurimin e ligatinave dhe rehabilitimin e pyjeve dhe shkurreve mesdhetare në park
4. Përmirësimi i biodiversitetit dhe rritja e popullatave të shpendëve ujorë dimëruar dhe folenizues në park
5. Përmirësimi i regjimit ujor, duke i kushtuar vëmendje të veçantë Kanalit të Vivarit dhe liqeneve
6. Përmirësimi i interpretimit dhe paraqitjes të pasurive natyrore dhe kulturore të parkut për kënaqësinë e vizitorëve
7. Promovimi dhe praktikimi i menaxhimit të qëndrueshëm të burimeve natyrore
8. Promovimi i turizmit miqësor ndaj mjedisit, nëpërmjet zhvillimit të infrastrukturës së ndjeshme për të nxitur angazhimin në veprimtari brenda parkut kombëtar që respektojnë pasuritë natyrore
9. Ndërgjegjësimi i publikut, rritja e pjesëmarrjes së komunitetit dhe përfitimet nga mbrojtja, përdorimi dhe menaxhimi i duhur i pasurive natyrore dhe kulturore të parkut.
10. Linjat e përgjithshme të menaxhimit të aspektit natyror të Parkut Kombëtar të Butrintit të parashikuar në këtë plan, do të detajohen me akte nënligjore të ministrit përgjegjës të mjedisit.

Arritja e këtyre qëllimeve dhe objektivave afatgjata është qëllimi kryesor i Planit të Veprimit. Megjithatë, ato ndikohen nga një sërë faktorësh të riskut artificial dhe natyror, të jashtëm ose të brendshëm.

Faktorët e riskut natyror të jashtëm ose të brendshëm:

- Bimësia natyrore
- Variacioni i prurjeve të ujit të ëmbël
- Era, stuhitë dhe zjarri
- Sedimentet
- Erozioni
- Ndryshimi klimatik

Faktorët e riskut artificial të jashtëm dhe të brendshëm:

- Ardhja e specieve pushtuese të huaja
- Ndotja

- Erozioni i zonës nga aktiviteti i njeriut
- Ndotja e shkaktuar nga njeriu
- Devijimi i lumenjve
- Zhvillimi i infrastrukturës.

Menaxhimi i këtyre faktorëve të riskut do të jetë fokusi i Planit të Menaxhimit të Riskut, që trajtohet në Seksionin 8.9.1 të Planit të Menaxhimit të Integruar.

5.4.1 Zonimi dhe veprimtaritë e lejuara

(Referojuni Figurës 6 dhe 7 për Zonat dhe Nënzonat ekzistuese të Parkut Kombëtar)

Zona A – Zona Bërthamë

Veprimtaritë e lejuara

Nënzonë A1 për ruajtje të veçantë:

- akses për monitorim shkencor nga ana e shkencëtarëve/menaxherëve, për të ndihmuar në arritjen e objektivave të menaxhimit, veçanërisht në përputhje me protokollin e monitorimit ekologjik;
- menaxhimi përqendrohet në shuarjen e zjarrit, kontrollin/largimin e specieve pushtuese të huaja (tokësore dhe detare)

Nënzona A2 e mjedisit natyror:

- akses për monitorim shkencor nga ana e shkencëtarëve/menaxherëve, për të ndihmuar në arritjen e objektivave të menaxhimit;
- menaxhimi përqendrohet në shuarjen e zjarrit, kontrollin/largimin e specieve pushtuese të huaja (tokësore dhe detare);
- pastrimi i plehrave dhe mirëmbajtja e shtigjeve;
- akses i rregulluar për publikun në veprimtaritë turistike me bazë natyrën ose edukimin

Nënzonë A3 për trashëgiminë kulturore dhe natyrore:

- akses i rregulluar për vizitorët, aty ku gjykohet e përshtatshme dhe në përputhje me legjislacionin aktual mjedisor dhe kulturor, me rregulloret dhe marrëveshje të tjera në fuqi;
- akses për qëllime kërkimi, edukimi dhe trajnimi.

Veprimtari të ndaluara

Veprimtaritë që bien në kundërshti me qëllimet e zonës, si:

- gjuetia, peshkimi dhe akuakultura, vjelja, mbledhja e paautorizuar, shkatërrimi ose shqetësimi i florës dhe faunës indigjene të egër (tokësore, detare dhe të ujërave të ëmbla);
- menaxhimi i habitatit, përveç kontrollit/largimit të specieve pushtuese të huaja;
- kullotja e bagëtive dhe veprimtari të tjera bujqësore;
- veprimtaritë pyjore;
- akses i paautorizuar nga çfarëdolloj mjeti (duke përfshirë varkat);
- depozitimi, hedhja dhe largimi i mbetjeve, duke përfshirë mbetjet e lëngëta të patrajtuara;
- ndërtimi dhe funksionimi i godinave industriale;

- ndërtimi i banesave;
- përdorimi i kimikateve (plehra kimike, biocide, etj.), ose shfrytëzimi i gurorëve, minierave;
- përdorimi i agregateve dhe futja e specieve të huaja nga njeriu.

Veprimtari që kërkojnë miratim

Për veprimtari që as nuk lejohen, e as nuk ndalohen shprehimisht duhet të kërkohet leje nga autoritet përkatëse, dhe në to përfshihen të mëposhtmet:

- monitorimi dhe kërkimi shkencor, që nuk është pjesë e protokollit të monitorimit ekologjik të Parkut, me kusht që efektet e tij të mos dëmtojnë qëllimet e Parkut;
- peshkimi me anije dajlan, peshkimi për sport;
- kullotja sezonale dhe e kontrolluar, me leje nga një ose më shumë organe.
- ndërhyrje të lehta në lidhje me menaxhimin e fluksit të vizitorëve/infrastrukturës.
- aktivitete me ndikim të ulët, për qëllime edukative/ekologjike/kulturore.

Zona B – Zonë rekreacioni

Veprimtaritë e lejuara

- ndërhyrje të lehta në sit për të menaxhuar numrin e vizitorëve;
- vende të posaçme për piknik, godinat e shërbimit të PKB-së dhe strukturat e interpretimit, vendparkimi, vend për kamping, fusha të vogla joformale për sport, godina për shërbime turistike;
- zhvillimi i turizmit me bazë komunitetin, si p.sh përshtatja e ndërtesave tradicionale ekzistuese për akomodim turistësh;
- kamping gjatë natës në zona të caktuara sipas rregullave të parashikuara;
- akses i pakufizuar për ecje, vrojtim zogjsh, zhytje, sërf, si dhe për veprimtari të tjera argëtuese;
- akses për qëllime kërkimi, edukimi dhe trajnimi;
- menaxhimi do të kufizohet në veprimtari thelbësore, si fikja e zjarrit, kontrolli/largimi i specieve pushtuese të huaja, dhe menaxhimi pas ikjes së vizitorëve, duke përfshirë largimin e mbetjeve, mirëmbajtjen e shtigjeve dhe të zonave të kampingut.

Veprimtari të ndaluara

Veprimtaritë që bien ndesh me qëllimet e zonës, janë:

- gjuetia, vjelja, mbledhja e paautorizuar, shkatërrimi ose shqetësimi i florës dhe faunës indigjene të egër;
- menaxhimi i habitatit, përveç kontrollit/largimit të specieve pushtuese të huaja;
- kullotja e bagëtive dhe veprimtari të tjera bujqësore;
- veprimtaritë pyjore pa miratim nga AKZM;
- hedhja dhe depozitimi i mbetjeve, duke përfshirë mbetjet e lëngëta të patrajtuara;
- ndërtimi dhe funksionimi i godinave industriale;
- shfrytëzimi i gurorëve, minierave; përdorimi i agregateve dhe futja e specieve të huaja nga njeriu.

Veprimtari që kërkojnë miratim

Për veprimtari që as nuk lejohen, e as nuk ndalohen shprehimisht duhet të bëhet kërkohet leje nga autoritet përkatëse, dhe në to përfshihen të mëposhtmet:

- monitorimi dhe kërkimi shkencor, me kusht që efektet e tij të mos dëmtojnë qëllimet e Parkut;
- ndërtimi i banesave dhe strukturave të tjera për përdorimin nga turistët nën menaxhimin e Parkut;
- ndërtimi i godinave të tjera për vizitorët dhe infrastrukturë për veprimtaritë e ekoturizmit me bazë komunitetin.

Zona C – Përdorim i zakonshëm

Veprimtaritë e lejuara

Nënzona C1 për Peshkim të zakonshëm:

- peshkimi dhe prodhimi i zakonshëm ose jo intensiv i midhjeve;
- akses i rregulluar për qëllime edukimi dhe trajnimi;
- akses i rregulluar për vrojtimin e zogjeve.

Nënzona C2 për Kullotje dhe bujqësi të zakonshme:

- zhvillimi i agroturizmit dhe i turizmit në natyrë;
- akses i rregulluar për shëtitje, ecje, çiklizëm, kalërim, vrojtim zogjsh;
- mbledhja e produkteve pyjore jodrusore (kërpudha, mjalti);
- kampingu gjatë natës do të lejohet në vende të caktuara sipas rregullave të parashikuara;
- akses i rregulluar për qëllime edukimi dhe trajnimi;
- menaxhimi i habitatit, duke përfshirë restaurimin e habitatit, shuarjen e zjarreve, kontrollin/largimin e specieve pushtuese të huaja dhe menaxhimin pas largimit të vizitorëve, mirëmbajtjen e shtigjeve dhe kontrollin e erozionit, si dhe mirëmbajtjen e zonave për kamping.

Veprimtari të ndaluara

Veprimtaritë që bien ndesh me qëllimet e zonës janë:

- vjelja, mbledhja e paautorizuar, shkatërrimi ose shqetësimi i florës dhe faunës indigjene të egër;
- veprimtaritë pyjore tregtare;
- ruajtja, hedhja dhe depozitimi i mbetjeve, duke përfshirë mbetjet e lëngëta të patrajtuara;
- ndërtimi dhe funksionimi i godinave industriale;
- shfrytëzimi i minierave, përdorimi i agregateve;
- futja e specieve invazive të huaja.

Veprimtari që kërkojnë miratim

Për veprimtari që as nuk lejohen, e as nuk ndalohen shprehimisht duhet të bëhet kërkohet leje nga autoritet përkatëse, dhe në to përfshihen të mëposhtmet:

- monitorimi dhe kërkimi shkencor, me kusht që efektet e tij të mos dëmtojnë qëllimet e PKB-së;

- veprimtari që janë subjekt i vlerësimit të ndikimit mjedisor dhe miratimit nga autoritetet menaxhuese të parkut, si ndërtimi i banesave/godinave për përdorim nga turistët;
- infrastrukturë dhe struktura të tjera të parashikuara për vizitorët;
- ndërtim dhe rikonstruktimi i banesave për banorët dhe peshkatarët lokal, ndërtesa, kufizimet e fushave, duke përfshirë gardhet, muret dhe rrethimet, dhe përdorimi i kimikateve të ndryshme (plehra kimikë, biocide, etj.).

Zona D – Zona e përdorimit të qëndrueshëm

Veprimtaritë e lejuara

- veprimtaritë ekonomike aktuale në përputhje me të gjitha rregulloret e planifikimit dhe të mjedisit;
- zhvillimi i turizmit të qëndrueshëm lokal.

Veprimtari të ndaluara

Veprimtaritë që bien ndesh me qëllimet e zonës janë:

- mbledhja e paautorizuar, shkatërrimi ose shqetësimi i florës dhe faunës indigjene të egër;
- ruajtja, hedhja dhe depozitimi i mbetjeve, duke përfshirë mbetjet e lëngëta të patrajtuara;
- shfrytëzimi i minierave, largimi i agregateve, ndërtimi dhe funksionimi i strukturave industriale (pa studimin e Vlerësimit të Ndikimit Mjedisor dhe licencën mjedisore);
- futja e specieve pushtuese të huaja.

Veprimtari që kërkojnë miratim

Për veprimtari që as nuk lejohen, e as nuk ndalohen shprehimisht duhet të bëhet kërkohet leje nga autoritetet përkatëse, dhe në to përfshihen të mëposhtmet:

- mbledhja e produkteve pyjore (fara, fruta, boçe pishë), bimëve medicinale, etj;
- monitorimi dhe kërkimi shkencor i paparashikuar, me kusht që efektet e tij të mos dëmtojnë qëllimet e PKB-së;
- veprimtari që janë objekt i vlerësimit të ndikimit mjedisor para miratimit të mundshëm nga autoritetet menaxhuese të parkut, ku përfshihen ndërtimi i banesave, strukturave të vizitorëve dhe infrastrukturës së turistëve, hoteleve, restoranteve dhe godinave të tjera turistike;
- ndërtimi dhe rikonstruktimi i banesave për banorët lokal, ndërtesat e fermave, kufizimet e fushave, duke përfshirë gardhet, muret dhe rrethimet;
- përdorimi i kimikateve të ndryshme (plehra kimike, biocide, etj.),
- dhe veprimtari pyjore, që nuk janë objekt i planit të miratuar për menaxhimin e kullotave pyjore.

5.4.2 Zonimi dhe veprimtaritë e lejuara në zonimin e ri të propozuar

Parku kombëtar i Butrintit propozohet të kemi një ndarje në katër nënzona me qëllim menaxhimin e tyre sipas rëndësisë së habitateve dhe të ekosistemeve që bëjnë pjesë në to:

1. Nënzona Qendrore (ZQ), ku zbatohet shkalla e parë e mbrojtjes;

Nënzona Qëndrore - 3374.12 ha

Qëllimi: Nën zona qëndrore e një zone të mbrojtur zbaton shkallën e parë të mbrojtjes dhe ka për qëllim krijimin e një territori pak ose aspak të shqetësuar nga aktivitetet njerëzore. Nën zona përfshin disa nga habitatet natyrore dhe nën zonat fito-klimatike, pyjet e vjetër dhe ata natyrore mesdhetare me ilqe (*Quercus ilex*), dafinë (*Laurus nobilis*) dhe valanidh (*Quercus macrolepis*), karakteristika gjeologjike dhe gjeomorfologjike të veçanta, shkëmbinj detarë, livadhe detare me posidonia (*Posidonia oceanica*), estuaret, kënetat ujë-ëmbël, të njelmëta dhe të kripura si dhe habitatet riparine (pyjet aluvionale).

Shtirja: Nënzona qëndrore përfshin: pjesën jugore të lagunës/liqenit të Butrintit (nga gjiri i Pallavraqit në perëndim deri në Diaporid në lindje) së bashku me kanalin e Vivarit që lidh lagunën me detin; liqenin e Bufit së bashku me kanalin që lidh atë me liqenin e Butrintit, si dhe kallamishtet që ndodhen përreth liqenit të Bufit dhe kanalit lidhës; kënetat e reja kryesisht me ujë të ëmbël në jug të liqenit të Bufit dhe Butrintit; kënetat e reja me ujëra të njelmët dhe të kripur në pjesën perëndimore të fushës së Vrinës; rrjedhën e poshtme të lumit Pavlo dhe grykëderdhjen e tij; zonën estuarine midis grykëderdhjes së lumit Pavlo dhe kanalit të Vivarit; gjirin e Alinures; kepën e Stillos, së bashku me ishujt, gjiret dhe brezin litoral detar; pjesën jugore të gadishullit të Ksamilit në kufi me zonën e rekreacionit; ishujt e Ksamilit (Tetranisit) dhe ujërat detare litorale rreth tyre.

Nënzona e Përdorimit Tradicional dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm - 4432.54 ha

Qëllimi: Në zonën e përdorimit tradicional dhe të qëndrueshëm (B) zbatohet shkalla e dytë e mbrojtjes sipas ligjit për zonat e mbrojtura. Kjo zonë ka për qëllim të mundësojë jetesën e banorëve brenda PKB, në mënyrë të përhershme apo sezonale, të vazhdojnë të ruajnë mënyrën e tyre të jetesës me mjete tradicionale. Nën zona lejon subjektet publike hyrëse, të respektojnë kufijtë tokësore rezidenciale dhe veprimtaritë e tyre ekonomike. Vizitorët mund të shijojnë të njëjtat aktivitete dhe vlera si në Zonën Rekreacionale por gjithashtu të mësojnë edhe rreth bujqësisë tradicionale, kullotjes, metodave tradicionale të peshkimit dhe mënyrave të jetesës.

Shtirja: Përfshin pjesën më të madhe të liqenit të Butrintit, në veri të zonës qëndrore, habitatet e mbetura të kënetave ujë-ëmbël të bregut verior të liqenit të Butrintit; brezi i tokave bujqësore në kufi me argjinaturën që ndan liqenin me fushën e Vurgut; në veri-lindje pyjet e rrallë të valanidhit deri në majën e malit të Milesë, makjen mesdhetare të vendosur mbi shpatet perëndimore të parkut, kodrës së Pallavraqit; makjen mesdhetare dhe pyjet e rrallë me valanidh që përdoren si kullota në lindje të liqenit të Butrintit, në kufi me zonën qëndrore në jug (Diaporidi), pyjet e rrallë të valanidhit, tokën bujqësore, plantacionet me ullinj, agrume dhe vreshta, në lindje (deri në majë të malit të Milesë); tokat bujqësore në jug të liqenit të Bufit, veri Shëndëllise deri në perëndim të Vrinës.

Nënzona e Rekreacionit - 202.05 ha

Qëllimi: Nën zonat të cilat mund të ofrojnë një edukim në shkallë të gjerë, mundësi të argëtimit në natyrë (tokë dhe det) dhe lehtësi të tjera në mënyrë të tillë që respekton funksionet e parkut, vlerat e tij ekologjike dhe ato të peizazhit natyror e kulturor.

Në këtë zonë zbatohet shkalla e tretë e mbrojtjes sipas ligjit për zonat e Mbrojtura.

Shtirja: Përfshin zonën në perëndim të parkut Butrint, anën perëndimore të gadishullit të Ksamilit, kufizohet në veri me Gjirin e Postës Kufitare, në lindje vijon drejt kodrës së Bajames, kufizohet me zonën qëndrore dhe përfundon në det drejt jugut të gadishullit të Ksamilit; në perëndim kufizohet

me ujërat e detit Jon. Kjo zonë përfshin edhe brezin litoral prej jo më pak se 300 m larg vijës bregdetare.

Në parkun kombëtar të Butrintit ndalohen të gjitha veprimtaritë që bien në kundërshtim me kategorinë, statusin dhe qëllimin e zonës, si dhe shkallën dhe nivelin e mbrojtjes sipas legjislacionit në fuqi për zonat e mbrojtura. Veprimtaritë e lejuara dhe ato që kërkojnë miratim detajohen në këtë plan. Ministri përgjegjës për mjedisin, me akt nënligjorë të posaçëm, ka të drejtë të detajojë më tej parashikimet e PMI. Zbatimi i legjislacionit sigurohet nga administrata e ZM-së me anë të patrullimit dhe vënies në zbatim të rregullave dhe qasjeve të përcaktuara.

Nënzona e Trashëgimisë dhe Peizazhit Kulturor - 592.23 ha

Zbatohet shkalla e parë e mbrojtjes, niveli B. Kjo zonë do të jetë në menaxhim të fondacionit të ri sipas standarteve dhe kërkesave që lindin nga përfshirja e sitit në UNESCO dhe i referohet për afërsisht ish nënzona A3 të cilat sipas VKM 495/2014 kanë qënë nën administrimin e Ministrisë së Kulturës me sipërfaqe 614.3 ha.

Qëllimi: Mbrojtja e vlerave të veçanta kulturore, natyrore dhe arkeologjike. Lejohen vizitat e përcaktuara në përputhje me ruajtjen e vlerave të veçanta kulturore dhe natyrore të zonës.

Shtrirja: Pylli i Butrintit (monument natyre) dhe vetë qyteti antik i Butrintit; gjithë monumentet e kulturës dhe arkeologjike të përfshira brenda zonës arkeologjike të Butrintit, Diaporit, Kalivo, Shën Dhimitri, Shëndëlli kështjella trekëndore Veneciane, Akuadukti Romak, Kulla Veneciane e Vrojtimit, Kështjella e Ali Pashës, manastiri i Demës.

Veprimtaritë e lejuara, të ndaluara dhe që kërkojnë leje

Nënzona	Aktivitetet e lejuara	Aktivitetet e ndaluara	Aktivitetet që kërkojnë miratim nga AdZM
Nënzona Qëndrore 39.23 %	<ul style="list-style-type: none"> • Akses për patrullimin dhe monitorim nga ana e menaxherëve, për të mbajtur nën kontroll zonën dhe për të ndihmuar në arritjen e objektivave të menaxhimit; • Ndërhyrje për përballimin e katastrofave natyrore, zjarreve, përmbytjeve apo raste të specieve invasive dhe infeksioneve, për të cilat është domosdoshmëri ndërhyrja emergjente. 	<ul style="list-style-type: none"> • Gjuetia, vjelja, mbledhja e paautorizuar, shkatërrimi ose shqetësimi i florës dhe faunës së egër (tokësore, detare dhe të ujërave të ëmbla); • Menaxhimi intensiv i habitatit, përveç kontrollit/largimit të specieve pushtuese të huaja; • Depozitimi dhe hedhja e mbetjeve, duke përfshirë mbetjet e lëngëta të patrajtuara; • Ndërtimi i strukturave të 	<p>Për veprimtari që as nuk lejohen, e as nuk ndalohen shprehimisht duhet të kërkohet leje/mendim nga administrata përgjegjëse për menaxhimin e parkut dhe sipas rastit subjekti duhet të pajset me lejen përkatëse sipas fushës së veprimtarisë, të tilla si:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Monitorimi shkencor dhe marrja e mostrave në ZM; • Ndërhyrje me qëllim parandalimin dhe menaxhimin e incidenteve apo katastrofave natyrore, zjarre, përmbytje apo largimin e specieve invasive, infeksioneve dhe mbajtjen e ekuilibrave ekologjikë të liqenit. • Shëtitje me varka në MN Kanali i Vivarit dhe në hapësirën detare në Kepin e Stillos.

	<ul style="list-style-type: none"> • Pastrimi i mbetjeve dhe mirëmbajtja e shtigjeve; • Akses i rregulluar për vizitorët, sipas intenerareve të përcaktuara, aty ku gjykohej e përshtatshme dhe në përputhje me legjislacionin aktual mjedisor dhe kulturor, me rregulloret dhe marrëveshje të tjera në fuqi; • Ndërhyrjet për mirëmbajtjen e monumenteve arkeologjike në STB, të cilat nuk kanë ndikim në mjedisin natyror. 	<p>përhershme me funksion turistik, zonave urbane; Ndërtimi dhe funksionimi i godinave industriale;</p> <ul style="list-style-type: none"> • Përdorimi i kimikateve (plehra kimike, biocide, etj.), ose shfrytëzimi i gurorëve, minierave; • Përdorimi i aggregateve dhe futja e specieve të huaja nga njeriu. • Mbjellja e pyjeve monokulturë; • Akuakultura intensive. 	<ul style="list-style-type: none"> • Kullotja sezonale dhe e kontrolluar për delet në zonat e përcaktuara nga administrata me miratim të AKZM. • Ndërhyrje të lehta infrastrukturore në lidhje me menaxhimin e fluksit të vizitorëve. Hapja e shtigjeve të reja turistike; • Kultivimi i midhjeve në impiantet ekzistuese, duke plotësuar standartet e BE mbi certifikimin e produkteve të përdorura. • Të gjitha llojet e ndërhyrjeve për mirëmbajtjen e monumenteve arkeologjike me ndikim në mjedisin natyror. • Ndërhyrje në pastrime dhe punime fitosanitare të cilat kërcënojnë ekzistencën e objekteve arkeologjike. • Punime rehabilituese për mirëmbajtjen e kanalit të Vivarit; • Zhytja në pikat e përcaktuara.
<p>Nënzona e Përdorimit Tradicional dhe Zhvillimit të qëndrueshëm</p> <p>6.89%</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Zhvillimi i praktikave bujqësore të qëndrueshme, sipas standarteve bashkëkohore; • Zhvillimi i agroturizmit dhe i turizmit në natyrë; • Akses i rregulluar për shëtitje, ecje, çiklizëm, kalërim, kundrim shpendësh etj; • Mbledhja e produkteve pyjore jodrusore (kërpudha, mjalti); • Kampingu në vendet e caktuara nga administrata e parkut sipas rregullave të parashikuara; • Shuarja e zjarreve, kontrolli/largimi i 	<ul style="list-style-type: none"> • Vjelja, mbledhja e paautorizuar, shkatërrimi ose shqetësimi i florës dhe faunës së egër; • Shfrytëzimi i pyjeve dhe ndryshimi i gjendjes natyrore të rezervave ujore; • Hedhja dhe depozitimi i mbetjeve, duke përfshirë mbetjet e lëngëta të patrajtuara; • Ndërtimi dhe funksionimi i godinave industriale dhe zonave urbane; • Shfrytëzimi i minierave. • Mbjellja monokulturë në fondet pyjore; 	<p>Për veprimtari që as nuk lejohen, e as nuk ndalohen shprehimisht duhet të kërkohet leje/mendim nga administrata përgjegjëse për menaxhimin e parkut dhe sipas rastit subjekti duhet të pajiset me lejen përkatëse sipas fushës së veprimtarisë, të tilla si:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Menaxhimi i habitatit, duke përfshirë restaurimin e habitatit. • Infrastruktura dhe struktura të lehta, struktura të përkohshme, të parashikuara për vizitorët me impakt minimal në natyrë; • Vozitja me varka për qëllime turizmit natyror me lejen nga AdZM/AKZM. • Peshkimi sportiv me leje të posaçme • Kullotja në zonat e përcaktuara dhe që nuk dëmtojnë habitatet. • Rikonstruktimi i godinave për banorët dhe peshkatarët lokal, kufizimet e fushave, duke përfshirë gardhet, muret dhe


	<p>specieve pushtuese të huaja dhe menaxhimi i sipërfaqes pas largimit të vizitorëve, mirëmbajtjen e shtigjeve dhe kontrollin e erozionit, si dhe mirëmbajtjen e zonave për kamping.</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Futja e specieve invazive të huaja; • Lëvizja jashtë zonave të përcaktuara (përfshirë lundrimin në liqen apo pjesën detare) dhe parkimi jashtë vendeve të përcaktuara. 	<p>rrethimet, në përputhje me Planin e Përgjithshëm Vendor.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Përdorimi jo intensiv i kimikateve të ndryshme (plehra kimikë, biocide, etj); • Mbledhja e produkteve pyjore (fara, fruta, boçe pishe), bimëve medicinale, etj; • Vendosja e stendave, tabelave të të dhënave, reklamave, shenjave dhe posterave për ushtrimin e aktiviteteve të lejuara në zonë. • Monitorimi shkencor dhe marrja e mostrave në ZM;
<p>Nënzona Rekreative 2.35%</p>	<p>Ndërhyrje të lehta në park për të menaxhuar numrin e vizitorëve;</p> <ul style="list-style-type: none"> • kamping në zona të caktuara sipas rregullave të parkut; • akses i pakufizuar për ecje, vrotim zogjsh, zhytje, sërf, vozitje me varka, si dhe sporte të tjera ujore në zonat e përcaktuara; • menaxhimi do të kufizohet në veprimtari thelbësore, si fikja e zjarrit, kontrolli/largimi i specieve pushtuese të huaja, dhe menaxhimi pas ikjes së vizitorëve, duke përfshirë largimin e mbetjeve, mirëmbajtjen e shtigjeve dhe të Nën zonave të kampingut. 	<ul style="list-style-type: none"> • gjuetia, vjelja, mbledhja e paautorizuar, shkatërrimi ose shqetësimi i florës dhe faunës indigjene të egër; • menaxhimi i habitatit, përveç kontrollit/largimit të specieve pushtuese (Invazive) të huaja; • kullotja e bagëtive dhe veprimtari të tjera bujqësore; • Shfrytëzimi i pyjeve. • hedhja dhe depozitimi i mbetjeve, duke përfshirë mbetjet e lëngëta të patrajtuara; • ndërtimi dhe funksionimi i godinave industrial dhe Nën zonave urbane; • shfrytëzimi i guroreve, minierave; përdorimi i aggregateve dhe futja e specieve të huaja nga njeriu. 	<ul style="list-style-type: none"> • Për veprimtari që as nuk lejohen, e as nuk ndalohen shprehimisht duhet të kërkohet leje/mendim nga administrata përgjegjëse për menaxhimin e parkut dhe sipas rastit subjekti duhet të pajiset me lejen përkatëse sipas fushës së veprimtarisë, të tilla si: • Zhvillime të infrastrukturës për vizitorët dhe infrastrukturë për veprimtaritë e ekoturizmit në përputhje me PPV. Të tilla si: Vende të posaçme për piknik, godinat e shërbimit të PKB-së dhe strukturat e interpretimit, vendparkimi, vend për kamping, fusha të vogla joformale për sport, godina për shërbime turistike; • Zhytja, peshkimi sportiv, aktivitete sportive ujore jashtë zonave të përcaktuara nga administrata. • Ndërhyrje silvikulturore për shëndetësimin dhe mirëmbajtjen e pyjeve dhe kullotave. • zhvillimi i turizmit me bazë komunitetin, si p.sh përshtatja e ndërtesave tradicionale ekzistuese për akomodim turistësh;

<p>Nënzona e trashëgimisë dhe peizazhit Kulturor</p> <p>6.89%</p>	<ul style="list-style-type: none"> • ndërtimi i qendres se vizitoreve • akses i rregulluar për vizitorët, sipas itinerareve të përcaktuara, aty ku gjykohet e përshtatshme dhe në përputhje me legjislacionin aktual mjedisor dhe kulturor, me rregulloret dhe marrëveshje të tjera në fuqi; • ndërhyrjet për mirëmbajtjen e monumenteve arkeologjike, të cilat nuk kanë ndikim në mjedisin natyror. 	<p>Ndalohen të gjitha veprimtaritë që bien në kundërshtim me kategorinë e parkut kombeëtar, si dhe shkallën dhe nivelin e mbrojtjes sipas legjislacionit në fuqi për zonat e mbrojtura, të tilla si:</p> <ul style="list-style-type: none"> • gjuetia, peshkimi, akuakultura intensive, vjelja, mbledhja e paautorizuar, shkatërrimi ose shqetësimi i florës dhe faunës indigjene; • akses i paautorizuar nga çfarëdo lloj mjeti (duke përfshirë varkat); • depozitimi dhe hedhja e mbetjeve, duke përfshirë mbetjet e lëngëta të patrajtuara; • ndërtimi dhe funksionimi i godinave industriale; shfrytëzimi i gurorëve, minierave; • ndërtimi i banesave; • përdorimi i kimikateve (plehra kimike, biocide, etj.) dhe agregateve; • futja e specieve të huaja nga njeriu; 	<ul style="list-style-type: none"> • Akses për qëllime kërkimi, edukimi dhe trajnimi jashtë itinerareve të përcaktuara. • Ndërhyrje në pastrime dhe punime fitosanitare të cilat kërcënojnë ekzistencën e objekteve arkeologjike në këtë nënzonë. • Të gjitha llojet e ndërhyrjeve për mirëmbajtjen e monumenteve arkeologjike me ndikim në mjedisin natyror dhe kur ndodhen brenda sipërfaqeve të monumenteve të natyrës. • Ndërhyrje në lidhje me menaxhimin e fluksit të vizitorëve/infrastrukturës. Hapja e shtigjeve të reja turistike për vizitorët • aktivitete me ndikim të ulët, për qëllime edukative/ekologjike/kulturo. • menaxhimi i habitatit;
---	---	--	--

5.0 Burimi natyror – Pika kyçe

- Kompleksi ligatinor i Parkut Kombëtar të Butrintit është një nga sitet ligatinore bregdetare më të rëndësishme në Shqipëri.
- Statusi ekologjik i Parkut Kombëtar të Butrintit është kritik për mbrojtjen dhe qëndrueshmërinë e Sitit të Trashëgimisë Botërore.
- Zona përreth Butrintit është në rrezik nga shfrytëzimi i skajshëm i tokës për projekte zhvillimore, për qëllime rekreacioni dhe për qëllime bujqësore.
- Do të hartohet një program i vazhdueshëm për monitorimin ekologjik dhe restaurimin për të ofruar të dhëna të dobishme për procesin e ardhshëm të vendimmarrjes së informuar.
- Do të përvetësohen praktika të qëndrueshme bujqësore dhe akuakulturore që kërkojnë një kombinim shtysash, rregullimesh dhe monitorimesh për të siguruar respektimin e ligjit.
- Linjat e përgjithshme të menaxhimit të aspektit natyror të Parkut Kombëtar të Butrintit të parashikuar në këtë plan, do të detajohen me akte nënligjore të ministrit përgjegjës të mjedisit.

6.0 TURIZMI DHE INFRASTRUKTURA



6.0 TURIZMI dhe INFRASTRUKTURA

'Ekoturizmi...praktika e udhëtimit me ndikim të ulët dhe të ndjeshëm nga pikëpamja kulturore, ekologjike dhe edukuese, që lu sjell përfitime komuniteteve lokal dhe vendeve pritëse'²⁷.

Duke qenë një atraksion turistik i rëndësishëm dhe falë ndërthurjes së pasurive ekologjike dhe arkeologjike, të njohura tashmë në rang ndërkombëtar, Butrinti zë një vend të veçantë në spektrin e ashtuquajtur të "destinacioneve ekoturistike". Megjithëse oferta e vizitorëve për në Butrint pa dyshim që e favorizon këtë formë turizmi, vetë vizitorët janë ata që aktualisht përbëjnë një nga kërcënimet kryesore të ruajtjes së monumentit dhe mjedisit të Zonës mbrojtëse të STB-së dhe mbarë Parkut Kombëtar.

Butrinti ka qenë një vend i panjohur në botë për shekuj të tërë. Pavarësisht punës arkeologjike pioniere të Ugolinit, në vitet 1920 dhe 1930, Butrinti filloi të njihet ndërkombëtarisht vetëm pas rënies së komunizmit në vitin 1992 dhe falë punës së Fondacionit Butrinti, pas vitit 1993.

6.1 Numri i vizitorëve

Nga vetëm disa qindra vizitorë në vitin 1998, në vitin 2018, kur u publikuan shifrat, Qytetin Antik e vizituan të paktën 211,500 persona. Kjo është një shifër e lartë, e cila pritet të rritet.




Figura 11: Rritja e numrit vjetor të vizitorëve dhe të muajve të paktë

Majtas: numri i vizitorëve ndër vite

djathtas: numri i vizitorëve në muaj

(Shqiptarë Të hua Totali)

Me normat aktuale të rritjes, përlogaritet se deri në vitin 2023 (viti 5), Butrintin do ta vizitojnë rreth 300,000 persona, shumica prej të cilëve (të paktën 60%) nuk do të jenë shqiptarë.

²⁷ Burimi: Honey M (1999) Ecotourism and Sustainable Development: Who Owns Paradise? Island Press




Figura 12: Rritja e parashikuar e numrit të vizitorëve 2018-2025

Për ta mbështetur këtë vlerësim, gjatë periudhës 2013-2017 numri i vizitorëve të huaj në rajon u rrit mesatarisht me 17% në vit²⁴, ndërsa numri i vizitorëve vendas u rrit me ritme më të ngadalta, megjithëse domethënëse, me një shkallë prej 11%. Këto prirje janë në përputhje me konstatimet e bëra në këtë Plan për Menaxhimin e Integruar. Turistët (vizitorë të huaj) mund të ndahen në dy lloje kryesore:

Turistë disa ditore:

- Individë ose turistë të huaj me paketa turistike, pjesë e tureve dhe qëndrime shtatë-ditore për vizita në monumente të trashëgimisë kulturore, që qëndrojnë në Sarandë dhe vijnë me qëllimin për të vizituar Parkun Arkeologjik të Butrintit dhe atraksione të tjera brenda dhe jashtë Sarandës, duke përfshirë monumentin natyror të Syrit të Kaltër;
- Turistë me anije turistike, që ankorohen në Sarandë dhe qëndrojnë një ose dy net, për të vizituar Butrintin dhe Syrin e Kaltër, dhe me shumë gjasa për të vizituar Gjirokastrën gjatë ditës së dytë, dhe më pas për t'u kthyer në anije.

Vizitorë ditore:

- Paketa turistike njëditore në grup për turistë të huaj nga Korfuzi, për të vizituar Butrintin dhe atraksione të tjera në Sarandë
- Turistë me anije që ankorohen në Sarandë për të vizituar Butrintin, Syrin e Kaltër dhe atraksione të tjera në Sarandë
- Vizitorë njëditorë individualë (që qëndrojnë në destinacionet e tjera të afërta bregdetare të Rivierës Shqiptare) që vizitojnë Butrintin dhe mbase Syrin e Kaltër.

Këto shifra ndikojnë mbi mënyrën se si duhet të zhvillohet dhe të menaxhohet Zona A3, sidomos për sa i përket marrëdhënies së tij me mbarë Parkun Kombëtar.

²⁴ Burimi: Horwath HTL (2018) Market Research and Development of a Tourism Product and Market Strategy for the South of Albania and Four Selected Municipalities.

Mbipopullimi është një problematikë serioze për t'u menaxhuar gjatë muajve të verës, përkatësisht në qershor, korrik dhe gusht, dhe kjo jo vetëm që ndikon në përvojën e vizitorëve, por edhe ruajtjen e arkeologjisë.

6.2 Menaxhimi i përdorimit të zonës nga vizitorët

Parqet kombëtare dhe zonat e mbrojtura duhet të vendosin një ekuilibër midis përdorimit dhe ruajtjes. Pa njohur dinamikën dhe sfidat themelore, menaxhimi i një parku nuk bëhet i mundur. Kjo gjë tregon rëndësinë e menaxhimit të përdorimit nga vizitorët dhe vendimmarrjen e integruar. Në Butrint, përveç shitjeve të biletave në hyrje, drejtuesit nuk kanë të dhëna të sakta për përdorimit nga vizitorët ose prirjet e vizitave në park.

Shërbimi i Parkut Kombëtar të SHBA-së ka 30 vjet që zbaton një program për menaxhimin e përdorimit të parkut nga vizitorët, që përfshin një program strikt kërkimor shkencor social (së bashku me një sërë universitetesh dhe agjenci konsulente), që përqendrohen në të kuptuarit e problematikës së kapacitetit pritës.

Një program i tillë për menaxhimin e përdorimit nga vizitorët i ndarë në faza është thelbësor për të ardhmen e Butrintit dhe duhet të përfshijë:

1. **Faza 1:** Hartëzimin në mënyrë narrative të prirjeve aktuale të përdorimit dhe numrit të vizitorëve. Identifikimin e treguesve të mundshëm të cilësisë së përvojës së vizitorëve (hartëzimi i vlerave), në përputhje me treguesin arkeologjik dhe ekologjik të cilësisë për këto burime
2. **Faza 2:** Vlerësimin e treguesve dhe ngritja e kapacitetit pritës të vendeve tërheqëse në park
3. **Faza 3:** Zhvillimin e protokollit të monitorimit për përdorimin nga vizitorët për të garantuar ruajtjen e kapacitetit pritës me kalimin e kohës.




Figura 13: Skema e siteve kryesore të adresuar në këtë Plan të Menaxhimit të Integruar

Aktualisht, shumica dërrmuese e turistëve të huaj (të cilët që prej vitit 2014, zënë një segment më të madh të tregut se vizitorët vendas) në Butrint, vijnë nga Saranda me autobusë të operatorëve turistikë (55 vendësh), ku shpeshherë udhëtimi bëhet me vështirësi në rrugën me kthesa pranë hyrjes së sitit, që ndodhet shumë pranë vendkalimit të lundrës.

Kufizimet në fuqi që nuk i lejojnë autobusët të shkojnë më larg se vendparkimi i Hotel Livia shpeshherë nuk respektohen me qëllim që turistët të arrijnë te porta e hyrjes përpara se pasagjerët e operatorëve të tjerë turistikë. Këtyre vizitorëve i bëhet një tur rreth 2-3 orë në pjesë të Zonës A3 dhe më pas nisen për të drekuar në një restorant jashtë sitit. Përgjithësisht, oferta gjithëpërfshirëse e Parkut Kombëtar shpërfillet ose anashkalohet nga operatorët turistikë, duke nënvlerësuar aspekte të tjera të turizmit për ecje, vrotim të zogjve dhe çiklizëm. Rrjedhimisht, minimizohet edhe përfitimi i komuniteteve lokale.

Rruga e re për në Ksamil deri në vendkalimin e trageteve në Kanalet e Vivarit ka ndikuar negativisht në rritjen e qarkullimit të automjeteve nga dhe drejt fshatrave të fushës së Vrinës. Kjo ka rënduar trafikun, ka shkaktuar ndotje akustike dhe atmosferike në hyrje, si dhe problematika të tjera në lidhje me shëndetin dhe sigurinë.

Për t'i trajtuar këto problematika, rekomandohet që autobusët dhe makinat e vizitorëve të parkohen në vendparkimin ekzistues në krye të skarpatit, rreth 1.5 km nga hyrja në sit. Kjo vendndodhje ofron një pamje panoramike nga fusha e Vrinës deri te kalaja e Ali Pashës, në grykën e kanalet të Vivarit në perëndim.

Një qendër e re vizitorësh në këtë vendndodhje do të shërbente si një lloj treguesi për mbërritjen dhe mikpritjen e vizitorëve, duke ofruar lehtësira për orientimin e tyre, shpërndarjen e biletave, interpretimin, pijet freskuese dhe shitjet me pakicë. Çka është më e rëndësishmja, do të rritej ndërgjegjësimi për një ofertë më të gjerë të Parkut Kombëtar, që aktualisht nuk po e realizon potencialin e plotë si destinacion për vizitorët.

6.2.1 Një qendër e re vizitorësh

Shumë Site të Trashëgimisë Botërore i konsiderojnë qendrat e vizitorëve si një mjet për të përmirësuar dhe menaxhuar përvojën gjatë vizitës dhe për të gjeneruar të ardhura. Shembujt më të fundit tregojnë struktura moderne të posaçme të ndërtuara posaçërisht ose që ndodhen brenda zonës bërthamë të Sitit të Trashëgimisë Botërore, ose rreth Parkut Kombëtar, ndaj duhet të jenë në përputhje me parashikimet e rrepta për Planifikimin, veçanërisht në konsultim me Qendrën e Trashëgimisë Botërore / UNESCO-s²⁵.

²⁵ Për shembull, qendra e re e vizitorëve në Stounhexh ndodhet brenda Sitit të Trashëgimisë Botërore dhe ishte objekt i debateve shumëvjeçare midis palëve të interesit dhe agjencive ligjzbatuese. Qendra e vizitorëve në Giant's Causeway, Sit i Trashëgimisë Botërore në Irlandën e Veriut, i hapur në vitin 2013, është një homolog i denjë i Butrintit, nëse krahasojmë vendndodhjen bregdetare shkëmbore dhe përshtatjes së projektimit me topografinë e sitit.



Figura 14: Vendet kryesore të përmendura në tekst

Sikundër është vërejtur, ekzistojnë disa shembuj të qendrave të vizitorëve me praktikat më të mira, që kanë fituar çmime, në Sitet e Trashëgimisë Botërore. Një studim duhet të kryhet për një qendër të re vizitorësh në Butrint, e cila do të ndërtohet si një godinë dykatëshe prej 700m² (kati nën dhe, dhe kati i parë) me një gjurmë (sipërfaqja totale e brendshme; SBB) prej 350m², me vendparkim prej 1,640 m² në kuoten më të lartë (Figura 14). Vendparkimi do të ofrojë hapësirë të mjaftueshme për një numër të kufizuar autobusësh dhe mjeteve automobilistike, ku mund të parkohen dhe të manovrojnë pa pasur nevojë të rritet sipërfaqja ekzistuese.

Për shkak të mosmarrëveshjes së vazhdueshme mbi pronësinë e vendparkimit në Zonën A3, ku propozohet që të ngrihet qendra e re e vizitorëve, planifikimi i zhvillimit të mundshëm të strukturës në dy faza të ndara sugjerohet si i përshtatshëm dhe i arsyeshëm:

Faza 1: Një strukturë e lehtë, krejtësisht e kthyeshme, që do të ofrojë orientime, restorante dhe shërbime të shitjes me pakicë, si dhe tualete dhe vendparkim (vitet 1-4), ndjekur nga

Faza 2: Një strukturë e përhershme, më e madhe që do të shtojë ambiente të tjera, si salla mbledhjesh, akomodim për stafin, dyqane, një sallë leksionesh audiovizuale dhe ekspozitë muzeu, nëse parashikohet nga lejet e Planifikimit (viti 5+).

Ky plan i propozuar, i ndarë në faza, ofron zgjidhje të menjëhershme për aspektet kryesore të gjenerimit të të ardhurave të qendrës (konkretisht, restorante dhe shitje me pakicë, në kuptimin e hapësirës së parashikuar), ndaj e shton ndjeshëm fluksin monetar në sit.

Të gjitha këto propozime zhvillimore do të kërkojnë kryerjen e studimeve të fizibilitetit, të cilat ndër të tjera do të përfshijnë Vlerësimet e Ndikimit në Trashëgimi (VNT) dhe Vlerësimet e Ndikimit Mjedisor (VNM) si të përshtatshme dhe në përputhje me legjislacionin aktual që rregullon zhvillimet e reja.




Figura 15: Fazat e propozuara për qendrën e vizitorëve (Faza 1= e gjelër; Faza 2= rozë)

Krahas zgjerimit të ndjeshëm të profilit turistik të Sitit të Trashëgimisë Kulturore dhe Parkut Kombëtar, qendra e re e vizitorëve do të mundësojë:

1. Rregullimin e fluksit të vizitorëve në Park, sidomos gjatë muajve të verës
2. Rregullimin e çështjes së biletave dhe disponimin e zyrave për stafin administrativ
3. Përmirësimin e përvojës së vizitorëve dhe lokaleve
4. Orientime, interpretime dhe informacione që i përshtaten Sitit të Trashëgimisë Botërore dhe Parkut Kombëtar
5. Mjete të qëndrueshme për aksesin dhe transportin deri në hyrjen (e re) të sitit, në këmbë ose me transport të qëndrueshëm
6. Reduktimin e ndjeshëm të dërgesave në strukturat aktuale të Akropolit
7. Ofrimin e lehtësimeve të reja interpretuese dhe edukuese në Kalanë Veneciane në Akropol
8. Përmirësimin e ndjeshëm të mundësive të shitjes me pakicë, duke përfshirë edhe mundësi për artizanët lokal
9. Aksesin në zona bregdetare dhe ligatinore të Parkut për ecje në natyrë, vrojtim zogjsh, vozitje, etj.

Më poshtë mund të gjeni një plan fillestar të ndarjes, ku tregohet se si mund të kryhet zhvillimi në dy faza, nëse është e nevojshme:

Sipërfaqja	m ²	F1	F2
Hyrja/Biletaria	78	60	18
Hapësira orientimi	60		60
Lokal	90	90	0
Kuzhina	35	35	0
Ekspozita/interpretimi	160		160
Tualetet	56	56	0
Shërbime Komunale/Shërbime	20	15	5
Shitje me pakicë/Artizanët	52	52	0
Monitor me informacione/hapësira edukative	54		54
Mobiliet/ Magazini i pajisjeve	25	10	15
Zyra e administratorit/ Magazina	30	10	20
Zyrat e stafit	40	20	20
Totali	700	348	352

6.2.2 Orientime

Një funksion kyç i qendrës së vizitorëve do të jetë orientimi i vizitorëve në lidhje me ato që ofron STB-ja dhe Parku Kombëtar më gjerë. Trajtimi i sugjeruar për prezantimin e gjallë historik të Butrintit dhe rrethinave të tij me anë të filmave, realitetit virtual dhe audios në teatrin audiovizual të qendrës së vizitorëve, si në anglisht ashtu edhe në shqip, mund të jetë si vijon:

Butrinti 2000 vjet më parë deri sot

- **Fluturimi i Shqipës**

00:00 Diset e sotme, pamje të xhiruara me dron ose me helikopter.

Dicitura – ‘Po udhëtojmë në Butrint ...’

Për skenën hapëse, kamera kalon mbi Butrint dhe rrethinat e tij duke nisur nga Pilaja e Vergut, përmes Finiqit, Mesopotamit drejt liqenit të Butrintit. Sitet dhe vendet kryesore që duhen theksuar dhe emërtuar kur kamera iu kalon sipër.

Në sfond, do të luhet kënga ‘Kaba’ e Laver Bariut

Kamera i afrohet liqenit Butrint, ulet duke rrëshqitur mbi sipërfaqen e liqenit, duke filmuar peshkatarët gjatë punës, krevatinat e midhjeve, shpendët e ujit, etj.

Në fund të liqenit, kamera ngrihet dhe kalon mbi Kalivo, Diaporit, që duken në cep të fushës në krahun lindor. Kamera rrotullohet mbi fushën e Vrinës, Butrinti shihet nga larg teksa kamera zbret ngadalë mbi fushë dhe ligatina, zogjtë fluturojnë lart mbi Kalanë e Ali Pashës.

03:00 Korfuzi duket nga larg, kamera ulet në nivelin e detit.

- **Butrinti në lartësi**

Dicitura – Mirë se vini në Butrintin e 3000 vjetëve më parë

Pamja rishfaqet nga e njëjta pikëpamje detare me peizazhin e modeluar në vitin 100 të erës sonë. Kamera dalëngadalë kalon mbi kanal. Dëgjohet një zë në sfond (zëri i përshtatshëm i një aktori britanik dhe shqiptar)

‘Pastaj urdhërova të ulëshin tek rremat, me portin e lënë pas;

E bënë me vrap, njerëzit e mi, duke i çarë dallgët me rrema dhe duke ecur përpara;

Kullat e Faecias i shahim të lëvizin dhe të zhduken pas nesh;

Kaluan përgjatë bregut të Epirit për në Portin e Kaonias, ku ndaluan;

Nën Buthrotin kryelartë të ngritur në kodër’ (Virgjili - Eneida)

03:30 Teksa kalon përgjatë kanalit, kamera kthehet majtas duke treguar dallimin midis ujërave të hapura në të shkuarën dhe kanalit të ditëve të sotme, shpendët e ujit dhe peshkatarët të lashtë. Dëgjohet një zë në sfond (zëri i një aktori, rekomandohet një zë i përshtatshëm për versionin në shqip) për qytetin: *Butrinti Antik ishte shumë ndryshe nga ditët e sotme. Duke iu afruar nga uji, peizazhi asokohe ishte krejtësisht ndrysheetj..’*

04:30 Teksa kamera ecën përpara, nga larg shihet qyteti me dritën e diellit që ndriçon çatitë dhe ndërtesat e Akropolit. Shfaqen anije mbi radë, duke parë skelet rreth perimetrit detar të Butrintit. Në fundi, teksa bëjmë kthesën përgjatë bregut, shfaqen ura dhe kanali.

• **Butrinti - Kryqëzimi i Mesdheut**

06:00 Kamera ngrihet dhe ripozicionohet për të treguar një pamje ajrore të qytetit antik, ku rrethinat shihen nga bregu i largët, teksa kafshët kalojnë urën.

07:30 Kamera kalon mbi këtë pamje teksa zëri vazhdon të flasë: *'Themeluar në Epokën e Bronzit në majën e Gadishullit të Ksamilit, kolonia romake e themeluar nga Augusti përfaqësonte apa gjënë e qytetit antik. Vini re Butrintin rreth vitit 100 të erës sonë! Dy anët e qytetit të lidhura me një urë, dhe skelet e populluara kërkajnë të gjejnë hapësirë midis shtëpive të mëdha përgjatë shtratit... etj.'*

08:15 Imazhi gradualisht zbehet në Butrintin e sotëm, nga i njëjti kënd ajror, por me monumentet kryesore të sitit të qarta. Një nga një, theksohen me zërin që ofron informacione të shkurtra (10 sekonda për secilin monument):

- Teatri
- Pagezimorja
- Forumi
- Pallati i Trikonkës
- Bazilika
- Muret
- Kalaja
- Fortesa trekëndore

Mundësia për të fokusuar monumentet mbi ujë dhe në prapatokë.

09:30 Lubet sërish kënga 'Kaba' e Laver Bariut

Kamera tërhiqet, kthehet drejt Jonit dhe Korfuzit, dhe pamja errësohet.

10:00 Fjala mbylëse: 'Vizita juaj në Butrint fillon tani' – Shtoni logot e përshtatshme të UNESCO-s, Ministrisë së Kulturës, Bashkisë Sarandë dhe Konispol.

Si pikënisje e vizitës në Butrint, qendra e vizitorëve vepron si urë lidhëse për disa veprimtari shtesë dhe mundësi për qëllime tregtare pranë Zonës A3 dhe më gjerë:




Figura 16: Mundësitë që paraqiten në mbarë sitin dhe itineraret e transportit

6.2.3 Akomodimi i stafit, strukturat në hyrje dhe rrethimi i sitit

Duhet të merret në shqyrtim aksesit i sitit, duke përfshirë hyrjen kryesore të sitit dhe rrethimin ekzistues, që duhet të përmirësohen me një skemë të re të sinjalistikës sipas markës së Butrintit, që do të krijohet.

Akomodimi aktual i stafit të sitit në hyrje është tërësisht i papërshtatshëm. Nuk ka hapësirë mjaftueshëm për të punuar, aksesit në internet nuk është i mirë dhe nuk ka salla mbledhjesh, nuk ka hapësirë për magazinimin e pajisjeve dhe as aksesit direkt në tualete. Këto shqetësime duhet të trajtohen si përparësi, për të mirën e stafit dhe sitit në tërësi.

Një shtesë e biletarisë ekzistuese në hyrje të sitit, me mesatarisht një sipërfaqe të barabartë dhe vëllim sa struktura ekzistuese (pra do të krijohet një sipërfaqe totale rreth 175 m² SBB), do të ofronte një sipërfaqe të hapur zyre, për stafin bashkë me një kuzhinë të vogël dhe tualet. Nëse ndërtohet me materialet përkatëse dhe një çati me një kulm, kjo strukturë do të përfaqësojë një ndërhyrje modeste me ndikim minimal në arkeologji²⁶.

Kjo do të kontribuonte shumë në mirëqenien e stafit dhe në punën e tyre në të ardhmen. Një arsye më shumë është se, deri në realizimin e punimeve të Fazës 2 për qendrën e re të vizitorëve (shihni më lart), ajo do të jetë zyrë parësore për sitin.

Rekomandohet që planimetria e sigurisë/rrethimit të jetë në përputhje me atë të vjetrën, sa të jetë e mundur, me qëllim shmangien e shqetësimeve të mundshme arkeologjike. Elementet e rrethimit prej betoni të periudhës komuniste duhet të ruhen për qëllime interpretimi dhe historie.

6.2.4 Interpretimi i ri në Kalanë Veneciane

Propozimet e mëparshme për qendrën e re të vizitorëve përfshinin strukturat e një ekspozite dhe muzeu të ri, si pjesë e orientimit të vizitorëve në sit. Parashikohej se kjo do të përfshinte riekspozimin e artefakteve që tani shfaqen në Kalanë Veneciane bashkë me materiale të tjera që ruhen në Universitetin e Tiranës dhe gjetkë.

Duke qenë se momentalisht kjo nuk është e mundur, të paktën për Fazën 1 të qendrës së propozuar të vizitorëve, tanimë propozohet që Kalaja Veneciane dhe rrethinat e saj t'i nënshtrohen një projekti konservimi, të strukturës, sëbashku me riekspozimin e artefakteve, për të shërbyer si muzeu kryesor i sitit për referencë dhe të dhëna.

Kjo mbështetet nga dëshmi historike të besueshme, si përdorimi i ndërtesave nga Ugolini në vitet 1930, dhe e mira do të ishte vendosja në përfundim të tureve me udhërrëfyes.

Siti gjithashtu ofron pamje spektakolare të Kanalit të Vivarit, sitit në fushën e Vrinës, të fshatrave përreth dhe peizazhit të tyre historik. Akropoli ofron tualete dhe një lokal të vogël, aktualisht i menaxhuar privatisht.

Ndaj, rekomandohet që muzeu ekzistues në Kalanë Veneciane të rinovohet dhe të riekspozohen artefaktet.

²⁶ Kërkimet tregojnë se kjo zonë është kënetore dhe përbëhet nga material pas gërmimit të Ugolini në vitet 1920 dhe 1930. Ndërkohë që nevojitet dhe rekomandohet të bëhet kujdes, nëpërmjet vëzhgimit arkeologjik, është arritur në përfundimin që kjo ndërhyrje në sit është plotësisht e përshtatshme.

ë sit ashtu edhe përreth tij, ka një sërë materialesh, me qëllim transmetimin e historinë e sitit nëpërmjet artefakteve dhe dëshmime të tjera të lidhura me të.

Duhet të nxiten qasjet e reja ndaj interpretimit dhe ka shumë shembuj të praktikave më të mira që të mbështetet hartimi i një plani të detajuar interpretimi, që mbulon si vlerat kulturore ashtu edhe ato natyrore të Parkut Kombëtar²⁷.

6.2.5 Interpretim i ri i Fortesës Trekëndore

Fortesa Trekëndore është një nga objektet historike më të dukshme dhe më madhështore të Butrintit, e cila aktualisht nuk është e hapur për publikun, dhe rrjedhimisht nuk ka shumë interpretime.

Fortesa është vendi ideal për të interpretuar rolin e venecianëve në Butrint, bashkë me të edhe arkeologjinë pas-klasike, ku për ta vizituar udhëtohet me lundër përmes Kanalit të Vivarit.

Vetë Kalaja ka nevojë për konservim dhe këto punime janë përfshirë në ndërhyrjet e rekomanduara në Planin e Konservimit, në përmbajtje të Shtojcës C. Kalaja ka një oborr të brendshëm mjaft të madh për komunitetin dhe kryerjen e veprimtarive të tjera, disa prej të cilave zhvillohen momentalisht (për shembull, gjatë kohës së vjeljes).

6.2.6 Lundra

Lundra ekzistuese që transporton mjete dhe njerëz përgjatë Kanalit të Vivarit, pranë hyrjes së Parkut, operohet nga subjekte private. Ai është mjeti që ofron akses të drejtpërdrejtë midis fshatrave të Fushës së Vrinës dhe Ksamilit. Për më tepër, lundra është mjeti i vetëm i aksesit për stafin e menaxhimit dhe vizitorët për në Fortesën Trekëndore dhe në mbarë Parkun Kombëtar.

Vetë lundra nuk i përmbush standardet kombëtare të shëndetit dhe sigurisë, ndaj tashmë nevojitet një zgjidhje afatgjatë për kalimin e sigurt dhe efikas në Kanalin e Vivarit. Lundra dhe rruga lidhëse duhet t'i nënshtrohen një studimi zyrtar për transportin dhe menaxhimin e trafikut, për të mbështetur politikat e menaxhimit lidhur me aksesin midis qendrës së propozuar të vizitorëve, hyrjes në sit dhe në mbarë Parkun Kombëtar.

6.2.7 Shtëpia e Doganës

Kompleksi i ndërtesave brenda dhe rreth Shtëpisë së Doganës (Figura 13), në brigjet e Kanalit të Vivarit, përballë kalasë së Ali Pashës, tregon elemente të shkëlqyer të arkitekturës mbrojtëse të periudhës Komuniste, duke nisur nga platformat e artilerisë deri te bunkerët e vegjël. Shtëpia e Doganës, ndërtuar mbi themelet e një vile romake buzë detit, ofron pamje spektakolare nga Kanali i Vivarit, Gjiri i Butrintit dhe Deti Jon.

Jo më larg se 1.5 km nga qendra e propozuar e vizitorëve që mund të aksesohet nga automjete 4x4, siti mund të shndërrohet në një hotel të përzgjedhur. Mund të jetë propozim interesant, për nga pikëpamja e vendit dhe domethënies së tij.

6.2.8 Interpretimi i ri i sitit

Zbatimi i programit të zhvillimit paraqet mundësinë për të rishikuar interpretimin e sitit në tërësi.

²⁷ Shembujt e praktikave më të mira të interpretimit të trashëgimisë natyrore dhe kulturore përfshijnë, STB - Muri i Hadrianit, që është një nga atraksionet turistike më të mëdha në Britani.

Kjo mund të bëhet nëpërmjet angazhimit të rojtarëve/kujdestareve të trajnuar dhe/ose përdorimit të teknologjisë moderne. Kjo e fundit është rruga e parapëlqyer si ndërhyrje kryesore, dhe duhet të autorizohet një studim i veçantë për të mbikëqyrur interpretimin e sitit me anë të mjeteve digjitale, mbase nëpërmjet platformave në telefona inteligjentë në një sërë gjuhësh të ndryshme²⁸.

Studimi duhet të kryhet përpara hapjes së qendrës së re të vizitorëve (Faza 1 në Vitin 2) si pjesë e periudhës së tranzicionit, për një ofertë më të gjerë interpretimi, që do të fillojë me t'u hapur qendra e re e vizitorëve. Cilado metodë të zgjidhet, duhet të jetë e matur dhe e kthyeshme, si dhe t'i shtojë vlera sistemit ekzistues informues me panele interpretimi, që përdoren aktualisht.

6.2.9 Varkat e pasagjerëve, platformat lundruese dhe skelat

Mënyra nëpërmjet së cilës qendra e vizitorëve do të mundësojë menaxhimin e vizitave në sit, krijon një sërë mundësish për banorët lokal dhe komunitetet e tyre për të përfituar me anë të shërbimit të transportit.

Dy mënyra kryesore janë të disponueshme: përdorimi i autobusëve ekologjikë drejt dhe nga qendra e re e vizitorëve në portën e hyrjes; dhe përdorimi i varkave elektrike nga disa pikënisje në Zonën A3 drejt vendeve më të largëta në liqenin e Butrintit, si Diaporiti.

Infrastruktura e nevojshme për të dyja veprimtaritë do të sigurohet nga Fondacioni i Ri, pasi nuk mund të priten investime të tilla nga banorët lokal. Nga ana tjetër, të gjithë operatorët e shërbimit të transportit tokësor dhe ujor, do të duhet të licencohen, t'u nënshtrohen inspektimeve të rregullta dhe do t'u kërkohet të promovojnë "markën Butrinti", për t'u dalluar si operatorë të besueshëm.

Infrastruktura e nevojshme për këto veprimtari duhet të fillojë në një fazë të hershme, pasi realizimi i tyre kërkon kohë, veçanërisht për sa iu përket çështjeve të Planifikimit dhe aksesit.

6.2.10 Shtigjet e ecjes në natyrë, shtegkalimet dhe sinjalet

Fondacioni Butrinti, së bashku me administratën e Parkut Kombëtar të Butrintit, identifikuan dhe piketuan një sërë shtigjesh për ecje në natyrë në mbarë Parkun Kombëtar. Këto shtigje, që përshkruhen në Udhërrëfyesin e Mjedisit dhe Shtigjeve të Ecjes, botuar në vitin 2004, fillimisht përbënin rrugëkalimi për shëtitësit dhe vrojtuesit e zogjve, por fatkeqësisht nuk mirëmbaheshin dhe tanimë nuk mund të përdoren, pasi janë mbuluar nga bimësia.

Këto shtigje duhet të rihapen krahas shtigjeve të reja, si ai që lidh qendrën e re të vizitorëve me Shtëpinë e Doganës dhe Liqenin Alinura. Duhet të ofrohen sinjale dhe interpretim, si dhe shëtitore në disa zona, për të mundësuar akses në terrene të vështira dhe për të mbrojtur mjediset e brishta²⁹.

Shtigjet e ecjes në natyrë, që paraqesin karakteristikat të spikatura të peizazhit dhe hartëzohen në planin digjital të sitit, shoqëruar këtij PMI, janë si vijon:

- Shtegu i malit të Sotirës – (7 km, 2.5 orë)
- Shtegu i Kalivos – (9 km, 3 orë)
- Shtegu i liqenit Bufi – (7 km, 2.5 orë)

²⁸ Shembujt e praktikave më të mira përfshijnë Aplikacionin "The Convict Road", që i tregon përdoruesit historinë e Sitit të Trashëgimisë Botërore "Old Great North Road", në Uellsin e Ri Jugor, Australi.

²⁹ Shembujt e praktikave më të mira të infrastrukturës që mundësojnë aksesin në terren të vështirë dhe peizazhe të cenueshme, përfshijnë Parkun Kombëtar Everglades, Parkun Kombëtar të Floridas dhe Parkun Kombëtar Yosemite, të dyja në SHBA.

- Shtegu i Gjirit të Butrintit – (10 km, 3 orë)
- Shtegu i Liqenit Alinura – (5 km, 2 orë)

Për qëllime ilustrimi në hartën e mëposhtme të tregohen vetëm këto shtigje:



Tokë e rrezikuar nga përmbytjet sezonale

Hartëzimi i shtigjeve:

- A** Mali i Sotirës
- B** Kalivo
- C** Liqeni i Bufit
- D** Gjiri i Butrintit
- E** Liqeni Alinura

Figura 17: Shtigje të mundshme për shëtitje

Këto shtigje rekomandohen, pasi:

- Janë në vetvete ndërhyrje të lehta, si dhe respektojnë dhe përmirësojnë frymën e vendit,
- Mund të ofrohen relativisht lehtë dhe shpejt, si dhe brenda buxheteve të njohura,
- Nuk kërkojnë kapacitet të pazakontë ose të jashtëzakonshëm për zbatimin e tyre.

6.3 Potenciali edukues dhe argëtues i Parkut Kombëtar

Butrinti është ndër shtet më të rëndësishme në Shqipëri edhe për kërkimin shkencor në një sërë disiplinash, si historia, arkeologjia, shkencat e natyrës, etj. Që prej viteve 1960, shteti është përdorur si objekt për kërkime nga institucione të ndryshme akademike dhe kërkimore, si Akademia e Shkencave, Universiteti i Tiranës (Fakulteti i Shkencave të Natyrës, Muzeu i Shkencave të Natyrës, Kopshti Botanik, Fakulteti i Historisë dhe Filologjisë, dhe Fakulteti i Gjeografisë), Universitetit Politeknik i Tiranës (Fakulteti i Gjeologjisë), si dhe Universiteti Bujqësor i Tiranës. Ekskursionet shkollore (shkolla 9-vjeçare dhe të mesme) të organizuara për në Butrint janë të shpeshta, dhe ofrojnë mundësi që nxënësit mësojnë rreth historisë, arkeologjisë dhe peizazhit kulturor të zonës.

Aktualisht, për vizitorët e rinj nuk ofrohet asnjë program specifik dhe nuk ka asnjë staf të përkushtuar për edukimin, ndonëse në të shkuarën janë bërë përpjekje për të ngritur një sistem të përshtatshëm edukues:

"Në vitin 2005 Fondacioni Butrinti zgjodhi një specialist komuniteti, që përfshinte dhe edukimin. Kjo nismë zgjati vetëm 2-3 vjet dhe nuk u bë pjesë e stafit; parkut (...) U hartuan paketa për shkollat fillore, që synonin edukimin e fëmijëve për historinë kulturore dhe natyrore të Butrintit. Për disa vjet, u organizuan vizita të shpeshta në Butrint nga shkollat e ndryshme nga zonat përreth. Në vitin 2007, Fondacioni Butrinti botoi librin "Mirë se vini në Butrint" në shërbim të nxënësve të shkollës fillore. Ky libër synonte t'i nxiste fëmijët ta vizitonin Parkun Kombëtar të Butrintit, për të organizuar veprimtari të ndryshme, si: formimi i mozaikëve, prodhimi i veshjeve të lashta, imitimi i perandorëve romakë, krijimi i maskave, si dhe aktivitete të tjera informuese dhe argëtuese për fëmijë. Nga viti 2007 deri në vitin 2009, libri ofrohej falas në shkollat fillore, sidomos në fshatin e Ksamilit²⁰.

Gjatë periudhës 2000 - 2012, u ngrit Shkolla e Trajnimit Butrint, për t'iu ofruar studentëve trajnime teorike dhe praktike për një sërë temash, duke përfshirë teknikat bazë të vrojtimit dhe gërmimit, sistemet e interpretimit statigrafik, skicimin arkeologjik, trajtimin dhe dokumentimin e artefakteve arkeologjike, etj. Krahas kësaj, ofrohej një prezantim për konservimin, restaurimin dhe turizmin. Shkolla finançohej nga Instituti Packard Humanities. Vlerësohet se:

"Rreth 40% e arkeologëve të rinj shqiptarë, që punojnë në nivel ministror ose në strukturat e Parkut Kombëtar, institute, organe vendase ose OJF e kanë filluar karrierën në Butrint"²¹

Në këto trajnime, shkolla angazhoi edhe banorët e Shëndëlliut, si mënyrë për të rritur ndërgjegjësimin dhe vlerësimin e rëndësishëm të Butrintit.

Bashkëpunimi me universitetet e huaja ka përfshirë edhe institucione, si: Universitetin Amerikan të Romës, Kolegjin Utica të Nju Jorkut, dhe Notre Dame, Indiana. Në të gjitha këto partneritete, Parku Kombëtar i Butrintit gjithnjë ka luajtur rol dytësor dhe nuk ka arritur të shfrytëzojë plotësisht përfitimet e mundshme afatgjatë të kësaj marrëdhënieje.

²⁰ Plani i Menaxhimit të Integruar të Parkut Kombëtar të Butrintit 2013 – 2020, projektraporti i parë – edukimi dhe zhvillimi i komunitetit, Valbona Hysa - Smirald Kola, shtator 2012, f. 4.

²¹ Plani i Menaxhimit të Integruar të Parkut Kombëtar të Butrintit 2013 – 2020, projektraporti i parë – edukimi dhe zhvillimi i komunitetit, Valbona Hysa - Smirald Kola, shtator 2012, f. 6.

6.4 Rekomandime për menaxhimin

Burimet natyrore e kulturore dhe komunitetet që jetojnë përgjatë kufijve të Parkut Kombëtar përfaqësojnë një potencial të madh për diversifikimin e ofertës së rekreacionit dhe edukimit për vizitorët. Aktivitete turistike që shfrytëzojnë natyrën, si vërtetimi i zogjve, janë të disponueshme, por mbeten të kufizuara. Aktivitete të mundshme argëtuese që mbështeten në burimet lokale njerëzore dhe natyrore të nënshfrytëzuara, duhet të përfshijnë:

6.4.1 Edukimi

- Grupi Kërkimor i Butrintit dhe AKZM të përcaktojnë dhe zbatojnë kushtet për kërkimin shkencor, inventarin dhe monitorimin mjedisor.
- Kërkimi shkencor në fushën e trashëgimisë kulturore materiale dhe inventarizimi e monitorimi i vlerave të përcaktuara nga Grupi Kërkimor i Butrintit, Ministria e Kulturës, Instituti i Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore dhe Instituti i Arkeologjisë.
- Hapësira trajnimi dhe kërkimi për studiuesit dhe anëtarët e komunitetit.
- Hapësira të përshtatura për grupet shkollore dhe përfshirja e pjesëtarëve të komuniteteve vendase.
- Arkivimi në terren (dhe bazë të dhënash digjitale përfundimtare) i raporteve shkencore, dokumentacionit dhe fotografive ekzistuese dhe të ardhshme të pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme të Parkut Kombëtar.
- Fushata informuese të shpeshta dhe një program mjedisor i përhershëm, me qëllim që të gjitha komunitetet brenda dhe jashtë Parkut të vlerësojnë plotësisht dhe të veprojnë për të ruajtur rëndësinë mjedisore të Butrintit.
- Një kalendar vjetor i vizitave shkollore, si nga rajoni ashtu edhe nga e gjithë Shqipëria. Duke mos qenë të detyrueshme në kurrikulën arsimore kombëtare, këto vizita nuk financohen nga shkollat, ndaj është e vështirë të planifikohen dhe të organizohen vetëm nga mësuesit dhe/ose prindërit. Parku Kombëtar mund të ofrojë financime për t'i nxitur këto vizita, të paktën për shkollat 9-vjeçare dhe të mesme në bashkitë e Sarandës, Finiqit dhe Konispolit.
- Një strategji zhvillimi e qartë për promovimin/edukimin.
- Oferta edukuese duhet të përfshijë tema, si: arkeologjia, arkitektura, arti, biologjia, gjeografia, letërsia dhe historia, etj., me mbështetjen e një stafi të specializuar (fillimisht një anëtar stafi) dhe komunitetit lokal në shërbim të vizitorëve (nëpërmjet materialeve, udhëzuesve specifikë, takimeve me profesionistë, etj.). Përdorimi i mjedisit si burim i rëndësishëm edukues duhet të konsiderohet si përparësi.
- Zhvillimi i kurseve të trajnimit për studentë dhe profesionistë të rinj, për të cilët tregu i mundshëm është ai ndërkombëtar. Kjo do të ndihmonte edhe me fluksin e vizitorëve gjatë sezoneve të caktuara, pasi këto programe mund të zhvillohen jashtë sezonit të verës.

6.4.2 Aktivitete dhe organizime të ndryshme në natyrë

- Ture me udhërrëfyes përgjatë Parkut Kombëtar, sipas interesit dhe grupmoshave të ndryshme
- Shtigje për ecje në natyrë përgjatë Parkut Kombëtar, sipas interesit dhe grupmoshave të ndryshme
- Shtigje për çiklizëm për përdorim rekreacional/çlodhës

- Konkurse sportive ndërkombëtare, në disiplina si: vrap në natyrë, sërif me vela, etj., që janë gjerësisht të pëlqyeshme
- Udhëtime të organizuara me varkë te Kalaja e Ali Pashës dhe përreth lagunës
- Veprimtari për vrojtimin e zogjve dhe infrastruktura përkatëse, veçanërisht në perëndim të Fushës së Vrinës.

6.4.3 Aktivitete kulturore lokale

- Ture gastronomie në fshatrat përreth, duke prezantuar prodhimet dhe kuzhinën lokale
- Dyqane shitjesh me pakicë për fermerët, artizanët dhe bizneset familjare lokale
- Hapja e një qendre për agroekonominë vendase, me panaire për promovimin e produkteve lokale
- Ture dhe seminare që përfshijnë burime dhe praktika bujqësore lokale
- Ekspozita dhe aktivitete festive për kostumet dhe këngët popullore vendase, etj.
- Akomodimi i turistëve në bujtina/familje lokale.
- Organizimi i shfaqjeve teatrale, koncerteve, performancave të ndryshme artistike etj.

6.4.4 Turizëm me interes të veçantë

- Dimër dhe pranverë: vrojtimi i zogjve
- Pranverë dhe vjeshtë: ture për të parë florën
- Vjeshtë, dimër dhe pranverë: shëtitje me udhërrëfyes, shkolla verore arkeologjike, shkolla verore mjedisore.

6.4.5 Aktivitete sezonale dhe aktivitete të tjera

- Ditët e Hapura në Butrint
- Panairi Bujqësor dhe të ngjashme
- Programe leksionesh

6.0 Turizmi dhe infrastruktura – Pika kyçe

- Aktualisht një nga kërcënimet kryesore të ruajtjes së monumentit, të Zonës së Mbrojtur dhe në mbarë Parkut Kombëtar janë vetë vizitorët.
- Propozohet një qendër e re vizitorësh me qëllim kontrollin e fluksit të vizitorëve dhe ofrimin e ambienteve pritëse, orientuese dhe që gjenerojnë të ardhura, të denjë për një Sit të Trashëgimisë Botërore.
- Ndërhyrjet e tjera të propozuara për Zonën A3 do të vënë në përdorim infrastrukturën ekzistuese dhe do të ofrojnë ambiente të reja dhe të nevojshme për menaxhimin.
- Burimet natyrore dhe kulturore dhe komunitetet vendase përfaqësojnë një potencial të madh për diversifikimin e ofertës së rekreacionit dhe edukimit për vizitorët.
- Do të promovohen forma të qëndrueshme të turizmit me bazë komunitare, që janë të ndjeshme ndaj mjedisit, të realizueshme në aspektin ekonomik dhe të drejta në aspektin social.
- Të gjitha ndërtimet dhe operimet e ardhshme në Parkun Kombëtar do të prioritetizojnë përdorimin e materialeve vendase, si dhe praktikat e qëndrueshme operationale.

7.0 ZHVILLIMI I KOMUNITETIT



7.0 ZHVILLIMI I KOMUNITETIT

'Nuk mjafton më veç përpjekja për një bashkëjetesë harmonike. Të gjitha palët duhet të kenë një qëllim dhe të jenë proaktive në përcaktimin e interesave të tyre të përbashkëta dhe në hartimin e strategjive më bashkëpunuese, që kontribuojnë për qëndrueshmërinë dhe konservimin afatgjatë'.

Ky citat i marrë nga Shërbimi i Parqeve Kombëtare në Shtetet e Bashkuara përmbledh qëllimin e identifikimit të dhe dhënies përparësi nevojave të Parkut Kombëtar dhe banorëve të komuniteteve lokale në zonat përreth.

7.1 Konteksti socio-ekonomik

Parku Kombëtar i Butrintit është nën juridiksionin administrativ të tri bashkive: Konispol, Finiq dhe Sarandë, ku brenda këtij territori ka një numër vendbanimesh pranë kufirit të Parkut:

- Vrinë, Shëndelli, Xarrë dhe Mursi – Bashkia Konispol
- Fanar/Dritas, Pllaka dhe Qenurjo/Vurg i ri – Bashkia Finiq
- Manastir dhe qyteti i Ksamilit – Bashkia Sarandë.

Sipas përllogaritjeve të përgjithshme, popullsia e përgjithshme vendore arrin deri në 10,000 banorë.

Demografia - Në vitet 1990, për shkak të rënies ekonomike, shkallës së ulët të punësimit dhe mungesës së arsimit dhe kujdesit shëndetësor, shumë familje dhe të rinj u larguan nga vendi (më së shumti drejt Italisë dhe Greqisë) ose u zhvendosën drejt qendrave urbane, si Gjirokastra apo Tirana. Vitet e fundit, emigrantët, të cilët luajtën një rol kyç në mbështetjen financiare të familjeve dhe të afërmeve të tyre që nuk emigruan, janë kthyer në këtë zonë, sidomos pas krizës ekonomike në Greqi.

Arsimi – Sipas përllogaritjeve, 1% e popullsisë së kësaj zone ka përfunduar vetëm arsimin fillor, 46% arsimin 9-vjeçar, 45% arsimin e mesëm të lartë (diplomë e Maturës Shtetërore) dhe 8% kanë diplomë të arimit të lartë³².

Punësimi – Përqindja e papunësisë në qytezën e Ksamilit është 53.2% (përqindja e papunësisë së të rinjve: 62.7%). Rënia e numrit të plantacioneve të agrumeve, të trashëguara që nga periudha e komunizmit, kontribuoi në reduktimin e mundësive për punësim. Aktualisht, sektori i vetëm si burim të ardhurash për shumë banorë mbetet turizmi sezonal³³ ose tregu i zi.

Në Vrinë, Shëndelli, Xarrë, Mursi, përqindja e papunësisë është 54.7% (përqindja e papunësisë së të rinjve: 72.5 %). Gjithashtu, nga kjo zonë një numër i konsiderueshëm banorësh shkojnë në Greqi si punëtorë sezonalë³⁴.

Bujqësia - Kultivimi i agrumeve vazhdon të jetë shtylla e ekonomisë lokale. Megjithatë, sistemi i ujitjes dhe kullimit në zonë ka degraduar konsiderueshëm që prej viteve 1990, dhe aktualisht nuk mirëmbahet dhe ndikohet edhe fragmentarizmi i pronësisë së tokës.

Xarra ndryshon nga tabloja shqiptare me ferma të fragmentuara dhe të drejtuara individualisht, pasi ajo ka një kooperativë private që prodhon mesatarisht 16,000 ton mandarina në vit nga rreth 500

³² "Plani i Menaxhimit të Parkut Kombëtar të Butrintit", Shoqata Shqiptare për Mbrojtjen e Shpendëve dhe Gjitarëve-SHMSHGJ, Draft i Rishikuar më shtator 2009

³³ Plani i Përgjithshëm Vendor, Bashkia Sarandë

³⁴ Plani i Përgjithshëm Vendor, Bashkia Konispol

hektarë tokë. Me çmimin aktual, prej 0.33 euro/kg, kooperativa është industri që arrin shifrën prej 6 milionë euro. Numri i fermerëve që kanë bashkuar forcat në Xarrë është rritur ndjeshëm, që prej themelimit të kooperativës në vitin 1995. Kooperativa tanimë ka 400 të punësuar, 250 prej të cilëve nuk vijnë nga zonat përreth.

Peshkimi dhe kultivimi i midhjeve - Sipas përllogaritjeve, në Liqenin e Butrintit ndodhen aktualisht 70 vaska për kultivimin e midhjes, 50 prej të cilave shfrytëzohen nga rreth 38 subjekte të licencuara, nëpërmjet kontratave të qiramarrjes. Kapaciteti aktual përllogaritet të jetë rreth 500 – 1,000 ton në vit. Kultivimi i midhjeve ka filluar herët, që prej viteve 1980, me prodhim vjetor nga 2,000 ton deri 5,000 ton, që është sasia maksimale e arritur në vitin 1989, kur 70% e prodhimit eksportohej. Prodhimi ra në mënyrë drastike në vitet 1990, për shkak të përhapjes së kolerës dhe ndalimit të eksportit të midhjeve për në Bashkimin Evropian (BE). Eksporti i midhjeve është ende i ndaluar. Për këtë arsye, BE-ja financoi ndërtimin e një impianti për pastrimin e midhjeve në zonën e Manastirit, në pikën më veriore të aksesit për në Parkun Kombëtar.

Akuakultura detare në këtë zonë është rritur ndjeshëm vitet e fundit, veçanërisht përgjatë vijës bregdetare midis Ksamilit dhe Kepit të Stillos, me dymbëdhjetë subjekte të licencuara, që merren me kultivimin e krapit dhe levrekut (kultura detare në kosha). Sipas përllogaritjeve, Liqeni i Butrintit ka një kapacitet prej 120 ton peshq në vit.

Blegtoria - Delet, dhitë dhe gjedhët kullosin pothuajse në të gjithë territorin e Parkut Kombëtar, madje edhe brenda zonave qendrore (A1 dhe A2). Në këtë zonë, ka edhe një numër të vogël subjektesh që merren me përpunimin e produkteve të qumështit, dhe thertore.

Bimët mjekësore- Megjithëse Parku ofron potencial të madh për grumbullimin dhe kultivimin e bimëve mjekësore, në këtë aktivitet angazhohen vetëm disa familje lokale.

Ndërtimi - Kërcënimet ndaj mjedisit dhe diversitetit ekologjik i kompleksit ligatinor janë reale, si pasojë e ndërtimeve të pakontrolluara në fshatrat përreth. Norma në rritje e ndërtimeve ka çuar në zhvillimin kaotik të zonave urbane, veçanërisht në Ksamil, popullsia e të cilit është dhjetëfishuar që prej viteve 1990, gjë që ka çuar drejtpërsëdrejti në degradimin e mjedisit, brenda dhe rreth Parkut Kombëtar.

Të drejtat e përdorimit të tokës - Të drejtat e përdorimit të tokës janë të ndryshme në zona të ndryshme të Parkut Kombëtar. Zona kryesore bujqësore shtrihet nga lindja në verilindje të Parkut (ish komuna Aliko), ku përveç disa fermerëve që gëzojnë vetëm të drejtat e përdorimit mbi tokë, shumica e tyre janë pronarë të tokës. Në Xarrë, tokat janë pjesërisht në pronësi private, ndërsa në Vrinë banorët lokal ende nuk disponojnë tituj pronësie.

Situata në Ksamil është edhe më e ndërlikuar, për shkak të ndërtimeve informale (të palegalizuara), urbanizimit të pakontrolluar dhe interesave financiare, shoqëruar edhe me faktin që qyteza është shpallur si zonë prioritare për zhvillimin turistik, që prej vitit 1993.

7.1.1 Komunitetet brenda Parkut Kombëtar

Komunitetet që jetojnë në fshatrat: Ksamil, Manastir, Fanar/Dritas, Pllakë dhe Qenurjo/Vurg i Ri, Vrinë dhe Shëndelli, Xarrë dhe Mursi kanë lidhje të drejtpërdrejtë me Parkun Kombëtar të Butrintit. Ato jetojnë dhe punojnë në zonat përreth dhe interesat e tyre ndikojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë burimet dhe vlerat e Parkut Kombëtar. Aspektet më të rëndësishme midis komuniteteve dhe përdorimit të Parkut Kombëtar janë:

Çështjet e përdorimit të paligjshëm dhe të pronësisë së tokës - Banorët lokal janë përdorues të një pjese të fushave të Vrinës dhe Vurgut, Liqenit të Butrintit dhe Liqenit të Bufit, Kanalit të Vivarit dhe gjirit detar të Butrintit dhe zonës bregdetare. Aktivitetet bujqësore dhe ato të peshkimit janë ato që bien ndesh ndjeshëm me interesat e Parkut Kombëtar. Këto veprimtari e kanë ndryshuar ekuilibrin e brishtë ekologjik të të gjithë zonës.

Angazhimi i pakët i komunitetit - Niveli i ulët i ndërgjegjësimit të stafit të Sitit dhe ekipi prej pak vetash e kanë kufizuar potencialin e Parkut Kombëtar për të depërtuar në komunitetet lokale, me qëllimin e promovimit të veprimtarive për krijimin e të ardhurave, duke i përdorur burimet e zonës në mënyrë të qëndrueshme. Aktualisht, Parku Kombëtar i Butrintit nuk i ka kapacitetet dhe kompetencat për hartimin dhe zbatimin e një strategjie të qëndrueshme për zhvillimin e komunitetit.

Ndërgjegjësimi i ulët i banorëve lokal për qëllimet dhe funksionet e Parkut Kombëtar - Banorët lokal nuk i kanë fort të qarta rregulloret dhe qëllimin e Parkut Kombëtar. Përgjegjësia e niveleve të ndryshme për sitin, mungesa e fushatave informuese dhe mungesa e ndërveprimit të rregullt me komunitetin, kanë bërë që banorët lokal ta perceptojnë Parkun Kombëtar si pengesë ndaj veprimtarive të tyre të përditshme.

Mungesa e ndërgjegjësimit të komunitetit - Megjithëse banorët e shumicës së fshatrave kanë të njëjtën kulturë dhe formim (me përjashtimin e atyre në Shën Delli, që janë zhvendosur nga veriu i Shqipërisë), dhe ndajnë të njëjtat shqetësime të mundshme, banorët lokal prirën që të mos bashkëpunojnë dhe të mos angazhohen në aktivitetet me bazë komunitare. Për më tepër, përzierja e popullsisë gjatë dekadave të fundit e ka penguar krijimin e identitetit të komunitetit, për shkak të imigrimit dhe lëvizjes në rritje të popullsisë. Aktualisht, banorët lokal nuk e perceptojnë vlerën dhe përfitimet nga angazhimi në shërbimet turistike të përmasave të vogla dhe/ose nga përdorimi i qëndrueshëm të burimeve natyrore.

Përdoruesit e tjerë të rëndësishëm të Parkut Kombëtar të Butrintit janë:

Shoqatat lokale të peshkimit

- Shoqatat e peshkimit të Sarandës dhe Butrintit
- Organizata e Menaxhimit të Peshkimit (OMP) "Fama"
- Organizata e Menaxhimit të Peshkimit (OMP) "Buka e Vivarit".

Barinjte - Megjithëse nuk janë të organizuar në grupe formale ose shoqata, ata janë ndër përdoruesit më të rëndësishëm të zonës, me ndikim kritik në konservimin dhe menaxhimin e pyjeve natyrore dhe kullotave në territorin e Parkut.

Artizanët - "Shoqata e Artizanëve dhe Zejtarëve të Butrintit" është shoqata lokale e artizanëve që funksionon brenda Parkut Kombëtar të Butrintit. Ajo përfshin pjesëmarrës nga më shumë se 30 familje lokale, të cilët prodhojnë produkte artizanale dhe i shesin ato në Dyqanin e Artizanatit të Komunitetit, që gjendet afër hyrjes në sit. Sipas kryetarit të Shoqatës, tanimë është arritur një konsensus i përgjithshëm midis artizanëve që punojnë në Butrint, me propozim të Ministrisë së Kulturës, e cila vuri si kriter kryesor punimin artizanal të produkteve me tipare të traditës lokale. Gjithashtu, artizanët lokal po bashkëpunojnë me Shoqërinë Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar (GIZ) dhe Fondin Shqiptar të Zhvillimit (FSHZH).

Bizneset lokale - Në këtë zonë operon edhe një numër shoqëri private, të cilat kanë marrë leje për të ushtruar veprimtaritë e peshkimit dhe akuakulturës në Liqenin e Butrintit, Liqenin e Bufit dhe ujërat detare, përgjatë bregut të gadishullit të Ksamilit dhe Kepit të Stillos.

7.2 Angazhimi i komunitetit

Komunikimi më i mirë me komunitetin është thelbësor për suksesin e menaxhimit të parkut, duke përfshirë gjithë strukturat menaxhuese dhe në mënyrë të veçantë Fondacionit të Ri. Duhet të ofrohen zgjidhje në nivel vendor, dhe jo të krijohen probleme, sidomos ato që vijnë nga një perceptim i hierarkisë së marrëdhënies. Për këtë qëllim, mund të nevojitet të bëhen kompromise, veçanërisht për t'u bërë palë me objektivat zhvillimit të qëndrueshëm, dhe sigurisht për të përmbushur nevojat e konservimit të arkeologjisë, të mbarë Parkut, si dhe të komunitetit lokal.

Gjithashtu, angazhimi proaktiv më efikas me komunitetet lokale është një aspekt, të cilit i duhet kushtuar më shumë rëndësi që në planin fillestar të menaxhimit, por edhe nga ana e stafit të ZAK Butrint, të cilët ishin tërësisht të patrajnuar për një rol të tillë.

Çështja e angazhimit të komunitetit shpesh lidhet ngushtësisht me interpretimin, trajnimin dhe edukimin. Puna me komunitetet është shpesh detyra më e vështirë, pasi kërkon shumë kohë, është delikate nga këndvështrimi politik, por është më e rëndësishmja në kontekstin e menaxhimit të zonave të mbrojtura.

Suksesi afatgjatë për shumë zona të mbrojtura varet nga marrëdhëniet e mira dhe reciproke me komunitetet e tyre fqinje. Prandaj, duhet të caktohet një pjesëtar i ekipit të menaxhimit për Angazhimin e Komunitetit, për koordinimin dhe nxitjen e kësaj marrëdhënieje të vazhdueshme.

Me qëllim ruajtjen e sitit, komunitetet lokale duhet ta perceptojnë atë si pronë të tyre dhe ta njohin si të tillë. Statusi i një siti që mban titullin e një Vlere të Jashtëzakonshme Universale është një njohje e rëndësishme. Megjithatë, kjo njohje sjell edhe disavantazhe, duke e bërë sitin ekskluziv për komunitetin e ekspertëve të kërkimit/konservimit/komunitetit arkeologjik, që praktikisht përjashton komunitetin lokal.

Seminaret, takimet dhe intervistat, u mbajtën me përfaqësues të bashkive të Sarandës, Konispolit dhe Finiqit, kryepleqtë e fshatrave të Vrinës, Shëndellit, Xarrës dhe Mursit, si dhe fokus grupe të tjera. Do të nevojiten edhe takime të tjera në të ardhmen për të:

- Informuar ata për mundësitë dhe çështjet e mbartura lidhur me Parkun Kombëtar në periudhën afatmesme dhe afatgjatë
- Nxitur të kuptuarit e nevojave dhe interesave të tyre
- Identifikuar rolet dhe përgjegjësitë përkatëse
- Vlerësuar kërkesat për ngritjen e kapaciteteve
- Planifikuar programet e nevojshme për edukimin dhe trajnimin.

7.3 Qëndrueshmëria mjedisore

Komunitetet lokale janë elemente kyçe për qëndrueshmërinë mjedisore të Parkut Kombëtar dhe duhet të jenë pjesë thelbësore e menaxhimit të tij të suksesshëm. Kooperativa bujqësore në Fushën e Vrinës dhe peshkimi për qëllime tregtare në Liqenin e Butrintit dhe në Kanalin e Vivarit kanë ndikuar në formësimin e peizazhit gjatë shumë mijëvjeçarëve dhe duhet të merren parasysh në çdo plan menaxhimi për Parkun Kombëtar në tërësi.

Për më tepër, territori i Parkut Kombëtar është thelbësor për identitetin e Qytetit antik të Butrintit dhe Statusin e tij si Trashëgimi Botërore, dhe ndaj duhet gjetur një ekuilibër ndërmjet interesave të komuniteteve lokale dhe shtit. Mjafton vetëm një vizitë e rastësishme në Butrint për të konstatuar se, ndonëse Zona A3 është e mirëmenaxhuar dhe e mirëmbajtur, ambienti përreth nuk është i pastër.

Kjo duhet të ndryshojë, në të kundërt, e ardhmja e Butrintit do të jetë ajo e një shti të pacenuar dhe të mirëmenaxhuar, por të izoluar dhe të rrethuar nga një peizazh ku nuk ka kujdes, i neglizhuar dhe i shkatërruar. Nëse përfundon kështu, numri i vizitorëve do të binte me kalimin e kohës. Të ardhurat do të uleshin, banorët vendas do ta humbnin kureshtjen dhe interesin, stafi me përvojë do të vendoste të largohej, dhe vetë shti do të degradonte në planin afatgjatë.

Parku Kombëtar i Butrintit do të lulëzonte vetëm nëse njerëzit kujdesen, e respektojnë dhe synojnë më të mirën për të. Prandaj, nuk mund të ketë justifikime për fonde të pamjaftueshme për konservimin apo për mungesën e stafit e burimeve të tjera për ta realizuar këtë gjë.

Një mundësi është që të përfshihen banorët lokal dhe të motivohen duke fituar financiarisht nga një nismë për pastrimin e zonës, që do të zgjasë, për shembull 2-3 vjet. Në të gjithë territorin e Parkut Kombëtar, njerëzit duhet të shpërblehen për mbledhjen e mbetjeve plastike dhe mbetjeve të tjera jo organike dhe për largimin e tyre në një pikë/a kryesore grumbullimi.

Shkollat duhet të nxiten të përfshihen, komunitetet lokale dhe fshatrat mund të bëjnë një konkurs se kush mbledh më shumë mbetje plastike.

7.4 Rekomandime për menaxhimin

Çështjet e menaxhimit, të cilat lidhen me komunitetet që jetojnë brenda Parkut Kombëtar të Butrintit apo rreth tij, dhe zhvillimi i tyre social apo ekonomik paraqiten në mënyrë të përmbledhur si veprime specifike menaxhimi në Planin e Veprimit³⁵:

7.4.1 Zhvillimi i komunitetit

Komunitetet lokale dhe grupet e interesit të Parkut duhet të përfshihen në një strategji të unifikuar zhvillimi për komunitetet dhe në planin përkatës të veprimit.

7.4.2 Përfaqësimi vendor dhe rajonal

Të forcohet përfaqësimi dhe përfshirja efikase e bashkive dhe njësive administrative si dhe Këshillit të Qarkut në proceset e menaxhimit dhe vendimmarrjes.

7.4.3 Koordinimi i palëve të interesit

Të përmirësohet efektshmëria e koordinimit me palët e interesit dhe forcimi i komunikimit me komunitetet rreth qëllimeve, strategjive, dhe pritshmërive reale, që lidhen me planet dhe projektet e zhvillimit.

- Zhvillimi i Strategjisë së Integruar për Zhvillimin e Komunitetit

³⁵ Parku kombëtar Teide, në Spanjë, është interesant si rast studimor i praktikës më të mirë, për këto aspekte: aktivitetet menaxheriale që zbatojnë standardet mjedisore, pjesëmarrja e palëve vendase të interesit, programi edukativ dhe interpretues, apikulturë, dhe kontrollimi i përdorimit publik.

- Caktimi i një pjesëtari të ekipit të menaxhimit për Angazhimin e Komunitetit, për koordinimin dhe nxitjen e kësaj marrëdhënieje të vazhdueshme.

7.4.4 Qëndrueshmëria

Të promovohen forma të qëndrueshme të turizmit me bazë komunitare dhe të bujqësisë, të cilat janë të ndjeshme ndaj mjedisit, të zbatueshme, nga pikëpamja ekonomike, dhe të drejta, nga pikëpamja sociale.

- Mirëmbajtja e Parkut Kombëtar dhe mbështetja e peshkimit tradicional në shkallë të vogël, kullotjes, veprimtarive në pemëtore dhe ullishte, që dallohen në peizazhin e kësaj zone dhe që përbëjnë një potencial madhor për zhvillimin e agroturizmit. Ato janë burime të pazëvendësueshme të ardhurash për banorët lokal, si në periudhën afatshkurtër, ashtu edhe në atë afatmesme
- Forcimi i lidhjeve ekonomike, nëpërmjet punësimit të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, midis banorëve lokal dhe veprimtarive që lidhen me arkeologjinë dhe turizmin, brenda dhe rreth Zonës A3:
 - Punimet e mirëmbajtjes brenda parkut arkeologjik
 - Organizimi i veprimtarive edukuese, interpretuese dhe udhërrëfyese
 - Prodhimi artizanal dhe/ose paraqitja e produkteve artizanale
 - Etiketimi i produkteve lokale ("Prodhuar në Butrint"), shërbime konsulence (marketing, etj.) për prodhuesit lokal artizanalë dhe prodhimet natyrale në Parkun Kombëtar
- Krijimi i një shumëllojshmërie ofertash turistike brenda Parkut Kombëtar (duke mbështetur nismat e vrojtimit të zogjve dhe ecjes në natyrë dhe në shtigje, kultivimin e bimëve mjekësore, akomodimin në bujtinat e fshatrave)
- Mbështetja dhe nxitja e bashkëpunimit të artizanëve lokal të kooperativës me prodhimin e produkteve artizanalë të cilësisë së lartë dhe prodhimeve natyrale.

7.4.5 Kujdesi me burimet

Ti ofrohet ndihmë komuniteteve lokale që të njohin, vlerësojnë dhe kujdesen për burimet e Parkut Kombëtar.

- Organizimi i fushatave të shpeshta informuese dhe i një programi të përhershëm për edukimin mjedisor, me qëllim forcimin e veçantisë së tij, dhe fuqizimi i pjesëtarëve të komuniteteve lokale në aspektin e administrimit të burimeve natyrore, që lidhen me mirëqenien e komunitetit
- Promovimi dhe mbështetja e veprimeve të përbashkëta periodike të banorëve lokal, ku përfshihet ndihma vullnetare për pastrimin dhe mirëmbajtjen e zonës, monitorimi, etj.
- Krijimi i një sistemi masash nxitëse dhe frenuese, për nxitjen e një sjelljeje më miqësore ndaj mjedisit.

7.4.6 Edukimi dhe të nxënit

Të bëhen përpjekje për ta bërë Parkun Kombëtar një mjedis që mundëson të nxënit dhe edukimin mjedisor, që ofron përvoja për të nxënit të thelluar dhe të bazuara në realitet, për një shumëllojshmëri temash.

- Zhvillimi i një programi edukues të cilësisë së lartë, që përfshin lëndë të ndryshme, si: arkeologji, arkitekturë, art, biologji, gjeografi, letërsi dhe histori, etj. Ky program mund të zhvillohet nga një staf i specializuar, fillimisht një person nga stafi dhe përfshirja e vazhdueshme e komunitetit lokal dhe institucioneve kyçe partnere
- Në terren:
 - krijimi i hapësirave/ambienteve për kërkim dhe trajnim, për studiuesit dhe pjesëtarët e komunitetit
 - arkivimi (dhe baza e të dhënave digjitale) i raporteve shkencore ekzistuese dhe të ardhshme, dokumentacioneve, fotografive, etj., për pasuritë materiale dhe jomateriale të PKB-së
 - krijimi i hapësirave të përshtatura (një sallë leksioni dhe hapësirë për aktivitete), për vizitat shkollore, që lidhen me aktivitete të komunitetit lokal
- Mbështetja te programet ekzistuese të edukimit, për të krijuar një kalendar vjetor për vizitat shkollore nga Saranda, Finiqi dhe Konispoli
- Ofrimi i kurseve trajnuese të specializuara me disa nivele në arkeologji dhe konservim, nga punëtorët e aftë deri te menaxherët dhe studiuesit. Gjithashtu, duhet krijuar një sistem për vendet e punës për praktikantët, për forcimin e përfshirjes së të rinjve të zonës dhe mundësitë e të nxënit gjatë punës.

7.0 Zhvillimi i Komunitetit – Pika kyçe

- Lidhje më të mira me komunitetin janë thelbësore për suksesin e Menaxhimit të Parkut.
- Komunitetet që jetojnë brenda Parkut dhe zonave përreth, kanë interesa të cilat ndikojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë në burimet dhe vlerat e Parkut Kombëtar.
- Komunitetet lokale mund të kenë shumë përfitime, si në aspektin social edhe në atë ekonomik, falë ngritjes së kapaciteteve, trajnimit dhe mundësive të punësimit.
- Prodhimi ekzistues artizanal do të zhvillohet nga artizanët lokal dhe do të përfshihet në produktet e reja që do të shiten në Butrint.
- Nxitja e njohjes së komuniteteve lokale, vlerësimit dhe kujdesit ndaj burimeve të Parkut është tejet e rëndësishme.
- Do të zhvillohen kurse trajnimi për specialistët në arkeologji dhe konservim dhe pozicionet fillestare do të synojnë përfshirjen e të rinjve lokal.
- Fshatrat e Vrinës, Shëndellit dhe Xarrës do të vlerësohen për potencialin e tyre në ofrimin e akomodimit për turistët dhe të strukturave të tjera që mund të ofrojnë të ardhura të mëtejshme.

8.0 DREJTIMI DHE MENAXHIMI



8.0 DREJTIMI dhe MENAXHIMI

Drejtimi është tërësia e rregullave që lidhen me strukturat, funksionet, proceset dhe mënyrën tradicionale të organizimit, brenda kontekstit të një mjedisi autorizues, për të siguruar zbatimin e programit me qëllim që objektivat e tij të përmbushen në mënyrë efektive dhe transparente. Vendimet merren brenda kuadrit rregullator të përgjegjësisë ndaj konsumatorëve, grupeve të interesit dhe komunitetit, duke drejtuar dhe kontrolluar funksionet e tyre në përmbushje të objektivave.

Menaxhimi parashikon zbatimin e përditshëm të programit, në kuadër të strategjive, politikave, proceseve dhe procedurave që janë hartuar nga organi qeverisës. Ndërkohë që drejtimi konsiderohet si "të krijosh vizionin", menaxhimi është "implementimi i këtij vizioni"¹⁶.

8.1 Metodatat e drejtimit dhe menaxhimit

Ky seksion merr parasysh metodatat se si drejtimi dhe menaxhimi i tri zonave që përbëjnë "peizazhin e Butrintit", dhe të cilat përshkruhen hollësisht më tej në këtë Plan Menaxhimi, mund të zbatohen në mënyrë të drejtpërdrejtë nga qeveria ose nga qeveria në bashkëpunim me një palë të tretë jo fitimprurëse; pra alternativat e disponueshme sipas legjislacionit shqiptar. Zonat janë:

- Zona A3 brenda të cilës ndodhet Qyteti Antik (614 ha)
- Siti i Trashëgimisë Botërore (2,500 ha)
- Parku Kombëtar (9,424 ha; brenda të cilit ndodhet zona mbrojtëse e STB-së 8.591 ha).

Nga të gjithë faktorët që kontribuojnë në ruajtjen afatgjatë të një Siti të Trashëgimisë Botërore, më e rëndësishme është mënyra se si drejtohet, menaxhohet dhe, për rrjedhojë, mbrohet.

Të gjitha parametrat e tjerë si: investimi kapital, punësimi i stafit të trajnuar dhe me përvojë, motivimi i popullsisë vendase, vullneti i mirë politik, ruajtja e vetë peizazhit janë rrjedhojë e mënyrës së menaxhimit.

Pa një drejtim efikas, që synon ruajtjen afatgjatë të aseteve të sitit, gjithçka tjetër vihet në rrezik: monumenti mund të shkatërrohet, mund të kryhen ndërhyrje dëmtoese, mund të përkrahet një qëndrim *laissez-faire*, i orientuar në fitimin afatshkurtër, në dëm të përfitimit afatgjatë.

Sitet e Trashëgimisë Botërore si Butrinti janë gjithnjë në qendër të vëmendjes. Megjithatë ndodhen në një vend, në një shtet, apo në një rajon të caktuar, rëndësia e tyre shkon përtej vendndodhjes së tyre gjeografike. Ato kanë rëndësi ndërkombëtare dhe duhet të mbrohen përjetësisht, për të mirën e të gjithëve. Për rrjedhojë, drejtuesit e këtij siti kanë një detyrim ndaj komunitetit botëror.

Por, Sitet e Trashëgimisë Botërore janë gjithashtu shumë të brishta. Në disa raste, ndryshimi i vullnetit qeverisës apo ndryshimet e qëndrimeve, mund të kombinohen dhe të çojnë edhe në shkatërrimin e shpejtë të vlerave të tyre, në disa raste me hapa shumë të shpejtë. Kjo vlen në veçanti për Butrintin, duke marrë parasysh VJU-n, si dhe vlerat e tjera të rëndësishme që mbart, saqë humbja e tij do të ishte e pallogaritshme. Prandaj, një drejtim afatgjatë, i qëndrueshëm dhe i efektshëm është shumë i rëndësishëm.

¹⁶ Marrë nga: http://siteresources.worldbank.org/EXTGLOREGPARPROG/Resources/grpp_sourcebook_chap12.pdf

8.2 Parqet Kombëtare

Në vitin 1969, IUCN-ja¹⁷ përkufizoi një 'park kombëtar' si një hapësirë të madhe gjeografike me këto karakteristika:

- Një ose më shumë ekosisteme të cilat nuk janë modifikuar materialisht nga shfrytëzimi dhe zaptimi njerëzor, ku speciet bimore dhe shtazore, sitet dhe habitatet gjeomorfologjike përbëjnë interes të veçantë shkencor, edukativ dhe rekreacional, ose të cilat karakterizohen nga një peizazh natyror me bukuri të mahnitshme
- Autoriteti kompetent më i lartë i vendit ka ndërmarrë hapa për të parandaluar ose eliminuar, sa më shpejt që të jetë e mundur, shfrytëzimin apo zaptimin në të gjithë zonën dhe për të zbatuar në mënyrë të efektshme respektimin e tipareve ekologjike, gjeomorfologjike, apo estetike të cilat kanë çuar në krijimin e tij
- Vizitorët lejohen të hyjnë vetëm nën kushte të veçanta, për qëllime , edukative, kulturore dhe argëtuese.

Në vitin 1971, këto kritere u zgjeruan duke përfshirë:

- Një sipërfaqe minimale prej 1,000 hektarësh brenda zonave ku mbrojtja e natyrës është përparësi
- Mbrojtje nëpërmjet akteve ligjore
- Buxhet dhe staf i mjaftueshëm për të ofruar mbrojtje të efektshme
- Ndalimin e shfrytëzimit të burimeve natyrore duke marrë parasysh veprimtari të tilla, si sport, gjueti, peshkim dhe nevoja për struktura për përdorim nga menaxhimi.

Duke nisur nga më i madhi (*Parku Kombëtar i Northwest Greenland* me një sipërfaqe mbi 972.000 km²) deri te më i vogli (ishujt e pabanuar të *Iles de la Medeleine* pranë bregut të Senegalit vetëm 0.45 km²), rreth 7.000 parqe kombëtare në mbarë botën nuk kanë rregulla të njëjta menaxhuese dhe ndryshojnë shumë për sa i përket përfshirjes së shtetit. Pjesa më e madhe e parqeve kombëtare, përfshirë edhe Butrintin, karakterizohen nga një kombinim i tokës private, publike dhe jopublike, ku rregullimet e tyre të pronësisë përbëjnë më shumë një problem të historisë se sa të planifikimit.

Megjithatë, pjesa më e madhe përdorin emërtimin "park kombëtar" si një njohje e markës për të promovuar idenë e drejtimit dhe mirëmenaxhimit që mbështetet në një mjedis me cilësi të lartë dhe me infrastrukturë turizmi të mirë-projektuar¹⁸ që synon si tregjet kombëtare dhe ato lokale. Menaxhimi mbikëqyrës zbatohet nëpërmjet një "komiteti" të përcaktuar i cili në shumë vende ushtron pushtetin nëpërmjet ndikimit të tij mbi sistemin e planifikimit duke vendosur dhe monitoruar objektivat afatgjatë të menaxhimit nëpërmjet dokumenteve të politikave, Planet e Parqeve Kombëtare dhe të ngjashme¹⁹.

Shumica e këtyre komiteteve janë një kombinim i agjencive kombëtare dhe qeverisjes vendore të mbështetura nga grupe të specializuara të interesit, si ornitologët, botanistët dhe arkeologët që punojnë në universitete apo si anëtarë të shoqatave apo instituteve.

¹⁷ Unioni Ndërkombëtar për Konservimin e Natyrës (IUCN) është një organizatë ndërkombëtare që punon në fushën e konservimit të natyrës dhe përdorimit të qëndrueshëm të burimeve natyrore.

¹⁸ Eagles, Paul F.J. "Trends in Park Tourism: Economics, Finance and Management". Arkivuar më 4 mars 2016 në Wayback Machine Në: *Journal of Sustainable Tourism* Volumi 10, Numri 2, 2002, f. 133.

¹⁹ Si shembull, në Mbretërinë e Bashkuar këto Autoritete konsultohen sipas detyrimit ligjor për të gjitha zhvillimet në tokë që kërkojnë miratim për Planifikim. E njëjta gjë zbatohet edhe në Shqipëri.

Qëllimi i tyre është përfshirja: komiteti përcakton prioritetet dhe synon që zbatimimi i tyre të arrihet nëpërmjet miratimit të mirëargumentuar, pasi zbatimimi i prioriteteve nga banorët lokalë është i rëndësishëm nëse ato do të zbatohen në terren. Ky është qartë edhe rasti në Butrint, ku për shembull, vetëm në Fushën e Vrinës ekzistojnë më shumë se 700 pretendime mbi pronësinë e tokës⁴⁰.

Zbatimimi operacional shumë shpesh realizohet nga punonjësit e parkut të cilët janë të angazhuar me mbikëqyrjen, menaxhimin dhe/ose punojnë lidhur me konservimin dhe përdorimin e burimeve të parkut. Kjo përfshin funksione si konservimin mjedisor dhe të peizazhit, menaxhimin e burimeve natyrore, historike dhe kulturore dhe zhvillimin dhe funksionimin e programeve të interpretimit dhe argëtimit në dobi të vizitorëve⁴¹.

Si rrjedhojë, ofrimi i një standardi efikas ndërkombëtar i kujdesit, për një park kombëtar kërkon:

- Një komitet të dakordësuar për mbikëqyrjen e parkut;
- Objektiva të qarta, të rëna dakord për të gjitha aspektet e peizazhit, natyror, historik dhe kulturor, të përcaktuar në terma afatgjatë;
- Mënyra për të trajtuar konfliktet e mundshme ndërmjet elementeve natyrore, historike dhe kulturore;
- Objektiva që asnjë nuk duhet të humbasë, të gjithë duhet të fitojnë;
- Duhet të sigurohen burime të mjaftueshme për zbatimin e planeve, të cilat duhet të përfshijnë punonjësit e parkut dhe ekipin mbështetës të mirëpajisur dhe financiar, pasi këta janë (ose duhet të jenë) kontakti kryesor me banorët vendas, si dhe me turistët;
- Të dëgjohen banorët lokalë sepse pa mbështetjen e tyre çdo plan për *cilindo* park kombëtar do të ishte i mangët.

8.3 Autoritetet aktuale përgjegjëse në Butrint

8.3.1 Në nivel ndërkombëtar

UNESCO

Zona e shpallur si Sit i Trashëgimisë Botërore përfshin një sipërfaqe prej 2.500 ha, përreth të cilës ndodhet zona mbrojtëse e Sitit të Trashëgimisë Botërore, të dyja pjesë e Parkut Kombëtar të Butrintit. Organi kombëtar përgjegjës për raportimin lidhur me Sitet e Trashëgimisë Botërore pranë QTB/UNESCO-s është Ministria e Kulturës, nëpërmjet Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore, në Tiranë.

ICOMOS dhe ICCROM janë organe këshillimore të QTB/UNESCO-s të cilat i ofrojnë UNESCO-s këshilla teknike lidhur me trashëgiminë kulturore.

RAMSAR

Në përputhje me Konventën e RAMSAR-it, Parku Kombëtar i Butrintit është shpallur si Ligatinë e Rëndësishme Ndërkombëtare. Ministria e Turizmit dhe Mjedisit është organi kombëtar përgjegjës për

⁴⁰ Burimi: kërkimi në zyrat vendore të regjistrimit të tokës i ndërmarrë nga CHwB në shkurt 2019 në emër të projektit.

⁴¹ Në rastet më të skajshme, kjo mund të përbëjë edhe risik të lartë, siç janë aktivitetet paramilitare të përdorimit të forcës vdekjeprurëse për mbrojtjen e elefantëve në Parkun Kombëtar në Republikën Demokratike të Kongos dhe rinoqerontëve në Kruger të Afrikës së Jugut. Në SHBA, roli i rojtarit të parkut (i krijuar në vitin 1916 si një shërbim udhërrëfyes) tashmë përfshin zbatimin e rregullt të ligjit, shpesh nga staf i armatosur.

raportimin lidhur me sitet e shpallura nga RAMSAR-i, nëpërmjet Agjencisë Kombëtare për Zonat e Mbrojtura.

8.3.2 Në nivel kombëtar

Aktualisht, Parku Kombëtar i Butrintit administrohet dhe mbikëqyret nga organe qeveritare në varësi të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit dhe Ministrisë së Kulturës. Konkretisht, aktiviteti në Zonën A3 drejtohet nga Bordi për Administrimin dhe Koordinimin e Butrintit dhe administrohet nga Zyra e Administrimit dhe Koordinimit, që u themeluan në vitin 1998; Bordi është i ngarkuar me kompetenca për zhvillimin strategjik të zonës, ndërsa zyra kryen funksionet administrative për Zonën A3.⁴⁷ Ky Bord drejtohet nga Ministri i Kulturës dhe përfshin përfaqësues institucioneve përgjegjëse për trashëgiminë kulturore, planifikimit të territorit, të turizmit dhe mjedisit, etj. Gjithashtu, Ministria e Kulturës raporton pranë QTB/UNESCO-s për gjendjen e konservimit të Sitit të Trashëgimisë Botërore dhe Zonës së Mbrojtëse të tij.

Në vitin 2000, zona arkeologjike prej 2.500 ha u shpall Park Kombëtar i mbrojtur nga Shteti.⁴⁸ Zyra e Administrimit dhe Koordinimit të Butrintit, i cili është institucion në varësi të Ministrisë së Kulturës, është autoriteti përgjegjës për administrimin e kësaj zone.

Në vitin 2002, Kompleksi Ligatinor Butrinti prej 13.500 ha u shpall zonë natyrore e mbrojtur, që do të përfshihej në listën e Ligatinave me Rëndësi Ndërkombëtare, sipas Konventës RAMSAR.⁴⁹ Ky vendim përcakton një zonë arkeologjike prej 408 ha. Për sa i përket organeve të qeverisjes, Zyra e Administrimit dhe Koordinimit të Butrintit, në bashkëpunim me strukturat e Ministrisë së Mjedisit dhe Ministrisë së Bujqësisë, është përgjegjëse për menaxhimin e zonës dhe zbatimin e planit të saj të menaxhimit.

Vendimi i Këshillit të Ministrave i vitit 2005⁵⁰, i ndryshuar, parashikon kufijtë aktual të Parkut Kombëtar të Butrintit. Ai e përcakton sipërfaqen prej 9.424,4 hektarësh të Kompleksit Ligatinor të Butrintit si park kombëtar dhe ia delegon përgjegjësinë e menaxhimit dhe kontrollin e zbatimit të planit menaxhues zyrës së administrimit dhe koordinimit të Parkut Kombëtar të Butrintit, në varësi të Ministrisë së Kulturës dhe administratës së Parkut Kombëtar (aktualisht AKZM/AdZM Vlorë) në varësi të Ministrisë së Mjedisit dhe komitetit të menaxhimit të këtij parku, në bashkëpunim me institucionet e specializuara. Komiteti i menaxhimit të Parkut Kombëtar të Butrintit sipas ligjit të mëparshëm për zonat e mbrojtura nuk u krijua.

Agjencia Kombëtare për Zonat e Mbrojtura (AKZM) u ngrit në vitin 2015⁵¹ dhe është autoriteti përgjegjës për menaxhimin e parkut për mbrojtjen e pasurive natyrore në zonat e mbrojtura. Komitetet e Menaxhimit për zonat e mbrojtura janë ngritur për të mbikëqyrur zbatimin e planeve të menaxhimit.

Duke marrë parasysh ndryshimet e sipërfaqes dhe zonës së Parkut Kombëtar të Butrintit, kuadri ligjor mund të interpretohet në dy mënyra, për sa i përket zgjerimit gjeografik dhe shtimit të kompetencave të Bordit të Butrintit dhe institucioneve të tjera, duke qenë se janë në fuqi disa akte ligjore që mbivendosin kompetenca. Nga ana praktike, Bordi i Butrintit merr vendime strategjike që lidhen me zhvillimin e Sitit të Trashëgimisë Botërore, të cilat zbatohen nga Zyra e Administrimit dhe

⁴⁷ Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 450, datë 01.07.1998, i ndryshuar.

⁴⁸ Vendim i Këshillit të Ministrave Nr.82, datë 02.03.2000.

⁴⁹ Vendim i Këshillit të Ministrave Nr.531, datë 31.10.2002.

⁵⁰ Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 693, datë 10.11.2005, i ndryshuar.

⁵¹ Vendim i Këshillit të Ministrave, Nr. 102, datë 04.02.2015, i ndryshuar.

Koordinimit, ndërsa Agjencia Kombëtare për Zonat e Mbrojtura është përgjegjëse, dhe konsultohet rregullisht me Zyrën e Administrimit dhe Koordinimit të Butrintit, për çdo çështje që lidhet me bimësinë ose çështje të tjera që lidhen me mjedisin.

Në mars të vitit 2019⁴⁷, u ngrit Komiteti i Menaxhimit për Parkun Kombëtar të Butrintit nga Prefekti i Qarkut të Vlorës, në bashkëpunim me Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit, dhe tashmë është mbajtur mbledhja e tij e parë. Komiteti i Menaxhimit të Butrintit përbëhet nga një përfaqësues nga Zyra e Administrimit dhe Koordinimit të Butrintit (ekspert mjedisor), me një përfaqësues nga Drejtoria Rajonale e Trashëgimisë Kulturore, Vlorë.

Kjo situatë kërkon një vendimarrje urgjente, duke marrë parasysh nevojat për një zgjidhje të integruar menaxheriale, bazuar tek bashkëpunimi dhe përgjegjësia e përbashkët e dy organeve, Ministrisë së Kulturës dhe Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit.

8.4 Analiza e menaxhimit

Në analizën e mëposhtme merrën parasysh Pikat e forta dhe Pikat e Dobëta kryesore të modelit aktual të menaxhimit të Butrintit si dhe Mundësitë dhe Risqet për zbatimin e suksesshëm të propozimeve të menaxhimit për PMI-në për 10 vitet e ardhshme.

Pikat e forta	Pikat e dobëta
<ul style="list-style-type: none"> Fakti që Butrinti është një vend mjaft i njohur dhe me vlera të jashtëzakonshme universale, gëzon statusin e një siti të trashëgimisë botërore. Mbështetja e qeverisë qendrore dhe mbështetje të tjerëfinanciare dhe të aseteve të tjera të Parkut, sipas marrëveshjes së administrimit. Aksesi në të gjitha institucionet shtetërore dhe institucionet e tjera akademike. Ekzistenca e nismaveprivate dhe bizneseve lokale, që përfshijnë akomodimin, restorante, bare, ture dhe guidat e Parkut. Ndërgjegjësimi në shkallë kombëtare rreth nevojës për rritjen e bashkëpunimit, për të pasur një zhvillim të qëndrueshëm. Aksesi në idetë dhe konceptet e praktikave më të mira, për mënyrën se si duhet të studiohet, gërmohet, konservohet, dokumentohet, publikohet dhe arkivohet siti, duke e njohur Butrintin si një vend unik dhe të veçantë, të dokumentuara në punët e bëra ngafondacioni Butrinti. Cilësia, aftësitë akademike dhe përvoja e stafit kryesor, që punojnë në Zonën A3 dhe në gjithë Parkun. 	<ul style="list-style-type: none"> Arsyeja më domethënëse që thekson nevojën për ndryshim është pamundësia e strukturave aktuale të menaxhimit për të marrë vendime në kohën e duhur, apo mungesës së koordinimit nga ana e ministrive, për të punuar së bashku në dobi të parkut kombëtar, e kombinuar edhe me mungesën e kapaciteteve për t'i zbatuar ato. Tradita e rregullimit nga qeverisja qendrore të gjithë sektorëve të ekonomisë, duke përfshirë bujqësinë, konservimin dhe turizmin, gjë që pasqyrohet në një mori aktesh ligjore e nënligjore shumë të detajuara lidhur me Zonën A3 dhe mbarë Parkun Kombëtar, gjë e cila pengon bashkëveprimin dhe ngadalëson progresin. Parku në tërësi nuk ka një plan zbatimi të publikuar, i mungon monitorimi dhe mbikëqyrja ditore ku mund të evidentohen zhvillime të paplanifikuara, dëmtime të habitatit dhe rrethime dhe mbjellje të jashtëligjshme, ku disa prej tyre ndodhin në zona me ndjeshmëri arkeologjike si në Fushën e Vrinës dhe gjetkë. Paqartësitë që janë krijuar ne aktet ligjore dhe nënligjorendërmjet Ministrisë së Kulturës dhe Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit (AKZM), për sa i përket roleve dhe përgjegjësi të tyre nëlidhje me kontrollin dhe menaxhimit e Parkut

⁴⁷ Urdhri i Prefektit Nr.19, datë 27.03.2019

	<p>Kombëtar dhe Zonës A3 (nënzonat A3).</p> <ul style="list-style-type: none"> Ministria e Kulturës ka në fokusin e saj menaxhimin e burimeve arkeologjike të Zonës A3, gjë e cila ka sjellë mungesë të propozimeve për nisma ligjore që përfshijnë mbarë parkun, në veçanti në lidhje me angazhimin e komunitetit, të cilit nuk i është kushtuar kujdesi i duhur. Punonjësit e specializuar të Butrinit në Zonën A3, ndihen jo të përfshirë në vendimarrjet e rëndësishme të marra nga institucionet. Këshillat e tyre, të cilat janë të bazuara në përvojën praktike, në shumë raste do të ishin të vlefshme. Mungesa e investimeve të mundshme private në menaxhimin e sitit nënkupton se të gjitha kostot janë të mbuluara nga qeveria nëpërmjet fondeve publike. Fakti që buxhetet përcaktohen çdo vit nga qeveria, frenon investimet strategjike afatgjata, të cilat mund të arrihen nëpërmjet përfshirjes së sektorit privat jofitimprurës. Këto dobësi tregojnë se <ul style="list-style-type: none"> (a) ka bashkëpunim të dobët ndërmjet bashkive që kanë ndikim administrativ mbi Parkun, (b) nga ana e sektorit publik mund të bëhet një menaxhim më profesional i turizmit, (c) nuk ka një faqe zyrtare interneti apo në mediat sociale të menaxhuar në mënyrë profesionale, (d) materialet promovuese përmbajnë informacion të pa azhurnuar (e) mungon një markë koherente dhe e unifikuar e Parkut.
Mundësitë	Risqet
<ul style="list-style-type: none"> Rivlerësimi i modelit të menaxhimit dhe krijimi i një modeli menaxhimi më të qëndrueshëm. Qeveria ka njohur rëndësinë dhe fuqinë e turizmit ndërkombëtar, si pjesë e agjendës më të gjerë socio-demografike. Krijimi i Fondacionit të Ri për të menaxhuar aktivitetin brenda Zonës A3 dhe si rrjedhojë, pjesërisht ndikimi në të ardhmen e Parkut në tërësi, si tregues i pranisë së institucioneve donatore që operojnë në shkallë kombëtare dhe rajonale dhe investojnë në turizëm, kulturë dhe konservim. 	<ul style="list-style-type: none"> Risku i menaxhimit është pamundësia për të marrë vendimet e duhura në kohën e duhur, ose për shkak të hezitimit të sektorit privat (jofitimprurës) për të marrë një rol drejtues të qartë dhe të mirëpërcaktuar. Ekzistenca e një sistemi ligjor dhe rregullash shumë të ndërlikuara, të centralizuara dhe burokratike, që reflektohet në nevojën e agjencive vendore për t'iu referuar qeverisë qendrore për miratimet për ndërhyrjet e nevojshme, çka çon në vonesatë panevojshme. Moskrijimi i Fondacionit të Ri për shkak të mungesës së dakordësisë me qeverinë.

<ul style="list-style-type: none"> • Nisma ekzistuese të OJF-ve të huaja dhe kombëtare të gatshme për të investuar në turizëm dhe në përmirësimin e përvojave turistike. • Statusi i vendit kandidat për anëtarësim në Bashkimin Evropian krijon mundësi për financime por, pa dyshim, të shoqëruara me kushte të BE-të. • Zbatimi i nismave në shkallë kombëtare për zhvillimin e zonave rurale dhe oferta e përgjithshme turistike. • Potenciali për nisma bashkëpunimi me Greqinë, duke përfshirë dhe aksesin e vizitorëve nëpërmjet aeroporteve ekzistuese greke. • Potenciali për bashkëpunim rajonal me vendet e tjera të Ballkanit dhe të Mesdheut, si Bosnja Hercegovina, Kroacia, Greqia, Italia, Mali i Zi, Serbia dhe Sllovenia. • Ndërhyrjet e reja të propozuara nga sektori privat (nëpërmjet Fondacionit të Ri) ofrojnë qëndrueshmëri financiare afatgjatë, krahas vendosjes së drejtimit të ri dhe strukturave të menaxhimit, duke e përfshirë qeverinë, së bashku me sektorin privat. • Aftësia për t'i përdorur karakteristikat e Parkut për përfitime tregtare, në mbështetje të operacioneve dhe zhvillimeve të ardhshme. • Mundësia për të krijuar një Komitet të ri të Parkut Kombëtar për të mbikëqyrur zbatimin e PMI në Parkun Kombëtar. • Krijimi dhe roli i Grupit Kërkimor të Butrintit për të ndihmuar Fondacionin e Ri për të gjitha çështjet në lidhje me të ardhmen e Parkut Kombëtar në të gjitha disiplinat akademike. 	<ul style="list-style-type: none"> • Mos rënia dakord për veprime të caktuarar ligjore dhe menaxheriale në marrëveshjen midis Fondacionit të Ri dhe Qeverisë. • Pamundësia për të zgjidhur mosmarrëveshjet aktuale për pronësinë e tokës brenda Parkut Kombëtar, sidomos për vendin e propozuar për qendrën e re të vizitorëve. • Mos ngritja e Komitetit të ri për mbikëqyrjen e menaxhimit të mbarë Parkut Kombëtar
---	--

8.5 Nevoja për ndryshim

Është e qartë se modeli aktual i menaxhimit të Butrintit nuk është më i efektshëm dhe i përshtatshëm për arritjen e qëllimit të tij.

Shkurtimisht, modeli aktual i menaxhimit ka këto dobësi:

- 1 Nuk ka arritur të vazhdojë politikën e ndjekur nga Fondacioni Butrinti për financim të qëndrueshëm nga donatorë të jashtëm. Sipas analizës është konstatuar se gjatë modelit aktual të menaxhimit, mbledhja e fondeve nga partnerë apo donatorë të tjerë vendas dhe të huaj ka qenë e vështirë. Të ardhurat e Butrintit gjenerohen kryesisht nga shitjet e biletave dhe marrja e qirave për përdorimin e hapësirave të vogla brenda sitit.
- 2 PK Butrint është menaxhuar sipas planit të menaxhimit miratuar me urdhër nr 404, datë 09.06.2011 të Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, "Për miratimin e Planit

të Menaxhimit PK Butrint”.

- 3 Aktet ligjore dhe nënligjore të miratuara nga qeveria janë fokusuar në kompetencat e strukturës së menaxhimit duke lënë Zonën A3 nën juridiksionin e Ministrisë së Kulturës, ndërsa Ministria e Turizmit dhe Mjedisit (AKZM) përgjegjëse për menaxhimin tërësor të Parkut Kombëtar. Kjo ka sjellë mbivendosjen të kompetencave që ka krijuar paqartësi lidhur me mënyrat e menaxhimit të Parkut ndërmjet AKZM-së (nën varësinë e Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit) dhe Zyrës së Administrimit dhe Koordinimit të Butrintit (në varësi të Ministrisë së Kulturës).
- 4 Burimet financiare të siguruara nga qeveria, në mbështetje të modelit aktual financiar kanë qenë të pamjaftueshme për të realizuar objektivat e një Plani Menaxhimi të integruar që ka për qëllim konservimin, mbrojtjen, zhvillimin dhe menaxhimin e Silit të Trashëgimisë Kombëtare.
- 5 Nuk është kryer studimi i tregut për të eksploruar potencialin e silit dhe për të vlerësuar pasuritë arkeologjike në mënyrë që sili të jetë më tërheqës për vizitorët vendas dhe të huaj.
- 6 Format aktuale të menaxhimit nuk mundësojnë marrjen e vendimeve të përshtatshme në kohën e duhur.

Si rrjedhojë: Zona A3 ka nevojë urgjente për ndërhyrje konservimi, si dhe trajtimin e ambienteve për stafin dhe vizitorët. Parku në tërësi nuk ka një plan zbatimi të publikuar, i mungon monitorimi dhe mbikëqyrja ditore dhe si rrjedhojë evidentohen zhvillime të paplanifikuara, dëmtime të habitatit dhe rrethime dhe mbjellje të jashtëligjshme, ku disa prej tyre ndodhin në zona me ndjeshmëri arkeologjike, në Fushën e Vrinës dhe gjetkë.

Kur Fondacioni Butrinti pushoi përfundimisht së funksionuari në terren në vitin 2012, nuk kishte një plan afatgjatë të dakordësuar me qeverinë për menaxhimin e ardhshëm të silit.

Nisur nga ky fakt, qeveria ndoqi të njëjtën mënyrë menaxhimi si të gjithë sektorët e tjerë të ekonomisë (përfshirë edhe ato që kishin të bënin drejtpërdrejtë me Butrintin), si bujqësia, konservimi dhe turizmi.

Në një sërë aktesh, ligjore dhe nënligjore pati mbivendosje kompetencash, e cila u reflektua ndërmjet Ministrisë së Kulturës dhe asaj të Turizmit dhe Mjedisit (AKZM), për sa i përket roleve dhe përgjegjësisë të tyre lidhur me kontrollin e menaxhimit të Parkut Kombëtar dhe nënzonës së tij, Zona A3.

Ministria e Kulturës ka në fokus të saj menaxhimin e burimeve arkeologjike të Zonës A3, dhe për këtë arsye nuk mund të bëjë propozime për nisma ligjore që të përfshijnë territorin e gjithë parkut dhe në veçanti në lidhje me angazhimin e komunitetit.

Nevojat për ndryshim, dhe rrjedhimisht nevojat për të sjellë burime të reja dhe pikëpamje të reja menaxhimi për parkun kombëtar, janë:

- 1 Mungesa e rregullave të qarta të menaxhimit në nivelin e qeverisë qendrore.
- 2 Mospërfshirja sa duhet e stafit të silit në proceset e ruajtjes dhe konservimit të silit.
- 3 Nevoja për të siguruar mbështetje financiare shtesë, të qëndrueshme dhe afatgjatë për të përkrahur strukturën e re të menaxhimit që është e aftë të zbatohet në kohën e duhur projektet të cilat janë shumë të nevojshme dhe me një fokus të qartë në Zonën A3 dhe Parkun Kombëtar
- 4 Ky financim shumë i nevojshëm është vështirë të sigurohet nga qeveria qendrore (e cila deri më tani nuk ka mundësi për burime të tilla financiare), ndaj konstatohet se e vetmja rrugë mund të

jetë përfshirja e një pale të tretë.

Në përmbledhje, modeli aktual i menaxhimit të Butrintit nuk ka një strukturë të pershtatshme që të funksionojë në sit. Ekspertiza është e pa mjaftueshme për të gjitha fushat e trashëgimisë kulturore, si: menaxhimi, konservimi, mbledhja e fondeve, marketing/marrëdhënie me publikun, kërkim dhe zhvillim, projekte multi disiplinore. Kjo për shkak të paqëndrueshmërisë së stafit në strukturat e menaxhimit dhe për shkak të mungesës së ndryshimit të organigramave tradicionale me pozicione dhe nevoja bashkëkohore.

8.6 Nevoja për fuqizimin e Komitetit të Menaxhimit të Parkut Kombëtar

Ndonëse tepër e qartë, gjithsesi, duhet theksuar se Plani i Menaxhimit të Integruar për Parkun Kombëtar mbulon të gjitha aspektet e Parkut, veprimtaritë, peizazhet dhe pasuritë e tij. Ky është i pari ndër planet e mëparshme të cilat janë përqendruar vetëm në Zonën A3 (si ai i përgatitur nga Fondacioni Butrinti në vitin 2005) ose në një element specifik të Parkut, si plani i vitit 2010 i cili mbuloi vetëm aspektet mjedisore dhe ekologjike.

Aktualisht, Ministria e Kulturës raporton pranë QTB/UNESCO-s për gjendjen e konservimit të Sitit të Trashëgimisë Botërore dhe Zonës Mbrojtëse të tij. Komiteti për Parkun Kombëtar të Butrintit, i ngritur me Urdhër nr. 19, datë 27.03.2019 të Prefektit të Qarkut Vlorë, bazuar në ligjin 81/2017 dhe VKM 593/2018 ka filluar të funksionojë, ndërkohë që, nga ana tjetër, Zona A3 drejtohet drejtpërdrejt nga Bordi i Butrintit, nën drejtimin e Ministrisë së Kulturës. Kjo ndarje mund të sjellë problematika për ruajtjen afatgjatë të mjedisit në tërësi, bashkëveprimin kritik ndërmjet aseteve të trashëgimisë ekologjike dhe kulturore të Parkut, dhe mënyrat se si ato do të mbikëqyren, menaxhohen dhe zhvillohen në të ardhmen.

Parku Kombëtar duhet të funksionojë si një njësi e vetme, edhe pse ai mund të jetë në pronësi/administrim të disa palëve, kjo në dobi të tij, si edhe të vizitorëve dhe, mbi të gjitha, të njerëzve që jetojnë dhe punojnë brenda Parkut.

Prandaj, synimi është fuqizimi i Komitetit të Parkut Kombëtar të Butrintit i ngritur në kuadër të legjislacionit për zonat e mbrojtura, i cili do të mbrojë dhe promovojë vlerat e tij kulturore dhe natyrore dhe do të zbatojë praktika të qëndrueshme, nëpërmjet regjimit të menaxhimit të integruar. Kjo bën të nevojshëm ndryshimin e mënyrës së drejtimit, duke fuqizuar dhe zgjeruar kompetencat e Komitetit që do të arrihet nëpërmjet një përfaqësimi ndërministror dhe jo në nivel prefekturë, siç funksionon aktualisht në kuadër të legjislacionit për zonat e mbrojtura.




Figura 18: Një strukturë koordinimi dhe monitorimi e unifikuar

Qasja e integruar është themelore në prezantimin dhe zbatimin e politikave në terren që janë në përputhje me parimet dhe standardet e sugjeruara nga UNESCO për menaxhimin e Siteve të Trashëgimisë Botërore dhe zonave të tyre mbrojtëse, një parim kyç ky për zhvillimin e Parkut në lidhje me propozimet e reja të menaxhimit për Zonën A3.

Në këtë kontekst, ligji i ri për trashëgiminë kulturore parashikon krijimin e një fondacioni të posaçëm të themeluar nga Ministria e Kulturës në bashkëpunim me një partner strategjik vetëm për menaxhimin e pasurive të trashëgimisë kulturore në pronësi të shtetit (pra, Zona A3). Kjo nënkupton se sipas rregullimeve aktuale, nuk mund të krijohet një fondacion i posaçëm për mbarë Parkun Kombëtar, edhe nëse kjo do të ishte e dëshirueshme.

Përsa i përket përfshirjes, çdo ministri: Ministria e Kulturës, Ministria e Mjedisit dhe Turizmit, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Ministria e Shëndetit, Punës dhe Çështjeve Sociale, Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës e deri te Ministria e Drejtësisë dhe Mbrojtjes, duhej ta kthente vëmendjen ndaj Butrintit. Përfshirja e shumë aktorëve shihet pothuajse në çdo park kombëtar në mbarë botën, duke qenë se të gjithë parqet zënë një sipërfaqe shumë të madhe toke ato zbatojnë rregullat kombëtare dhe normat operacionale.

Ajo që ka nevojë Butrinti është një strukturë mbikëqyrëse e integruar, e qartë, e mirëformuluar, e përkushtuar dhe e besueshme, ku të zhvillohen debate për territorin brenda Parkut dhe atë përreth tij, me fuqinë e nevojshme për të ndikuar në vendimmarrje dhe në mirëqenien e ardhshme të Parkut, duke e konsideruar atë si detyrën e tij parësore. Ky organizëm duhet të marrë parasysh edhe pikëpamjet e banorëve lokal, të shprehura nëpërmjet përfaqësuesve të bashkive të tyre dhe organeve të tjera vendore.

Në një skenar të tillë, rekomandohet ndryshimi i VKM Nr. 593 datë 09.10.2018 "Për përbërjen, funksionet, detyrat dhe përgjegjësitë e Komiteteve të Menaxhimit të zonave të mbrojtura mjedisore" për të propozuar fuqizimin e Komiteteve që kanë nën mbikëqyrje zona të mbrojtura me vlera të integruara natyrore dhe kulturore. Përbërja e një Komitetit të tillë propozohet të jetë ndërministror dhe me përfaqësues nga institucioni që do të ketë administrimin e pasurisë kulturore (Fondacioni i Ri), me sekretariat teknik nga institucionet e specializuara për burimin natyror dhe kulturor. Funksionimi i Komitetit të Parkut Kombëtar do të mbështetet financiarisht nga të gjitha institucionet pjesëmarrëse. Komiteti i propozuar i Menaxhimit të Parkut Kombëtar do të mbajë role koordinuese dhe mbikëqyrëse për të siguruar që Plani i Menaxhimit të Integruar po ndiqet dhe ekzekutohet nga subjektet përkatëse publike dhe private.

Komiteti i Menaxhimit të Parkut Kombëtar të Butrintit, i cili është ngritur me Urdhër të Prefektit të Qarkut Vlorë Nr. 19 datë 27.03.2019, e ka të përcaktuar antarësinë, por kjo antarësi do duhet të ndryshojë sipas ndryshimeve të VKM nr. 593, datë 09.10.2018, duke fuqizuar nivelin e përfaqësimit nga institucionet përgjegjëse për trashëgiminë kulturore.

Nevoja për fuqizimin e Komitetit të Menaxhimit të Parkut në tërësi theksohet dhe nga fakti se, përgjatë viteve, nuk ka qenë e mundur të rakordohet ndarja e territorit (pra, në zona si A2, A3, B, C etj) me mënyrën se si UNESCO klasifikon tokën në "zona bërthamë" dhe "zona mbrojtëse".

Për fuqizimin e Komitetit të Menaxhimit të Parkut Kombëtar të Butrintit do të jetë e nevojshme rishikimi i kuadrit ligjor për organizimin dhe funksionimin e komiteteve të menaxhimit. Rasti i Butrintit (si pasuri me vlera të integruara natyrore dhe kulturore, sit i trashëgimisë botërore dhe

zonë Ramsar) ofron mundësinë që shteti të rishqyrtojë të gjitha rregullimet ekzistuese legislative në këtë pikëpamje në zona të tjera me karakteristika të ngjashme.




Figura 19: Propozimet për Komitetin e ri të Menaxhimit të Parkut Kombëtar Butrintit

Natyra e saktë e marrëdhënieve të ardhshme midis institucioneve anëtare të propozuara dhe organeve të tjera që përbëjnë Komitetin do t'i nënshtrohet akteve legislative në Republikën e Shqipërisë.

Duhet të kihet parasysh se të gjitha rekomandimet e dhëna nga Komiteti i Menaxhimit të Parkut Kombëtar të Butrintit do të zbazohen nga të gjitha institucionet anëtare sipas fushës së tyre të kompetencës.

8.7 Komiteti i Menaxhimit të Parkut Kombëtar – Kompetencat e përgjithshme

Përmes fuqizimit, Komiteti i Menaxhimit të Parkut Kombëtar të Butrintit, do të jetë në gjendje (a) për të përcaktuar politika dhe standarde për të gjitha veprimtaritë në Parkun Kombëtar, dhe (b) për të vepruar si organi kompetent për të gjitha zhvillimet e ardhshme.

Në këtë kuptim, ai është ndryshe nga komiteti ekzistues i menaxhimit, që 'ka rol mbikëqyrës, me veprimtari jo menaxhuese ... i ngritur në nivelin rajonal'⁴⁰ vetëm për aspektet mjedisore të Parkut Kombëtar të Butrintit. Megjithatë, shumë nga kompetencat e Komitetit (parashikuar në vendimin Nr. 593) janë të vlefshme dhe të dobishme për Komitetin e propozuar.

Ajo që i mundon komitetit aktual sipas VKM Nr. 593 janë pikërisht kompetencat mbikëqyrëse të integruara për aspekte të natyrës dhe të trashëgimisë kulturore mbikëqyrëse natyrore si dhe niveli i

⁴⁰ Vendimi i Këshillit të Ministrave i Republikës së Shqipërisë Nr. 593 (9 tetor 2018) 'Për përbërjen, funksionet, detyrat dhe përgjegjësitë e komiteteve të menaxhimit të zonave të mbrojtura'.

përfaqësimit, i cili propozohet të jetë në nivel ndërministror dhe kjo është pikërisht çfarë i nevojitet Komitetit të ri.

Rolet dhe përgjegjësitë e Komitetit, të përcaktuara në VKM Nr. 593 janë të qarta, dhe mund të zbatohen edhe për komitetin e propozuar. Ato përfshijnë (*citim*):

- a. mbikëqyrjen e ecurisë së zbatimit të planit të menaxhimit të zonës dhe të programeve që hartohen në mënyrë të hollësishme, sipas kërkesave të tij,
- b. përfshirjen në procesin e hartimit të planit të menaxhimit të zonës dhe ndjekjen e zbatimit të elementeve të tij, për të siguruar përputhshmërinë e tij me strategjinë dhe planet vendore e sektoriale të zhvillimit, duke u kujdesur që këto të fundit të respektojnë kërkesat për mbrojtjen e zonës,
- c. nxitjen e zhvillimit ekologjik të mjediseve përreth zonës, si rrjedhojë e zbatimit të planit, me qëllim ruajtjen e cilësisë së saj,
- d. analizën e kryerjes së detyrave dhe funksioneve të administratës së zonave të mbrojtura, në funksion të zbatimit të planit të menaxhimit, si dhe të raporteve për të ardhurat dhe shpenzimet financiare që lidhen me zbatimin e planit,
- e. rekomandimin për përcaktimin e drejtimit të investimeve në zonë,
- f. miratimin e raportit vjetor të gjendjes së zonës së mbrojtur,
- g. propozimin të ministri përgjegjës për mjedisin dhe AKZM-ja për ndryshime në planin e menaxhimit të zonës, zgjerimin e kufijve, si dhe masa shtesë për përmirësimin e cilësive të saj, kur këto mbështeten në studime të kryera dhe argumente mbi nevojën e ndryshimit. Në rast se propozimi përfshin një zonë që ka dhe vlera të trashëgimisë dhe peizazhit kulturor, propozimi duhet të marrë edhe miratimin e organeve kolegjiale vendimmarrëse të ministrisë përgjegjëse për trashëgiminë kulturore,
- h. nxitjen e hartimit dhe të zbatimit të projekteve për përmirësimin e cilësive të zonës,
- i. ndjekjen e zbatimit të planit të menaxhimit të zonave të mbrojtura.

Ministri përgjegjës për mjedisin, prefekti i qarkut, bashkitë dhe Agjencia Kombëtare për Zonat e Mbrojtura ngarkohen me zbatimin e këtij vendimi” (fundi i citimit).

Pyetja kryesore që ngrihet këtu nuk është nëse ekzistojnë ligjet, strukturat dhe komitetet (pasi këto tashmë janë të parashikuara në legjislacionin shqiptar), por se si këto ligje, struktura dhe komitete funksionojnë të integruara realisht në praktikë, gjë që është e rëndësishme për të ardhmen e Parkut.

Integrimi në këtë nivel nënkupton:

- 1 Përfshirjen më të madhe të përfaqësuesve të ministrive përgjegjëse për vlerat natyrore dhe kulturore (Vlera e Jashtzakonshme Universale) në përbërjen e komitetit të menaxhimit të Parkut Kombëtar të Butrintit,
- 2 Zgjerimin e detyrave dhe përgjegjësisë të këtij Komiteti lidhur me ruajtjen dhe mbrojtjen e vlerave e kulturore që ndodhen në Parkun Kombëtar të Butrintit krahas mbrojtjes së vlerave natyrore,
- 3 Ndërhyrjen aktive, praktike dhe të orientuar drejt përmbushjes së qëllimit të PMI-së,
- 4 Dakordësinë e të gjitha palëve mbi strategjitë për zbatimin e politikave,
- 5 Heqjen e pengesave ndërmjet shtetit dhe aktorëve të tjerë,
- 6 Bashkëpunimin e plotë të të gjitha palëve: publike, private dhe të sektorit jo fitimprurës,

- 7 Politikat, qëllimet dhe objektivat e përbashkëta, të mbështetura nga vullneti politik,
- 8 Kapacitetin dhe vullnetin për t'u siguruar që qëllimet e përbashkëta përmbushen në përputhje me legjislacionin,
- 9 Prezantimin e unifikuar në UNESCO, dhe në agjenci të tjera,
- 10 Përdorimin e kapaciteteve të mundshëm për të siguruar rezultatet e dëshiruara të menaxhimit,
- 11 Përfshirjen e komuniteteve lokale në rezultatit e arritur, me idenë që të gjitha palët janë pjesë e zgjidhjes, dhe jo të problemit.

Si rrjedhojë, kjo mënyrë e re organizimi propozohet për tre qëllime kryesore:

- 1 Për të konservuar dhe përmirësuar bukurinë natyrore, botën e egër dhe trashëgiminë kulturore të Parkut,
- 2 Për të promovuar mundësitë për njohjen dhe gëzimin e cilësive të veçanta të Parkut Kombëtar nga ana e publikut,
- 3 Për të nxitur mirëqenien ekonomike dhe sociale të komuniteteve vendase, brenda dhe rreth Parkut Kombëtar.

Në këtë fazë fillestare, nuk do të ishte me vend që të diskutohej struktura e anëtarësisë së Komitetit të propozuar, por mund të nxirret në pah që duhet gjetur një ekuilibër ndërmjet Fondacionit të Ri, Ministrisë së Kulturës, Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit dhe agjencive të tjera qeveritare, të ngarkuara me përgjegjësinë për të punuar për të mirën afatgjatë të të gjithë Parkut Kombëtar.

Si rezultat i konstatimeve dhe shqetësimeve të ngritura në Seksionet 8.2 deri te 8.5, rekomandohet që të rishikohet VKM Nr.593 me rekomandimet e mësipërme sa më shpjet të jetë e mundur për ngritjen e Komitetit të fuqizuar të Menaxhimit të Parkut Kombëtar të Butrintit.

Duke u bazuar në praktikat e mëparshme, dhe duke pasur parasysh se sa kohë mund të marrë hartimi, dakordësimi dhe zbatimi i legjislacionit të nevojshëm përkatës, lidhur me atë që mund të gjykohej si një hap i rëndësishëm, sugjerohet që të nisim menjëherë veprimet për këtë rekomandim.

Në përmbledhje, Komiteti i Menaxhimit i Parkut Kombëtar me kompetencat e zgjeruara sipas rekomandimit më sipër, do të jetë mekanizmi shtetëror i cili do të mbikëqyrë dhe monitorojë zbatimin e standardeve, kritereve dhe rekomandimeve që vijnë nga PMI-ja për mbarë parkun, duke përfshirë edhe rekomandimet nga UNESCO.

Në përfundim, zbatimi i PMI-së do të monitorohet nga një komitet i vetëm si për Pasurinë e Trashëgimisë Botërore dhe zonën e saj mbrojtëse, si dhe Parkun Kombëtar.

Komiteti i ri i Menaxhimit do të sigurojë koordinimin e të gjitha palëve private dhe publike dhe përfaqësi të komunitetit lokal me qëllim zbatimin e rekomandimeve të PMI-së.

8.8 Menaxhimi i Zonës A3

Legjislacioni aktual i lejon Ministrisë së Kulturës që të krijojë një fondacion të posaçëm vetëm për Zonën A3; pra, për tokën dhe asetet që janë aktualisht nën administrimin e saj dhe janë në pronësi të shtetit.

Zona A3, pa dyshim është kompleksi arkeologjik më i rëndësishëm në mbarë Shqipërinë, si një pikë reference thelbësore për identitetin shqiptar prandaj nevojitet të bëhet shumë më tepër lidhur me ruajtjen dhe menaxhimin e tij.

Mungesa e vullnetit të unifikuar ka çuar në nevoja urgjente për burime që sigurojnë mbarëvajtjen e pasurive arkeologjike në terma afatgjatë, dhe që ndërmarrin një numër ndërhyrjesh të lehta dhe thelbësore për të mundësuar që siti të funksionojë më së miri si një atraksion për vizitorët, por pa e rrezikuar integritetin e tij.

Për këtë arsye propozohet një mënyrë e re menaxhimi, ku qeveria, mund të hyjë në bisedime me një palë të tretë, e cila do të vlerësohet si 'partneri strategjik' për të zhvilluar Zonën A3 në terma afatgjatë.

Partneri strategjik do të sigurojë fondet e nevojshme për të mbështetur punimet në Zonën A3, dhe së bashku me qeverinë, të menaxhojë Zonën A3 në të ardhmen nëpërmjet një subjekti të posaçëm menaxhues të njohur si Fondacioni i Ri.

Me konfirmimin e këtyre fondeve, planet për menaxhimin e Zonës A3 mund të fillojnë menjëherë pasi të hyjnë në fuqi të gjitha aktet e nevojshme ligjore.

Prandaj, bazuar në arsyet e shprehura në Seksionin 8.6, ka shumë mundësi që Fondacioni i Ri për Zonën A3 të ngrihet dhe të funksionojë përpara krijimit të Komitetit të Menaxhimit të Parkut Kombëtar i propozuar me kompetenca më të zgjeruara.

Një rregullim i tillë është tërësisht legjitim sipas legjislacionit shqiptar dhe ka ardhur si rezultat i diskutimeve lidhur me delegimin e mundshëm të menaxhimit për site të caktuara të trashëgimisë.

Për sa i përket financimit, sipas legjislacionit shqiptar është e përcaktuar se, funksionimi i modelit të menaxhimit parashikohet nga aktet e reja nënligjore për trashëgiminë të cilat nuk mund të jenë në interes të palëve të treta; pra, nevojat e menaxhimit të pasurisë do të mbizotërojnë gjithnjë mbi interesat private, siç garantohet nga:

- Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 625, datë 04.09.2019, i cili përcakton rregullat që zbatohen për administrimin indirekt të pasurisë kulturore nëpërmjet një fondacioni
- Marrëveshja e administrimit që do të lidhet ndërmjet Ministrisë së Kulturës dhe fondacionit të ri, që do të parashikojë detyrimet specifike të palëve, si dhe çdo penalitet të zbatueshëm
- Miratimi i marrëveshjes së administrimit nga Kuvendi i Shqipërisë, i cili është niveli shtetëror më i lartë që miraton dhe garanton kontrollin dhe transparencën
- Ministria e Kulturës do të garantojë mbrojtjen e nevojave për menaxhimin e pasurisë në dy nivele: si bashkëthemelues, nëpërmjet pjesëmarrjes në Bordin e Drejtorëve, organi më i lartë vendimmarrës i fondacionit të ri, dhe si pala shtetërore mbikëqyrëse që do të sigurojë përmbushjen e detyrimeve sipas marrëveshjes së administrimit.

8.9 Parimet e delegimit

Në mënyrë që Zona A3, mjediset e saj dhe komunitetet që jetojnë brenda dhe rreth saj, të kenë përfitime afatgjata, duhet vënë në funksion një strukturë e re drejtimi dhe menaxhimi.

Avantazhi kryesor i funksionimit të sitit bazuar në një lloj fondi vetëqeverisës ose një mjet të ngjashëm, qëndron te potenciali i tij për të siguruar menaxhim efikas dhe planifikim afatgjatë, i karakterizuar nga elementet e mëposhtme. Organet drejtuese të një siti të pavarur duhet të:

1. Kenë besim të plotë në potencialin e sitit dhe të përgatitet për të punuar për mbrojtjen e interesave të tij;

2. Jenë të pavarur nga politikat vendore dhe kombëtare, por të aftë për të ndikuar, nëse është e nevojshme;
3. Vlerësojnë rëndësinë themelore të cilësisë së lartë të stafit, të motivuar dhe të paguar në mënyrën e duhur;
4. Pranojnë se stafi ka nevojë për liri akademike dhe sipërmarrëse, për të punuar në mënyrë krijuese dhe të efektshme;
5. Jetë i gatshëm për përballimin e rrethanave të ndryshme, që bëjnë të mundur përshtatjen dhe zhvillimin e sitit;

Në këtë kontekst, përgjegjësitë e organit qeverisës janë:

1. Ofrimi i një kuadri planesh dhe politikash që përcaktojnë qëllimin e sitit, monitorojnë arritjen e këtyre objektivave dhe ua komunikojnë të gjithë palëve që punojnë në sit dhe palëve të jashtme të interesit, në rastin tonë në nivelin ndërkombëtar
2. Veprimi si mbrojtës i sitit në komunitetin lokal, si në nivelin kombëtar ashtu edhe në atë ndërkombëtar
3. Sigurimi i burimeve të mjaftueshme financiare dhe burime të tjera, për të bërë të mundur vijimin e punës në sit dhe garantimin që këto burime të menaxhohen në mënyrë të efektshme dhe efikase
4. Garantimin që siti t'i shërbejë publikut dhe të jetë i hapur gjatë gjithë vitit
5. Garantimin e qëndrueshmërisë financiare dhe sigurimin afatgjatë.

Në përmbushje të këtyre përgjegjësiave, organi qeverisës ka katër role kyçe:

1. Garantimin e ekuilibrit të përfitimeve ndërmjet brezave të tanishëm dhe të ardhshëm
2. Sigurimin e vijueshmërisë së qëllimeve me burimet financiare
3. Bashkërendimin e burimeve të fondeve me përdorimin e tyre
4. Sigurimin e zhvillimit të qëndrueshëm
5. Implementimin e sukseshëm dhe efektiv të planit të menaxhimit të integruar

Prandaj i jepet rëndësi:

1. Llogaridhënies - monitorimi i performancës dhe incentivave për performancë të mirë, nëpërmjet treguesve të performancës (TXP-të)
2. Ndarjes së strategjisë nga zbatimi, fokusi është te menaxhimi më shumë se te politikat; këto të fundit duhet të përcaktohen në Statutin e ri të fondacionit (ose në dokument të ngjashëm)
3. Paraqitjes të mekanizmave të tregut për ofrimin, duke përfshirë marrëveshjet kontraktore që janë konkurruese dhe transparente dhe duke i dhënë prioritet zhvillimit të ekonomisë lokale
4. Përgjegjshmërisë ndaj preferencave të konsumatorëve
5. Ndarjes së strukturave të mëdha, të cilat ndoshta janë joefikase dhe burokratike.

Pothuajse të gjitha rastet e sukseshme ndërkombëtare, ku qeveria qendrore ia ka deleguar menaxhimin e aseteve të saj të trashëgimisë një pale të tretë, ndajnë karakteristikat e mëposhtme:

1. Qeveria qendrore mban pronësinë e aseteve, në interes të popullit të saj;
2. Kjo organizatë zakonisht është një organizatë jofitimprurëse (me emrin 'Fond' ose 'Fondacion', në përputhje me parashikimet e legjislacionit vendas), e krijuar për ofrimin e shërbimeve të

përcaktuara për sitin, me qëllimin e mbajtjes së një marrëdhënieje afatgjatë me zotëruesin e asetit në emër të të cilit operon.

3. Të gjitha përgjegjësitë e qeverisë qendrore kundrejt sitit, duke përfshirë planifikimin strategjik, dhe jo thjesht përgjegjësitë e administrimit, i delegohen organizatës së re, duke përfshirë edhe stafin
4. Ka një periudhë që njihet si 'periudha e tranzicionit' dhe zakonisht lidhet me përfundimin e punimeve të mbartura të konservimit dhe punimet e mirëmbajtjes së sitit, siç është rasti i Butrintit.

Avantazhet e përgjithshme të fondeve dhe fondacioneve të deleguara të sitit përfshijnë:

1. Drejtim më efikas, i pandikuar nga çështjet e gjera politike të qeverisë qendrore, rajonale dhe vendore, dhe për rrjedhojë, me kapacitetin për t'u përqendruar në punën bazë
2. Fleksibilitet dhe liri për të hartuar plane dhe politika të përshtatshme sipas nevojës së audiencës aktuale dhe asaj të mundshme, po ashtu të palëve vendore, kombëtare dhe ndërkombëtare të interesit
3. Struktura menaxhimi që mundësojnë marrjen e vendimeve në kohë, në nivelin operacional më të përshtatshëm
4. Kuadër të qëndrueshëm, i bazuar në marrëveshje financiare të sigurta, që krijojnë një bazë të konsoliduar për planifikimin dhe zhvillimin afatgjatë të biznesit
5. Mundësi për ndryshime në organizimin e sitit gjatë praktikave të punës (dhe bashkërendimit të stafit)
6. Mundësi për të përfituar nga avantazhet financiare të statusit jofitimprurës, nëse është e mundur, (p.sh., çështje që lidhen me TVSH-në), dhe për rritjen e të ardhurave nëpërmjet aktivitetit tregtar, sponsorizimit, mbledhjes së fondeve dhe angazhimeve të tjera të palës së tretë
7. Mundësi për të krijuar lidhje të reja, brenda dhe jashtë vendit, dhe liri për të krijuar partneritete të reja, në sektorin e trashëgimisë dhe sektorë të tjerë, që janë të rëndësishëm për qëllimet dhe nevojat bazë të sitit
8. Interes më i madh nga donatorët financiarë të palëve të treta, si rrjedhojë pavarësisë politike të Fondacionit.

8.9.1 Llojet e delegimit

Sipas neneve 171-173 të Ligjit Nr. 27/2018 për trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë, lejohen tri forma të administrimit indirekt të pasurive kulturore në pronësi të shtetit:

- A. Nëpërmjet një fondacioni të posaçëm, të krijuar nga qeveria e përfaqësuar nga Ministria e Kulturës, në bashkëpunim me një partner strategjik;
- B. Nëpërmjet një fondacioni të krijuar nga një institucion qeveritar i specializuar për trashëgiminë;
- C. Nëpërmjet transferimit të administrimit një subjekti privat apo publik, të përzgjedhur me një procedurë konkurrimi. Ky model e përjashton qeverinë nga administrimi i pasurisë.

Në të tre rastet, pasuritë mbeten në pronësi të shtetit. Rrjedhimisht, administrimi indirekt përfshin vetëm në menaxhimin e sitit.

Për administrimin e pasurisë së trashëgimisë kulturore të Butrintit, modeli i parë konsiderohet më i përshtatshmi pasi ai përfshin pjesëmarrjen e shtetit dhe të partnerit privat strategjik në menaxhimin

e sitit. Duke pasur parasysh rëndësinë e Butrintit si një Sit i Trashëgimisë Botërore dhe faktin se administrimi indirekt i trashëgimisë kulturore është një risi në kontekstin shqiptar dhe do të realizohet për herë të parë, do të ishte e pamatur që të përjashtohet qeveria nga modeli i administrimit dhe të mos përfshihej një donator i besueshëm dhe i gatshëm.

Modeli i dytë i menaxhimit indirekt, ku një institucion i specializuar i trashëgimisë kulturore mund të krijojë një fondacion të tij, nuk konsiderohet i përshatshëm për Butrintin për këto arsye:

1. Mungesa e një financuesi të fuqishëm dhe të pavarur paraqet një risk të lartë për mbarëvajtjen dhe qëndrueshmërinë financiare të sitit në të ardhmen për shkak të mbështetjes jo të qëndrueshme.
2. Të ardhurat financiare që vijnë nga funksionimi i sitit mund të mos jenë të mjaftueshme për të ofruar ambiente bashkëkohore siç kërkohen nga një Sit i Trashëgimisë Botërore
3. Mbledhja e fondeve nga donatorë të jashtëm për të mbështetur një sit të menaxhuar nga dhe në pronësi të qeverisë, vetëm i lejon këta donatorë që të kontribuojnë në restaurimin e monumenteve dhe i përjashton ata nga përfshirja në mënyrë aktive lidhur me shpenzimin e parave të tyre.

Në nivel ndërkombëtar, delegimet nga qeveritë qendrore kanë qenë dy lloje:

1. I plotë – ku siti dhe të gjitha asetet e tij i transferohen organit pritës të sapokrijuar (zakonisht si fond ose fondacion) apo një fondi apo fondacioni ekzistues,
2. Hibrid - ku përgjegjësia e menaxhimit i delegohet fondacionit.

Në shumicën e rasteve, Modeli 2 ka qenë rregullimi ku shteti ruante pronësinë shtetërore të aseteve fizike dhe aseteve të tjera duke lidhur një marrëveshjeje administrimi (ose një lloj tjetër që lejohet nga legjislacioni kombëtar) me organin e sapokrijuar.

Ndaj, Modeli 2 (Hibridi) rekomandohet për Zonën A3 pasi është në përputhje me legjislacionin shqiptar.

Gjatë hartimit të ligjit të ri për trashëgiminë kulturore nga qeveria qendrore, u studiuan modele të ndryshme administrimi dhe iu referuan praktikave më të mira. Ligjit i ri për trashëgiminë kulturore, referuar udhëzuesit operacional është dërguar për konsultim në QTB/UNESCO-n, dhe ka marr komente pozitive nga kjo e fundit.

Modelet e administrimi të parashikuara në ligjin e ri për trashëgiminë kulturore në Shqipëri bazohen në modelin italian të krijimit të fondacioneve. Prandaj, çdo zgjidhje e propozuar administrimi duhet të zbatohet sipas legjislacionit shqiptar dhe rrjedhimisht duhet të kufizohet tek ato modele që në fakt mund të zbatohen. Për shembull, në vende të tjera, si Mbretëria e Bashkuar dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës, të cilat kanë një traditë më të hershme të angazhimit të palëve të treta (jo shtetërore) në çështjet kulturore, ku sipas rastit, palës së tretë që është gjithnjë një organizatë jofitimprurëse, i transferohen edhe asetet e sitit. I tillë ka qenë rasti i trustit Kombëtar të MB-së i cili në të kaluarën ka blerë toka, pasuri dhe pasuri të tjera kulturore dhe natyrore nga qeveria e MB-së përmes transferimit të këtyre pasurive kryesisht në vend të taksës së trashëgimisë. Por, kjo qasje aktualisht është e papajtueshme me legjislacionin shqiptar.

Rajoni nuk ofron zgjidhje të mundshme të një modeli administrimi indirekt që mund të zbatohen sipas legjislacionit aktual shqiptar⁴⁹. Modeli i administrimit indirekt i parashtruar më poshtë (në Seksionin 8.10) është në përputhje të plotë me legjislacionin aktual përkatës shqiptar, pasi i përgjigjet aftësisë së ligjit për të krijuar mekanizma të përshtatshëm për partneritetet publike private në sektorin e trashëgimisë në mënyrë që të tërheqë financime private pa dëmtuar pronësinë publike, aksesin dhe konservimin e pasurive të trashëgimisë kulturore.

Në vende të tjera, ka pasur raste që shteti paguan një shumë paraprake për t'i dhënë shtysë delegimit, jo vetëm në kuptimin e kostove ligjore dhe të planifikimit të biznesit, por edhe, për shembull, të parave shtesë për kompensimin e mirëmbajtjes së prapambetur të objektit ose për përfundimin e punimeve të mbartura të konservimit. Këto çështje duhet të diskutohen midis Partnerit Strategjik dhe ministrive përkatëse.

8.9.2 Përfitimet e përgjithshme nga delegimi

Shumica e përfitimeve të lidhura me delegimin shihen në spektrin afatgjatë dhe shprehen në kuadër të:

1. Zhvillimit të sitit dhe përmirësimit të vazhdueshëm të cilësisë së tij;
2. Aftësisë të stafit, për të përmbushur potencialin e tyre në periudhën afatgjatë;
3. Investimeve domethënëse në sit, nëpërmjet financimit të jashtëm, që zakonisht nuk është i disponueshëm nga shteti;
4. Promovimit të sitit në një treg më të gjerë, dhe reagimeve më të shpejta ndaj kërkesave të tregut;
5. Logaridhënies së drejtpërdrejtë ndaj komunitetit, veçanërisht komunitetit lokal, në emër të të cilit funksionon sit;
6. Sigurimit të së ardhmes së suksesshme ekonomike për sitin, e bazuar te planifikimi i duhur i biznesit dhe menaxhimi financiar;
7. Shtimit të mbështetjes financiare për sitin në komunitet, si brenda edhe jashtë vendit.

8.9.3 Risqet e delegimit

Në vende të tjera janë konstatuar rreziqet e mëposhtme në sitet e decentralizuara:

1. Zhvillimi me ritëm të shpejtë që e çon sitin në atë nivel ku modeli i tij i biznesit nuk mund ta mbështesë më.
2. Ngadalësim i financimit bazë, duke i çuar të ardhurat që kërkohen nga burime të tjera në nivele realisht jo të arritshme.
3. Mbështetja e madhe tek financimet e jashtme të projektit, që në rast se financimi mbaron, i vë veprimtarinë në rrezik.
4. Ndryshimet e qëndrimit politik brenda shtetit, që kërkon dhënie fund të marrëveshjeve për decentralizimin dhe delegimin dhe kthimin e shërbimeve nën kujdes të shtetit.
5. Ndryshimet në tatimet (veçanërisht në TVSH dhe taksa të tjera vendore), që në mënyrë të paqëllimshme ushtrojnë tryzni mbi modelin e biznesit
6. Mos rekrutimi i personave të aftë për të zëvendësuar bordin themelues.

⁴⁹ Për shembull, në Greqi, Bullgari, Serbi, Mal i Zi dhe Maqedoni e Veriut, të cilat nuk konsiderohen si shembuj të praktikave më të mira në botë.

Shumica e këtyre risqeve, financiare ose jo, mund të zvogëlohen, madje edhe të shmangen, me anë të zbatimit të një strukture menaxhimi të përshtatshme dhe produktive, dhe falë cilësive të individëve të emëruar në bordet e themelimit dhe në borde të tjera që mund të krijohen. Analiza e mëposhtme përmbledh mendimet kryesore:




Figura 20: Analiza kryesore krahasuese e strukturave të menaxhimit

Rrjedhimisht, Fondacioni i Ri paraqet perspektivën e një risku të ulët, kostoje të ulët oportune, organizate me vlerë të lartë të parasë, i aftë për të ofruar shërbime cilësore me përfitime të drejtpërdrejta dhe të dukshme për komunitetin vendas.

Modelet e tjera të menaxhimit paraqesin një risk më të lartë apo të vazhdueshëm, sepse ato ose mbështeten te shteti për të gjitha fondet e nevojshme kapitale dhe të të ardhurave (të cilat nuk kanë qenë të njëtrajtshme në të kaluarën) ose rezultojnë në ndërthurjen e objektivave të menaxhimit ndërmjet ministrive të ndryshme dhe agjencive të tjera të përfshira, gjë që çon për inerci, zbatim të dobët, mungesë të një plani afatgjatë dhe (ndoshta) degradim.

8.10 Fondacioni i Ri

Duke marrë në konsideratë të gjithë këta faktorë, rekomandohet krijimi i një organizate të re, për të menaxhuar Zonën A3. Kjo organizatë e re duhet të krijohet me një synim të ri afatgjatë dhe mund të njihet si 'Fondacion', me statusin "jofitimprurës", sipas Ligjit Shqiptar. Ligji i ri për trashëgiminë kulturore dhe muzetë parashikon krijimin e kësaj organizate⁵⁰.

Rekomandohet që Fondacioni i Ri të krijohet në vijim të diskutimeve midis Partnerit Strategjik dhe Qeverisë Shqiptare, në përputhje me Ligjin për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë (Nenet 171-172), si një 'Fondacion Jofitimprurës', me qëllim ruajtjen, interpretimin, menaxhimin dhe zhvillimin e Butrintit, në të mirë të popullit shqiptar dhe komunitetit ndërkombëtar⁵¹.

⁵⁰ Ligji Nr. 27/2018: Trashëgimia Kulturore dhe Muzetë

⁵¹ Jemi të ndërgjegjshëm që termi "Fondacion jofitimprurës" nuk ekziston në ligjin e Republikës së Shqipërisë nr.8788 (7 maj 2001), ku organizatat jofitimprurëse njihen si Shoqata, Qendra ose Fondacione.




Figura 21: Fondacioni i Ri, propozimet për anëtarët themelues

Sipas parashikimeve, ky Fondacion do të funksionojë nëpërmjet Bordit të tij të Drejtorëve (të referuar si anëtarët e Bordit), me qëllim ofrimin e një përvoje të qëndrueshme, edukuese dhe të kënaqshme për vizitorët e Butrintit, duke garantuar që sipërmarrjet dhe komunitetet lokale të bashkëjetojnë, duke pasur përfitim reciprok. Në këtë përpjekje, Fondacioni i Ri, në fillim do të mbështetet nga Ministrinë që ushtrojnë kompetencat e tyre në menaxhimin e Parkut dhe nga Grupi Kërkimor i Butrintit, i propozuar rishtas (për të cilin do të gjeni më tepër informacion në vijim).

Fondacioni i Ri mund të pranojë mbështetje dhe financime nga truste, fondacione, individë, shoqëri të tjera private, etj., për llogari të tij dhe pa mbështetjen e organeve të tjera, atje ku gjykohej më e arsyeshme dhe e përshtatshme, sigurisht në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe parimet etike, sipas të cilave do të funksionojë fondacioni, si një organ i pavarur, me qëllimin e sigurimit të mirëqenies afatgjatë të sitit.




Figura 22: Fondacioni i Ri - përshtatjet kryesore

Ekipi i menaxhimit bën parashikime funksionale, me miratim të Drejtuesit të tij (për të cilin do të gjeni më tepër informacion në vijim), për një plan biznesi shtatëvjeçar, të përditësuar çdo vit. Si rrjedhojë, organizimi financiar në aspektin e fluksit të fondeve kapitale dhe të të ardhurave mund të përmbledhet si vijon:




Figura 23: Fluksi kryesor i fondeve kapitale dhe të ardhurave

8.10.1 Fluksi i fondeve dhe përgjegjësia për sitin

Sipas propozimit tonë, Fondacioni i Ri, nëpërmjet Bordit të tij, do të ngrihet me fonde nga Partneri Strategjik dhe Ministria e Kulturës, dhe do të veprojë në emër të qeverisë shqiptare.

Fondacioni i Ri mund të pranojë fonde nga palë të treta për punimet kapitale dhe operacionale, si: truste, fonde universitare, fonde private e të tjera si këto. Fondacioni do të mbështesë Grupin e ardhshëm Kërkimor të Butrintit dhe do të caktojë fonde për funksionimin e Ekipit të Menaxhimit të Sitit, duke e pasur si qëllimin e tij parësor.

Si rrjedhojë, një nga detyrat kryesore të Bordit të Fondacionit të Ri është sigurimi i financimeve nga burime të ndryshme (si për projektet kapitale, ashtu edhe mbështetjes së të ardhurave), në mënyrë që të zbutet rreziku nga investimi afatgjatë.

Kjo është praktikë e zakonshme e Fondacioneve të tjera kudo në botë, veçanërisht në ato që kanë nevojë për financime dhe mbështetje të jashtme për projektet e konservimit, siç është rasti i Butrintit.

Kështu, Fondacioni do të ofrojë kapitalin për funksionimin e Zonës A3 dhe për veprimtaritë në Zonën mbrojtëse të STB-së, në përputhje me nënzonat dhe veprimtaritë menaxhuese të përcaktuara në këtë plan.

Siti, nga ana tjetër, i kthen Fondacionit tepricën nga veprimtaritë e tij, dhe ky i fundit duhet t'i investojë përsëri për mirëmbajtjen dhe funksionimin e sitit, si edhe për punimet e parashikuara në pjesë tjetër të parkut sipas nje marrëveshje të vençantë me AKZM.

Sipas këtij propozimi, asetet, menaxhimi dhe përgjegjësia funksionale e sitit janë ndarë ndërmjet organizatave të duhura përgjegjëse.

Aspektet kyçe të këtij rregullimi, janë si vijon:

1. Qeveria Shqiptare gëzon pronësinë e të gjitha aseteve të sitit për përfitime publike;
2. Fondacioni i Ri investon për kërkesat funksionale dhe kapitale të sitit, ndoshta në partneritet me palë të treta të jashtme, siç gjykohet e arsyeshme;

3. Siti, nga ana tjetër, i kthen Fondacionit tepicën nga veprimtaritë e tij, dhe ky i fundit duhet t'i investojë përsëri për mirëmbajtjen dhe funksionimin e sitit, si edhe për punimet e parashikuara sipas nje marrëveshje të veçantë me AKZM;
4. Duke qenë fondacion jofitimprurës me synim të vetëm menaxhimin e Zonës A3, Fondacioni i Ri nuk do të bëjë shpërndarjen e dividendit dhe as nuk do t'i paguajë paga anëtarëve të bordit;
5. Bordi i Fondacionit të Ri do të punësojë një Drejtor për Sitin, i cili do të ngarkohet me detyrën për të zhvilluar të gjitha funksionet e sitit, me anë të një plani menaxhimi dhe investimi shtatëvjeçar, të përditësuar çdo vit, me miratim të Bordit dhe financim të Fondacionit.




Figura 24: Përgjegjësia e përgjithshme dhe lëvrimi

Pra, Fondacioni i Ri duhet, dhe do të jetë, i aftë të shfaqë zotësi në të gjitha fushat e aktivitetit që prekin si Zonën A3 dhe mbarë Parkun Kombëtar, duke përfshirë dhe fushat e konservimit dhe mbrojtjes, menaxhimin e vizitorëve, projektim dhe lëvrim të kënaqshëm, kujdesin ndaj stafit, aftësinë për t'u angazhuar me komunitetet lokale dhe ngritjen e kapaciteteve dhe aftësive lokale.

8.11 Menaxhimi i riskut

Faktorët e riskut ndaj zhvillimit të suksesshëm dhe të qëndrueshëm të Butrintit ndahen në tri kategori: globale, kombëtare dhe vendore.

Risqet globale përfshijnë ato risqe të cilat siti ka shumë pak gjasa që t'i zbusë. Për shembull, lëkundjet e forta sizmike, të cilat kanë ndodhur edhe më parë, duke lënë gjurmët e tyre në Zonën A3, mund ta ndryshojnë rrënjësisht strukturën e tij. Sipas parashikimeve, ka shumë gjasa që të rritet niveli i Detit Jon, për shkak të ngrohjes globale, dhe nëse kjo ndodh, do të përmbysë sipërfaqe të mëdha të Zonës A3, duke përfshirë rrënojat Romake në periferi, siç konstatohet edhe në një raport të fundit në revistën *Nature*⁵².

⁵² Reimann, L, Athanasios, T V, Brown S, Hinkel J, Tol R S J (2018) Mediterranean UNESCO World Heritage at risk from coastal flooding and erosion due to sea-level rise. *Nature* 16 tetor 2018

Risqet kombëtare janë ato risqe, mbi të cilat siti ka shumë pak gjasa të ndikojë, duke qenë se ato përfshijnë politikën e vendit, ndryshimet në leadershipin, filozofinë, vullnetin politik, që mund të kenë pasojat e tyre në Parkun Kombëtar.

Destabilizimi politik në rajon, një shembull i të cilit u vu re shumë vite më parë, si edhe ndonjë kërcënim terrorist, mund të rezultojë në rënie të shpejtë dhe të vijueshme të numrit të vizitorëve të hua, siç ka ndodhur edhe në vende të tjera të Mesdheut, veçanërisht në Egjipt, gjatë viteve të fundit.

Risqet vendore kanë të bëjnë me risqet e lidhura drejtpërdrejt me sitin, funksionimin e tij dhe atë të zonave të tjera pranë dhe rreth Butrintit.

Në këtë aspekt, risqet lidhen me mospranimin e rekomandimeve dhe propozimeve për zhvillimin, që parashtrihen në këtë Plan të Menaxhimit të Integruar. Këtu përfshihet:

1. Pamundësia për të zgjeruar sitin përmes qendrës së re të vizitorëve, për shkak të pretendimeve mbi pronësinë e tokës, po ashtu dhe të zonave të tjera brenda Zonës A3.
2. Mos miratimi i planeve të zhvillimit, veçanërisht për qendrën e re të vizitorëve, sepse shihen si plane me ndikim negativ të mënyra se si funksionon aktualisht ekonomia lokale, ku përfshihet: blegtoaria, akuakultura, linja e tragetit, etj.
3. Institucionet qendrore (ose vendore) i refuzojnë planet, ose nuk arrijnë një marrëveshje për to.
4. Kundërshtimi vjen nga një sërë organesh dhe institucioneve akademike ndërkombëtare.

Këto risqe vendore, nëse nuk mund të trajtohen, të paktën mund të zbuten nga drejtuesit, duke përcaktuar qartësisht se çfarë po përpiqen të arrijnë me ndërhyrjet e propozuara dhe arsyen përkatëse.

Prandaj, përpjekjet e Marrëdhënive me Publikun duhet të jenë shumë cilësore dhe afatgjata. Kjo përpjekje duhet të bashkërendohet me Planin e Menaxhimit të Integruar dhe zhvillimin e "markës" së Butrintit, të cilat kanë potencialin të ofrojnë përfitime domethënëse për komunitetin lokal.

Forca madhore

Çështja e forcës madhore përgjithësisht përjashtohet nga planifikimi i menaxhimit të riskut, pasi trajtohet si risk që mund të sigurohet, nga pronari i tokës, menaxheri, ose të dyve së bashku. Kjo vlen edhe për Butrintin.

Pronësia e pasurive kulturore dhe natyrore të sitit do të mbetet e Qeverisë së Shqipërisë dhe sigurimi nga rreziqet e forcës madhore dhe ndaj shkatërrimit të pasurive kulturore dhe natyrore të një vendi do të arrijnë një shifër astronomike. Madje dyshohet nëse një kompani sigurimi do ta ndërmerte një rrezik të tillë apo do të kishte kapacitete për ta mbuluar financiarisht. Në vendet perëndimore, si p.sh Britania e Bashkuar, kjo qasje është quajtur "Sigurimi i dëmshpërblimit të qeverisë"⁵³ nën të cilin qeveria pranon se është burimi i fundit i fondeve kundër të gjitha rreziqeve të tilla.

⁵³ "Government Indemnity Insurance"

8.11.1 Plani i Menaxhimit të Riskut

Parku Kombëtar i Butrintit duhet të ketë një strategji të posaçme për Menaxhimin e Riskut, që të ofrojë kuadrin e një regjimi menaxhimi me plane të detajuara, duke mbuluar Gatishmërinë, Zbutjen, Reagimin dhe Rimëkëmbjen, kundrejt faktorëve natyrorë dhe artificialë të riskut, brenda dhe jashtë kufijve të tij.

Faktorët e brendshëm dhe të jashtëm natyrorë të riskut përfshijnë:

- Bimësia natyrore
- Variacioni i prurjeve të ujit të ëmbël
- Era, stuhitë dhe zjarri
- Sedimentet
- Erozioni
- Ndryshimi klimatik

Faktorët e brendshëm dhe të jashtëm artificialë të riskut përfshijnë:

- Ardhja e specieve pushtuese të huaja
- Ndotja
- Erozioni i zonës nga aktiviteti i njeriut
- Ndotja e shkaktuar nga njeriu
- Devijimi i lumenjve
- Zhvillimi i infrastrukturës

Në vija të përgjithshme, termat e referencës për Planin e Menaxhimit të Riskut duhet të përfshijnë:

- njohjen e risqeve nga fatkeqësitë e mundshme natyrore
- identifikimin e të gjitha palëve të interesit dhe reaguesve, dhe vlerësimin e gatishmërisë, përgatitjes dhe bashkërendimit të tyre
- ngritjen e mekanizmave të reagimit
- krijimin e mekanizmave për rimëkëmbjen, pas goditjes nga fatkeqësitë natyrore (duke përfshirë Ndihmën e Parë dhe rimëkëmbjen afatgjatë).

Hartimi i një strategjie të integruar për menaxhimin e riskut për Parkun Kombëtar duhet të nisë menjëherë për të mbrojtur asetet kulturore dhe natyrore të vendit, turistët, stafin e sitit dhe komunitetet lokale, deri sa të hartohet Plani gjithëpërfshirës për Menaxhimin e Riskut. Për këtë çështje, do të gjeni më tepër informacion në Seksionin 11 - Zbatimi dhe Monitorimi. Kjo strategji do të hartohet duke marrë në konsideratë kërkesat e Ligjit 45/2019 "Për mbrojtjen civile".

Plani i ardhshëm për zbutjen e risqeve nga fatkeqësitë natyrore duhet të parashikojë veprimet e mëposhtme:

- Krijimin e një baze të dhënash të përkushtuar për risqet, dhe të hartave përkatëse
- Vlerësimet dhe planifikimin e menaxhimit të riskut
- Planifikimin e kontrollit të dëmeve (duke përfshirë programet për mirëmbajtjen)
- Planifikimin e vazhdueshëm të aktiviteteve
- Bashkërendimin me forcat zjarrfikëse dhe autoritetet e tjera (duke përfshirë veprimtaritë e komunikimit me autoritetet)
- Trajnimin dhe menaxhimin e personelit.

8.0 Drejtimi dhe Menaxhimi– Pikat Kyçe

- Modeli aktual i menaxhimit të Butrintit nuk është më i efektshëm dhe i përshtatshëm për qëllimin e tij.
- Ligji i ri Nr. 27/2018 për Trashëgiminë Kulturore dhe muzetë parashikon forma të reja menaxhimi për sitet kulturore.
- Për Zonën A3 parashikohet një model i ri menaxhimi, një partneritet midis qeverisë dhe partnerit strategjik.
- Fondacioni i Ri do të përmirësojë në mënyrë të ndjeshme mbrojtjen dhe promovimin e Zonës A3 dhe të mbarë Parkut Kombëtar.
- Me strukturën e re të menaxhimit, do të kemi një rritje të trefishtë të stafit teknik dhe administrativ.
- Në terma afatgjatë, propozohet krijimi i një Komiteti Menaxhimi të ri të Parkut Kombëtar me përfaqësim nga Fondacioni i ri, qeveria qendrore dhe vendore dhe komunitetet lokale.

9.0 VISION



9.0 VIZIONI

Parku Kombëtar i Butrintit do të njihet si model në menaxhimin e qëndrueshëm të siteve me elemente kulturore dhe natyrore, duke u bërë qendra e ofertës turistike rajonale, duke i ofruar vizitorëve një përvojë unike, nëpërmjet angazhimit të komuniteteve vendase dhe institucioneve kombëtare për të vepruar si model për parqe të tjera në Shqipëri.

Ky vizion për Butrintin tregon në thelb qëllimin e Planit të Menaxhimit të Integruar dhe është në linjë me Axtendën për Zhvillimin e Qëndrueshëm 2030 të UNESCO-s.

9.1 Qëllimet dhe Objektivat

Nëse synohet realizimi i vizionit të deklaruar për Butrintin, pjesë të menaxhimit duhet të jenë edhe qëllimet dhe objektivat e mëposhtme. Ato do të përmbushen me anë të zbatimit të suksesshëm të një sërë veprimesh menaxhuese dhe do të përfshihen në Planin e Veprimt. Si rrjedhojë, ekziston një lidhje e dukshme midis veprimeve të menaxhimit dhe vizionit.

9.1.1 Burimi Kulturor

Qëllimi: Mbrojtja dhe ruajtja e Vlerës së Jashtëzakonshme Universale të Sitit të Trashëgimisë Botërore dhe strukturës së saj, për brezat e sotëm dhe atyre të ardhshëm

- Mbrojtja dhe ruajtja e vlerave kulturore dhe natyrore të sitit, për të mirëmbajtur mjedisin dhe identitetin e sitit.
- Zgjerimi i potencialit turistik dhe edukativ të Parkut Kombëtar, nëpërmjet një programi të vazhdueshëm për kërkimin, gërmimin, konservimin dhe monitorimin e Parkut.

9.1.2 Burimi Natyror

Qëllimi: Mbrojtja dhe ruajtja e vlerave natyrore të Parkut Kombëtar për brezat e sotëm dhe atyre të ardhshëm

- Zhvillimi dhe zbatimi i një programi të vazhdueshëm për monitorimin ekologjik dhe restaurimin, atje ku vlerësohet e realizueshme dhe e përshtatshme, për të siguruar të dhëna të nevojshme për të informuar vendimmarrjen e ardhshme.
- Vendosja e praktikave të qëndrueshme bujqësore dhe akuakulturore brenda dhe përgjatë kufijve të Parkut Kombëtar. Për të siguruar pajtueshmërinë, nevojitet një ndërthurje shtysash, rregulloresh dhe monitorimi.

9.1.3 Drejtimi

Qëllimi: Mbështetja dhe pasqyrimi i menaxhimit të mirë të STB-së

- Ndërmarrja dhe mirëmbajtja e një strukture të konsoliduar menaxhimi, për koordinimin e efektshëm të të gjitha veprimtarive që ndikojnë në VJU-ja e Sitit.
- Garantimi i disponimit të burimeve të mjaftueshme që lejojnë zbatimin efikas të Planit STB.

9.1.4 Turizmi dhe Infrastruktura

Qëllimi: Ofrimi i një përvoje të sigurt dhe të kënaqshme për vizitorët, e cila nuk e rrezikon Vlerën e Jashtëzakonshme Universale të Sitit

- Mundësimi i aksesit të përshtatshëm për vizitorët brenda Sitit dhe rreth tij, në mënyrë të sigurt dhe të qëndrueshme.
- Promovimi i turizmit miqësor me mjedisin, nëpërmjet zhvillimit të infrastrukturës me impakt minimal dhe materiale ekologjike, për të nxitur kontaktin me asetet dhe angazhimin në aktivitete natyrore brenda Parkut Kombëtar.
- Përmirësimi i interpretimit dhe paraqitjes së aseteve natyrore dhe kulturore të Parkut, për edukimin dhe çlodhjen e vizitorëve.

Qëllimi: Ndërgjegjësimi i publikut për Parkun Kombëtar të Butrintit dhe statusin e tij si STB

- Rritja e të kuptuarit dhe vlerësimit nga ana e publikut të Vlerës së Jashtëzakonshme Universale të pronës pasuri botërore dhe Parkut Kombëtar
- Përmirësimi i materialeve interpretuese dhe ofrimit të informacionit, brenda STB-së dhe Parkut Kombëtar.

9.1.5 Zhvillimi i komunitetit

Qëllimi: Angazhimi i komuniteteve lokale për t'iu mundësuar gëzimin e përfitimeve më të mëdha nga STB-ja dhe Parku Kombëtar

- Përfshirja e komuniteteve lokale në menaxhimin e STB-së,
- Mbështetja e komuniteteve lokale në përdorimin e STB-së, si motor zhvillimi ekonomik,
- Forcimi i përfaqësimit dhe përfshirjes efikase të bashkive dhe komunavenë proceset e menaxhimit dhe vendimmarrjes,
- Përmirësimi i efektshmërisë së koordinimit të palëve të interesit dhe forcimi i komunikimit me komunitetet rreth qëllimeve, strategjive, dhe pritshmërive reale, që lidhen me planet dhe projektet e zhvillimit.

Qëllimi: Shndërrimi i Parkut Kombëtar në një mjedis edukues që mundëson mësimdhënien dhe të nxënëit për të gjitha moshat, që ofron përvoja thellësisht të bazuar në realitet.

- Zhvillimi dhe përmirësimi i programeve edukuese dhe mjediseve në STB dhe në Parkun Kombëtar,
- Nxitja dhe njohja nga ana e komuniteteve lokale kundrejt burimeve të Parkut, si dhe vlerësimi dhe kujdesi i tyre ndaj këtyre burimeve,
- Integrimi i komuniteteve lokale dhe grupeve të interesit të Parkut në një strategji të unifikuar zhvillimi për komunitetet dhe të vënë në zbatim në një plan veprimi.

Qëllimi përfundimtar i këtyre objektivave është qëndrueshmëria mjedisore, ekonomike dhe shoqërore, në përputhje me vizionin e sipërpërmendur.

Komponentët e qëndrueshmërisë së Butrintit trajtohen në Planin e Veprimat dhe ndërvarësia e tyre pasqyrohet në diagramën e mëposhtme:

10.0 PLANI I VEPRIMIT



Plani i Veprimit Afatshkurtër 2020-2023

Veprimi	Agjencia përgjegjëse për zbatimin	Autoriteti miratues / mbikëqyrës	Periudha	Kohëzgjatja / frekuenca	Buxheti (USD)
1.0 BËRIMI KULTUROR - Mbrojtja dhe konservimi i VJU-së së SHIT të Trashëgimisë Botërore dhe mjedisit të tij për brezat e sotëm dhe të ardhshëm.					
1.1 Mbrojtja dhe konservimi i attributeve kulturore dhe ruajtja e një mjedisi të përshtatshëm dhe me identitet					
KONSERVIMI					
1.1.1 Kryerja e vlerësimeve për gjendjen e të gjithë monumenteve brenda Zonës A3.	Fondacioni i Ri me konsulentët e jashtëm Konsultim me IKTK-në gjatë procesit të vlerësimit dhe me AKZM-në për largimin dhe trajtimin e specieve të mbrojtura dhe ndëkëmbimin e mjedisit.	MK IKTK IA AKZM	2020	3 muaj Rishikim vjetor	30 mijë
1.1.2 Paraqitja e propozimeve/përmbledhjeve teknike për konservimin, përzgjedhja e konsulentëve, menaxhimi dhe fillimi i dorëzimit të 'Punimeve Urgjente' të renditura në Planin e Konservimit për Zonën A3 (Shtojca C). Do të përfshihen monumentet si vijon: Porta e Ligenit, Colunbarium, Porta Veriore, Forumi Romak, Porta Perëndimore, Struktura e Gymnasium, Muret rrethuese të Akropolisit, Muri rrethues nga Porta e Ligenit për në Akropolin, Mozaiku i Pagëzimores.	Fondacioni i Ri me konsulentët e jashtëm Konsultim me IKTK-në gjatë hartimit të propozimeve dhe me AKZM-në për largimin dhe trajtimin e specieve të mbrojtura dhe ndëkëmbimin e mjedisit.	MK IKTK KXTRM IA AKZM	2020	6 muaj	90 mijë
1.1.3 Ngritja e mekanizmave të monitorimit; sigurimi dhe vendosja e pajisjeve të monitorimit në Zonën A3.	Fondacioni i Ri me konsulentët e jashtëm	MK IKTK AKZM	2020	1 muaj Rishikim dy herë në vit	6.6 mijë
1.1.4 Nxitja e zhvillimit të një programi mirëmbajtjeje sezonale për të gjitha shtat arkeologjike, të cilat do qeverisen nëpërmjet një plani vjetor konservimi dhe mirëmbajtjeje.	Fondacioni i Ri me konsulentët e jashtëm	IKTK AKZM	2020-2023	4 muaj Zbatuar gjatë gjithë vitit	260 mijë Buxhet 4 vjeçar
1.1.5 Prokurimi dhe zbatimi i 'Punimeve Urgjente' për Zonën A3.	Fondacioni i Ri	MK IKTK IA	2020-2023	26 muaj	698 mijë Operacional (Fondacioni)

Veptrimi	Agjencia përgjegjëse për shkrimin	Autoriteti miratues / mbikëqyrës	Periodha	Kohëzgjatja / frekuenca	Buxheti (USD)
1.1.6 Hartimi i propozimit dhe sigurimi i ndriçimit për monumentet.	Fondacioni i Ri me shoqëri të jashtme	MK IKTK KXTKM IA AKZM	2020-2021	24 muaj	132 mijë Operacional (Fondacioni)
1.1.7 Shqyrtimi i mundësisë së ekspozimit të mozaikëve në fushën e Vrinës dhe në Diaporit. Vrojtimet e gjendjes do të duhet të përgatiten nga specialistë të kësaj fushe	Fondacioni i Ri me konsulentët e jashtëm	MK IKTK IA	2021	1 muaj	Operacional (Fondacioni)
1.1.8 Propozimi për konservim të Mozaikëve në fushën e Vrinës dhe në Diaporit, sipas një kalendarit dhe propozimi për ekspozimin e tyre për vizitorët.	Fondacioni i Ri me konsulentët e jashtëm	MK IKTK KXTKM IA	2021	4 muaj	30 mijë
1.1.9 Prokurimi i punimeve konservuese të mozaikëve.	Fondacioni i Ri	MK IKTK IA	2021	2 muaj	Operacional (Fondacioni)
1.1.10 Konservimi i mozaikëve dhe hartimi i kalendarëve për ekspozimin e tyre për vizitorët, nëse gjykohet e nevojshme	Fondacioni i Ri me shoqëri të jashtme	MK IKTK IA	2021-2022	12 muaj	181 mijë
1.1.11 Paraqitja e propozimeve/përmbledhjeve teknike për konservimin, përzgjedhja e konsulentëve, menaxhimi dhe fillimi i dorëzimit të 'Punimeve Urgjente' të listuara në Planin e Konservimit për Zonën A3 (Shtojca C). Do të përfshihen monumentet si vijon: Struktura Romake me dy dhoma, Prytaneum, Afresku i shëtitores së kishës, Pagëzimetorja, Pallati i Trikonkës, Banjo publike (Termae) në Bazilikën e Kalivos	Fondacioni i Ri me konsulentët e jashtëm Konsultim me IKTK – në gjatë procesit të hartimit të propozimeve dhe me AKZM-në për largimin dhe trajtimin e specieve të mbrojtura dhe ndëtimin e mjedisit.	MK IKTK KXTKM IA AKZM	2022	6 muaj	70 mijë
1.1.12 Grupi Kërkimor i Butrintit (GKB) të krijojë Platformën Arkeologjike të Kërkimit për të ofruar kuadër dhe udhëzime të qarta për gërmimet në të ardhmen.	GKB në bashkëpunim me Fondacionin e Ri	MK IKTK IA AKZM	2020	6 muaj	Operacional (Fondacioni)
1.1.13 Studim gjeofizik i përgjithshëm i Kalasë së Ali Pashës për përcaktimin e masave të konsolidimit. (Shihni Shtojcën C për më tepër detaje)	Fondacioni i Ri me konsulentët e jashtëm Në konsultim me IKTK (AKZM-së t') kërkohet konsulencë për efektet mjedisore).	MK IKTK IA AKZM	2022	4 muaj	50 mijë

Veprimi	Agjensia përgjegjëse për zbatimin	Autoriteti miratues / mbikëqyrës	Periodha	Kohëzgjatja / frekuenca	Buxheti (USD)
1.1.14 Rishikimi i marrëveshjeve ekzistuese të sigurisë, që të ofrohet sistem sigurie i integruar 24-orë, i cili mbron plotësisht asetet e Parkut.	Fondacioni i Ri (për zonën A3) AKZM (për pjesë tjetër të parkut)		2020	2 muaj Rishikim vjetor	Operacional (Fondacioni)
1.1.15 Prokurimi dhe zbatimi i punimeve: "E qëndrueshme, ka nevojë për punime madhore". (Shihni 1.1. 11) (Shihni Shtojcën C për më tepër detaje)	Fondacioni i Ri me shoqëri të jashtme	MK IKTK IA AKZM	2022-2023	18 muaj	196 mijë Operacional
1.1.16 Prokurimi dhe zbatimi i punimeve për kalanë e Ali Pashës (Shihni 1.1. 13) (Shihni Shtojcën C për më tepër detaje)	Fondacioni i Ri me shoqëri të jashtme	MK IKTK IA AKZM	2022-2023	18 muaj	117.6 mijë Operacional
1.1.17 Bashkëpunimi i Fondacionit të Ri me Institutin e Arkeologjisë dhe GKB-në, për të rënë dakord mbi një strategji që mundëson kushte më të mira për arkivimin e aseteve afatgjata të Institutit të Arkeologjisë dhe përdorimin e mundshëm të hapësira ekzistuese të arkivit në Kalanë Veneçiane.	Fondacioni i Ri Insttuti i Arkeologjisë Grupi Kërkimor i Butrintit	IA	2020	6 muaj	Operacional (Fondacioni)
NGRITJA E KAPACITETEVE					
1.1.18 Trajnimi i stafit teknik të Fondacionit dhe i mjeshtrave lokal lidhur me teknika të rëlvimit dhe monitorimit. (Në mbështetje të veprimeve praktike për t'u ndërmarrë në Zonën A3).	Fondacioni i Ri me konsulentët e jashtëm. Konsultim me IKTK	IKTK IA	2020	1 muaj Gjatë gjithë vitit	1.5 mijë
1.1.19 Trajnimi i stafit teknik të Fondacionit dhe i zejtarëve lokal lidhur me teknika të ndërtimit/meremetimit të muraturës / suvatimit për punime minimale mirëmbajtje. (Në mbështetje të veprimeve praktike për t'u ndërmarrë në sit).	Fondacioni i Ri me konsulentët e jashtëm. Konsultim me IKTK	IKTK IA	2020	5 muaj Gjatë gjithë vitit	10 mijë
1.1.20 Trajnimi i fuqisë punëtore të dedikuar në baza sezonale për menaxhimin e bimëstolë invazive si pjesë e programit vjetor të vazhdueshëm të mirëmbajtjes. (Përkrahje e veprimeve praktike për t'u ndërmarrë në Zonën A3).	Fondacioni i Ri me konsulentët e jashtëm.	AKZM IKTK	2020	2 muaj Gjatë gjithë vitit	4 mijë

Veprimi	Agjensia përgjegjëse për zbatimin	Autoriteti miratues / mbikëqyrës	Periodha	Kohëzgjatja / frekuenca	Buxheti (USD)
<p>1.1.21 Zbatimi i një programi trajnimi afatgjatë për konservuesit arkeologë dhe specialistë e konservimit të mozaqeve.</p> <p>(Ngritja e një ekipi konservimi të posaçëm me synimin e ofrimit të punësimit të qëndrueshëm për angazhim në Zonën A3 dhe në shtet të tjera në Shqipëri.)</p>	Fondacioni i Ri me konsulentët e jashtëm. Konsultim me IKT	IKTK IA	2021	5 muaj Gjatë gjithë vitit	20 mijë
1.2 Zgjerimi i potencialit turistik dhe edukativ të Parkut Kombëtar, nëpërmjet një programi kërkimi, gërmimi, konservimi dhe monitorimi.					
KËRKIMI SHKENCOR, ARKIVIMI DIGJITAL DHE PREZENCA KËRKIMI SHKENCOR, ARKIVIMI DIGJITAL DHE PREZENCA					
1.2.1 Mobilizimi i Grupit Kërkimor të Butrintit dhe hartimi i një programi kërkimi shkencor, ku të përfshihen të gjitha aspektet kulturore dhe natyrore të Parkut Kombëtar. (Shihni 3.2. 2)	Fondacioni i Ri me institucionet e propozuara		2020	6 muaj Rishikim vjetor	755 mijë (Totali për 10 vjet)
1.2.2 Zhvillimi, përditësimi dhe integrimi i arkivës digjitale të dokumenteve, të dhënave dhe gjetjeve shkencore, në platformën e re GIS. (Shihni 1.2.10)	Fondacioni i Ri me konsulentët e jashtëm		2020	6 muaj Rishikim vjetor	40 mijë
1.2.3 Kontrolli, përditësimi dhe zhvillimi i faqes së internetit të Butrintit, për të ofruar një burim informacioni të hollësishëm për STB-në dhe Parkun Kombëtar dhe programin e aktiviteteve.	Fondacioni i Ri		2020	4 muaj Rishikim ditor	Operacional
1.2.4 Kryerja e një vrojtimi/studimi hidrologjik për Zonën A3, në mënyrë që të përcaktohen pasojat e përmbajtjes tek monumentet, duke përfshirë mozaqet.	Fondacioni i Ri me konsulentët e jashtëm dhe MBZHR Konsultim me IKT	MK IKTK IA AKZM	2020	3 muaj Rishikim vjetor	120 mijë (Totali për 10 vjet)
GËRMIME ARKEOLOGJIKE					
1.2.5 Hartimi dhe përditësimi i rregullt i një harte arkeologjike, ku të tregohen me detaje ato pjesë të parkut ku dihet se ka rreñoja arkeologjike. (Shihni 1.2. 10)	Fondacioni i Ri Insbtuti i Arkeologjisë me konsulentët e jashtëm	MK IA	2021	5 muaj Shqyrtim vjetor dhe në varësi të gërmimeve në vazhdim dhe të miratuara.	Operacional

Veptrimi	Agjencia përgjegjëse për zbatimin	Autoriteti miratues / mbikëqyrës	Periodha	Kohëzgjatja / frekuenca	Buxheti (USD)
Ka një sërë çështjesh kritike që duhet të adresohen dhe trajtohen në mënyrë që këto rekomandime të bëhen të zbatueshme. E një rëndësie të vecantë janë sigurimi i hapësirës për ndërtimin e një qendër të re vizitorësh, e cila është thelbësore për fluksin dhe menaxhimin e vizitorëve, miratimi i rekomandimeve të drejtimit të Parkut Kombëtar dhe çështjeve të përdorimit të tokës të lidhur me menaxhimin e zhvillimit të Ksamilit.

Për dy vitet e ardhshme të cilat përkufizojnë "Periudhën Tranzitore", (2020-2022), nevojiten masat e mëposhtme:

1. Fillimi i procesit të ngritjes së Fondacionit të Ri sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi.
2. Fillimi i punimeve të parashikuara për periudhën tranzitore - kjo është veçanërisht e rëndësishme për punimet e konservimit të sitit.
3. Fillimi i aktivizimit të rolit të anëtarëve të autorizuar të bordit (nëse nevojitet) gjatë periudhës tranzitore.

Nëse pikat 1-3 janë në proces do të duhet:

4. Kryerja e një studimi fizibiliteti dhe projekt ideje për fazën 1 të qendrës së vizitorëve.
5. Kryerja e Vlerësimit të Ndikimit në Trashëgimi (HIA - Heritage Impact Assessment) dhe Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis (EIA - Environment Impact Assessment) në lidhje ngritjen e një qendre të re vizitorësh në bashkëpunim me agjenci vendore, rajonale dhe kombëtare. Procesi do të vijojë në varësi të rezultatetve të HIA dhe EIA dhe vlerësimit teknik të ICOMOS/QTB.
6. Hartimi dhe përgatitja e udhëzimeve dhe fillimi i zhvillimit të studimeve të mëposhtme të specializuara:
 - Studim hidrologjik mbi të gjithë vijën ujëndarëse të Parkut Kombëtar, për të bazuarveprimet e përshtatshme për zbutjen e efekteve të rritjes së nivelit të ujërave.
 - Menaxhimi/ mbështetja duke udhëzuar stafin për periudhën tranzitore në tërësi, për t'ju mundësuar sistemimin dhe adaptimin e plotë në sit.

³⁵ Martin S (2001) Plani i Menaxhimit të Butrintit. Fondacioni Butrinti.

- Hartimi i një plani infrastrukturor interpretues dhe turistik për mbarë Parkun, Studime për menaxhimin e qarkullimit dhe transportit, veçanërisht lidhur me përdorimin e varkave të vizitorëve dhe efikasitetin e transportit alternativ, të përshtatshëm për vizitorët.
 - Menaxhimi i vizitorëve dhe sondazhe të kënaqshme, janë edhe çelësi i menaxhimit të suksesshëm afatgjatë të sitit.
 - Hartimi i planeve të detajuara për trajnimin dhe angazhimin e komunitetit lokal dhe të tjerëve, në një sërë disiplinash të lidhura me sitin.
 - Plan biodiversiteti/ekologjik për Zonën A3 me monitorim vjetor.
 - Plane për menaxhimin e shëndetit dhe sigurisë, si dhe planet e emergjencës për menaxhimin ndaj fatkeqësive, përditësimi i tyre, veçanërisht lidhur me rrezikun ndajzjarrit.
7. Hartimi dhe përgatitja e udhëzimeve, si dhe fillimi i hartimit të projekteve për interpretimin e Silit, duke përfshirë muzeun e ri në Kalanë Veneciane, Kalanë Trekëndore dhe sitin në tërësi, varkat për transportimin e pasagjerëve, mjetet ekologjike të transportit etj.).
 8. Vijueshmëria e angazhimit të palëve vendase të interesit për të dhënë sugjerimet e tyre, teksa u shpjegohen mundësitë për tregti, që do t'iu ofrohen falë zhvillimeve të propozuara, duke siguruar kështu mbështetjen e tyre, e cila do të jetë jetike në plan afatgjatë.
 9. Marrja në konsideratë e "Markës" që do t'i ofrojë Butrinti brezave të ardhshëm, së bashku me mënyrat se si kjo markë do të pasqyrohet dhe konsolidohet si në Zonën A3, ashtu edhe në të gjithë Parkun Kombëtar.
 10. Vlerësimi i ndikimeve për të gjithë stafin ekzistues të sitit dhe mirëqenien e tyre në të ardhmen, si dhe punësimin e personave të rinj, duke përfshirë përshkrime të detajuara të pozicioneve të punës dhe kushteve të shërbimit, si dhe intervistimi dhe fillimi i përzgjedhjes së kandidatëve, të përshtatshëm.

Shumë prej këtyre veprimeve mund dhe duhen kryer paralelisht. Megjithatë, ka një sërë çështjesh delikate lidhur me mënyrën e trajtimit, për të mundësuar zbatimin e këtyre rekomandimeve. Të një rëndësie të veçantë janë:

- Mundësia për të siguruar tokën për ndërtimin e një qendre të re vizitorësh, e cila është kritike për menaxhimin e fluksit të vizitorëve;
- Miratimi i rekomandimeve të drejtimit për Zonat A3;
- Çështje të përdorimit të tokës në lidhje me menaxhimin e zhvillimit të Zonave A3.

11.2 Monitorimi

Ky seksion përvijon qasjen në nivel strategjik për monitorimin e ndryshimeve në Parkun Kombëtar. Kjo do t'i ndihmojë drejtuesit të identifikojnë prirjet, problematikat dhe konfliktet që mund të lindin dhe të sigurohet trajtimi i tyre.

Qasja e përzgjedhur për monitorim bazohet në qasjet standarde të monitorimit të mjedisit:

- Identifikimi i tematikave kryesore që do të monitorohen (në këtë rast të marra nga deklarata e Vlerës së Jashtëzakonshme Universale dhe deklarata të Vlerave të Tjera);

- Identifikimi i një ose disa treguesve për çdo tematikë të identifikuar, që tregojnë natyrën e të dhënave bazë, të cilat kërkohen për çdo ndryshim të ardhshëm që mund të matet;
- Evidentimi i mënyrës se si duhet të ndodhë ndryshimi;
- Artikulimi i rezultateve të dëshiruara në mënyrë që sukcesi, apo dështimi i nismave të identifikohet sa më shpejt.

11.3.1 Kuadri i monitorimit

Qasja e propozuar për monitorimin strategjik paraqitet në tabelën e mëposhtme. Plani i Veprimit identifikon veprimet kyçe që nevojiten për trajtimin e disa prej çështjeve të identifikuara.

Objekti	Treguesit kryesorë	Të dhënat bazë	Të dhënat e monitorimit	Rezultatet e dëshiruara
Mbrojta dhe konservimi i atributave kulturore dhe ruajtja e një mjedisi të përshtatshëm dhe me identitet	Degradimi i pamjes së mjedisit nga ndërtesat e reja, rrugë, gardhe të rinj etj. Shkalla e erozionit, shkaktuar nga njeriu. Gjendja e pasurisë arkeologjike dhe ekologjike	Vlerësimet e konservimit dhe rievimet me përdorimin e GIS. Vrojtime për gjendjen.	Përditësimet dyvjetore të të dhënave bazë të GIS dhe vrojtimeve fotografike Përditësimet vjetore të vrojtimeve të gjendjes për burimet arkeologjike dhe ekologjike	Ulja e shkallës së degradimit të mjedisit. Përmirësim real i kushteve të burimeve arkeologjike dhe ekologjike.
Zgjerimi i potencialit turistik dhe edukativ të sitit përmes programeve të vazhdueshme të kërkimit, gjurmimit dhe konservimit.	Numri i kurseve, diskutimeve, ecjeve me udhërrëfyes, tabelave interpretuese, personave të përfshirë, nivelet e kënaqshmërisë.	Numri i këtyre aktiviteteve etj., që zhvillohen aktualisht	Përditësimi vjetor i të gjitha aktiviteteve. Anketime për kënaqshmërinë e pjesëmarrësve	Rritja e pjesëmarrjes dhe kënaqësisë në të gjitha aktivitetet që nuk i dëmtojnë burimet arkeologjike dhe ekologjike.
Nxjtja dhe mbështetja e programeve të kërkimit dhe monitorimit që informojnë menaxhimin e qëndrueshëm të Sitit dhe mjedisit të tij	Anketimet dhe mbledhja e të dhënave në të gjitha aspektet e funksionimit të Parkut.	Informacion aktualisht i disponueshëm nga burime të publikuara dhe/ose prestigjioze.	Përditësimet vjetore ose dyvjetore, siç gjykohet e nevojshme, për çdo fushë të dhënash të ndërmarrë nga ekspertët nën kujdesin e Grupit Kërkimor të Butrintit.	Zgjerim i grupit të të dhënave të mbledhura vit pas viti, në mënyrë që prirjet të mund të monitorohen dhe veprimet të merren sipas mënyrës së duhur dhe në kohën e duhur
Zhvillimi dhe zbatimi i një programi të vazhdueshëm për monitorimin dhe restaurimin ekologjik kur është i realizueshëm dhe i përshtatshëm për të ofruar të dhëna që janë thelbësore për informimin e vendimmarrjes në të ardhmen	Mirëqenia ekologjike për sa i përket cilësisë së ajrit dhe ujit, shkalla e ndotjes nga plastika dhe ndotjeve të tjera, numri dhe larmia e kafshëve, cilësia e pemëve dhe bimëve të tjera, numri i specieve joindigjene dhe invazive.	Informacion aktualisht i disponueshëm nga burime të publikuara dhe/ose prestigjioze.	Përditësimet vjetore ose dyvjetore, siç gjykohet e nevojshme, për çdo fushë të dhënash të ndërmarrë nga ekspertët nën kujdesin e Grupit Kërkimor të Butrintit.	Përmirësime mjedisore të dëshmuara në të gjitha aspektet, të matura me tregues kryesorë.

Objekivi	Treguesit kryesorë	Të dhënat bazë	Të dhënat e monitorimit	Rezultatet e dëshiruara
Promovimi i ndërgjegjësimit ndaj mjedisit të vizitorëve dhe komunitetit lokal lidhur me biodiversitetin, habitatet dhe peizazhet e brishta.	Nivelet e sjelljeve mjedisore të dobëta dhe dëmtuese	Informacion aktualisht i disponueshëm nga burime të publikuara dhe/ose prestigjioze dhe vëzhgime brenda Parkut.	Vlerësimi vjetor i sjelljes së papërshtatshme dhe dëmtuese ndaj mjedisit, nga të gjitha burimet.	Përmirësim real i sjelljes ndaj mjedisit, si p.sh reduktimi i hedhjes së plehrave. Përmirësim i pamjes së mjedisit.
Vendosja e praktikave të qëndrueshme bujqësore dhe të akuakulturës brenda dhe përgjatë kufijve të Parkut Kombëtar.	Nivelet e praktikave të dobëta ose të paqëndrueshme në bujqësi dhe akuakulturë, duke përfshirë atotë lidhura me ndotjen, hedhjen e mbeturinave dhe menaxhimin e dobët të mbetjeve.	Informacion aktualisht i disponueshëm nga burime të publikuara dhe/ose prestigjioze dhe vëzhgime brenda Parkut.	Vlerësimi vjetor i sjelljes së papërshtatshme ose dëmtuese ndaj mjedisit, nga të gjitha burimet.	Përmirësim real në të gjitha praktikat bujqësore dhe të akuakulturës nga të gjitha burimet, si p.sh reduktimi i ndotjes, hedhjes së mbeturinave, shkarkimeve. Përmirësim i pamjes së mjedisit.
Krijimi dhe ruajtja e një strukture drejtimi dhe menaxhimi të konsoliduar dhe të qëndrueshëm për koordinim efikas të të gjitha veprimtarive që ndikojnë VJU-në e sitit.	Performancë të vazhdueshme në aspektin menaxherial dhe financiar. Rritja e bashkëpunimit nga të gjitha agjencitë e përfshira që punojnë për mirëqenien e Parkut.	Rregullimet aktuale të menaxhimit.	Rishikimet vjetore të menaxhimit të praktikave të punës, që sjellin rezultate bashkëpunuese.	Strukturë e konsoliduar dhe e qëndrueshme drejtimi dhe menaxhimi.
Garantimi i disponimit të burimeve të mjaftueshme financiare dhe të tjera, që lejojnë zbatimin efikas të Planit të Menaxhimit të Integruar.	Mirëqenia financiare, kënaqësia e stafit, përmirësimi i shërbimeve dhe rritja e kënaqësisë së vizitorëve/përdoruesve	Rregullimet aktuale të menaxhimit.	Rishikimet vjetore të menaxhimit të praktikave të punës, niveleve të kënaqshmërisë së stafit dhe anketimeve të kënaqshmërisë së vizitorëve.	Burime financiare dhe burime të tjera të garantuara, vizitorë të kënaqur dhe staf i përkushtuar.
Sigurimi i aksesit të përshtatshëm për vizitorët, si për brenda ashtu dhe përreth sitit, në mënyrë të sigurt dhe të qëndrueshme.	Numri i incidenteve, nivelet e kënaqësisë së vizitorëve, aktivitetet e përshtatshme për konservimin.	Rregullimet aktuale të menaxhimit.	Rishikimet vjetore të praktikave të punës, niveleve të kënaqësisë së vizitorëve, numrit të incidenteve të regjistruara dhe të tjera si këto.	Përmirësimi i shërbimeve dhe rregulimeve të aksesit, zero incidente, vizitorë të kënaqur.

Objektivi	Treguesit kryesorë	Të dhënat bazë	Të dhënat e monitorimit	Rezultatet e dëshiruara
Promovimi i turizmit ekologjik, nëpërmjet zhvillimit të infrastrukturës soft (të lehtë, për të rritur angazhimin në asetet natyrore dhe aktivitetet brenda Parkut.	Zhvillimet e infrastrukturës duhet të jenë në përputhje me standardet e qëndrueshmërisë të njohura ndërkombëtarisht.	Standardet e përshatshme ndërkombëtar e.	Monitorimi në terren gjatë ndërtimit, përshatja e ambientit etj., dhe rishikimet dyvjetore të tyre në vijimësi	Infrastrukturë e përshatshme me standardet ndërkombëtare,
Përmirësimi i interpretimit dhe paraqitjes së pasurive natyrore dhe kulturore të Parkut Kombëtar për qëllime edukuese dhe argëtuese të vizitorëve.	Të kuptuarit e kënaqësisë dhe argëtimit të vizitorëve.	Informacion aktualisht i disponueshëm nga burime të publikuara dhe/ose prestigjioze.	Anketime vjetore për kënaqshmërinë dhe perceptimin e vizitorëve.	Përmirësimi i perceptimit dhe i kënaqshmërisë dhe argëtimit të vizitorëve.
Përmirësimi i materialit interpretues dhe ofrimi i informacionit brenda STB-së dhe zonës më të gjerë të Parkut Kombëtar.	Të kuptuarit e kënaqësisë dhe argëtimit të vizitorëve.	Informacion aktualisht i disponueshëm nga burime të publikuara dhe/ose prestigjioze.	Anketime vjetore për kënaqshmërinë dhe perceptimin e vizitorëve.	Përmirësimi i perceptimit dhe i kënaqshmërisë dhe argëtimit të vizitorëve.
Rritja e të kuptuarit të termave VJU dhe STB dhe Park Kombëtar nga publiku	Të kuptuarit e kënaqësisë dhe argëtimit të vizitorëve.	Informacion aktualisht i disponueshëm nga burime të publikuara dhe/ose prestigjioze.	Anketime vjetore për kënaqshmërinë dhe perceptimin e vizitorëve.	Përmirësimi i perceptimit dhe i kënaqshmërisë dhe argëtimit të vizitorëve.
Përfshirja e komuniteteve në menaxhimin e STB-së dhe Parkut Kombëtar.	Përfshirja.	Anketime bazë.	Vlerësimet vjetore të përfshirjes.	Rritja e përfshirjes dhe angazhimit.
Mbështetja e komuniteteve lokale në përdorimin e STB-së dhe Parkut Kombëtar, si shtysë për rritje ekonomike	Të ardhurat dhe tregues të tjerë të mirëqenies.	Anketime bazë.	Vlerësimet vjetore.	Rritja e të ardhurave dhe treguesve të tjerë të mirëqenies.
Konsolidimi dhe përmirësimi i programeve dhe strukturave edukuese në STB dhe në Parkun Kombëtar.	Hartimi dhe zhvillimi i programeve edukuese	Informacion aktualisht i disponueshëm nga burime të publikuara dhe/ose prestigjioze.	Vlerësimet vjetore të programeve të ofruara dhe pranueshmërisë së tyre.	Përmirësimi i perceptimit të rëndësisë së vendit nga komunitetet lokale dhe të tjerë.

Treguesit e përgjithshëm	Treguesit kryesore	Të dhënat bazë	Të dhënat e monitorimit	Rezultatet e dëshiruara
Veprimtari shkencore	Artikuj dhe botime akademike, të vlerësuara nga kolegët	Arkivat aktuale	Materiale të reja	Shtimi i këtyre materialeve
Mbulimi publik	Mbulim televiziv dhe nga mediat e tjera	Aktivitete aktuale	Materiale të reja	Shtimi i këtyre materialeve
Statusi i përgjithshëm i sitit	STB, Ramsar, Park Kombëtar etj.	Statusi aktual	UNESCO -RAMSAR etj	Ruajtja dhe përforcimi i statusit kur është e nevojshme
Statusi i përgjithshëm socio-ekonomik	Numri i vizitorëve, kohëzgjatja e qëndrimit, ndikimet ekonomike	Informacion aktualisht i disponueshëm nga burime të publikuara	Anketime dhe studime për ndikimin	Përmirësimi i ndikimeve, duke ruajtur njëkohësisht integritetin e Parkut
Monitorimi i asetëve	Të gjitha asetet	Burime të verifikuara të dhënash të aksesueshme në distancë nga publiku	Sensorë në distancë të teknologjisë së lartë (GIS, ASIG.ai, satelit konstelacioni Cosmo-SkyMed i menaxhuar nga ASI - Agjencia Hapësinore Italiane, LandSat, NASA)	Përditësimi dhe monitorimi i vazhdueshëm i burimeve kulturore dhe natyrore

SHTOJCAT



SHTOJCA A Konventa e Trashëgimisë Botërore

Përfshirja e Butrintit në Listën e trashëgimisë botërore të UNESCO-s

Shpallja në rang kombëtar

1948 - Ligji mbi mbrojtjen e monumenteve dhe të sendeve natyrore të rralla, miratuar me dekret Nr. 586, datë 17.03.1948. Ligji autorizon një organ të posaçëm që i është caktuar Institutit të Shkencave të nxjerrë listën e parë të monumenteve që vihen në mbrojtje nga shteti dhe që kanë vlera historike, shkencore dhe artistike. Rrënojat e Butrintit (Buthrotum) renditen në vendin e 86-të në listë, kufijtë e të cilit përshkruhen si më poshtë: Gjithë qyteti antik i rrethuar në të tre anët me kanalën dhe liqenin e Butrintit dhe nga jugperëndimi i rrethuar me qafën; kalaja e Ali Pashës në Butrint renditet e 87-a në listë, kufijtë e së cilës përshkruhen si më poshtë: ndodhet në anën e majtë të buzë kanalit, me mure rrethuese prej 5 metrash distancë.

Shpallja u bë nga Presidiumi i Institutit të Shkencave, me vendim të botuar në Fletoren Zyrtare, Nr.95, datë 16.10.1948, në hyrjen e së cilës shkruhet: Duke patur parasysh urgjencën që paraqet mbrojtja, konservimi dhe vendosja e një kontrolli më të mirë mbi monumentet e ndryshme të kulturës, duke çmuar vlerën historike, shkencore dhe artistike të monumenteve të propozuara për shpallje, Presidiumi i Institutit në bazë të kompetencave, që i jep neni 3 i ligjit për mbrojtjen e monumenteve të kulturës dhe sendeve natyrore të rralla, deklaron të mbrojtura nga shteti imonumentet e mëposhtme".

1973 - Me Vendim Nr.1886, datë 10.06.1973 të Ministrisë së Arsimit dhe Kulturës, Rrënojat e Butrintit renditen si Qyteti Antik i Buthrotit në Butrint.

1998 - Me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 450, datë 1.07.1998 qyteti antik i Butrintit, *si pjesë përbërëse e trashëgimisë kulturore, kombëtare dhe asaj botërore, vihet tërësisht në konservimin e Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporteve.*

2000 - Me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 82, datë 02.03.2000, zona, duke përfshirë edhe zonën arkeologjike, me sipërfaqe 25 km² (2500 ha) u shpall Park Kombëtar.

2002- Me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 351, datë 31.10.2002, territori natyror i kompleksit ligatinor i Butrintit që përfshinte: Liqenin e Butrintit, Parkun Kombëtar të Butrintit, Kepin e Stillos dhe ishujt e Ksamilit, shpallen zonë natyrore, veçanërisht e mbrojtur, për t'u përfshirë në listën e konventës për "Ligatinat me rëndësi ndërkombëtare veçanërisht si habitate të shpendëve ujorë".

2005 - Me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 693, datë 10.11.2005, Parku Kombëtar i Butrintit u zgjerua duke përfshirë edhe pjesë të territorit kompleks ligatinor natyror të Butrintit. Sipërfaqja e Parkut është 8.591,2 ha dhe ndahet në zonat e mëposhtme:

- Zona A – Zona qendrore e Ruajtjes së Biodiversitetit, 3980 ha
- Zona B – zona rekreacionale prej 592 ha, ku mund të zhvillohen veprimtari edukuese dhe të ngjashme
- Zona C – zona e vlerave natyrore prej 3081,2 ha
- Zona D – zonë mbrojtëse, që lejon zhvillime të vogla dhe të qëndrueshme

2013 – Me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 134, datë 20.02.2013, krahas Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 693, datë 10.11.2005, parku u zgjerua edhe më tej. U caktuan kufijtë e rinj të Parkut Kombëtar të Butrintit, i cili ka tashmë një sipërfaqe prej 9424 ha dhe ndahet në zonat e mëposhtme:

- Zona A – me nënzonat A1, A2 dhe A3, zona natyrore me rëndësinë dhe ruajtjen më të lartë. Sipërfaqja: 3838,75 ha
- Zona B – nënzonë ku mund të zhvillohen veprimtari rekreacioni dhe edukuese me sipërfaqe prej 844,36 ha
- Zona C – me nënzonat C1 dhe C2 me sipërfaqe prej 3958,29 ha, ku mund të zhvillohen veprimtari natyrore, tradicionale dhe ekonomike
- Zona D – me sipërfaqe prej 782,99 ha, mundëson zhvillimin e veprimtarive të reja, të ndjeshme dhe të qëndrueshme

Shpallja në nivel ndërkombëtar

1992- Propozimi që Butrinti të përfshihej në Listën e Trashëgimisë Botërore u dorëzua më 15 maj 1990. Rekomandimi i ICOMOS në vitin 1991 ishte që të shtyhej përfshirja në listë për shkak të mungesës së të dhënave mbi mbrojtjen, shtrirjes së zonës së mbrojtur të propozuar dhe problemit të depërtimit të ujit në sit. Pas marrjes së informacionit të kërkuar, Butrinti u përfshi në Listën e Trashëgimisë Botërore në sesionin e Komitetit të Trashëgimisë Botërore, të mbajtur në Santa Fe, SHBA, më 7-14 dhjetor 1992.

Për sa i përket kategorive të objekteve kulturore të përcaktuara në Nenin 1 të Konventës së Trashëgimisë Botërore 1972, Butrinti u përfshi në listën e pasurive botërore për komponentin kulturor në bazë të kriterit (iii)³⁶ si dëshmi unike dhe të jashtëzakonshme të traditës kulturore dhe civilizimit që tashmë janë zhdukur.

1997- Për shkak të kaosit të shkaktuar nga paqëndrueshmëria politike, pas dështimit të Skemave Piramidale në Shqipëri, Butrinti u vu në shënjestër të vjedhjeve, ndërsa artefaktet e tij u vunë në shënjestër të tregtisë së paligjshme dhe siti nuk kishte më asnjë lloj mbrojtjeje. Në seancën e 21-të të Komitetit të Trashëgimisë Botërore, pas raportimeve të UNESCO-ICOMOS-Fondacioni Butrint, si dhe miratimit të plotë të Ministrisë së Kulturës në Shqipëri, Butrinti u përfshi në Listën e Trashëgimisë Botërore në Rrezik.

Sesioni i 21-të u mbajt në Napoli, Itali, më 1-6 dhjetor 1997.

1999 – Qeveria Shqiptare kërkoi zgjerimin e Sitit të Trashëgimisë Botërore, në mënyrë që të përfshinte zonën arkeologjike me sipërfaqe 25 km². Gjatë sesionit të 23-të, të mbajtur në Marrakesh, Marok, më 29 nëntor-4 dhjetor 1999, Komiteti i Trashëgimisë Kulturore vendosi ta zgjeronte sitin të klasifikuar në kategorinë (iii), me kusht që zona e përjashtuar të përfshihej në zonën e propozuar për zgjerim. Përveç kësaj zone, u sugjerua të përfshihej dhe të mbrohej edhe një zonë e vogël në bregdet. Zgjerimi u miratua në vitin 2000.

2003 - Territori natyror dhe ligatinor i Butrintit përfshirë: Liqenin e Butrintit, Parkun Kombëtar të Butrintit, Kepin e Stillos, ishujt e zonës natyrore të Ksamilit, nën mbrojtjen e veçantë dhe të rekomanduar për t'u përfshirë në listën e konventës së "Ligatinave me rëndësi ndërkombëtare dhe habitate të veçanta

³⁶ Atributet që shprehin Vlerën e Jashtëzakonshme Universale nuk u shtuan në atë kohë.

për zogjtë e ujit” u përfshinë në listën me shënime të Ramsarit të ligatinave me rëndësi ndërkombëtare. Shpallja u miratua më 28 mars 2003. Siti u shpall në bazë të 4 kritereve kryesore:

Kriteri 1 - Ligatinë e konsideruar si me rëndësi ndërkombëtare pasi është e një shembull përfaqësues, i rrallë dhe unik i një lloj ligatine natyrore ose thujse natyrore që ndodhet brenda rajonit të përshtatshëm biogeografik;

Kriteri 2 - Ligatinë e konsideruar si me rëndësi ndërkombëtare pasi mbështet speciet e rrezikuara apo në rrezik kritik zhdukjeje, ose komunitetet ekologjike të kërcënuara;

Kriteri 3 - Një ligatinë me rëndësi ndërkombëtare pasi mbështet popullatat e bimëve dhe/ose kafshëve të rëndësishme për ruajtjen e diversitetit biologjik të një rajoni të caktuar biogeografik.

Kriteri 8 - Një ligatinë me rëndësi ndërkombëtare pasi është burim i rëndësishëm për ushqim për peshqit, dhe ofron vendosjen e vezëve dhe/ose rrugët e migrimit të tyre.

2005 – Në seancën e 29-të të Komitetit të Trashëgimisë Botërore të mbajtur në Durban, Afrikë e Jugut më 10 - 17 korrik 2005, Butrinti u hoq nga Lista e Trashëgimisë Botërore në Rrezik.

2007 – Në seancën e 31-të të Komitetit të Trashëgimisë Botërore të mbajtur në Christchurch, Zelandë e Re më 23 qershor - 2 korrik 2007, Parku Kombëtar i Butrintit (sipas VKM Nr. 693, datë 10.11.2005, dhe me një sipërfaqe prej 8.591,2 ha) u miratua si zonë e mbrojtur e Butrintit.

2014 – Në seancën e 38-të të Komitetit të Trashëgimisë Botërore të mbajtur në Doha, Katar, më 15–25 qershor 2014, u miratua deklarata retrospektive e vlerës së jashtëzakonshme universale për sitin e Butrintit. Deklarata retrospektive: Atributet që shprehin Vlerën e Jashtëzakonshme Universale për Kriter (iii): Evoluimi i mjedisit natyror të Butrintit solli braktisjen e qytetit në fund të Mesjetës, dhe për pasojë ky sit arkeologjik ofron dëshmi të çmuara për qytetërimet antike dhe mesjetare në territorin modern shqiptar.

Përgjegjësitë kryesore që rrjedhin nga Konventa

Në Nenin 4 të Konventës, Shtetet Palë pranojnë se detyra e identifikimit, mbrojtjes, paraqitjes, transmetimit tek brezat e ardhshëm të trashëgimisë kulturore dhe natyrore që ndodhet në territorin e tij, i përket kryesisht shtetit. Megjithatë, Konventa pranon se Shteti Palë do ta përmbushë këtë detyrë brenda mundësive të tij, bazuar në burimet e veta dhe angazhimin e asistencës ndërkombëtare, kur është e nevojshme.

Neni 5 i Konventës parashikon se në mënyrë që të merren masa efikase dhe aktive për mbrojtjen, konservimin dhe prezantimin, çdo Shtet Palë duhet:

1. të përshtatë një politikë, e cila ka si synim t'i japë trashëgimisë kulturore dhe natyrore një funksion në jetën e komunitetit dhe të integrojë mbrojtjen e kësaj trashëgimie në programe të përgjithshme planifikuese;
2. të ngrejë brenda territorit të tij, atje ku këto shërbime nuk ekzistojnë, një ose më shumë shërbime për mbrojtjen, konservimin dhe prezantimin e trashëgimisë kulturore dhe natyrore me një staf të përshtatshëm dhe që ka mundësitë për të kryer funksionet e veta;
3. të zhvillojë studime shkencore dhe teknike, punë kërkimore, dhe të përgatisë metoda operative të atilla që do ta bënin shtetin të aftë, për të përballuar rreziqe që kërcënojnë trashëgiminë e tij kulturore ose natyrore.

4. të marrë masat e duhura ligjore, shkencore, teknike, administrative dhe financiare të nevojshme për identifikimin, mbrojtjen, konservimin, prezantimin dhe rehabilitimin e kësaj trashëgimë.
5. të nxisë ngritjen ose zhvillimin e qendrave kombëtare apo rajonale për ofrimin e trajnimit mbi mbrojtjen, konservimin dhe prezantimin e trashëgimisë kulturore dhe natyrore, si dhe nxit kërkimin shkencor në këtë fushë.

Neni 29 parashikon se Shteti Palë raporton dhe jep informacione mbi dispozitat ligjore dhe administrative të miratuara, si dhe mbi veprime të tjera të ndërmarra nga Shteti Palë për zbatimin e kësaj Konvente, së bashku me detajet për përvojën e fituar në këtë fushë. Raportet paraqiten në mbledhjen e Komitetit të Trashëgimisë Botërore, dhe më pas në Konferencën e Përgjithshme të UNESCO-s në sesionin e zakonshëm.

Udhëzimet operacionale

Udhëzimet operacionale ofrojnë me tepër këshillim praktik për aplikimin dhe zbatimin e Konventës. Theksi vihet kryesisht te mbrojtja e Vlerës së Jashtëzakonshme Universale dhe rëndësia e Deklaratës së saj përkatëse si elemente bazë për menaxhimin dhe monitorimin e pronës pasuri botërore.

Shënimet kryesore udhëzuese të Udhëzimeve Operacionale janë përfshirë edhe në dokumentin e këtij Plani Menaxhimi të Integruar. Duke pranuar se qëllimi i një sistemi menaxhimi është sigurimi i mbrojtjes efikase të pasurisë së nominuar, për brezat e sotëm dhe të ardhshëm, Shqipëria si Shtet Palë, siguron:

Aspektet e menaxhimit	Përgjegjësitë e drejtpërdrejta të Shtetit Palë
Sistemi i Menaxhimit	Çdo pasuri e nominuar duhet të ketë një plan të përshtatshëm menaxhimi, ose sistem menaxhimi të dokumentuar, që duhet të përcaktojë se si duhet të ruhet Vlera e Jashtëzakonshme Universale e pasurisë, mundësisht, duke përdorur mjete me pjesëmarrje.
Sistemet efikase të menaxhimit	Sistemi efikas i menaxhimit varet nga lloji, karakteristikat dhe nevojat e pasurisë së nominuar dhe kontekstit të saj kulturor dhe natyror. Elementet e përbashkëta të një sistemi efikas menaxhimi mund të përfshijë: <ol style="list-style-type: none"> a. Një perceptim të hollësishëm dhe të përbashkët të pasurisë nga të gjitha palët e interesit; b. Një cikël planifikimi, zbatimi, monitorimi, vlerësimi dhe reagimi; c. Monitorimin dhe vlerësimin e ndikimeve të prirjeve, ndryshimeve dhe ndërhyrjeve të propozuara; d. Përfshirjen e partnerëve dhe palëve të interesit; e. Përcaktimin e burimeve të nevojshme; f. Ngritjen e kapaciteteve; g. Përshkrimin llogaridhënës dhe transparent se si funksionon sistemi i menaxhimit.
Veprimet për mbrojtjen, konservimin dhe prezantimin	Menaxhimi efikas përfshin një cikël veprimesh afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata për mbrojtjen, konservimin dhe prezantimin e pasurisë së nominuar.

Qasja e Integruar	Qasja e integruar në planifikim dhe menaxhim është esenciale për orientimin e zhvillimit të pronës pasuri botërore përgjatë viteve dhe për të siguruar mirëmbajtjen e të gjitha aspekteve të Vlerës së tyre të Jashtëzakonshme Universale. Kjo qasje shkon përtej përfshirjes së ndonjë zone të mbrojtur, si dhe mjedisit më të gjerë të pasurisë.
Menaxhimi i fatkeqësive	Sistemi i menaxhimit duhet të mbulojë edhe planet për përgatitjen ndaj fatkeqësive dhe ndikimin e mundshëm të ndryshimeve klimatike. Ato kërkojnë edhe përdorimin e vlerësimit të impaktit për të vlerësuar efektet e propozimeve për zhvillim të Vlerës së Jashtëzakonshme Universale të një pasurie, dhe theksimin e rolit të objekteve të Trashëgimisë Kulturore në zhvillimin e qëndrueshëm, me kusht që ky zhvillim të mos ndikojë negativisht në pasuri.
Treguesit e raportimit dhe monitorimit	Nevoja për të raportuar ndryshimet apo propozimet për zhvillime madhore që prekin pasurinë e Trashëgimisë Botërore, përpara se të merren vendimet përfundimtare në Komitetin e Trashëgimisë Botërore. Treguesit e monitorimit lidhen me monitorimin, ndryshimin dhe sfidat e vlerës së jashtëzakonshme universale.

Zbatimi i Konventës së Trashëgimisë Botërore në Shqipëri

Butrinti është shpallur si Sit i Trashëgimisë Botërore në kategorinë e pasurisë kulturore.

Përgjegjësitë e Shtetit Palë	Koment mbi gjendjen aktuale
Sistemi i Menaxhimit	Hartimi i planit të menaxhimit të integruar është në proces.
Sistemet efikase të menaxhimit	
Veprimet për mbrojtjen, konservimin dhe prezantimin	
Qasja e integruar	
Menaxhimi i fatkeqësive	Plani i Menaxhimit dhe Gatishmërisë ndaj Riskut të Fatkeqësive për Butrintin u hartua në maj të vitit 2012. Megjithatë, plani nuk përfshin protokolle, veprime dhe kosto specifike.
Treguesit e raportimit dhe monitorimit të VJU-së	<ul style="list-style-type: none"> - Gjendja e konservimit (në bazë Vendimi) - Raporti i fundit i gjendjes së konservimit u dorëzua në vitin 2017; - Raportimi periodik (çdo 6 vjet): raporti i fundit u dorëzua në vitin 2014 - Korrespondenca mbi çështje të ngritura nga UNESCO ose palë të treta (reaguese dhe sipas kërkesës). Korrespondenca e fundit (sipas kërkesës së Qendrës së Trashëgimisë Botërore) u zhvillua

	<p>Vendimi i fundit trajtonte deklaratën retrospektive të VJU-së</p> <ul style="list-style-type: none"> - Vlerësimet e Bordit Këshillimor (sipas kërkesës së Qendrës së Trashëgimisë Botërore): vlerësimi i fundit u bë në vitin 2007, duke miratuar kufijtë për t'u bërë zonë mbrojtëse zonës bërthamë - Treguesit për monitorimin e VJU-së nuk janë hartuar ende
--	--

SHTOJCA B Zhvillimi i Zonave të Mbrojtura

1992

Qyteti Antik i Butrintit u shpall Sit i Trashëgimisë Botërore në vitin 1992, me Vendim Nr. 570 të Komitetit të trashëgimisë botërore të UNESCO-s (Figura 20). Me një sipërfaqe prej 16 ha, ai përfshin gadishullin qendror (qytetin antik me rrënojat e tij të periudhës klasike dhe periudhave të mëvonshme):



1999

Në vitin 1999, Shteti sugjeroi një zgjerim të Sitit të Trashëgimisë Botërore nga 16 hektarë në 2.500 hektarë³⁷ duke përfshirë Kanalin e Vivarit, pjesë e Fushës së Vrinës, Liqenin e Bufit, pjesën jugore të Liqenit të Butrintit dhe rrethinat e Malit të Sotirës deri në fshatin e Ksamilit.



³⁷ Të gjitha zonat (në hektarë) janë përafëruar në numrin më të afërt.

2000

Në vitin 2000, po e njëjta zonë u shpall Parku Kombëtar i Butrintit, me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 82, datë 2 mars 2000.



Gjithashtu, në vitin 2000, zgjerimi i propozuar (1999) i kufijve të Pasurisë së Trashëgimisë Botërore nga 16 ha në 2.500 ha, hyri në fuqi me vendim të Komitetit të Trashëgimisë Botërore në sesionin e 23-të, të mbajtur në Marrakesh, më 29 nëntor-4 dhjetor 1999.


Kështu, në vitin 2000 kufijtë e Sitit të Trashëgimisë Kulturore të Butrintit dhe Parkut Kombëtar të Butrintit përkonin me njëri-tjetrin, me një sipërfaqe prej 2.500 ha.

2005

Në vitin 2005, kufijtë e Parkut Kombëtar të Butrintit u zgjeruan nga 2.500 ha në 8.591,2 ha, me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 693, datë 10 nëntor 2005. Zgjerimi kryesor përfshiu Kepin e Stillos dhe Kodrat Korafi në jug, Gadishullin e Ksamilit (duke përfshirë edhe vetë qytetin e Ksamilit që po zhvillohej me ritme të shpejta) dhe një pjesë të Gjirit të Butrintit në perëndim, të gjithë Liqenin e Butrintit në veri dhe vargmalet e Majës së Milesë në lindje, që rrethojnë zonën ujëmbledhëse të Liqenit të Butrintit. Fshatrat e Fushës së Vrinës (Vrina, Shën Deli dhe Xarra) ishin dhe mbeten ende kufijtë e jashtëm të parkut. Më e rëndësishmja ishte se për herë të parë, parku përfshiu të gjithë vijën bregdetare, nga jugu i Sarandës në veri, deri në kufirin me Greqinë në jug-perëndim.



Gjithashtu, në vitin 2005, Zona A3 brenda zonimit të Parkut Kombëtar të Butrintit u cilësua si zonë me vlera të veçanta kulturore, me një sipërfaqe të përgjithshme prej më shumë se 472 ha.



2007

Në vitin 2007, në sesionin e 31-të të Komitetit të Trashëgimisë Kulturore, të mbajtur në Christchurch, Zelandë e Re, më 23 qershor-2 korrik, kufiri prej 8.591,2 ha i Parkut Kombëtar të Butrintit u shpall Zonë e Mbrojtur për Sitin e Trashëgimisë Botërore prej 2.500 ha.



2013

Në vitin 2013, kufijtë e Parkut Kombëtar të Butrintit u zgjeruan nga 8.591,2 ha në 9.424,2 ha, me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 134, datë 20 shkurt 2013, duke ndryshuar kështu Vendimin Nr. 693.

Më e rëndësishmja është se ky ndryshim zgjeroi kufijtë e Parkut Kombëtar në drejtim të detit, me afro 1,5 kilometra, duke përfshirë ishujt afër vijës bregdetare të Ksamilit, si dhe pjesën tjetër të vijës bregdetare në jug të Gjirit të Hartës, në kufi me Greqinë, duke e përafëruar më tepër me kufijtë e zonës Ramsar (Figura 7).



Zona Ramsar

Kompleksi ligatinor i Butrintit u shpall më 28 mars 2003 Zonë Ramsar (Siti Nr. 1290) që përbëhet nga laguna tektonike e Liqenit të Butrintit (1.600 hektarë) dhe kodrat e malet pyjore përreth, të përshkuara nga kënetat ujëmbledhëse dhe ujëkripura, me një sipërfaqe prej 13.500 ha. Megjithatë kufiri (me ngjyrë vjollcë) pasqyron Parkun Kombëtar në vijë bregdetare, ai zgjatet shumë kilometra në brendësi të tokës dhe përfshin edhe zona të banuara dhe peizazhet që shtrihen jashtë Parkut Kombëtar, veçanërisht në verilindje dhe jug-perëndim.



Gjithashtu, në vitin 2014, nënzona A3 u zgjeruar edhe me 614,3 hektarë, të cilat përfshinin edhe ishujt e Ksamilit.



Situata aktuale

Harta më poshtë tregon kufijtë aktualë të (a) Parkut Kombëtar (e gjelbër), (b) të gjithë Sitit të Trashëgimisë Botërore (me ngjyrë kafe) dhe (c) Zonën A3 (e gjelbër e vjësuar).



Ndryshimet

Harta e Butrintit e vitit **2007** (siç tregohet më poshtë) është pjesë e paketës së dokumenteve të vëna në dispozicion në webfaqen e UNESCO-s si pjesë e shpalljes Sit i Trashëgimisë Botërore.



Megjithatë, kjo hartë nuk përkon as me kufijtë e Parkut Kombëtar, të miratuara në vitin 2005, dhe as me kufijtë e Zonës A3, të përcaktuara po në vitin 2005.



2013 – Për shkak të ndryshimit të kufijve të Parkut Kombëtar të Butrintit në vitin 2013, kufijtë e STB-së nuk përkojnë plotësisht me kufijtë jugorë të Parkut Kombëtar.



2013 – Ndryshime identifikohen edhe në Zonën A3, të cilat paraqiten ndryshe nga Ministria e Kulturës dhe nga Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura.



-  Kufijtë e PKB-së 2013
-  Kufijtë e STB-së
-  Nënzonimi i A3 nga 2013-a
-  Rilevimi GIS i nënzonës A3 nga ministria e Kulturës në 2016-n
-  Nënzonimi A3, dokumentuar në hartat e Ministrisë së Kulturës

Rekomandime për kufijtë aktualë

Nënzonimi i Zonës A3

- Zona A3 duhet përcaktuar brenda nënzonimit të Parkut Kombëtar të Butrintit, duke i regjistruar kufijtë e tij sipas rilevimit me koordinata të gjeoreferencuara GIS, koordinuar nga Ministria e Kulturës në vitin 2016.
- Të gjitha hartat që përdorin Ministria e Kulturës dhe Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, dhe më konkretisht Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura, duhen harmonizuar në mënyrë që të përmbajnë të njëjtin informacion për Zonën A3.

Siti i Trashëgimisë Botërore

- Kufijtë e STB-së duhen përcaktuar qartësisht brenda kufijve të rinj të Parkut Kombëtar, të përcaktuara me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 134, datë 20 shkurt 2013, krahas Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 693, datë 10 nëntor 2005.
- Kufijtë e STB-së në pjesën jugore duhet të ndjekin vijëzimin e kufijve të rinj të Parkut Kombëtar, dhe kufijtë lindorë duhen korrigjuar në mënyrë që të harmonizohen me ato të Parkut Kombëtar.

- Për miratimin e korigjimit të kufijve duhet bërë kërkesë pranë Komitetit të Trashëgimisë Botërore.

Shpallja e Parkut Kombëtar të Butrintit/STB-së

- Kufiri aktual i Parkut Kombëtar të Butrintit, i përcaktuar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 134, datë 20 shkurt 2013, krahas Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 693, datë 10 nëntor 2005 mbetet ende për t'u miratuar si modifikim i kufirit të zonës së mbrojtur të STB-së dhe si rrjedhojë, në vijim të miratimit të këtij modifikimi nga Komiteti i Trashëgimisë Botërore, do të përditësohet harta e pasurisë së STB-së në dokumentat e shpalljes.

Ndryshimet e mundshme të kufirit në të ardhmen dhe rishikimi i përcaktimeve

1. Modifikimi i kufirit të Zonës së Mbrojtur të Pasurisë Botërore sipas kufirit të Parkut Kombëtar të Butrintit (bazuar në VKM Nr. 134, datë 20 shkurt 2013).

Në vitin 2007, kufijtë e Parkut Kombëtar u miratuan si kufinj të Zonës e Mbrojtur e Sitit të Trashëgimisë Botërore. Megjithatë, kufijtë e Parkut Kombëtar ndryshuan në vitin 2013, duke u zgjeruar nga 8591,2 ha në 9424,39 ha. Si rrjedhojë, modifikimi i kufirit të Zonës së Mbrojtur do të njihet përmes kërkesës zyrtare të shtetit shqiptar dhe miratimit zyrtar të Komitetit të Trashëgimisë Botërore.

2. Zgjerimi i kufijve të Sitit të Trashëgimisë Botërore për të përfshirë të gjithë sipërfaqen e Liqenit të Butrintit

Kufiri aktual i pasurisë së Trashëgimisë Botërore kalon mes për mes Liqenit të Butrintit duke përfshirë pjesë të liqenit në STB dhe duke lënë pjesën veriore të tij në Zonën e Mbrojtur. Zgjerimi i kufirit të Sitit të Trashëgimisë Botërore do të siguronte trajtimin e barabartë të të gjithë sipërfaqes së Liqenit të Butrintit dhe do të përfshinte një regjim më rigoroz mbrojtjeje.

3. Zgjerimi i kufirit të Zonës A3 për të përfshirë Kalanë e Ali Pashë Tepelenës

Kalaja e Ali Pashë Tepelenës, e cila ndodhet buzë Kanalit të Vivarit, është një komponent i rëndësishëm arkeologjik i Butrintit. Bazuar në nevojat për konservim që ka monumenti, janë parashikuar fonde në buxhetin e shpenzimeve kapitale për Zonën A3. Gjithashtu, kalaja përbën një pasuri domethënëse të historisë së Butrintit me një potencial të gjerë interpretimi dhe turistik. Rrjedhimisht, kufijtë e Zonës A3 duhet të zgjerohen për të përfshirë territorin e kësaj kalaje.

4. Rishikimi i statusit ndërkombëtar të mbrojtjes, përcaktimi i Butrintit në Listën e pasurive botërore si "pasuri mikse kulturore dhe natyrore"

Udhëzimet Operacionale i përkufizojnë pasuritë mikse si ato pasuri që plotësojnë një pjesë ose të gjithë kriteret e trashëgimisë kulturore dhe asaj natyrore, të parashtruar në Nenet 1 dhe 2 të Konventës.

Duke qenë se Butrinti është shpallur tashmë si pasuri kulturore për Vlerën e tij të Jashtëzakonshme Universale në kriterin III, mund të bëhet kërkesë që të përfshihet edhe komponenti natyror i tij.

Deklarata e Unikalitetit e Planit të Menaxhimit të Parkut Kombëtar të Butrintit (e vitit 2010), përcakton:

"Kombinimi i arkeologjisë dhe natyrës i jep Butrintit një pamje të vërtetë autentike. Kombinimi i pyjeve të përzierë, të mbushur me lisa përherëblertë, ofron një habitat në zhdukje në Shqipëri. Pikërisht ky fakt e bën këtë zonë njëkohësisht më të zakonshmen dhe më uniken në vend".

Në vijim të deklaratës, që në një farë mënyrë ishte baza e Vendimit të Këshillit të Ministrave për zgjerimin e kufijve të Parkut Kombëtar, u njohën disa vlera të rëndësishme që mund të kontribuojnë në përpilimin e deklaratës së Vlerës së Jashtëzakonshme Universale për pasurinë mikse, si më poshtë:

- Më 2003 kompleksi ligatinor, përfshirë dhe pjesën e lagunës dhe zonën bregdetare të Butrintit – Kepin e Stillos – u shpallën Zonë Ramsar sipas kritereve 1,2,3 dhe 8 të Konventës Ramsar për Ligatinat dhe Park Kombëtar (Kategoria II e IUCN-it për Kategorinë e Menaxhimit të Zonave të Mbrojtura).
- Parku Kombëtar i Butrintit është i njohur për shumëllojshmërinë e habitateve të tij, ku gjashtëdhjetë e gjashtë konsiderohen si Habitata Evropiane, nga të cilat pesë konsiderohen si Habitata Evropiane Prioritare.
- Rreth 140 specie bimë dhe shtazore janë vlerësuar me rëndësi për t'u mbrojtur; nga të cilat 35 specie shtazore janë vlerësuar me rëndësi mbrojtjeje në nivel botëror.
- Ligatinat e Butrintit përfaqësojnë habitata me një humbje të madhe të biodiversitetit: 16 specie kanë humbur, ndërsa 58 specie konsiderohen si të rralla dhe shumë të rralla.
- Butrinti është habitati edhe i specieve që kërcënohen në nivel global, si rosa kokëbardhë (*Oxyura leucocephala*), rosa pikaloshë (*Marmaroneta angustirostris*), shqiponja bishtbardhë (*Haliaeetus albicilla*), shqiponja mbretërore (*Aquila heliaca*), shqiponja e madhe e rosave (*Aquila clanga*) dhe pula me mjekër (*Otis tarda*).
- Butrinti njihet si një habitat ushqimi për dy nga speciet më të kërcënuara në botë: shqiponjën bishtbardhë (*Haliaeetus albicilla*) dhe shapkën (*Gallinago media*).
- 13 specie shpendësh, që gjenden në Butrint, konsiderohen sipas librit të kuq të IUCN-së si të kërcënuara në nivel global.
- 95 e specieve në Butrint (duke përfshirë 38% të specieve të shpendëve të vëzhguara) konsiderohen si të kërcënuara në Evropë. Me këto shifra kaq të larta, Butrinti është padyshim një prej zonave që paraqet interes të madh për ruajtjen e natyrës në të gjithë Evropën.

Duke u nisur vetëm nga këto fakte, mund të shihet qartë edhe arsyeja e fortë për plotësimin e statusit pasuri botërore të Butrintit duke përfshirë dhe komponentin natyror në përcaktim, pasi këto vlera mbështeten në tre kriteret bazë të përkufizimit të trashëgimisë kulturore sipas nenit 2 të Konventës së Trashëgimisë Botërore.

1. Tipare natyrore që përbëhen nga formacione fizike dhe biologjike ose grupe të këtyre formacioneve, të cilat janë me vlerë të jashtëzakonshme universale nga pikëpamja estetike ose shkencore;
2. Formacione gjeologjike dhe fiziko-grafike dhe zona të përcaktuara me saktësi, të cilat përbëjnë habitatin e specieve të kërcënuara të kafshëve dhe bimëve, me Vlerë të Jashtëzakonshme Universale nga pikëpamja e shkencës ose konservimit
3. site natyrore ose zona natyrore të përcaktuara saktë me vlerë të jashtëzakonshme universale nga pikëpamja e shkencës, konservimit ose bukurisë natyrore.

Propozimi paraqitet në faqen tjetër.



— Zona buferike për Siti e Trashëgimisë Botërore (Parku Kombëtar, 9424.39 ha)

— Siti i Trashëgimisë Botërore përfshirë Liqenin e Butrintit

● Butrinti i listuar në kategorinë e siteve të përziera kulturore dhe natyrore

Shtojca C Konservimi i Qytetit Antik

Qasja e rekomanduar për konservimin e Qytetit Antik është ajo e ruajtjes e sa më shumë informacioneve, në formë fizike të gërmuar më parë, që ti transmetohet brezave të ardhshëm duke ruajtur "identitetin e vendit" si një monument i veçantë.

Për këtë qëllim, udhëzime janë marrë nga konsulentët e grupit të punës, veçanërisht nga Richard Hodges dhe Oliver Gilkes, të cilët kanë një eksperiencë të madhe në gërmimet dhe punimet brenda dhe përreth Butrintit në më shumë se tridhjetë vitet e fundit, si dhe nga profesionistë të trashëgimisë duke përfshirë arkitekten konservatore Lejla Hadzic.

Qasja e rekomanduar për të gjitha punimet (nga konservimet tek ndërtimet e reja) ka të bëjë me përdorimin e ndërhyrjeve sa më të lehta në struktura. Nëse do të veprohej ndryshe, nuk do të kërcënohej vetëm puna e deritanishme e Fondacionit Butrinti (dhe organizatave të tjera) por do të ishte një akt i pajustificueshëm ndaj strukturës dhe mirëqenies së një prej zonave më të rëndësishme kulturore dhe të ndjeshme ekologjike në të gjithë Shqipërinë.

Ka një numër të shumë shembujsh "restaurimesh" që kanë pasur qëllim të mirë por që kanë qenë krejtësisht të papërshtatshme brenda dhe përreth siteve antike të Mesdheut lindor. Kjo nuk është rruga që duhet të ndjekur në Butrint.

Debate lindin, dhe kanë lindur, në lidhje me përkufizimin e "restaurimit" dhe "konservimit" në Shqipëri dhe gjetkë. Një debat i tillë është thelbësor për të ardhmen e Qytetit Antik, dhe jo vetëm.

Dallimi kryesor është se ndërsa konservimi (për qasja e rekomanduar) mbron strukturën e qytetit në një mënyrë të tillë e cila i mundëson brezave të ardhshëm të marrin të dhëna për çdo fazë të zhvillimit të qytetit, restaurimi e fikson monumentin në një kohë të caktuar, në një të shkuar të supozuar dhe si rrjedhojë e bën atë shterp për kërkime dhe për t'u kuptuar në të ardhmen.

Është e nevojshme që Butrinti të veçohet nga këto raste.

Nëse ky sit aspiron të jetë një shembull për pjesën tjetër të Shqipërisë, Ballkanit në përgjithësi dhe Mesdheut lindor, ai duhet të përpiqet dhe të ruajë integritetin e vendit, t'u flasë brezave të rinj, të angazhojë komunitetet vendore, të ruajë atë përzjerje midis qytetit antik dhe peizazhit modern në mënyra të tilla që na pasurojnë ne të gjithëve.

Kjo Shtojcë përbëhet nga tetë pjesë kryesore:

Pjesa 1 – Hyrje

Pjesa 2 – Planifikimi dhe prioritizimi

Pjesa 3 – Monumente pa mure rrethuese

Pjesa 4 - Muret rrethuese






Pjesa 5 – Sitet/monumentet jashtë mureve

Pjesa 6 – Mozaikët

Pjesa 7 – Sipërfaqet e Pikturuara dhe suvatuara

Pjesa 8 – Kostot e Buxhetit

Planifikimi është bërë për pesë kategori:

	Kategoria 1	E qëndrueshme
	Kategoria 2	E qëndrueshme, në nevojë për punë të vogla
	Kategoria 3	E qëndrueshme, në nevojë për punë të mëdha
	Kategoria 4	E pa qëndrueshme, në nevojë për punë të mëdha
	Kategoria 5	E panjohur, mbuluar nga vegjetacioni

Përkufizimi i kushteve:

Metodologjia e përshtatur nga rekomandimet e Rene Rice 2009

-Condition Survey – Butrint

www.butrintconditionsurvey.com

Pas identifikimit numerik të kategorive, ato u ndanë më pas në kategori nga A-ja te D-ja sipas emergjencës ku kategoria “A” ishte më urgjentja.

Punimet e paraqitura në këtë Shtojcë janë referuar raporteve të Erjona Qilla dhe Evgjani Thomagjini (pjesë të stafit të ZAKP Butrint), të hartuara përkatësisht në vitet 2015 dhe 2017; u bë krahasimi midis raporteve, që u përcaktuan nga Fondacioni Butrinti në vitin 2009 si pikënisja, duke përfshirë vizitat në terren dhe vëzhgimet, si dhe punimet dhe raportet e publikuara. Ky tekst iu referohet këtyre materialeve.

Qasja e Fondacionit Butrinti¹ për mirëmbajtjen dhe ruajtjen afatgjatë të sitit ka ne thelb të saj ruajtjen “e frymës së vendit” si një prioritet i padiskutueshëm.

Kjo qasje përshkruhet me detaje në librin e Richard Hodges *“The Archaeology of Mediterranean Placemaking: Butrint and the Global Heritage Industry.”*² Si pjesë e ekipit aktual të konsulentëve (dhe formalisht, ndër të tjera, si Drejtor Shkencor i Fondacionit Butrinti ndërmjet viteve 1993 dhe 2012), idetë e tij kanë qenë vendimtare në qasjen tonë ndaj zhvillimit të qytetit dhe si rrjedhojë në Planin e Biznesit dhe Planin përkatës të Menaxhimit të Integruar.

Të gjitha rekomandimet në këtë dokument vlerësojnë se planifikimi ose kryerja e ndërhyrjeve të tjera nuk është e mundur pa pasur më parë të përgatitura propozime për konservimin, si dhe përshkrime të plota teknike të cilat normalisht do të prezantoheshin përmes një plani formal konservim dhe menaxhimi. Një plan i tillë është pjesë e Planit të Menaxhimit të Integruar i paraqitur si Plan Veprimi.

Mozaikët nuk janë studiuar në detaje në këtë raport, duke qenë se gjendja e shumicës prej tyre nuk është e njohur. Rekomandimi kryesor lidhur me to është që mozaikët të hapen gradualisht dhe të dokumentohen me kalimin e kohës. Por, kjo punë me shumë gjasë do të kërkojë disa vjet.

¹ Fondacioni Butrinti u themelua në vitin 1993 nga Lord Rothschild dhe Lord Sainsbury i Preston Candover, të cilët janë ende anëtarë aktivë të bordit të trustit. Fondacioni ka për qëllim konservimin, ruajtjen dhe zhvillimin e sitit të Butrintit dhe ka qenë jashtë mase instrumental në ruajtjen e tij, si dhe në nxitjen e punës kërkimore në Butrint që prej rënies së komunizmit në Shqipëri në vitin 1992.

² Hodges, R (2017) *The Archaeology of Mediterranean Placemaking*. Bloomsbury Academic, London.

Shënim për çmimet

Çmimet dhe kostot për të gjitha vëllimet e punimeve bazohen në *Manualin e Shtetit për Restaurimet*.

Çmimi i çdo njësie përfshin punën, taksat, dhe të gjitha kostot e tjera të lidhura me to. Megjithatë, duke qenë se nuk janë zhvilluar projekte të detajuara konservimi për secilin nga monumentet/muret/mozaikët/afresket, është rritur paksa çmimi për njësi, në mënyrë që të mundësohet përfshirja e ndërhyrjeve shtesë pasi të jenë zhvilluar propozime të plota konservimi për çdo monument/mur/mozaik/afresk.

Përveç kësaj, buxheti i detajuar bazohet mbi konsiderata realiste dhe të detajuara për zonën, vëllimet dhe ndërhyrjet, dhe jep rezultate të parashikuara që nuk përbëjnë shqetësim për punimet si konservuese ashtu edhe mirëmbajtëse.

Për rrjedhojë, grupi i punës ka shumë besim te ndërhyrjet e propozuara dhe buxhetet e tyre përkatëse.

Planifikimi dhe Prioritetet


Ndarja në prioritete/MONUMENTE DHE MURE				
EMRI	KATEGORIA	PRIORITETI	ORARI	
MONUMENTE				
Porta e Ligerit	katëgoria 4	A	E MENËHERSHME	
Columbarium	katëgoria 4	A		
Porta e Veriut	katëgoria 4	A		
Forumi Romak	katëgoria 4	A		
Porta Perëndimore	katëgoria 4	A		
Struktura e Gjymnaziumit	katëgoria 4	A		
Nisfeu	katëgoria 4	A		
Mure/Mozaikë				
Muri 10 Muri Rethues i Akropolit	katëgoria 4	A		
Muri 12 Nga Porta e Ligerit tek Akropoli	katëgoria 4	A		
TË QENDRUESHME KANË NEVOJË PËR PUNIME MADHORE				
Monumenta				
Porta e Luasit	katëgoria 3	B	E NDËRMJETME	
Strukturë Romake me dy Othona	katëgoria 3	B		
Kulla Veneciane	katëgoria 3	B		
Pallati i Trikonës (Eudja, qendër dhe perëndim)	katëgoria 3	B		
Stratëja Veneciane	katëgoria 3	B		
Pagëzimet dhe ndërtimet përreth	katëgoria 3	B		
Nisfeu 2	katëgoria 3	B		
Gjymnazium	katëgoria 3	B		
Prytaneum	katëgoria 3	B		
Afresko e kishës me stoa	katëgoria 3	B		
Sosja të Pagëzimeve	katëgoria 3	B		
Ndërtesa me Tre Othona	katëgoria 3	B		
Teatri	katëgoria 3	B		
Fabrika/Thesori	katëgoria 3	B		
Varr Monumental	katëgoria 3	B		
Mure/Mozaikë				
Muri 3 Nga Trikonka të Sosera Tregtare Veneciane	katëgoria 3	B		
Muri 4 Nga Banesa Tregtare Veneciane të Porta e Ligerit	katëgoria 3	B		
Muri 6 Nga Porta e Ligerit të Porta e Luasit	katëgoria 3	B		
Muri 7 Nga Porta e Luasit të Porta e Veriut	katëgoria 3	B		
Muri 9 Nga Porta e Veriut të Porta Perëndimore	katëgoria 3	B		
Muri 14 Porta Perëndimore të Fortifikimit Perëndimor	katëgoria 3	B		
Jedër Muri				
Kalaja e Ali Pashait	katëgoria 3	B		
Fortesa Triklëndore	katëgoria 3	B		
Kembët e Luksjellëkut	katëgoria 3	B		
Kalivo	katëgoria 3	B		

TË QËNDRUESHME KANË NEVOJË PËR PUNIME TË VOGLA		
MONUMENTE		
Kishë e vogël te Pagëzitorja	katëgoria 2	C
Barja te Pagëzitorja	katëgoria 2	C
Porta e Lijit	katëgoria 2	C
Gërbët e Ujës/jellëut	katëgoria 2	C
Porta me kulla	katëgoria 2	C
Pusi i Junia Rufinës	katëgoria 2	C
Tezori	katëgoria 2	C
Foltorja/Thesari	katëgoria 2	C
Barje Romake	katëgoria 2	C
Kafneu i vogël	katëgoria 2	C
Mura/Mozaike		
Muri 2 Muri i Trikonikës	katëgoria 2	C
Muri 5 Nga Porta e Lijit deri te Porta e Lijerit	katëgoria 2	C
Muri 8 Degëdora Veriperëndimor	katëgoria 2	C
Muri 11 Foruliceret Perëndimore	katëgoria 2	C
Muri 13 Muri i Postnëm Helenik	katëgoria 2	C
Jashtë Murit		
Diaporiti	katëgoria 2	C
TË QËNDRUESHME DHE TË NIPËRMBAJTSHME - NIPËRMBAJTJE		
Monumente		
Bazilika e Akropolit	katëgoria 1	D
Bazilika e Madhe	katëgoria 1	D
Ndërtesë Helenistike	katëgoria 1	D
Kishë e vogël në verilindje	katëgoria 1	D
Bazilika e Akropolit	katëgoria 1	D
Pusi/Çunimi i shenjtë	katëgoria 1	D
Stoa	katëgoria 1	D
Peristili	katëgoria 1	D
Tempulli i Asklepit	katëgoria 1	D
Mura/Mozaike		
Muri 1 Kulla Veneciane te Titrikonika	katëgoria 1	D
Jashtë Murit		
Vari me djegie	katëgoria 1	D

RSHTATJA DHE MONITORIMI
PËR TË NDËRMBAJTSHME NË FAZAT
E MËNDRËSHME DHE
TË NDËRMBAJTSHME

TË QËNDRUESHME KANË NEVOJË PËR PUNIME MADHORE		
Afresko/ Sipërfaqet e pikturuara		
Gymnasium	katëgoria 3	B
Nimfeu 2	katëgoria 3	B
Kishë e vogël te Pagëzitorja	katëgoria 3	B
Nimfeu 1	katëgoria 3	B
Afresko e kishes me stoa	katëgoria 3	B
Pritaneum	katëgoria 3	B
Nimfeu	katëgoria 3	B
Thesari	katëgoria 3	B
Tempulli i Asklepit	katëgoria 3	B
Porta Perëndimore	katëgoria 3	B
Pusi i Junia Rufinës	katëgoria 3	B
Kisha të vogla	katëgoria 3	B
Pagëzimore	katëgoria 3	B
Kolona te Forumi Romak	katëgoria 3	B
Ndërtesa me Tre Dhoma	katëgoria 3	B
Bazilika e Madhe	katëgoria 3	B

Monumentet brenda qytetit antik



Banjat- periudha e sugjeruar: shek. V para Kr.

Pozicioni

Planimetria

Fotografia 2018



Përshkrim i shkurtër: Një numër banjash publike dhe dhomash të tjera rrethojnë dhomën qendrore tetëkëndore. Mure me reshta tulle që përshkohen me raste nga gurë gëlqerorë, veçanërisht në pjesën e jashtme. Muret në përgjithësi janë afërsisht deri në 1 m mbi nivelin e ujit/bazë, i cili është mbi nivelin e dyshemesë fillestare. Pjesa më e lartë e murit në këndin juglindor të dhomës qendrore është afërsisht 1.8m mbi llum. Disa mbetje të mozaikut të dyshemesë në vendkalimin e portikut në lindje, hipokausti në jug, dhe rrënojat e pragjeve prej mermeri dhe veshjet e mureve në bazamentin e banjës me ujë të ftohtë në pjesën perëndimore.

Në pjesën lindore, dhe në lindje të dyshemesë me mozaikë të portikut hyrës, është një mur mesjetar i ndërtuar mbi rrënojat e murit të portikut. Ka dy hapje dhe një bashkim të drejtpërdrejtë. Shërben për të ruajtur këtu bankinën, por lidhja e tij me banjën, dhe më saktë me murin e qytetit, është e paqartë dhe ka nevojë për inspektime të mëtejshme arkeologjike (Nga Vrojtimi / Gjendjes i vitit 2001)

Ndërhyrjet e konservimit: Në vitin 2007 është hequr bimësia që rritej në monument, pemët që rriteshin në afërsi dhe është krasitur zona përreth monumentit; Pas rekomandimeve për konservim nga viti 2009, në vitin 2015 monumenti është konservuar dhe mbushur për të parandaluar ekspozimin e mëtejshëm ndaj nivelit në rritje të ujit për pjesët më të ulëta të murit prej tulle.

Gjendja aktuale:

Rimbushja nuk e ka zgjidhur plotësisht problemin e nivelit në rritje të ujit. Si rrjedhojë e pjesëve të poshtme të murit të zhytur në ujë, lagështia shihet përmes likeneve dhe myshqeve që rriten në sipërfaqen e strukturave të murit. Llaçi lidhës është zbutur në disa pjesë dhe është duke degraduar.

Rekomandime/Veprime:

- Pastrimi sistematik i bimësisë së ulët nga strukturat e murit
- Pastrimi i likeneve dhe myshqeve; duke vijuar me konservimin e lidhjeve dhe pjesëve të sipërme
- Konsolidim i pjesshëm i ndërtimit
- Pastrim i bimësisë në një distancë prej 4 metrash nga strukturat e jashtme; dhe e gjithë zona rrethuese dhe e brendshme duhet të krasitet të paktën dy herë në vit.

Kategoria 1 – e qëndrueshme dhe e mirëmbajtëshme

Kulla Veneciane - periudha e sugjeruar: shek. XVI		
Pozicioni	Planimetria	Fotografia 2018
		
<p>Përshkrim i shkurtër: Kulla, së bashku me fortesën trekëndore në pjesën jugore të Kanalit të Vivarit është ndërtuar për të kontrolluar rezervuarët e peshkut si dhe aksesin në Liqenin e Butrintit. Kulla ka dy porta për topa të ndërtuara brenda mureve në të dyja anët (jug dhe perëndim) të cilat dominojnë kanalin, si dhe frëngji pushkësh në të gjitha anët. Hyrja për në kullë është në anën lindore, dhe kontrollohej nga një urë lëvizëse e vogël. Mbi hyrjen kryesore mund të shihet ende dritarja e sistemit të tërheqjes së urës lëvizëse (Neritan Ceka, po aty f. 34).</p> <p>Brenda kullës një tavan me qemer mbështet katin e sipërm; këtu hyhej përmes një shkallareje spirale prej druri. Frëngji të ngushtë të veshur me tulla për pushkë janë të pranishëm në të katër anët e kullës. Frëngji më të mëdhenj për topa ka në çdo kat në murin jugor që dominon Kanalin e Vivarit. Një tjetër pjesë e hapur në pjesën lindore përdorej për të lejuar zinxhirët e urës lëvizëse të cilët kalonin përmes një të çare në katin e sipërm drejt një mekanizmi rrotullues. Një derë me shul mundësonte një tjetër shtresë sigurie prapa urës së ngritur lëvizëse.</p> <p>Mendohet se kulla daton nga shek. i XVI kur Venecianët u kthyen në Butrint pas rrethimit të Korfuzit nga Sulejmani në vitin 1537. Edhe pse kjo nuk mund të verifikohet tani, duke mjaft e qartë se kulla ishte krijuar për të funksionuar në sinkron me fortesën Trekëndore në bregun përballë për mbrojtjen e pendave të çmueshme të peshkimit. (Andrew Crowson: <i>Venetian Butrint</i> f. 57-9)</p> <p>Ndërhyrjet e konservimit: U restaurua në vitet 1930 dhe e pajis me çati të re në vitin 1999 kur u ndërmorën edhe punimet e brendshme: ndërtimi i një sipërfaqeje të re dyshemeje druri për të mbuluar dyshemenë e dikurshme prej gëlqereje në katin e parë, ndërtimi i një vatre dhe një oxhaku në katin e sipërm dhe ndërtimi i një shkallareje midis kateve të poshtme dhe të sipërme. Kati i poshtëm u pajis me trarë të rinj për dyshemenë. Kulla u restaurua sërish në vitin 2015 për t'u përshtatur në Zyrën e Koordinimit dhe Administrimit. Restaurimi i fundit përfshinte riparim të çatisë, trajtim të strukturave të dyshemesë në të dyja katet; ndryshim të kanateve të dritareve dhe deryve; instalime elektrike; ndryshimin e urës lëvizëse dhe pastrimin e bimësisë përreth.</p> <p>Gjendja aktuale: Kulla ka një gjendje relativisht të qëndrueshme. Megjithatë, nuk u kryen riparimet e tullave në muraturë të rekomanduara në analizën e vitit 2008; gjatë restaurimit të fundit janë përdorur materiale jo të përshtatshme, si për shembull: arkitra me betonarme nën qemer; llaç çimentoje në mure, arkitra çimentoje mbi pjesët e hapura; shikimë izoluese që përdoret për të fiksuar kanatet prej druri; pjesa e brendshme është me lagështi dhe e papërdorshme. Pjesët e poshtme të ndërtimit janë të mbuluara me myshk dhe lëken.</p> <p>Rekomandimet/Vepimet:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Propozime të reja për konservimin e përshtatshëm të të gjithë ndërtesës duke përfshirë punimet me tulla - Pastrimi i myshkut dhe lëkenit; duke vijuar me konservimin e materialeve lidhëse - Plan interpretimi për përshtatjen e pjesës së brendshme për vizitat e turistëve 		
<p>Kategoria 3 – e qëndrueshme, ka nevojë për punime madhore</p>		

Pallati i Trikonkës- periudha e sugjeruar: shek. IV- dhe më vonë/ka të integruar rrënoja më të hershme




Fotografia 2018



Përshkrim i shkurtër: Faza e parë e pallatit daton në fund të shek. IV pas Krishtit. Rrënojat e kësaj faze mund të shihen pranë Kanalit. Pallati i Trikonkës u ndërtua në fund të shek. V. U ndërtua mbi zonën e kopshtit të pallatit më të hershëm dhe mbi të paktën katër ndërtesa më të hershme, pjesë së të cilave u inkorporuan në të. Pallati i Trikonkës është shtrihet përgjatë një oborrit të madh. Në lindje të oborrit është një dhomë ngrënie në formën e bimës së tërfillit (*triklinium*), me pjesët mbështetëse të një divani ende të dukshëm në absidën qendrore. Në jug është një dhomë pritjeje e cila shikon mbi Kanalin e Vivarit (mundësisht me një port privat).

Në fillim të shekullit VI hyrja e drejtpërdrejtë nga pallati i Trikonkës për në Kanalin e Vivarit ishte bllokuar nga muri rrethues i ri i qytetit (muri 3) dhe dhomat përdoreshin për aktivitet të vogël industrial. Nga mesi i shek. VIII ndërtesat ishin braktisur. (*Neritan Ceka po aty f.44/45*)

Pallati i Trikonkës në Perëndim- periudha e sugjeruar: shek. IV – dhe më vonë/ka të integruar rreñoja më të hershme

Pozicioni	Planimetria	Fotografia 2018
		

Përshkrim i shkurtër: Pjesa perëndimore e zonës së Trikonkës nuk është pjesë e pallatit të Trikonkës dhe përbëhet nga një seri muresh të ulëta dhe hapësirash të rrethuara nga kanali - muri rrethues (muri 2). Një pus është i dukshëm në qendër të një prej hapësirave të mbyllura. Kjo mund të ketë qenë zona e shtëpisë së ndonjë tregtari në mesjetë.

Ndërhyrjet e konservimit: Nuk është konservuar asnjë nga muret e pallatit; përveç konservimit të ndërmarrë në vitin 208 në muret fortifikuese dhe konservimit të mozaikëve.

Gjendja aktuale: Sipas vërtimit të gjendjes vihet re se mund të ndërhyhet shumë pak në muret që kanë mbetur, duke qenë se i gjithë pallati i Trikonkës rrezikohet nga përmytjet stinore. Ndërsa muret e mbetur janë ndërtuar krejtësisht me blloqe guri gëlqeror të latuara ashpër me përdorimin e harëpasbershëm të fragmenteve të tullave dhe tjegullave. Disa mure janë veshur me ilaç gëlqereje, disa janë konstruksione më të ashpra dheu. Në veçanti, muret me konstruksione dheu nuk mund të mbrohen ndaj ndikimit të ujit, që ka shkakuar lëvizjen e disa pjesëve të murit (pjerrësi e dukshme). Uaçi është dobësuar, ndërsa pjesë gurësh dhe tullash bien nga struktura.

Rekomandimet/Veprimet:

Rekomandimet e vitit 2009 të cilat nuk u përmbushën janë ende të vlefshme:

- Përdorimi i dheut nga jashtë rrethit të Kanalit për të mbushur këtë zonë deri në 10 cm mbi nivelin e lartë të ujit. Marrja e dheut jashtë murit rrethues të Kanalit pritet që të ketë efekt të dyfishtë: theksimi i ndikimit pamor të murit dhe përmirësimi i aksesit nga ana e kanalit të murit për mirëmbajtje në të ardhmen. Në rimbushjen me dhe mund të krijohet një "shtresë e gjelbër" bimësh që mund të mirëmbahet lehtësisht.
- Konsolidim i mureve që mbeten mbi nivelin e rimbushjes (veshjet dhe lidhjet e mureve)
- Ndryshimi i vendit të urës së lëvizshme për vizitorët, pasi është krejtësisht e kalbur
- Monitorim i rregullt i mozaikëve

Kategoria 3 – e qëndrueshme, ka nevojë për punime madhore

Pallati i Trikonkës Qendër – shek. IV – dhe më vonë/ka të integruar rrënoja më të hershme




Pozicioni	Planimetria	Fotografia 2018
		
<p>Përshkrim i shkurtër: I njëjtë si dhe pallati i Trikonkës</p> <p>Ndërhyrjet e konservimit: Nuk është konservuar asnjë nga muret e pallatit; përveç konservimit të ndërmarrë në vitin 2008 në muret fortifikuese, dhe konservimit të mozaikëve.</p> <p>Gjendja aktuale: Sipas vërtimit të gjendjes vihet re se mund të ndërhyhet shumë pak në muret që kanë mbetur, duke qenë se i gjithë pallati i Trikonkës rrezikohet nga përmytjet stinore. Ndërsa muret e mbetur janë ndërtuar krejtësisht me blloqe guri gëlqeror të latuara ashpër me përdorimin e herëpashershëm të fragmenteve të tullave dhe tjegullave. Disa mure janë veshur me llaç gëlqereje, disa janë konstruksione më të ashpra dheu. Në veçanti, muret me konstruksione dheu nuk mund të mbrohen ndaj ndikimit të ujit, që ka shkaktuar lëvizjen e disa pjesëve të murit (pjerrësi e dukshme). Llaçi është dobësuar, ndërsa pjesë gurësh dhe tullash bien nga struktura.</p> <p>Rekomandimet/Vepimet:</p> <ul style="list-style-type: none">- Konsolidim i mureve rrënojë mbi nivelin e mbushjes (veshjet dhe lidhjet e mureve)- Monitorim i rregullt i mozaikëve		
<p>Kategoria 1 – e qëndrueshme dhe e mirëmbajtshme</p>		

Pallati i Trikonkës Lindje - periudha e sugjeruar: shek. IV:- dhe më vonë/ka të integruar rrethoja më të hershme




Pozicioni	Planimetria	Fotografia 2018
		
<p>Përshkrim i shkurtër: Pallati i Trikonkës u ndërtua në pjesën e fundit të shek. V. U ndërtua mbi pjesën e kopshtit të pallatit të dikurshëm dhe mbi të paktën katër ndërtesa të dikurshme, pjesë të së cilave u integruan në të. Pallati i Trikonkës shtrihet përgjatë një oborrit të madh. Në lindje të oborrit është një dhomë ngrënie (<i>triklinium</i>), me pjesët mbështetëse të një divani ende të dukshme në absidën qendrore. Në jug është një dhomë pritjeje e cila vështron mbi Kanalin e Vivarit (me shumë gjasë një port privat).</p> <p>Në fillim të shekullit VI aksesi i drejtpërdrejtë nga pallati i Trikonkës për në Kanalin Vivari ishte bllokuar nga muri i ri rrethues i qytetit (muri 3) dhe dhomat përdoreshin për aktivitete të vogla industriale. Në mesin e shekullit VII ndërtesa ishte braktisur. <i>(Neritan Ceka po aty f. 44/45)</i></p> <p>Ndërhyrjet e konservimit: Mozaikët e Pallatit të Trikonkës janë konservuar në vitin 2003 dhe 2010/2011. Pas analizës së gjendjes së konservimit dhe dokumentimit të pjesshëm, sipërfaqet u rimbushën.</p> <p>Gjendja aktuale: Struktura murale e gurit është e lirë dhe ka nevojë për konservim. Tullat në mur janë deri diku të qëndrueshme. Bimësia është mirëmbajtur.</p> <p>Rekomandimet/Veprimet:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Konsolidim i mureve që janë mbi nivelet e rimbushjes (veshjet dhe lidhjet e mureve) - Monitorim i rregullt i mozaikëve <p>Kategoria 2 – e qëndrueshme, ka nevojë për punime të vogla</p>		

Banesa Veneciane - periudha e sugjeruar: shek. XVI		
Pozicioni	Planimetria	Fotografia 2018
 <p>4. Venetian House</p>		
<p>Përshkrim i shkurtër: Një strukturë e madhe me qemer ngjitur me murin e qytetit. Ugolini mendonte se kjo ndërtesë ishte një kishë, por tani ajo interpretohet si një banesë Veneciane (megjithëse funksioni i saj i saktë nuk kuptohet mirë). Një dhomë e nëndheshme me qemer në formë kryqi mund të aksesohet nga jugu përmes një dhome me qemer (nga e cila ka mbetur vetëm një pjesë e vogël). Sipër këtyre dhomave të nëndheshme gjenden gjurmët e një kati të sipërm i cili do të duhet të ketë formuar pjesën kryesore të mjedisve të punës ose jetesës. Në pjesën lindore të shtëpisë ndodhet një kullë, nga e cila ka mbetur vetëm një pjesë, e cila mund të aksesohet si nga kati përdhës dhe i pari. (Neritan Ceka po qyt. f. 48)</p> <p>Ndërhyrjet e konservimit: Konservimi i kryer në vitin 2000 dhe më herët tregon përdorimin e materialeve të papërshtatshme. Në vitin 2007 është kryer konservim dhe konsolidim i plotë gjatë një projekti trajnimi të një shkolle verore. Në vitin 2008 janë kryer punime konservimi më të rëndësishme: u hoq bimësia, u restauruan lidhjet, ndërsa në qemerin kryesor u ndërtua pjesa e sipërme e mureve. Në vitin 2009 u mbyll e çara në mur, e cila ishte krijuar deri në vitet 2000 për të lejuar vizitorët që të ndiqnin shtegun bregdetar, pasi kërcënonte qëndrueshmërinë e mureve.</p> <p>Gjendja aktuale: Meqenëse ndodhet pranë ujit, monumenti është në një gjendje konstante lagështie. Sipërfaqet e brendshme të suvatuara ishin në gjendje të dëmtuar nga uji që penetronte përmes qemerit të zbuluar. Si pasojë e mungesës së mirëmbajtjes, sipërfaqet e suvasë janë dëmtuar dhe lejojnë edhe më shumë penetrimin e ujit; dës nga pjesët e strukturës së sipërme të murit janë të lira dhe gurët kanë rënë nga pozicioni i tyre fillestar.</p>		

<p>Kategoria 2- e qëndrueshme, ka nevojë për punime të vogla</p> <ul style="list-style-type: none"> - muratues; - Pastrim i likeneve dhe myshqeve; pasuar nga konservimi i strukturave lidhëse - Bimësia ka nevojë të mirëmbahet dhe të mbahet minimalisht 4 m larg nga struktura - Sistemimi i gurëve përreth monumentit
<p>Kategoria 3 – i qëndrueshëm, ka nevojë për punime</p>

Ndërtesa Industriale (mulliri) – periudha e sugjeruar: shek. XV-XVI		
Pozicioni	Planimetria	Fotografia 2018
		
<p>Përshkrim i shkurtër: Kjo ndërtesë ka qenë e njohur si ndërtesa "Bizantine" ose "Industriale". "Shumë e prishur nga uji", sipas Andrew Crowson: "ajo duket të ketë pasur një funksion industrial, dhe mund të ketë funksionuar si një mullir" (<i>Butrinti Veneçian f. 51</i>). Rrënojat në jug të pagëzimitores mendohet se datojnë nga periudha Bizantine, dhe shtrihen mbi një ndërtesë Romake (me gjasë një tjetër pjesë e kompleksit të banjës që ndodhet nën pagëzimore). Funksioni i kësaj ndërtesë nuk dihet." (<i>Neritan Ceka po aty f. 48</i>). Edhe pse një ndërtesë që daton prej dy fazash të mëdha, përdorimet gjatë këtyre dy fazave mbeten të paqarta. Muret e hershme janë prej guri dhe tulla të papunuar. Gurët variojnë nga të vegjël në blloqe të mëdhenj katrori dhe janë afërsisht 0.5 m larg nga njëri tjetri në këndin verilindor. Elemente të dukshme janë vrmat e ulëta katrore të skelave në anët verilindore dhe lindore, kornizat dekorative të çdo guri me tulla në pjesën e lartë që ka ngelur të murit (1.2 m e lartë) në këndin veri lindor, dhe rrënojat e dyshemesë me hipokaust në dhomën veriperëndimore. Ndërtesa e mëvonshme, në përgjithësi, ka muret më të holla në nivel më të lartë në anët veriore dhe perëndimore. Ato janë rrënoja muri guri të cilat herë pas here kanë mbushje me tulla si dhe punime me tulla në rrënojat e ditares në anën veriore." (<i>nga Analiza e Gjendjes e vitit 2001</i>)</p> <p>Ndërhyrjet e konservimit: Nuk ka të dhëna për konservimin.</p> <p>Gjendja aktuale: Muret duken të qëndrueshme, megjithëse pjesa e brendshme e muraturës është e ekspozuar ndaj kushteve atmosferike dhe lagështia gjithnjë e pranishme mundëson kushtet për krijimin e myshkut në të gjitha strukturat e murit.</p> <p>Rekomandimet/Vepimet:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Konsolidime të vogla; mbushje të të çarave; pastrimi i likeneve dhe myshkut duke vijuar me konservimin e strukturave lidhëse; meremetimin e gurëve të lirë ose të rrëzuar - Bimësia ka nevojë të mirëmbahet dhe të ruhet minimalisht 4 m larg strukturës - Sistemimi i gurëve përreth monumentit 		

Pagëzimet dhe ndërtesat përreth- periudha e sugjeruar për pagëzimet: shek. VI

Pozicioni	Planimetria	Foto 2018
		

Përshkrim i shkurtër: Pagëzimet në Butrint është ndoshta më e madhja në lindje të Adriatikut (me përjashtim të Shën Sofisë në Kostandinopojë). U ndërtua në gjysmën e dytë të shek. VI, në vendin e dikurshëm të banjave publike Romake (të cilat mund të kenë qenë përdorur edhe për pagëzime), duke integruar një pjesë të strukturës më të hershme për të krijuar pjesën e jashtme katrore brenda së cilës u ndërtua pjesa e brendshme rrethore. Për sa i përket madhësisë dhe distancimit të saj nga bazilika e madhe në veri, ajo të kujton pagëzimet bashkëkohore në Italinë e Jugut. Çdo aspekt i ndërtesës është i pasur me simbolizmin e pagëzimit të hershëm të Krishterë. *(Neritan Ceka: po aty)*

Ndërhyrjet e konservimit: Pagëzimet u është nënshtruar programeve të konservimit që prej gërmimeve të Ugolini. Dyshemeja me mozaikë u konservua dhe restaurua kur ajo u gërmua për herë të parë dhe i është nënshtruar disa ndërhyrjeve që kanë pasur shkallë të ndryshme suksesi (dhe dështimi). Në korrik 2007 u dokumentua, monitorua dhe konsolidua nga Jacques Neguer. Në vitin 2008 u restaurua pusi i pagëzimit. Në vitin 2013 mozaiku u rihap përsëri dhe teserat të cilat ishin shpëputur nga sipërfaqja u rivendosën; në vitin 2017 u kryen konsolidime të vogla dhe rivendosje të gurëve të vegjël nga stafi i parkut.

Struktura u rindërtua me hamendje nga Ugolini i cili vendosi kolonat aty ku ato mund të shihen sot. Fasadat si dhe pjesët e brendshme dhe të sipërme të zbuluara të mureve janë konsoliduar me llaç çimentoje gjatë periudhave të ndryshme të konservimit.




Gjendja aktuale: Struktura është e qëndrueshme; likene dhe myshqe kanë mbuluar pjesët më të mëdha të mureve dhe kolonave. Megjithatë, në fasadat e ndërtesës ka zona që janë të zbuluara si dhe punime të brendshme jo të konsoliduara në muraturën në veri-perëndim dhe juglindje të shatërvanit me hark. Kolonat prej tullie të hipokaustit në lindje duken të brishta dhe një pastrim i kujdesshëm duhet t'i paraprijë konsolidimit. Në disa zona ka humbje të mbushjeve në ndërtesë. Shumica e ndërhyrjeve moderne kanë përdorur llaç prej çimentoje portlandiani dhe kjo kërkon monitorim të kujdesshëm për t'u siguruar nëse kjo po përshpejton ose jo prishjen e tullave përreth. Veshja me mermer përpara është e thyer në disa vende dhe në disa të tjera ka humbur. Nevojitet një pastrim i kujdesshëm i llumit të algave për të parë përmes mbeturinave në fund nëse kanë mbetur fragmente të veshjes (nga raporti i vitit 2009).

Rekomandimet/Veprimet:




- Zhvillimi i një raporti të plotë konservimi për monumentin dhe strukturat përreth (nga raporti i vitit 2009)
- Pastrimi i kujdesshëm i hipokaustit në fund të shatërvanit për të vendosur nëse nevojitet ndonjë konsolidim emergjent (nga raporti i vitit 2009).
- Punime të vogla që lidhen me pastrimin e algave pasi të thahet uji
- Mirëmbajtja e bimësisë
- Rihapja çdo vit e mozaikut për të kontrolluar gjendjen e tij
- Sistemi i gurëve përreth monumentit

Kategoria 3 – e qëndrueshme, ka nevojë për punime

Pagëzimet dhe ndërtesat përreth - periudha e sugjeruar e kishës së vogël: shek. XIV

Pozicioni	Planimetria	Fotografia 2018
 <p>6. Baptistery & adjacent buildings</p>		
<p>Përshkrim i shkurtër: Rrënojat e një kishë të vogël mesjetare, e cila përfshin një nef të thjeshtë, një narteks dhe një kambanore, mund të shihen në veri të pagëzimit. Ajo shtrihet mbi dhomën më në veri të kompleksit të pagëzimit, një pjesë e derës së të cilës është e dukshme në faqen e jashtme të murit jugor të kishës. Kisha me shumë gjasa është ndërtuar në shek. XIV. Të paktën një absidë e një kishë më të hershme dhe më të madhe shtrihet nën absidën e kësaj kishë më të vonë. (Neritan Ceka; po aty)</p> <p>Ndërhyrjet e konservimit: Në vitin 2007 janë konservuar pjesët e sipërme të mureve, dhe kisha ishte pjesë e programeve për pastrimin e bimësisë.</p> <p>Gjendja aktuale: Struktura është e qëndrueshme; likenet dhe myshqet kanë mbuluar shumë pjesë të muraturës.</p> <p>Rekomandimet/Vepimet:</p> <ul style="list-style-type: none">- Monitorimi i bimësisë brenda dhe jashtë mureve të ndërtesave- Konservimi dhe konsolidimi i sipërfaqeve të suvatuara që kanë mbetur- Monitorimi i pemëve në afërsi të strukturës, dhe veçanërisht i atyre mbi rrënojat e kambanores- Pastrimi i likeneve dhe myshqeve dhe konsolidim i strukturave lidhëse- Meremetimi i gurëve të lirë <p>Kategoria 2 – e qëndrueshme, ka nevojë për punime të vogla</p>		

Pagëzimet dhe ndërtesat përreth - periudha e sugjeruar e banjës: shek. II

Pozicioni	Planimetria	Fotografia 2018
		

Përshkrim i shkurtër: Për shkak të përdorimit të gjerë të teknikës *opus testaceum* mendohet se kjo banjë daton në shek. II. Vetëm një pjesë e vogël është gërmuar, por mund të shihet *calderium* (kaldaja), bashkë me gjurmë të hipokaustit. Në perëndim, në absidë, ishte një banjë me ujë të ftohtë gjysmë-rrethore me ngrohje me një tjetër banjë me ujë të ftohtë katër këndore afër. Banja do të ketë qenë furnizuar me ujë nga ujësjellësi i cili kalonte paksa mbi tatëpjetën në veri. Kjo banjë mendohet të kishte një kapacitet prej 15 personash. Është e mundshme që banja nën pagëzimore dhe banja nën rrënojat bizantine në jug të pagëzimites të ishin në fakt të lidhura deri diku me kaldajën dhe të formonin një kompleks të vetëm të madh banjash publike. (Neritan Ceka *po aty f. 49*)




Ndërhyrjet e konservimit: Në vitin 2013 dhe 2016, u ndërmor një pastrim dhe konservim i plotë i pjesës jugore të strukturës.

Gjendja aktuale: Të gjitha sipërfaqet e dyshemesë së banjës publike përmbyten sipas stinës në një nivel deri në 40 cm. Disa, në verilindje, mbeten të përmbytura përgjatë vitit. Ky cikël i lagështisë dhe tharjes duket sikur nuk shkakton dëme në muraturë ose llaç - ka pak tullë ose pllaka në këtë nivel. Harku me tullë në nivelin e poshtëm të pjesës fundore në verilindje përbën një përjashtim, pasi këtu tullat janë duke degraduar. I vetmi efekt i dukshëm është një çngjyrim i muraturës nga algat gri/të zeza në këtë zonë.

Rekomandimet / Veprimet:

- Monitorimi i bimësisë jashtë mureve të ndërtesave, veçanërisht të pemëve
- Pastrimi i likeneve dhe myshqeve duke vijuar me konsolidimin e strukturave lidhëse
- Konsolidimi i pjesëve të strukturave prej tulle
- Pas konsolidimit, rimbushja e monumenteve deri në 10 cm mbi shenjën e lartë të ujit duke përdorur dhe material mbushës të niveluar mbi skarë. Në nivelin e ujit, rimbushja duhet të ketë gurë, çjegulla dhe më pas zhavorr.

Kategoria 2 – e qëndrueshme, ka nevojë për punime të vogla

Porta e Ujit- periudha e sugjeruar: shek. VI		
Pozicioni	Planimetria	Fotografia 2018
		
<p>Përshkrim i shkurtër: Porta e ujit ishte një hyrje e mirë-fortifikuar në qytet, me drejtim nga Kanali i Vivarit për në Liqenin e Butrinti. Porta, e cila mund ta ketë origjinën e saj në shek. VI, ka gjurmë të rindërtimeve të mëvonshme. Forma e portës lejon krijimin e një moli në anën e saj të jashtme. Një pjesë e madhe e murit rrethues në këtë zonë daton nga fundi i shek. V ose VI, me disa kulla ose vendkalime të shtuara më vonë. <i>(Neritan Ceka po aty f. 52)</i></p> <p>Ndërhyrjet e konservimit: Në vitin 2007 u ndërmorën punime të mëdha konsoliduese. Më parë ishin hequr disa pemë të mëdha nga muratura. Në vitin 2012 u kryen konsolidime të pjesshme si dhe mbushje të lidhjeve në muret afër portës, kryesisht në anën e saj Perëndimore. Kripërat, likenet dhe algat janë duke degraduar muraturën fillestare.</p> <p>Gjendja aktuale: Përpara Korrikut 2007, rrënojat e Portës së Ujit ishin në gjendje shumë të cenueshme. Inkursioni i fuqishëm dhe në ritje i rrënjëve ka shkaktuar dëmtime të ndryshme të mëdha dhe këndi juglindor u përforcua me thasë me rërë. Rrënjë që kishin hyrë thellë në disa prej bedenave të parëzuar të vendkalimit ishin duke kërcënuar shembjen e menjëhershme të tyre dhe nikaja më në jug kishte një qemer që ishte duke u rrëzuar. Këto probleme u trajtuan gjatë një trajnimi një mujor konservimi (nga raporti i vitit 2009). Kripërat, likenet dhe algat janë duke prishur muraturën fillestare. Ndërtesa është e qëndrueshme, megjithatë është e nevojshme që të fillojnë punimet që lidhen me rivendosjen e gurëve të lirë si dhe punime të mëtejshme në materiale lidhëse.</p> <p>Rekomandimet/Veprimet:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Monitorimi i bimësisë brenda dhe jashtë mureve të ndërtesës - Monitorimi i pemëve në afërsi të strukturës - Pastrimi i likeneve dhe myshqeve duke vizuar me konsolidimin e strukturës lidhëse - Konsolidimi i pjesëve të sipërme të murit dhe rivendosja e gurëve të lirë - Sistemimi i gurëve përreth portës 		
<p>Kategoria 2 – e qëndrueshme, ka nevojë për punime të vogla</p>		



Nimfeu me këmbët e ujësjellësit- periudha e sugjeruar: 31 para Kr.



Pozicioni

Planimetria

Fotografia 2018



Përshkrim i shkurtër: Ujësjellësi i Butrintit u ndërtua kur kolonia u themelua me urdhër të Augustit. Kjo datë mbështetet nga zbulimi i një monedhe të Augustit e cila tregon një arkadë, që mendohet se përfaqëson ujësjellësin. Riparime ose modifikime gjatë mbretërimit të Neronit dëshmojnë nga gjetja e monedhave të tjera. Në fakt, gjurmë të shumë riparimeve dhe rindërtimeve tregojnë se ujësjellësi mirëmbahej gjatë periudhës së vonë Romake.

Burimi i ujësjellësit ishte me shumë gjasë në Xarrë, rreth katër kilometra larg, megjithëse mund të jetë sjellë ujë shtesë përmes një dege nga Çuka e Aitoit (8 kilometra larg). Këmbët e ujësjellësit janë ende të dukshme në Fushën e Vrinës, që kalon nga Xarra në drejtim të Butrintit. Janë gjetur gjithashtu rrënojat e cisternave të cilat mund të sillnin ujë për ndërtesat në anën veriore të Kanalit të Vivarit. Ujësjellësi hynte në qytet në pikën ku ndodhet tani nimfeu i shek. II (Neritan Ceko po aty f. 50).

Ndërhyrjet e konservimit: Biloqe gëlqerore katrore të punuara, tulla Romake të bëra me liç gëlqerore shtuar me pozolan janë materialet bazë të këmbëve. Nuk ka të dhëna të menjëhershme në lidhje me punimet konservuese pas gërmimit. Kjo me shumë gjasë si rrjedhojë e cilësisë tejet të lartë të liçit Romak që do të thotë se ka pasur pak prishje në fragmentet e mbetura të këmbëve pas çfarëdo katastrofe mekanike që ato pësuan.

Gjendja aktuale: Këmbët e ujësjellësit janë ruajtur më mirë në zonën midis nimfeut dhe portës së kullës. Kur niveli i ujit ishte i lartë një pjesë e këmbëve të ujësjellësit mbetej nën ujë. Kjo rrit rrezikun nga bimësia dhe po prek muraturën prej tulle. Këmbët e ujësjellësit në njërin anë të nimfeut kanë nevojë për punime konsoliduese të pjesshme të cilat konsistojnë në pastrimin e likeneve dhe myshkut, konsolidimin e strukturave lidhëse dhe rivendosjen e pjesëve të lira të muraturës.

Rekomandimet / Veprimet:

- Monitorimi i bimësisë brenda dhe jashtë mureve të ndërtesave
- Rivendosja e tullave të lira në muraturë
- Studime konservuese për ndërhyrje më gjithëpërfshirëse
- Pastrimi i likeneve dhe myshqeve dhe më pas konsolidimi i strukturave lidhëse
- Konsolidimi i pjesëve të sipërme të mureve dhe rivendosjen e pjesëve të lira të muraturës
- Sistemi i gurëve

Kategoria 2 – e qëndrueshme, ka nevojë për punime të vogla

Nimfeu me këmbët e ujësjellësit- periudha e sugjeruar: shek. II

Pozicioni	Planimetria	Fotografia 2018
		

Përshkrim i shkurtër: Ky shatërvan, i datuar nga përdorimi i opus testaceum në shek. II, u gërmua nga Ugolini dhe Misioni Arkeologjik Italian. Ai është vendosur në rrugën e shtruar e cila të çon në portën e kullës. Shatërvani, duke përfshirë daljet të tre niketë, e merrte ujin nga një cisternë, që ndodhej pas saj, e cila furnizohej me ujë nga ujësjellësi. Punimet me tulla fillimisht ishin të veshura me një shtresë të hollë mermeri. Gjatë gërmimeve janë gjetur dy statuja të shtrira, si në teatër, me fytyrën poshtë përpara pozicioneve të tyre fillestare në nike (nuk dihet çfarë ka ndodhur me statujën e tretë). Në nikenë qendrore ndodhej një statujë e Dianisit dhe në nikenë në të majtë ndodhej një statujë e Apollosit. (Neritan Ceka po aty f. 49-50)




Ndërhyrjet e konservimit: Gjatë viteve 1980 janë kryer ndërhyrje konservimi të cilat kishin si qëllim mbushjen e nikeve me tulla të krijuara si të ishin origjinale. Në vitin 2008, ka patur ndërhyrje të vogël, kryesisht lidhur me pastrimin e bimësisë dhe rimbushjeve të vogla. Në vitet 2007-2008, punimet ishin fokusuar kryesisht te pastrimi i bimësisë. Ndërtesa është në gjendje të qëndrueshme. Pjesë të muraturës prej tulle janë të shkëputura dhe rrezikojnë të bien. Dhoma me qemer ka shumë të çara dhe struktura nuk është e qëndrueshme.

Gjendja aktuale: Plinta të bëra me gur gëlqeror, kanal me gur gëlqeror dhe rrethuar nga buzë prej guri gëlqeror. Materialet ekzistuese ballore janë tullë me gurë gëlqeror dhe llaç. Ndërtesa e parë ishte e suvatuar me llaç të trashë kontrapest i cili në ballore ishte i veshur me mermer të bardhë 25 mm. Poshtë dhe sipër absidës së ndërtesës ishte një cisternë e madhe nga e cila nuk ka mbetur asgjë përveç një dysHEMEJE kontrapest dhe dhomës me qemer në të. Kjo cisternë furnizohej me ujë nga ujësjellësi në fushën e Vrinës dhe e mbante ujin për të furnizuar ujësjellësin që shkonte në forum dhe banjë si dhe në ndërtesa të tjera të qytetit. Ndodhet nën ndikimin konstant të ujit. Dhoma me qemer nën cisternë si dhe pjesa jugore e ndërtesës është pothuajse gjatë gjithë kohës nën ujë. Ndërtesa është në gjendje të qëndrueshme. Pjesë të muraturës me tulla janë të shkëputura dhe janë në rrezik shembjeje. Dhoma me qemer ka shumë të çara dhe struktura nuk është e qëndrueshme. Raporti i vitit 2009 sugjeronte disa masa konsolidimi të cilat nuk janë ndjekur deri tani.




Rekomandimet/Veprimet (nga raporti i vitit 2009):

- Mbushje gravitacionale me gëlqerore pozolanike, të zonave që rrethojnë dy pjesët e fragmentuara të muraturës. Më pas do të vijojë mbushja e thellë.
- Në zonat e rrezikuara duhet të kryhet një pastrim i thellë me furça, biocid dhe ujë. Përforsim me llaç gëlqereje për zonat e rrezikuara.
- Identifikimi i zonave të rrezikuara me dysHEMEJE kontrapest si dhe konsolidim të zonave horizontale të zbuluara si dhe pastrim të të gjithë materialit të lirë. Mbushje me gëlqere të këtyre zonave për izolimin e materialeve të lira. Mbushja e zgavrave me llaç/kontrapest pozolanik.
- Mbushje e kujdesshme e të çarave në tavanin me qemer me llaç gëlqereje, si dhe përforsimi i tavanit me material drusor në qendër.
- Mbushje e kujdesshme e të çarave të qemerit me llaç gëlqeror dhe mbështetja e tavanit me një strukturë qendrore prej druri. Izolim të rrjedhjeve me argjilë nëse është e disponueshme. Përdorni pak litra fino në një aplikim. Jepini kohë çdo sasi finoje të ngrië përpara se të vijoni me aplikimin tjetër.
- Mbushje e thellë të të çarave në brendinë e qemerit
- Mbushje e materialeve lidhëse në themelet e plintës dhe pastrimi i kanaleve nga mbeturinat.
- Konservim i fragmenteve të suvasë në pishinën e shatërvanit
- Mbushje e përgjithshme e fugave të hapura në muraturën me tulla aty ku ato janë të dukshme

Kategoria 4 – E paqëndrueshme, potencialisht e rrezikshme

Bazilika e Madhe - periudha e sugjeruar: shek. VI - XIII		
Pozicioni	Planimetria	Fotografia 2018
		
<p>Përshkrim i shkurtër: Bazilika e Madhe është monumenti më i vjetër në këmbë në Butrint. E ndërtuar fillimisht si një kishë Bazilikë në mesin e shek. VI, ajo u përdor pa ndërprerje deri në shek. e XIII. Gjatë kësaj kohe ajo pësori disa riparime, kryesisht në pjesët e sipërme të muraturës. Kisha ka qenë një strukturë që përbëhej nga një nef dhe dy anijata, me një absidë dhe krahë trefaqëshe. Bazilika u ndërtua mbi themelet e një strukture më të hershme Romake nga e cila disa pjesë janë të dukshme në absidë. Në përgjithësi ne mund të dallojmë tre faza kryesore ndërtimi: periudha e hershme (shek. VI); periudha e mesit (rreth fundit të shek. të IX dhe fillimit të shek. të X); periudha e fundit e ka filluesën në periudhën e vonë mesjetare. Në fazën e parë, materialet e ndërtësës ishin kryesisht blloqe guri me shtresa tulle. Sot janë ruajtur vetëm krahët, një pjesë e madhe e absidës dhe disa pjesë të vogla të strukturës fillestare. Në fazën e dytë të ndërtimit Bazilika iu nënshtua shumë rindërtimeve. Në fazën e tretë u shtuan dhomat në afërsi të absidës, një pranë çdo krahu duke bllokuar hyrjet anësore për në kishë.</p> <p>Ndërhyrjet e konservimit: Gjatë vitit 2009 dhe 2011 u ndërmorën punime të mëdha konservimi në të gjithë strukturën e kishës. Puna konsistonte në pastrimin e bimësisë, konsolidimin e muraturës së lirë, suvatimin dhe konservimin e mureve duke i veshur ata.</p> <p>Gjendja aktuale: Struktura është në një gjendje të qëndrueshme.</p> <p>Rekomandimet/Veprimet:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Menaxhimi periodik i bimësisë - Konsolidimi i veshjes së mureve 		
Kategoria 1 – e qëndrueshme dhe e mirëmbajtëshme		

Porta me kulla- periudha e sugjeruar: shek. III para Kr.		
Pozicioni	Planimetria	Fotografia 2018
		
<p>Përshkrim i shkurtër: Porta me kulla është porta më mbresëlënëse në muret e qytetit antik. Mendohet se është vendosur në murin e qytetit në fund të shek. III para Kr. (pak pas mbretërimit të Pirros, 297-72 para Kr.). Porta në anë ka dy kulla të mëdha: një kullë në formë katrori të thjeshtë, dhe tjetra është një dhomë katrore me një dhomë gjysmë-rrethore që shtrihet përtej vijës së jashtme të murit. Mbështetësit për mahitë janë ende të dukshëm në çdo dhomë. Rruga e cila kalonte përmes kullave ishte e aq e gjerë sa që mund të lejonte kalimin e qerreve. Në pjesën e brendshme mbyllet nga një portë me dy kanata dhe nga jashtë mbrohej nga një portcuallis (portë hekuri), kanalet vertikale të së cilës janë ende të dukshëm. Vendet për shigjeta shponin murin e jashtëm. Një tjetër rrugë e dytë më e vogël ndodhej në pjesën perëndimore të kullës katrore. Vija e ujësjellësit tregon se kjo rrugë ende përdorej gjatë periudhës Romake, ku shumë ndërtesa ishin pozicionuar pranë portës. (Neritan Ceka, po aty f. 53-4).</p> <p>"Tani ato duken si dy struktura të veçanta nga secila anë e rrugës, njëra katrore, dhe tjetra me një fund të dalë gjysmërrrethi, me një numër muresh shoqëruar të mëvonshëm. Muraturë me blloqe të mëdha të cilat qëndrojnë 7 deri në 8 rreshta të lartë dhe ndoshta edhe më shumë, por monumenti është i saturuar me ujë në themele. Tre të çara të brendshme me arkitrarë betoni modern, dhe një numër të çarash për shigjeta që vijnë të ngushta". (nga Vrajtimi / Gjendjes 2001)</p> <p>Ndërhyrjet e konservimit: Gjatë viteve 1980 u vendosën arkitrarët prej betoni të cilët qëndrojnë ende.</p> <p>Gjendja aktuale: Struktura është në një gjendje të qëndrueshme, përderisa është e ndërtuar me blloqe të mëdhenj guri. Megjithatë, dyshemeja e zbuluar është vazhdimisht nën ujë, dhe po akumulon shumë mbetje dhe depozita. Dyshemeja nuk është e dukshme; dhe depozita të lehta nga uji aktualisht janë mbuluar nga bimësia e ulët. Disa prej blloqeve prej guri kanë lëvizur nga pozicionet e tyre fillestare, ndërsa disa të tjera kanë ende të çara të dukshme. Arkitrarët prej betoni duket sikur po përkulen.</p> <p>Rekomandimet/Veprime:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Mbushja e monumentit deri në 10 cm mbi nivelin e lartë të ujit - Monitorimi i arkitrarëve prej betoni - Monitorimi i bimësisë dhe mirëmbajtja e saj 		
Kategoria 2 – E qëndrueshme, ka nevojë për punime të vogla		

Nimfeu 2 - periudha e sugjeruar: shek. III - V		
Pozicioni	Planimetria	Fotografia 2018
		
<p>Përshkrim i shkurtër: Pranë Kullës së Mbishkrimeve gjenden rrënojat e nimfeut absidal ose shatërvanit të periudhës së vonë Romake. Shatërvani e merrte ujin nga ujësjellësi Romak që kalonte në veri të ndërtesës (përgjatë vijës së murit antik të qytetit). (<i>Neritan Ceka pa aty f. 46</i>). "Një pjesë e ndërtesës është e dukshme, me disa mure të sipërme të zbuluara nga instalimet e mureve. E vendosur në tokë, vetëm pak mbi horizontin e ujit. Në pjesën më të madhe, muret qëndrojnë deri në 1 m, por në pjesën verilindore të fundit të absidës, me nike dhe e mbyllur me mure, rrënojat janë deri në 4 m". (<i>nga Vrajtimi / Gjendjes 2001</i>)</p> <p>Ndërhyrjet e konservimit: Në vitin 2007, ndërhyrjet për pastrimin e bimësisë dhe konservimin e muraturës u ndërmorën për të parandaluar prishjen e strukturës.</p> <p>Gjendja aktuale: Struktura është në gjendje të qëndrueshme, megjithëse duhen konsolidime të pjesshme. Sipërfaqet e suvatuara janë çarë dhe kanë nevojë për konsolidim. Segmentet veriore kanë nevojë të riparohen duke vendosur gurët e rrëzuar, të cilët janë in situ, nën strukturë. Është e nevojshme të aplikohet përsëri veshja e mureve.</p> <p>Rekomandimet/Veprimet:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Konservimi i sipërfaqes së mbetur të suvatuar - Meremetimi i muraturës së rrëzuar 		
Kategoria 3 – E qëndrueshme por ka nevojë për punime të mëdha		

Gymnasium - periudha e sugjeruar: shek. II - III		
Pozicioni	Planimetria	Fotografia 2018
 <p>12. Gymnasiumi</p>		
<p>Përshkrim i shkurtër: Gërmimi i grupit të ndërtesave të njohura më parë si Kompleksi Perandorak, i ashtuquajtur gymnasium (gjinaz), u ndërmor nga Misioni Italian Arkeologjik. Piro Marconi, drejtori i Misionit arkeologjik, e interpretoi atë si një gjimnaz. Ky interpretim u refuzua nga pasardhësi i tij, Domenico Mustilli, megjithëse nuk u propozua ndonjë funksion alternativ. Si rezultat, edhe pse mund të mos ketë qenë i tillë, ky kompleks ende referohet si "gymnasium". Kompleksi përfshin shumë faza: faza më e hershme është një var nga periudha Augustiane. Ky varr, dekoruar me mermer, ndodhet në një rrugë, ndodhet në një nyje ose pranë një porte, jashtë murtit rrethues të kohës (duke qenë se ligji romak e ndalonte varrimin brenda qytetit). Në shek. II përreth këtij varri u ngritën ndërtesa, duke treguar se modeli i rrugëve dhe kufijtë e qytetit kishin ndryshuar. Hyrja kryesore për në ndërtesën e shek. II është në anën perëndimore, që të çon në dhomën e pritjes e cila ka një eksedër në murin përbi. Kjo dhomë dikur ishte dekoruar me veshje mermeri dhe një dysheme me mozaikë. Dy dhoma të çonin në jug, të dyja shumë mirë të dekoruara. Në veri ishte një burim dhe përtej tij, një oborr i shtruar me gurë. Nuk duket të ketë pasur lidhje të drejtpërdrejta ndërmjet oborrit dhe dhomave në jug, duke qenë të penguar nga tubat e ujit që çonin ujë në shtatërvan në njërin anë dhe nga një cisternë në anën tjetër. Nuk është e qartë nëse mund të shihet përmes zonës së shtatërvanit të dhomat pas ose nëse hapësira e shtatërvanit ishte e mbyllur në pjesën jugore. Niketë në shtatërvan përmbajnë fragmente mozaikë; kompleksi i ndërtesave qëndroi në përdorim gjatë periudhës Romake dhe deri në fillim të kohërave Bizantine. Në shek. III disa dhoma u shtruan në veri të oborrit, një dhomë ka një dysheme me mozaikë të bukur. Në periudhën mesjetare zona e shtatërvanit ishte konvertuar në një kishë të vogël me një kambanore afër, dhe oborri ishte zgjeruar me anë të shtimit të një portiku. Kisha dhe oborri i saj u hoqën si pjesë e gërmimeve të Misionit Italian Arkeologjik.</p> <p>Ndërhyrjet e konservimit: Në vitin 2009, u rimbushën hapësira të mëdha, por, kjo ndërhyrje nuk parandaloi përmblyetjen e mëtejshme. Në vitin 2011, pjesa e poshtme e nimfeut u konsolidua (pjesa ku ishin prishur pllakat e tullave) dhe u konsolidua edhe një pjesë e mureve të gymnasium-it. Në vitin 2012 u ndërmor konservimi i 3 niveleve të nimfeut. Në vitin 2017 filluan punimet për rivendosjen e muraturës së liqë, të cilat vijojnë ende.</p> <p>Gjendja aktuale: Përveç zonës qendrore të shtatërvanit/kishës, këto janë rënoja me mure të ulëta dhe lum të cilat përmblyen rregullisht. Efekti (efektet) i cikleve konstante të përmblyetjeve dhe tharjes së pjeshme ose të plotë është kompleks. Algat dhe bimët e tjera lulëzojnë në ujë e pasur me ushqyes dhe më pas thahen në lum i cili mundëson edhe një ambient për rritjen e tyre. Rrënjët e bimëve prishin mozaikët e mbuluar dhe ciklet e lagështisë dhe të tharjes krijojnë tryzni nga kristalizimi i kripës në sipërfaqet e sipërme të mozaikut dhe muraturës vertikale.</p> <p>Rekomandimet/Veprimet (nga raporti i vitit 2009 - për t'u rishqyrtuar përkundrejt ndërhyrjeve të bëra aktualisht):</p> <ul style="list-style-type: none"> - Zbulimi dhe konservimi i mozaikut për të vlerësuar mundësinë (a) e zbulimit fizik në nivelet përkatëse të ujit (b) e konservimit në nivelet ekzistuese të ujit (c) e financimeve dhe lejeve. Nëse gjykohet praktikë në të gjitha aspektet duhet të ndërmerret konservimi i mozaikut si dhe vlerësimi, konsolidimi dhe krijimi i mureve të reja mbajtëse si dhe mbushja me zhavorr të ri. - Konservimi i mëvonshëm i mozaikëve të gjimnazit duhet të përfshijë mbushjen e plotë të tyre deri në 30 cm mbi nivelin më të lartë të ujit. Nëse është e mundur, mbushja duhet të nivelohet në zonat e mozaikut dhe të shtrohet "tapeti i gjelbër" mbi mbushjet me dhe në zonat më pak sensitive. Ekziston një debat si estetik dhe mjedisor për ta mbajtur zonën e shtatërvanit/kishës të hapur gjatë gjithë vitit si një pishinë. Kjo do të sillte nevojën e ndërimit të mureve mbajtës për të parandaluar që mbushja përreth të rrihqiste në pishinë. - E gjithë suvaja, kontrapesti dhe mozaiku duhet të dokumentohen, vlerësohen dhe konservohen/konsolidohen sipas nevojës. - Të gjithë muret, pjesët e sipërme të mureve dhe muratura duhet të dokumentohen, vlerësohen dhe konservohen/konsolidohen sipas nevojës. - Pas mbushjes, duhet t'i kushtohet vëmendje ndërimit të rrugëve të lejueshme përreth rënojave dhe të bëhen 		

përpjekje për të parandaluar krijimin e rrugëve opsionale të cilat çojnë në shkatërrimin e pjesës së sipërme të mureve dhe strukturës historike, si në Pallatin e Trikonkës. Shpresohet që rruga të mund të hapet midis veriut të gjimnazit dhe Bazilikës së Madhe, ndaj është e nevojshme një rrugë përgjatë dhe përreth gymnasium-it.

- Vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet konservimit dhe prezantimit të varrit të periudhës Augustiane. I veçantë për Butrintin turistik, aktualisht ai ka mbetur i heshtur dhe fshehur. Duhet të krijohet një rrugë që të çon drejt varrit dhe të përmirësohet sinjalistika.
- Sistemimi i gurëve (i atyre që nuk do të vendosen në vendin e tyre fillestar)
- Monitorimi i bimësisë dhe heqja e pemëve.

Kategoria 4 – E paqëndrueshme, ka nevojë për punime madhore

Ndërtesë Helenistike - periudha e sugjeruar: shek. II para Kr.		
Pozicioni	Planimetria	Fotografia 2018
		
<p>Përshkrim i shkurtër: Kjo strukturë e pazakontë ndodhet afër një kthese të fortë në murin e qytetit antik me pamje nga Liqeni i Butrintit. Ndërtesa është e ndërtuar me blloqe të mëdhenj, me një teknikë të ngjashme me atë që është përdorur për muret e qytetit, dhe daton nga shek. II para Kr. Struktura është ngjitur me murin e qytetit (i cili ndodhet poshtë rrugës aktuale) dhe përfshin një dhomë të vendosur përkundrejt munt të qytetit, në të cilën hyhet përmes dy dhomave në perëndim. Mund të ketë qenë një dyqan ose një punishte, me një hyrje nga rrugica. Përpara ndërtesës është një mur i madh tarracor i ndërtuar me blloqe poligonale, të cilat mund të jenë pjesë e një rampe të një rrugice që përshkon anën e kodrës. (Neritan Ceka "Butrint: Një guidë në qytet dhe monumentet e tij"). Nga dy fazat kryesore, ajo më e hershme është në veri e cila është shtrirë më vonë në jug. Në perëndim të fazës më të hershme është një mur poligonal me blloqe, i cili qëndron 2 m i lartë dhe i cili vesh pjesën fundore të faqes së kodrës. Shumica e ndërtesës ka blloqe të mëdha gurësh katërkëndor me lidhje të mira pa llaç, të cilat janë nga një deri në pesë meshta të larta. Nuk ka dysheme të dukshme. Në jug është një shtesë. Muri veshës në perëndim është shtrirë edhe më shumë, i ndërtuar me gurë të çrregullt, pa tulla, dhe muret e tjerë janë një përzierje ndërmjet gurëve të rregullt dhe të çrregullt dhe gurëve katror (nga Vrojtimi i Gjendjes 2001).</p> <p>Ndërhyrjet e konservimit: Në vitin 2017, rrënojat u pastruan dhe terreni përreth u gërmua dhe nivelua. Gurët u vendosën në pozicionin e tyre fillestar dhe u bë konsolidimi i blloqeve të gurëve in-situ.</p> <p>Gjendja aktuale: Struktura është në një gjendje të qëndrueshme, por është e rrezikuar nga muri fortifikues sipër. Një pjesë e murit është prishur në vitin 2014 dhe restauruar më vonë në vitin 2018. Shumë nga blloqet e gurëve kanë të çara të dukshme të cilat janë zmadhuar.</p> <p>Rekomandimet/Veprimet:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Konsolidimi i murit rrethues mbi rrënoja - Studimi i konservimit dhe konsolidimi (nëse është e mundur) i të çarave - Interpretimi i zonës 		
<p>Kategoria 1 – E qëndrueshme dhe e mirëmbajtshme</p>		

Kisha e vogël në verilindje - periudha e sugjeruar: shek. XIII dhe më vonë		
Pozicioni	Planimetria	Fotografia 2018
 <p>14. Small Church</p>		
<p>Përshkrim i shkurtër: 'Kjo kishë e vogël daton në shek. XIII dhe më vonë. Është një strukturë me një nef dhe me një absidë në fundin lindor. Në secilën anë të absidës është një dritare e vogël. Kisha u ndërtua përkundrejt një muri mbrojtës që përshkon portën e Liqenit deri të muri rrethues i akropolit. Shenja e vijës së çatisë së kishës mund të shihet ende në murin mbrojtës. Në niketë afër absidës (dhe në zonat e tjera) ka fragmente pikturash murale' (Neritan Ceka: <i>po oty</i>). Muret janë 2m të lartë në fundin jugor dhe përkundrejt murit, dhe deri në 500 mm në mes. Reshti i muraturës përbëhet nga gurë të vegjël paksa katror me tulla dhe gurë më të mëdhenj të papunuar.' (Nga Vrojtimi i Gjendjes 2001)</p> <p>Ndërhyrjet e konservimit: Në vitet 2009-2010 muret e kishës u konsoliduan, si dhe inertet u pastruan nga brendia e mureve. Pasi u restaurua muri rrethues në vitet 2016-2017, në vitin 2017 rrënojat lu nënshtruan konservimit. Konservimi konsistoi në pastrimin e likeneve, mbushjen e të çarave dhe rivendosjen e gurëve lëvizës në muraturë, rivendosjen e gurëve të rrëzuar, mbushje dhe konsolidim të veshjes së murit.</p> <p>Gjendja aktuale: Një pjesë e mureve u dëmtua kur pjesa e murit rrethues u prish në vitin 2014. Pasi muri rrethues u restaurua në vitin 2016-2017, rrënojat lu nënshtruan konservimit. Rrënojat janë në gjendje të qëndrueshme, megjithatë është e nevojshme të bëhet një konservim i sipërfaqeve të pikturuara që kanë mbetur.</p> <p>Rekomandimet/Veprimet:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Konservimi i sipërfaqeve të pikturuara të murit - Sugjerim nga raporti i vitit 2009: pastrimi i brendisë deri në nivelin e dyshemesë për të kuptuar më mirë 		
<p>Kategoria 1 – E qëndrueshme dhe e mirëmbajtëshme</p>		

Porta e Liqenit- periudha e sugjeruar: shek. IV para Kr.		
Pozicioni	Planimetria	Fotografia 2018
		
<p>Përshkrim i Shkurtër: Kjo portë u emërtua porta "Scaean" nga Misioni Italian Arkeologjik pas përshkrimit të Virgjilit të hyrjes Aeneas në Butrinti. Është një nga portat të ruajtura më mirë në Butrint dhe duket që ka mbetur në përdorim përgjatë historisë së qytetit me shumë pak ndryshime. Porta është ndërtuar në shek. IV para Kr. dhe ishte 5.0 metra e lartë si dhe 5.25 m e gjatë, ku shtrimi që duket sot është Bizantin. Përthyerja e murit të qytetit mundësonte mbrojtje për portën, e cila gjithsesi ishte e dukshme nga liqeni. (Neritan Ceka po aty f. 55-56)</p> <p>Ndërhyrjet e konservimit: Përveç rindërtimit të pjesshëm të bërë menjëherë pas gërmimit, nuk është bërë asnjë konservim tjetër.</p> <p>Gjendja aktuale (Ende e vlefshme nga raporti i vitit 2009): Bimësia rrethon dhe është sipër muraturës dhe portës së liqenit e cila është e ndërtuar mbi një tokë të thatë afërsisht një metër sipër dhe 15 metra larg nga ujërat e Liqenit të Butrintit. Muratura fillestare është shumë e puthitur dhe pa llaç, duke lënë pak hapësirë ose mundësi për rritjen e bimëve. Muratura e mëvonshme, e ndërtuar gjatë periudhave të rindërtimeve mbrojtëse ka humbur llaçin. Si rrjedhojë e kompostimit të gëtheve nga dekadat e rënies së gëtheve dhe rritjes së rrënjëve të pemëve kjo është bërë një zonë pjellore por edhe shkatërruese e cila rrethon pjesën e brendshme të sipërme të portës. Ka të çara të forta të gurët e këndtë të jashtëm të murit të përthyer dhe një prej qemerëve masiv të brendshëm është çarë. Ka të ngjarë që ky problem të jetë shkaktuar shumë kohë më parë dhe nuk mendohet se mund të ketë një rrezik të menjëhershëm ndaj qëndrueshmërisë së pjesës së jashtme të portës dhe pjesëve që e rrethojnë atë. Këto të çara duhet të mbahen pastër nga bimësia dhe ndotja. Qëndrueshmëria e muraturës kërcënohet më shumë sipër dhe brenda pjesës së brendshme të portës. Pra, ka shumë bimësi, dhe shumë rritje të rrënjëve penetruese. Ka pasur një përpjekje për të trajtuar sërish këto probleme në vjeshtën e vitit 2007 por nuk ka pasur kohë dhe fonde të mjaftueshme për të bërë një punë të përshtatshme.</p> <p>Rekomandimet/Veprimet (nga viti 2009) :</p> <ul style="list-style-type: none"> - Të gjitha sipërfaqet horizontale me drejtim nga qielli duhet të pastrohen nga të gjitha bimët dhe dheu përveç luleve dhe barit vjetor. Grumbuj të pjerrët dheu duhet të vendosen përsëri në shtresa vertikale dhe më pas të përforcohen qoftë me mure të thatë prej guri ose gardhe prej druri. Të gjitha rrënjët duhet të hiqen nga muratura dhe ajo duhet të ruhet e pastër. Të gjitha mbetjet duhet të hiqen nga brendia. Gurë veshës të lirë duhet të vendosen në pozicionin e tyre me llaç. Duhet të hiqen dhe zëvendësohen mbushjet e lira të muret me llaç. 		
<p>Kategoria 4 – Jo i qëndrueshëm, ka nevojë për punime madhore</p>		

Pusi i Junia Rufinës- periudha e sugjeruar: e panjohur – rindërtuar në periudhën Romake

Pozicioni

Planimetria

Foto 2018



6. Junia Rufina's Well



Përshkrim i Shkurtër: Një dhomë dikur nëntokë në të cilën hyhej përmes një shkallareje, me një pus në anën jugore nën një çati me qemer cilindrik. Pjesa kryesore ishte ose me kupolë, ose me kupolë të shtrirë, me tulla, nga e cila sot ruhet çereku. Gjendet një nike në anën e pasme të shatërvanit, dhe një tjetër në dhomën kryesore. (Nga Vrajtimi / Gjendjes 2001). Pusi i Junia Rufinës, i vendosur pikërisht brenda Portës së Luanit, duket të ketë qenë një pikë qendrore e kultit në qytet. Në periudhën romake ishte rindërtuar dhe i përkushtohej nimfave nga Junia Rufina, një dedikim që është dokumentuar në kapitulet përgjatë buzës së pusit. Disa shekuj më vonë burimit të ujit iu dha një identitet dhe referim i krishterë. Në këtë kohë muri me hark mbi pus u pikturua me dy fazanë në anë të një kantharos (kupë vere); duke ruajtur një nike të thellë me pjesë të sipërme trekëndore e cila mund të ketë pasur një imazh ose një dritë. Piktura tashmë është zbehur saqë nuk shihet më, por mund të shihet deri diku qartazi nga fotografitë e bëra menjëherë pas zbulimit të saj. Harku mbi pus formohet nga dy rreshta rrezatuese tullash të vendosura në mënyrë të rregullt dhe është qartazi punim romak. Zona menjëherë përpara pusit duket se ka pasur qemer në një fazë të caktuar. Rrënoja e bazamentit të kupolës mund të shihen në këndin veriperëndimor. Gjurmët e ngjyrës në murin e fasadës së pusit dhe në murin perëndimor sugjerojnë se kjo hapësirë me qemer mund të ketë qenë e pikturuar. Një nike në formën e kërpudhës, me shumë gjasë e përdorur si një tempull i vogël blatimesh, ishte ndërtuar në murin lindor i cili gjendej përballë shkallëve dhe hyrjes së re. Muret e kësaj nikeje janë suvatuar dhe mbartin gjurmë të zbehta të dekorimeve të pikturuara, breza vertikale të kuq në sipërfaqet anash dhe fundore dhe këndet e pasme. Duket sikur këtu ishte ndërtuar një faltore me qemerë e cila kishte pusin si fokus të saj, qoftë në Antikitetin e vonë ose gjatë një periudhe më të vonë, pasi është e vështirë të përcaktohet data nga pikturat e pakta të mbetura në këto mure. Gjatë periudhës mesjetare, u ndërtua një mur i cili bllokonte hapjen për në pus në këtë nivel më të ulët. (Ugolini 1942). Një shufër përshkonte qemerin Romak që gjendej mbi pus, duke i mundësuar ujit që të merrej nga një nivel më i lartë në shpatet e akropolit. Ky mur më vonë u prish nga Italianët, duke qenë se ishte pjesë e një strukture të mëtejshme e cila ndante shkallët poshtë pusit nga shkallët poshtë Portës së Luanit. Struktura krijonte një shkallare të ngushtë poshtë deri te zona e pusit, me shumë mundësi e orientuar te nikeja e vogël në të majtë të pusit të përshkruar më sipër. Zona përballë pusit ishte me një çati me qemer rrënojat e të cilës mund të shihen ende. Hyrja për te zona ishte përmes një dore në fundin perëndimor të shkallares e cila është ende e dukshme sot. Mendohet se pusi të ketë mbijetuar si një simbol kulturi deri në fund të Mesjetës.




Ndërhyrjet e konservimit: Heqja e bimësisë në vitin 2007; konservim i afreskut dhe konsolidim i murit.

Gjendja aktuale: Është në një gjendje të qëndrueshme, megjithatë është e nevojshme të bëhet konsolidimi i pjeshëm i kupolës dhe i mureve prej guri përballë me pusin si dhe konsolidim i sipërfaqeve të mbetura të suvasë.

Rekomandimet/Vepimet:


- Menaxhimi i bimësisë
- Konsolidimi i strukturave të kupolës
- Studimi i konservimit dhe konsolidimi i sipërfaqeve të pikturuara që kanë mbetur
- Konsolidimi i mureve

Kategoria 2 – E qëndrueshme, ka nevojë për punime të vogla



Porta e Luanit - periudha e sugjeruar: shek. IV para Kr.		
Pozicioni	Planimetria:	Fotografia 2018
		
<p>Përshkrim i shkurtër: Porta e Luanit është emërtuar sipas relievit të madh që tregon një luan duke sulmuar një dem, i vendosur në arkitra diku në shek. VI. Është rindërtuar disa herë. Porta fillestare (hyrja e së cilës mund të shihet ende pas relievit të luanit) kishte një planimetri të thjeshtë, si porta e Liqenit. Megjithatë, ndryshe nga porta e Liqenit, porta e Luanit u ndërtua ndërmjet dy mureve paralele dhe kështu ishte e padukshme nga liqeni. Në periudhën e antikitetit të vonë porta u fortifikua përsëri dhe u shtua një reliev luan. Relievi i luanit ishte fillimisht i një tempulli, me gjasë nga akropoli. Futja e relievit zvogëloi shumë madhësinë e portës. Më vonë aksesit për në qytet u bë edhe më shumë i kufizuar kur një kullë (tani plotësisht e prishur) u ndërtua në pjesën e jashtme të portës. <i>(Nevitan Crka; po oty)</i></p> <p>Ndërhyrjet e konservimit: Në vitin 1962 u rindërtua muratura masive e brendësisë së vendkalimit nga Instituti i Monumenteve. Dëshmi për këtë janë çengelat prej hekuri të cilët dukshëm po gërryejnë muraturën. Nuk dihet deri në ç'pikë u çmontua dhe më vonë u rindërtua porta. Nuk është bërë konservim i mëtejshëm.</p> <p>Gjendja aktuale: Çengelat prej hekuri janë duke gërryer muraturën. Gërryerja është duke shkaktuar fryrje e cila po i fragmenton gurët përreth. Kjo mund të shihet qartësisht në faqen e brendshme të portës si mbi ashtu edhe sipër arkitraut. Kjo është një çarje e madhe vertikale në muraturë; dhe llaçi i mbushur bie nga pjesa më e madhe e sipërfaqes.</p> <p>Rekomandimet/Veprimet (nga raporti i vitit 2009; i miratuar plotësisht nga raporti i vitit 2018 nga ZAKB):</p> <ul style="list-style-type: none"> - Ekzaminim i bërshëm nga një inxhinier me kualifikim dhe përvojën e duhur dhe që e njej stilin e muraturës - Heqja e të gjithë bimësisë nga sipërfaqet e sipërme të mureve dhe konsolidimi i tyre - Konsolidim i muraturës mesjetare - mbushje të të çarave dhe rivendosjen e llaçit që mungon në thellësi - Shkaqët e gurta që janë brenda portës duhet të shqyrtohen nëse kanë gurë të lirë, të cilët duhet të shtrohen sërish për të parandaluar aksidentet me vizitorët. 		
<p>Kategoria 3 – e qëndrueshme, ka nevojë për punime madhore</p>		




Columbarium – ndërtesa e varrezave- periudha e sugjeruar: shek. V

Pozicioni	Planimetria	Fotografia 2018
 <p>18. Cemetery Building</p>		
<p>Përshkrim i shkurtër: 'Në veri të qytetit, jashtë murit të qytetit pranë portës së luanit, në zonën e cila mendohet të jetë porti fillestar i Butrintit, janë gjetur disa monumente të mëdha funerale nga periudha e vonë Romake. Ka të paktën dy ndërtesa, një prej të cilave ka mbetur deri në lartësinë e ulluqeve. Funkzioni fillestar i këtyre ndërtesave nuk është i qartë, por në fund të shek. V ato ishin nëndarë për të lejuar vendosjen e një numri të madh varresh. Varre të vetëm janë gjetur më tej përreth gjirit në anën veriore të qytetit.' (Neritan Ceka, <i>pa aty f. 57-8</i>)</p> <p>Ndërtesa u identifikua fillimisht si një banjë që më pas ishte konvertuar në një monument funeral në shek. V (Ugolini 1937). Megjithatë pozicioni i saj jashtë murit të qytetit na sugjeron se funksioni i saj kryesor ishte ai i një mauzoleu. Një ndërtesë katërkëndore, afërsisht 8x16 m, me shumë ndarje të brendshme të mëvonshme për vendosjen e varreve. Pjesa më e madhe gjendet ende nëntokë dhe në të ka rënie të mëdha. Rrënoja gurësh të papunuar me reshta tullash dhe suva të antikitetit të vonë në faqen e brendshme. (Vrojtimi / Gjendjes 2001).</p> <p>Ndërhyrjet e konservimit: Nuk ka patur asnjë ndërhyrje konservimi, përveç heqjes së bimësisë në vitet 2007-2008 dhe 2009. Në vitin 2015, mozaiku i shek. VI u zbulua në njërin prej dhomave, së bashku me një pllakë guri që besohet se përdorej si vendosje për trupat. Në vitin 2013, u ndërmor konservimi emergjent, kryesisht në pjesët jugperëndimore dhe veri-lindore të murit për të parandaluar rrëzimin; u pastrua bimësia, dhe u mbush zona përreth për të krijuar një itinerar të sigurt për vizitorët.</p> <p>Gjendja aktuale: Lagështia shkakton rritjen e shpejtë dhe të fuqishme të bimësisë. Myshku mbulon shumicën e sipërfaqeve horizontale dhe fiqtë dhe bimë të tjera që rriten shpejt kanë kolonizuar zonat fushore më të lagështa. Gërmime jo të njëtrajtshme, mbulesa të prishura varresh, arkitra të kalbura druri dhe pishina të thella kontribuojnë në rreziqet që paraqiten nga kjo ndërtesë. Sipërfaqe të paqëndrueshme të mureve si dhe të çara të shkaktuara nga rrënjët e pemëve dhe tronditjet sizmike e shtojnë madhësinë e problemit.</p> <p>Rekomandimet/Veprimet:</p> <ul style="list-style-type: none">- Vijimi i menaxhimit të bimësisë përreth, duke prerë dhe spërkatur me helme pemët që kanë ngelur dhe përdorimi i kujdesshëm i biocidit për të hequr të gjitha bimët shumëvjeçare në muraturë ose brenda perimetrit të ndërtesës. Një "vijë sanitare" pa pemë dhe shkurre drusore duhet të ruhet përreth perimetrit të monumentit- Ripërtëritja dhe nivelimi i zonave të mbushura me ujë- Studimi i mozaikëve dhe konservimi gjatë verës i atyre që janë të mbuluar me ujë- Duhet të ndërmerren vajtme arkeologjike si dhe çdo gërmim tjetër i cili është i nevojshëm për të kuptuar plotësisht ndërtesën. Kjo duhet të përfshijë edhe planifikim për paraqitjen përfundimtare të ndërtesës duke i kushtuar një vëmendje të veçantë niveleve të dyshemesë dhe rrugëve si dhe çdo rrugë përreth dhe përmes strukturës.- Ky gërmim mund të vijojë me konsolidimin e muraturës: mbushjen e të çarave të thella, konsolidimin e sipërfaqeve të sipërme, etj.		
Kategoria 4 – E paqëndrueshme, ka nevojë për punime madhore		


Porta Veriore- periudha e sugjeruar: shek. IV		
Pozicioni	Planimetria	Fotografia 2018
		
<p>Përshkrim i shkurtër: Muratura masive e portës fillestare Helenistike Veriore është ende e dukshme si themel i murit fillestar të jashtëm dhe si spoja gjatë shtesave të mëvonshme në strukturën mbrojtëse. E gjithë zona është tani e mbuluar dhe mbytur nga mbetjet e dheut dhe rrëzimi i gurëve nga shpatet më sipër. Gurët e punuar të së çarës fillestare, të ngjashëm për nga përmasa me gurët që ende qëndrojnë në portën e liqenit na sugjerojnë për një ngjashmëri strukturore ndërmjet dy portave me një rampë të brendshme e cila të çon përgjatë shpatit në brendinë e portës.</p> <p>Ndërhyrjet e konservimit: Nuk ka ndërhyrje konservuese, përveç heqjes së bimësisë në vitin 2007.</p> <p>Gjendja aktuale: Shtegu kryesor turistik kalon në një vijë horizontale për rreth një të tretën e rrugës. Vetë muratura është në gjendje të mirë, përveç nivelit të sipërm ku është shumë e trazuar nga rrënjët e pemëve. Megjithatë në çdo anë të bastionit më sipër muret kanë humbur punimet e bëra në faqet e tyre dhe një shpat i pambështetur prej rrënojash dhe dheu shtrihet nga rruga te rrënojat e murit në nivelin më të poshtëm. (Nga raporti 2009) "Nga vërtetimi aktual kuptohet se gjendja e zonës nën rrugën kryesore e cila përfshin portën Veriore ka qenë e pranueshme vetëm sepse ka qenë e fshehur nga bimësia. Në fakt, zona është në rrezik të një erozioni të mëtejshëm i cili do ta bënte rrugën aktuale edhe më të paqëndrueshme dhe të rrezikshme. Bankinat prej dheu kanë nevojë për përforcues për të parandaluar prishjen e mëtejshme".</p> <p>Rekomandimet/Veprimet (nga raporti i vitit 2009, miratuar nga raporti ZAKB i vitit 2018):</p> <ul style="list-style-type: none"> - Në bashkëpunim me një ekip arkeologësh, zona duhet të pastrohet për të shfaqur strukturat e saj fillestare duke përfshirë themelet e mureve të jashtëm të portës Veriore. Shpatet prej dheu duhet të pastrohen për të shfaqur gurët e mureve të mëvonshëm. Të gjitha pemët dhe rrënjët duhet të hiqen dhe ilaçi të konsolidohet. - Kur të jenë ndërmarrë masat e mësipërme dhe zonat të jetë vrojtuar plotësisht duhet të planifikohet vendosja e kafazeve prej metali, ndoshta duke ndjekur vijën e murit fillestar, këto do të mundësojnë mbështetje për bankinën. - Muratura e pastruar duhet të konsolidohet - Zona midis portës Veriore dhe anës së liqenit duhet të pastrohet rregullisht nga shkurret për të ruajtur aksesin në mure dhe ndërtesa 		
<p>Kategori 4 – E paqëndrueshme, ka nevojë për punime madhore</p>		

Bazilika e Akropolit- periudha e sugjeruar: shek. VI

Pozicioni	Planimetria	Fotografia 2018
		
<p>Përshkrim i shkurtër: Në pikën më të lartë të akropolit, në drejtim të fundit lindor të kodrës, janë rrënojat e një bazilike të hershme të krishtere. Bazilika ishte një strukturë me tre nefe, me orientim lindje-perëndim, me një narteks në perëndim. Nefet anësore ishin të ndarë nga nefi kryesor nga tre kolona të mëdha, gjë që mund të tregojë se ndërtesa ishte me qemer dhe kupolë. Bazilika u gërmua nga Misioni Arkeologjik Italian dhe u zbulua një dysheme me mozaik me dizajn kryesisht gjeometrik, por me një panel që tregonte një portik me imazhin e një krijese nën secilin hark. Stili dhe teknika e mozaikut, së bashku me arkitekturën e kishës, tregojnë se kjo kishë ishte ndërtuar në gjysmën e dytë të shek. VI. (Neritan Ceka pa aty f. 59)</p> <p>Ndërhyrjet e konservimit: Kjo zonë i është nënshtruar një sërë gërmimesh, pastrimesh dhe konservimesh. Të dhënat më të hershme janë nga puna e Misionit Arkeologjik Italian. Në vitin 2007, zona u hap dhe u ekzaminua nga pikëpamja arkeologjike duke vijuar me pastrimin e bimësisë dhe konsolidimin e muraturës. Në vitet 2008-2009 u kryen pastrime të mëtejshme të bimësisë. Në fundin e verës 2009, zona u mbush për të mbrojtur dyshemetë dhe gropat e hapura për shtyllat dhe varret pas kryerjes së punimeve konsoliduese.</p> <p>Gjendja aktuale: Gjendja aktuale vlerësohet si e qëndrueshme.</p> <p>Rekomandimet/Veprimet:</p> <ul style="list-style-type: none">- Menaxhimi i bimësisë brenda mureve dhe përreth monumentit është thelbësor. Në veçanti duhet të pastrohet bimësia mbi dyshemetë e mbuluara me mozaikë.- Konsolidimi i materialeve lidhëse të gurëve në muraturë dhe konsolidim i veshjes së murit- Studimi i konservimit të mureve Helenistike <p>Kategoria 1 – E qëndrueshme dhe e mirëmbajtshme</p>		

Porta Perëndimore - periudha e sugjeruar: e ndryshuar në periudha të ndryshme		
Pozicioni	Planimetria	Fotografia 2018:
		
<p>Përshkrim i shkurtër: Kjo portë u ndryshua gjatë Misionit Arkeologjik Italian. U gërmua për të lejuar kalimin e shinave të lehta të cilat ishin përdorur në misionin e viteve 1920-1930 për depozitimin e mbeturinave. Kjo ishte një portë klasike e cila besohet të ketë pasur një hyrje me dy kanata. Më vonë, gjatë periudhës mesjetare u përforcua me mure dhe porta të tjera për të mundësuar një mbrojtje më të mirë të akropolis. Zona në anën e djathtë të portës ka piktura me afreske në pjesën e jashtme të mureve rrethuese.</p> <p>Ndërhyrjet e konservimit: Në vitin 2007 u krye konservimi i afreskeve. Përveç kësaj nuk ka të dhëna për ndërhyrje të tjera.</p> <p>Gjendja aktuale: Struktura e përgjithshme është e mirë. Veprat klasike janë të qëndrueshme dhe mbijetesa e saj deri në ditët e sotme dëshmon për qëndrueshmërinë e saj. Punimet më të vonshme kanë pësuar humbje të gurëve në faqet e tyre duke e lënë brendinë të zbuluar dhe të cenueshme. Bimësia është kërcënimi kryesor për qëndrueshmërinë e muraturës dhe çdo fugë e hapur dhe pjesë e zbuluar e brendshme është një vend potencial për rritjen e pemëve dhe shkurreve të reja dhe të vjetra. Ky nuk është dhe aq një kërcënim ndaj muraturës klasike e cila ka një cilësi dhe masë më të madhe por që mund të jetë katastrofike ndaj muraturës me cilësi më të dobët.</p> <p>Rekomandimet/Veprimet (nga raporti i vitit 2009) :</p> <ul style="list-style-type: none"> - Pastrimi të gjithë bimësisë nga muratura dhe nga 'zona sanitare' të paktën deri në katër metra afër muraturës. Rrënjët e mbetura duhet të spërkatën me helm dhe monitorohen nëse rriten përsëri. Rrënjët që lihen pa jetë duhet të monitorohen për kalbëzim dhe nëse nuk janë hequr nga muratura përreth kur të jenë zbutur mjaftueshëm. Muratura duhet të konsolidohet me llaç të ri kur rrënjët të jenë hequr - Dokumentimi i detajuar i mureve pasi të jetë hequr bimësia dhe dheu i lirë - Pas dokumentimit e gjithë muratura e lirë duhet të konsolidohet me llaç të ri dhe të mbushen fugat e hapura thellë dhe të çarat. - Një konservator i pikturave murale me aftësi të mjaftueshme dhe të certifikuara duhet të pyetet për konservimin e fragmenteve të pikturave murale që kanë mbetur. Ndërhyrjet e mëparshme dhe të fundit kanë përshpejtuar prishjen e punimeve dikur të shkëlqyera dhe fatkeqësisht tani ka ngelur pak për konservim. 		
<p>Kategoria 4 – e paqëndrueshme, ka nevojë për punime madhore</p>		

Forum Romak me burimet e shenjta; ndërtesa me tri pjesë; tempulli me dy kate; bazilika; forumi; taberna; curia



Ndërtesa me tre dhoma - periudha e sugjeruar: shek. I ose më herët

Pozicioni	Planimetria	Fotografia 2018

Përshkrim i shkurtër: E ndodhur në fundin verior të sheshit qendror të qytetit të lashtë, që daton në shek. I pas Kr. ose më herët, ndërtesa me tre dhoma ishte fillimisht një strukturë e madhështore ku ndodheshin tempujt Romakë. Një mbishkrim për Minerva Augusta i gjetur në dhomën qendrore na sugjeron se ndërtesa me tre dhoma ishte një *capitolium*, që përfshinte tempujt për Jupiterin, Junon dhe Minervën. Pesë shkallë mermeri të çonin sipër nga dyshemeja e forumit dhe fasada e ndërtesës ishte e pikturuar me ngjyrë të bardhë, duke krijuar shkëlqimin reflektues që ishte i zakonshëm për tempujt Romakë. Fundi verior i forumit dihet se përfshinte ndërtesën me tre dhoma, të ashtuquajturën "magazinën" (dhoma depo) në lindje të saj. Tani është e qartë se "magazina" me qemer është aktualisht një ndërtesë me dy kate ku mund të hyhej me anë të rreth 20 shkallëve prej mermeri nga dyshemeja e forumit, duke e bërë atë strukturën më të dallueshme në forum, ndoshta edhe një tempull të kultit perandorak.

Ndërhyrjet e konservimit: Në vitin 2009 u ndërmor një program mirëmbajtjeje për të konsoliduar zonat e gërmuara duke vendosur rrjeta çeliku inoks, dhe duke kryer mbushjen e muraturës, ri-mbushjen e sipërfaqes së forumit, pastrimin e algave dhe lëneve, heqjen e ujit nga pjesa veri-perëndimore e forumit.





Gjendja aktuale: Në përgjithësi struktura është në gjendje të mirë por me tre probleme të mëdha: pjesa veriore e murit në dhomën e parë ka një sipërfaqe prej 1.5m² e cila është duke u anuar drejt brendisë së dhomës (shkronja h në imazh), kolona me tulla në pjesën jugperëndimore të dhomës një (shkronja j në imazh) ka nevojë për konsolidim dhe sipërfaqja ka nevojë të mbushet, muri me tulla (pjesa k në imazh) ka një të çarë që duhet konsoliduar

Rekomandimet/Veprimet:

- Konsolidimi dhe mbushja e të gjitha mureve
- Veshja e muraturës
- Menxhimi i bimësisë
- Vendosja e çelikut inoks për gatë pjesëve që nuk kanë përfunduar
- Pastrimi dhe kullim i ujit
- Konsolidim i kolonës me tulla
- Konsolidim i murit me tulla
- Pastrimi dhe konsolidimi i hapësirës së ashtuquajtur magazinë
- Monitorimi i pjesës së murit në dhomën e parë

Kategoria 2 – E qëndrueshme, ka nevojë për punime të vogla

Forumi Romak - periudha e sugjeruar: shek. I (jo plotësisht i zbuluar)		
Pozicioni	Planimetria	Fotografia 2018
		
<p>Përshkrim i shkurtër: Pranë shtigjeve të vizitorëve mund të shihen skajet veriore dhe jugore të Forumit Romak. Forumi Romak ka një drejtim lindje-perëndim paralel me kodrën e Akropolit. U përdor deri në shek. III. Gërmimet e fundit kanë zbuluar dyshemenë e forumit e ndërtuar prej pllakave të bardha guri gëlqeror. Përreth dyshemesë, mund të shihet një kanal, i ndërtuar për të kulluar ujin nga forumi si dhe disa ndërtesa. Ndërtesa që rrethojnë forumit ishin pjesë të tij, dhe forumi u ngrit me dy nivele. Kompleksi i forumit vijon në drejtim të lindjes. Gërmimet përfunduan në vitin 2014 dhe rezultatet e tyre janë duke u studiuar.</p> <p>Ndërhyrjet e konservimit: Pjesë të reja të gërmuara në vitin 2014.</p> <p>Gjendja aktuale: Gjendja e pjesëve të gërmuara rishtasi në pjesën lindore është shumë e dobët. Pjesët e gërmuara nuk janë stabilizuara, rrënojat nuk janë konservuar ose mirëmbajtur.</p> <p>Rekomandimet/Veprimet:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Pjesa lindore e Forumit ka nevojë të dokumentohet, publikohet dhe duhen propozuar ndërhyrje konservimi - Menashimi i bimësisë <p>Më pas :</p> <ul style="list-style-type: none"> - Të krijohet interpretimi i rrënojave të gërmuara - Shtigjet e vizitorëve duhet të çojnë drejt Forumit (pjesa lindore) 		
Kategoria 4 – E paqëndrueshme, ka nevojë për punime madhore		

Pusi (burimi) i shenjtë – periudha e sugjeruar: shek. IV para Kr.		
		
Pozicioni	Planimetria	Fotografia 2018
		
<p>Përshkrim i shkurtër: Në afërsi të stoas, një guvë 4 m e thellë ishte e mbushur me ujë. E anuar mbi murin masiv që lidhet me stoan, besohet se ky burim përdorej që nga shek. IV para Kr. Gryka e burimit është veshur me pllaka të marra nga monumentet më të hershme dhe sipër është pajisur me një qemer prej tullash.</p> <p>Ndërhyrjet e konservimit: Restaurimet e viteve 1990 janë të dukshme në pjesën e qemerit. Mbi pllakat e mermerit që mbulojnë hyrjen, dallohen lidhjet në kornizën e gurtë të derës. Mbushja nuk ekziston në fugat, megjithëse kjo nuk ka ndikuar qëndrueshmërinë. Harku prej tullash mbi hyrje është rindërtim i mëvonshëm.</p> <p>Gjendja aktuale: Lidhjet te korniza e gurtë e derës janë të dukshme mbi pllakat e mermerta që mbulojnë hyrjen. Mbushja mungon te fugat, por kjo nuk ka ndikuar shumë. Është e dukshme se disa nga tullat e qemerit kanë humbur pjesë të tyre dhe disa lidhje janë bosh. Megjithatë, struktura duket e qëndrueshme.</p> <ul style="list-style-type: none"> - Menaxhimi i bimësisë - Konsolidimi i harkut dhe qemerit. 		
Kategoria 1 – E qëndrueshme dhe e mirëmbajtshme		

Struktura Romake me dy dhoma		
Pozicioni	Planimetri	Fotografia 2018
		
<p>Përshkrim i shkurtër: Pas kompleksit të forumit Romak në anën verilindore, në shpatin e kodrës së akropolit gjendet një strukturë Romake me dy dhoma. Funkzioni i kësaj hapësire mund të ketë qenë publik. Kjo ndërtesë nuk është bërë kurrë e vizitueshme. Ky monument është gërmuar nga Ugolini në vitin 1939, por nuk janë gjetur gjurmë të shkruara në lidhje me këtë ndërtesë. Nga një krahasim analogjik me struktura të ngjashme, veçanërisht me ato që gjenden në pjesën lindore të Forumit, ne mund ta vendosim këtë ndërtesë në shek. I.</p> <p>Ndërhyrjet e konservimit: Në vitin 2015 ndërtesa u pastrua nga bimësia, por nuk u ndërmor asnjë konservim.</p> <p>Gjendja aktuale: Pjesët e sipërme të murit janë në gjendje jo të mirë, dhe për shkak të rrënjëve të pemëve ky mur nuk është i qëndrueshëm. Të çarat janë të dukshme përgjatë muraturës. Pjesët prej tullave mungojnë pasi janë prishur nga rrjedhjet e ujit nga shpati i kodrës. Përderisa ka qenë e mbuluar për një kohë të gjatë, ndërtesa është e mbuluar me lëkencë dhe myshqe, ndërsa lidhjet janë prishur. Dheu sipër dhe pas mureve është duke krijuar presion të konsiderueshëm si rrjedhojë e bimësisë të pakontrolluar.</p> <p>Rekomandimet/Veprimet:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Menaxhimi dhe pastrimi i bimësisë, veçanërisht përgjatë muraturës, pastrimi i lëkencave, heqja e rrënjëve, krijimi i një zone buferike duke hequr bimësinë minimalisht 2 m larg nga muratura, heqja e pemëve në anën veriore të monumentit dhe në brendi - Konsolidimi i të gjitha të çarave dhe rivendosja e gurëve dhe tullave që lëvizin. - Investigim arkeologjik për të kuptuar funksionin dhe rolin që kjo strukturë mund të ketë pasur - Dokumentim i plotë i ndërtesës - Interpretim i strukturës 		
Kategoria 3 – E qëndrueshme, ka nevojë për punime madhore		

Teatri me zonën e teatrit; faltore/thesar; Pritaneumi; Stoa; Peristili; Banja; Muri jugor i Temenos (Porta e Asklepit); stoa, afresk kishe

24. the Theatre area



Zona e teatrit – periudha e sugjeruar: shek. III para Kr. (Ndërtimi më i hershëm)

Pozicioni	Planimetria	Foto 2018

Përshkrim i shkurtër: Përveç funksionit të teatrit, kjo ndërtesë mund të ketë funksionuar si një dhomë këshilli dhe një qendër fetare për qytetarët e Butrintit dhe të rajonit. Të dhëna epigrafike nga tempulli i Asklepit dokumentojnë se teatri ishte ndërtuar me fondet e dhuruara për tempullin. Teatri fillestar, që daton në shek. III para Kr., ishte i ndërtuar brenda një strukture katrore e cila ishte 100 këmbë Epirote (28.5 metra), në çdo anë, duke qenë i mbështetur mbi shpatin e kodrës. Mbështetet nga një përforcues anësor, duke përdorur një teknikë të ngjashme inxhinierike si ajo që ishte përdorur për teatrin në Dodona. Janë 23 rreshta me ulëse, të ndarë në pesë pjesë me nga gjashtë sete shkallësh. Rreshti i parë i vendeve ishte i dekoruar me këmbë e luanit. Në rreshtin e 12 është një rresht me blloqe të mbishkruar, disa me dedikime për Asklepin, dhe të tjera dokumentojnë lirinë e skllevërve nga të zotërit e tyre. Ky rresht me blloqe formonte diazomën e cila ndante ulëset për elitën nga ulëset për qytetarët e zakonshëm. Rreshtat fillestarë të uljes duhet të kenë pasur një kapacitet prej 2.500 personash. Në pjesën e pasme të teatrit, aty ku është i zbuluar guri natyral, në gur ishin gdhendur vende të tjera për t'u ulur. Në pikën më të lartë, ishin prerë shkallë të cekëta për të dhënë përshtypjen e uljes dhe për ta bërë teatrin të dukëj më i madh se sa ishte. Me krijimin e kolonisë romake, një *scenae frons* (ndërtesë për skenën) iu shtua pjesës anësore të orkestrës, tani e dukshme si një strukturë prej tullash me gjashtë nise. Kjo bllokonte pjesërisht rrugën e shenjtë ndërsa ajo kalonte pranë teatrit për në *prytaneum*. Në të njëjtën kohë një portik ishte rindërtuar përgjatë anës jugore të rrugës së shenjtë, përkundraill skenës së re, dhe kolonat prej tulle të tij mund të shihen në strukturën e mëvonshme të skenës. Teatri u rimodelua plotësisht në shek. II. U ndërtua një tjetër *scenae frons* e cila mbyllte plotësisht rrugën dhe bëri të nevojshme prishjen e portikut. Në të njëjtën kohë tempulli i Asklepit u rindërtua dhe formoi themelet e një radhe tjetër ulësesh, mbi tempull, në anën perëndimore të teatrit, i pasqyruar nga një breg i ngjashëm në anën lindore. Një hyrje e re për në teatër u ndërtua në nivelin e diazomës, me akses përmes vomitorias. Në pjesën perëndimore hyrja për në vomitorium ishte përmes një kalimi të ngritur mbështetur mbi pilastra. Kjo rrugë të çonte në dhomën e cila mbronte guvën e Asklepit. Në pjesën lindore, rruga hyrëse ishte më pak e qartë. Një shkallare ekziston ende, por nuk dihet rruga përmes ndërtesës fqinje.

Teatri u gërmua në fund të viteve 1930 nga Misioni Arkeologjik Italian. Gërmimet zbuluan një sërë statujash mbresëlënëse nga zonat përpara skenës. Kur ndërtesat si teatrot braktisen, statujat dhe mermerët zakonisht hiqen dhe përdoren diku tjetër, ose copëtohen për të bërë gëlqere, kështu që zbulimi i këtyre statujave të mira in situ është jashtëzakonisht i pazakontë. Një hipotezë për këtë është se teatri mund të jetë shkatërruar nga ngjarje

dramatike, si për shembull tërmeti i vitit 360 pas Kr., ku statujat mbeten nën rrënojat deri në gërmimin e tyre në shek. XX (Neritan Ceka: *po aty*).

Ndërhyrjet e konservimit: Pjesë të konsiderueshme të *scenofrons* janë rindërtuar dhe punimet konsoliduese janë kryer në pjesët e sipërme të mureve. Këto punime kanë ardhur si rezultat i një fushate të Institutit të Monumenteve në vitet 1980. Janë ndërtuar shkallë të reja prej guri ndërmjet pjesëve për t'u ulur. Restaurimi është i justifikuar nga përdorimi i teatrit si një hapësirë bashkëkohore performancash, veçanërisht kur duhet të merreshin parasysht aspektet e sigurisë. Në pjesën më të madhe janë zgjedhur gurë të rinj dhe janë vendosur mirë dhe aty ku shkëlqimi i gurëve të rinj të vret sytë ai do të zbehet nga gërryerjet dhe patinimi (Nga raporti i vitit 2009).

Gjendja aktuale (nga raporti i vitit 2009): Ulësja e teatrit nuk është e niveluar, por ky nuk është një defekt që mund të rregullohet lehtësisht ose që po shkakton probleme. Riparimet e mëparshme të shkallëve po zbehen dhe do të bëhen më të pranueshme nga sa dukeshin fillimisht. Ato tregojnë më së miri vështirësinë e rindërtimit të elementëve arkitekturor kur vija flëstare ka humbur nga lëvizjet. Nuk është me vend që gurët e mbetur nga ky program riparimesh të lihen të braktisura në këtë zonë. Duhet të vëzhgohet kalbja në shkallën e fundit, pasi këtu ka një sërë çarjesh dhe disa copa gurësh janë të lirë dhe mund të bien në ujë. Disa nga rreshtat e sipërm që qëndrojnë veçmas janë në rrezik dhe këtu duhet të ndërtohen përforcues prej betoni, dheu ose materiale të ngjashme për të parandaluar këto rreziqe. Nevojitet një trase 8 m, afërsisht 600 mm e lartë, dhe është e rëndësishme që ajo të mos duket si mur, por si një shpat i qëndrueshëm. (nga *Vrojtimi i Gjendjes 2001*) Në përgjithësi teatri është në gjendje të mirë me pak probleme bimësie. Megjithatë ka dy problematika. Së pari zona e uljes: është në nivel të ulët siç edhe mund të pritët nga një ndërtesë e cila ka pësuar trazime sizmike, zona të pasheshuara dhe çarje. Lart në auditorium kemi një problem më të madh. Mungon një pjesë për ulje, me gjasë e ripërdorur. Mbi gurët që mungojnë pjesa tjetër e ulësës në disa vende është e rrezikuar dhe e cenushme. Shqetësimi i dytë ka të bëjë me panelet e lirimet nga skllavëria, të dhëna të rëndësishme të shikruara të ngjarjeve të shikuara dhe rëndësishme kulturore. Duket sikur ka leshkërim si dhe çarje të vogla të këtyre gurëve të cilat janë të vështirë për t'u matur pa një program monitorimi.

Rekomandimet/Veprimet (nga raporti i vitit 2009 i miratuar nga raporti i kryer nga stafi i ZAKB në vitin 2018)

- Ka nevojë për menaxhim të vizitorëve në mënyrë që teatri të mos dyndet
- Duhet të gjendet një zgjidhje që është e mirë nga ana strukturore dhe e pranueshme nga ana vizuale për të përforcuar uljet prej guri në nivelet më të larta në teatër. Vrojtimi i vitit 2001 përmend se riparimet 'nuk duhet të duken si një mur, por një shpat i stabilizuar'. Plotësimi i kësaj kërkesë do të jetë i vështirë për t'u plotësuar. Të vijojë puna e kryer deri tani, me mur prej gurësh të thatë të vendosur mirë.
- Duhet të institucionalizohet një program monitorimi për të përfshirë lirimet nga skllavëria në teatër, ato në murin e ri të mbishkrimeve dhe ato që janë ende të pranishme në rrënojat e Kullës së Mbishkrimeve. Humbja e këtyre paneleve do të ishte tragjike dhe duhet të mendohet për vendosjen e një kampioni të tyre brenda strehës dhe mjedisit të kontrolluar të një mjedisi.
- Sistemimi i gurëve
- Menaxhimi i bimësisë
- Mirëmbajtja e skenës prej druri
- Pastrimi, konsolidimi dhe meremetimi i muraturës së lirë të teatrit dhe ndërtesave përreth
- Duhet të fillojë studimi hidrologjik për të kuptuar efektin e ujit në nivelet e mëposhtme

Kategoria 2 – E qëndrueshme, ka nevojë për punime të vogla		
Faltorja/Thesari- periudha e sugjeruar: shek. III		
Pozicioni	Planimetria	Fotografia 2018
		
<p>Përshkrim i shkurtër: Faltorja kushtuar Asklepit është ngritur në vendin e një guve natyrale, me gjasë vendi i një burimi. Ndërtesa e parë e shenjtë, e ndërtuar me blloqe gëlqerore, kishte planimetri të thjeshtë. Ajo kishte dy dhoma, e pasmja me një dritare e cila shikonte në guvë. Një portikë e thjeshtë e mbështetur nga dy kolona formonte fasadën.</p>		

Gjatë gërmimeve të Misionit Arkeologjik Italian këtu janë gjetur objekte qeramike ex-voto, kryesisht të shek. III para Kr.. Në shek. II pas Kr., faltorja u rindërtua. Megjithëse ruajtja përmasat e saj fillestare, tani ajo ishte i ndërtuar me beton me fasadë tullash. Shumica e kësaj strukture ekziston ende. Fasada ishte e thjeshtë në formë, me një derë në qendër dhe dritare në anë për të lejuar dritën që të hynte në dhomën përballë. Dyshemeja dhe altari i faltores fillestar u ruajtën, ashtu si dhe hapja e dritares në gjuhë. Ky rindërtim ishte pjesë e një riorganizimi të madh të teatrit, ku qemeri i ndërtesës së tempullit përdorej si një bazë për zgjerimin e vendeve ulëse në teatër. Dedikimi i qytetit ndaj kultit të Asklepit konfirmohet nga mbishkrimi i shek. të III para Kr. Këto mbishkrime dokumentojnë priftërinjtë e tempullit dhe një, në veçanti, dedikuar prifti Filistit, përmban dedikimin për tempullin e Asklepit. Mbishkrimet janë një burim shumë i rëndësishëm informacioni për të kuptuar historinë e Butrintit. Shumë prej tyre japin detaje në lidhje me lirinë e shkëlqerjeve që i dha një dinamikë sociale historike të qytetit, ndërsa të tjerat dëshmojnë për statusin administrativ të Butrintit në lidhje me sitet e tjera si Finiqi. Disa dokumentojnë se nga erdhën fillimisht qytetarët, disa prej të cilëve përmendet se ishin deri edhe nga Nikopoja (afërsisht 160 km në jug të Butrintit).
(*Neritan Ceka: po aty*).

Ndërhyrjet e konservimit: (Nga raporti i vitit 2009) Faltorja/thesari ishte një nga ndërtesat kryesore në Butrint, një prej të parave që u gërmua nga Ugolini dhe i cila iu nënshtrua restaurimeve të mëdha në vitet 1980. Gjatë asaj periudhe, të cilën survejuesi e sheh si "periudha e rindërtimit të harkut të madh në historinë e Butrintit", u ndërtuan harqe të reja me tulla si për të theksuar detajet e hamendësuarashtu edhe për të përfunduar muraturën pa mbështetje. Është një kohë kur në park, në shumë ndërtesa, (pusi i shenjtë, scenoë frons, bazilika e madhe, faltorja/thesari, pusi mbi ndërtesën me tre pjesë etj.) u rindërtuan një numër i madh i harqeve. Përgjatë dhe mbështetur nga harqet është një sasi e madhe murature e rindërtuar. Në brendësi ka suva e cila është ende e pranishme në kalimin me qemer të dhomave kryesore në lindje. Kjo është me interes të veçantë sepse shenjat fillestare të kanatave mund të shihen ende në sipërfaqen e suvatuar. Sipërfaqja e përfunduar pothuajse ka humbur. Suvaja bazë është shkëputur keqas në disa dhe ka humbur në të tjera duke kërkuar kështu konsolidim dhe riparim.




Gjendja aktuale: (Nga raporti i vitit 2009) Fasada perëndimore e ndërtesës paraqet aspektin më të neglizhuar. Bimësi, të çara dhe mbushjet e lira janë të gjitha të dukshme. Edhe pse në veri të kësaj pjesë të ngritur është një hark prej tullash i rindërtuar, pjesa tjetër duke sikur është anashkaluar nga ndonjë fushatë konservimi ose konsolidimi. Është e vështirë që t'i bësh bashkë trajtimin që i është bërë pjesëve të ndërtesës përballë teatrit me trajtimin të dy pjesëve të tjera të ngritura më pak të dukshme, përveç kur marrim në konsideratë natyrën bashkëkohore të teatrit arkeologjik, si një 'teatër', si një hapësirë performance më shumë se sa një entitet arkeologjik.

Rekomandimet/veprimet:

- Heqja e të gjithë bimësisë nga muratura në të gjitha pjesët e ngritura të ndërtesës duke përfshirë pjesët që shikojnë lart. Heqja e të gjithë bimësisë që ka natyrë drusore shumëvjeçare nga bazamenti i ndërtesës në një distancë deri në katër metra.
- Rivendosija e të gjithë gurëve të lirë dhe rimbushja e fugave të hapura
- Mbushja e thellë e të gjitha të çarave dhe monitorim për të vlerësuar lëvizjet bashkëkohore
- Mbushja anësore e të gjithë suvasë së brendshme dhe lidhje të zonave të shkëputura
- Pastrimi i sipërfaqeve të brendshme të dyshemesë nga mbeturinat dhe mbetjet.

Kategoria 2 – E qëndrueshme, ka nevojë për punime të vogla

Prytaneum- periudha e sugjeruar: shek. I (pas shumë ndryshimeve)

Pozicioni	Planimetria	Fotografia 2018
		
<p>Përshkrim i shkurtër: <i>Prytaneumi</i> ndodhet në fundin perëndimor të rrugës së shenjtë, pranë një prej bastioneve të mëdha të murit rrethues të qytetit. Ishte një vend ku magistratët i drejtoheshin njerëzve, bënin sakrifica dhe mbanin gosti. Në fazën e tij më të hershme, kishte një oborr qendror të rrethuar nga një portik jonik nga i cili shkohej për në dhoma. Hyrja ishte në anën lindore, përballë rrugës. Ndërtesa u rimodelua në disa raste, me ndryshime thelbësore në shek. I, në kohën e themelimit të kolonisë Romake. Këto ndryshime përfshinin një rritje të numrit të dhomave që të çonin në portik, shtimin e një dyshemeje të re dhe përmirësimin e aksesit nga rruga e shenjtë nëpërmjet vendosjes së pillakave prej guri gëlqeror. Mbetjet e një burimi të vogël që ishte vendosur në anën veriore të rrugës mund të shihen ende, ashtu si dhe pjesa e një portiku që u shtua në anën jugore të rrugës, me gjasë në</p>		

në të njëjtën kohë. Burimi, i cili mund të ishte furnizuar nga ujësjellësi i ri, ruan disa pjesë nga suvaja e tij ngjyrë e kuqe dhe blu e zbehtë që ishte përdorur për dekorimin e tij, ndërsa themelet e këmbëve të portikut ruhen edhe sot në një mur të mëvonshëm. Sponsori kryesor i kësaj pune, Lucius Domitius Ahenobarbus, një mbrojtës i kolonisë së re, i ruajti punimet e tij në një mbishkrim të gdhendur në pllakat e rrugës së shenjtë pranë hyrjes për në *prytaneum*.⁷ (Neritan Ceka: *po aty*).

Ndërhyrjet e konservimit: *Prytaneumi* u konservua menjëherë pas gërmimit të tij në vitet 1980. Gjatë kësaj kohe, veshja e murit u bë me beton dhe kjo krijoi probleme. Në vitin 2008 u krye konsolidimi polikromik i suvasë në anën veri-lindore të ndërtesës.




Gjendja aktuale: Muratura në përgjithësi nuk është e qëndrueshme dhe kjo është më e dukshme në pjesët në veri; Gurë kanë rënë nga pozicionet e tyre fillestare dhe lidhjet janë pothuajse jo ekzistente, gjë e cila mund të çojë në rënien e strukturës. Pjesë mesjetare të muraturës janë gjithashtu të paqëndrueshëm, veçanërisht në pjesët e themeleve si dhe përgjatë pjesëve jugperëndimore. Sipërfaqja e suvatuar ka nevojë për konsolidim.

Rekomandimet/veprimet:

- Menaxhimi i bimësisë: në pjesën veriore të monumentit duhet të krijohet një zonë buferike 2 m duke hequr të gjithë bimësisë. Pastrimi dhe konsolidimi i shkallëve;
- Heqje e kujdesshme e veshjes prej çimento të mureve; restaurim i veshjes së mureve duke përdorur llaç prej gëlqereje hidraulike; përpara veshjes duhet të fillojë pastrimi; konsolidimi i muraturës dhe rimbushja;
- Konsolidimi i sipërfaqeve të suvatuara
- Menaxhimi i bimësisë në pjesët mesjetare; riparime të dyshemesë; gërmime arkeologjike
- Pastrimi i sipërfaqeve të dyshemesë përpara hyrjes për në *Prytaneum*; me një vëmendje të posaçme ndaj shkronjave prej plumbi të cilat kanë nevojë të konservohen

Kategoria 3 – E qëndrueshme, ka nevojë për punime madhore

Stoa - periudha e sugjeruar: shek. IV para Kr.

Pozicioni	Planimetria	Foto 2018
		

Përshkrim i shkurtër: Në lindje të teatrit një strukturë e madhe kalon përgjatë shpatit të kodrës në drejtimin lindje-perëndim. Ndërtesa, e cila është më e hershme se teatri interpretohej si një stoa (një ndërtesë e gjatë me kolona e cila ofronte strehë nga erërat, reshjet, etj. dhe e cila mund të përdorej gjithashtu si një treg, dhomë këshilli, klasë ose një vend i përgjithshëm takimi). Sipërfaqet e jashtme të murit të kësaj ndërtesë kishin punim shumë më të mirë nga ato të brendshmet ndoshta sepse ishte në rrugën ceremoniale të përdorur nga ata që vizitonin tempullin e Asklepit.⁸ (Neritan Ceka: *po aty*)

Ndërhyrjet e konservimit: Disa punime konservuese janë të dukshme, dhe me shumë gjasë datojnë në vitet 1990




Gjendja aktuale: Struktura duket e qëndrueshme

Rekomandimet/veprimet:

- Studime të mëtejshme të strukturës për konservim
- Menaxhimi i bimësisë mbi dhe përreth monumentit

Kategoria 1 – I qëndrueshëm dhe i mirëmbajtur

Peristil - periudha e sugjeruar: shek. II		
Pozicioni	Planimetria	Fotografia 2018
		
<p>Përshkrim i shkurtër: 'Kjo është një strukturë enigmatike, e cila daton kryesisht në shek. II para Kr.. Qendra e ndërtesës formohet nga një portik katror prej 12 kolonash jonike përreth një impluviumi (pellgu). Tre krahë, secili me disa dhoma, disa prej të cilave kanë dekorim të pikturuar, të çojnë në portik në jug, lindje dhe perëndim. Gjetjet e gërmuara sugjerojnë se ishte një ndërtesë publike që shërbente si teatër. Qëndroi në përdorim deri në shek. IV, megjithëse u kryen disa riparime dhe modifikime. Rrënojat më të hershme, që datojnë nga shek. I, janë në këndin juglindor të zonës së gërmuar. Janë dy mure, të ndërtuara në opus mixtum, të cilat mund të formonin një pjesë të një ndërtese katrore me portik me drejtim nga lindja, dhe me gjasë përballë një rruge. Rruga në të cilën ndodhet të çon në veri, në një pus (ende i dukshëm dhe i ruajtur mirë) dhe të dy shkallare të cilat vijonin sipër në shpatin e kodrës.' (Neritan Ceka: <i>po aty</i>).</p> <p>Ndërhyrjet e konservimit: Nuk ka punime konservimi, përveç menaxhimit të vazhdueshëm të bimësisë</p> <p>Gjendja aktuale: Struktura duket e qëndrueshme</p> <p>Rekomandimet/veprimet:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Menaxhimi i bimësisë në dhe përreth monumentit - Meremetimi i gurëve të lirë; konsolidimi i muraturës dhe veshjes së murit të muraturës <p>Kategoria I – I qëndrueshëm dhe i mirëmbajtshëm</p>		

Banja romake - periudha e sugjeruar: shek. I - II		
Pozicioni	Planimetria	Foto 2018
		
<p>Përshkrim i shkurtër: Si rrjedhojë e rreshtimit të saj me rrugën e shenjtë dhe përdorimit të opus mixtum në ndërtim, me shumë mundësi, banja është ndërtuar në të njëjtën kohë kur <i>scenae frons</i> dhe portiku iu shtuan teatrit, pra, kur u krijua kolonia Romake. Ndërtimi përfshiu prishjen e murit <i>temenos</i>, duke nënkuptuar se kishte një riorganizim të qendrës së Butrintit. Banja lu nënshtrua një sërë modifikimesh, duke përfshirë punime të mëdha në pjesën e parë të shek. II (datimi nga tullat opus testaceum) dhe vijoi të përdorej deri në shek. IV ose shek V. Nuk është gërmuar plotësisht, kështu që madhësia dhe planimetria nuk dihen plotësisht. Megjithatë aktualisht është banja më e madhe në Butrint.</p> <p>Dhoma kryesore ka një mozaik të punuar mirë me ngjyrë të zezë dhe të bardhë me stola mermeri përkundrejt çdo muri. Në perëndim të dhomës kryesore është <i>tepidarium</i> (dhoma e ftohtë) dhe në jug është <i>caldarium</i> (dhoma e ngrohtë). Një banjë me ujë të ftohtë ndodhet në absidën e vogël në perëndim. Këto dhoma ngroheshin nga një sistem hipokausti (një pjesë e të cilit është rindërtuar).’ (Neritan Ceka: <i>po aty</i>).</p> <p>Ndërhyrjet e konservimit: Banja u rindërtua në mënyrë të konsiderueshme për ekspozitë në vitet 1980 pasi u gërmua. Pjesët e sipërme të mureve janë konsoliduar dhe zonat me tullat romake janë rindërtuar. Punimi më i mirë është rindërtimi i një dyshemeje hipokausti me mbështetje pilastrash (raport i vitit 2009). Në vitin 2008 u hap dhoma me mozaikë, në të cilën u krye pastrimi si dhe u bë rimbushja. Nga vera e vitit 2010 mozaikët hapen çdo vit për të monitoruar gjendjen e tyre dhe për t'i bërë ata të vizitueshëm. Gjatë kësaj periudhe u krye konsolidimi i mozaikëve si dhe riparimi i zgavrave duke zëvendësuar mbushjen me çimento. Gjatë vitit 2012 u riparuan kolonat e hipokaustit.</p> <p>Gjendja aktuale: Prania konstante e ujit po shkakton dëmtime në muraturën prej tulle, megjithatë, struktura duket e qëndrueshme.</p> <p>Rekomandimet/Veprimet:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Menaxhimi i bimësisë në dhe përreth monumentit - Meremetimi i gurëve të lirë, konsolidimi i muraturës dhe veshja e muraturës prej guri - Monitorimi i mozaikëve - Analizë konservimi për konsolidimin e muraturës prej tullash - Rimbushje deri në 10 cm mbi nivelin e ujit 		
Kategoria 2 – E qëndrueshme, ka nevojë për punime të vogla		

Afresk i Kishës së Stoas

Fotografia 2018



Përshkrim i shkurtër: 'Mbetjet e një tjetër kisha janë të dukshme më lindje të Teatrit, ku rrënojat e një pikturë murale mund të shihen në murin sipër strukturës Helenistike e cila mendohet të jetë një stoa. Kisha ishte një ndërtesë e vogël, pak më shumë se një kapelë. Muri i saj verior ishte 4.75 m i gjatë. Pozicioni i murit hyrës përëndimor është i shënuar nga blloqe të dala dhe një e çarë vertikale deri në mur, ndërsa pozicioni i përafërt i absidës mund të përcaktohet deri diku nga fundi i suvasë që mbulonte murin.

Muri është i pikturuar nga një rend prej pesë ose gjashtë figurash shenjtorësh më të mëdhenj se trupi i një njeriu. Këta janë të vendosur në panele katër këndore të kornizuar nga shirita të kuq 354 mm me kontur të bardhë. Panelet fillojnë rreth 0.15 m mbi dyshemenë e suvatur të kishës dhe janë 1.83 m të lartë, me gjerësi që varion nga 0.58 në 1.05 m. Meqenëse muri ishte i zbuluar, ai është prekur nga kushtet atmosferike dhe sipërfaqet e pikturuara janë shumë të prishura.'

Ndërhyrjet e konservimit: Afresku u konservua në vitin 2007. Në vitin 2009 u ndërmorën konservime të tjera të cilat fatkeqësisht kishin efekte të dëmshme në afresk. Një strukturë e thjeshtë është e ndërtuar në mur për ta mbrojtur afreskun nga kushtet atmosferike.

Gjendja aktuale: Shumë e dobët si rrjedhojë e konservimit në vitin 2009

Rekomandimet/Vepimet:


- Analizë konservimi e mënyrave se si ishte aplikuar afresku; Kjo do të mundësonte të dhëna me shumë në lidhje me teknikat e ndërtesës si dhe për kulturën dhe historinë e periudhës së identifikuar
- Ndalimi i prishjes së mëtejshme të afreskut
- Konsolidimi i të gjitha shtresave: *arriccio* me murin dhe *intonakos* me *arriccio*; mbushja e sipërfaqes ndërmjet murit dhe *arriccio*; rimbushja e boshllëqeve; konsolidimi dhe krijimi i anëve përreth sipërfaqeve të mbetura;
- Mbushje e të çarave

Kategoria 3 – E qëndrueshme, ka nevojë për punime madhore

Nimfeu i vogël - periudha e sugjeruar: shek. II		
Pozicioni	Planimetria	Fotografia 2018
		
<p>Përshkrim i shkurtër: Nimfeuka formën e një nikeshe, e cila është e ndërtuar me tulla dhe e suvatuar. Brenda strukturës së saj është një banjë e cila ishte e mbushur nga kanalet me ujë.</p> <p>Ndërhyrjet e konservimit: Nuk ka punime konservimi të dukshme.</p> <p>Gjendja aktuale: Prania konstante e ujit po dëmton muraturën prej tullash, ndonëse struktura duket e qëndrueshme.</p> <p>Rekomandimet/Veprimet:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Monumenti ka nevojë të pastrohet nga likenet dhe myshqet - Meremetimi i gurëve të lirë, konsolidimi i muraturës dhe veshjes së muraturës - Konservimi i sipërfaqeve të suvatuara brenda nikesë dhe jashtë saj 		
Kategoria 2 – E qëndrueshme, ka nevojë për punime të vogla		

Tempulli i Asklepit- periudha e sugjeruar: shek. III para Kr.		
Pozicioni	Planimetria	Fotografia 2018
		
<p>Përshkrim i shkurtër: Tempulli i sipërm, pas teatrit, është ndërtuar në shek. III para Kr. Kishte një portik të mbështetur nga dy kolona dhe dy pilastra (të cilat nuk janë më të pranishme). Naosi ishte i ndërtuar me blloqe të mëdhenj, i suvatuar dhe me pas i lyer me gëlqere. Në pjesën e pasme të tempullit gjendet bazamenti i një altari. Nuk dihet se kujt i dedikohet tempulli, megjithëse mendohet se i është dedikuar Asklepit. Hyrja për në tempull mendohet se ishte përgjatë një rruge të tarracuar e cila të çonte në shpatin e një kodre nga perëndimi. Një mur i madh i ndërtuar me blloqe poligonale është i dukshëm në shpatin e kodrës nën tempull, mund të shërbente si një mur i tarracuar dhe themel për një rrugë kortezhi, si dhe formonte një tjetër kufi ndërmjet tenementit dhe pjesës rezidenciale të qytetit. Tempulli do të kishte qenë gjithashtu i aksesueshëm nga teatri' (Neritan Ceka po aty f. 39)</p> <p>Tempulli ndodhet brenda Parkut Kombëtar të Butrintit, në perëndim dhe veriperëndim të forumit, mbi teatrin. Hyrja për në tempull ishte me gjasë përgjatë një rruge të tarracuar dhe gjithashtu nga teatri. Një mur i madh i ndërtuar me blloqe poligonale është i dukshëm në shpatin e kodrës nën tempull.</p> <p>Ndërhyrjet e konservimit: Në fragmentet e opus tessellatum (mozaiku 2), janë të dukshme disa mbetje të një riparimi anësor si dhe mbushje të zgavrave. Për riparime u përdorën dy lloje materialesh: njëra është çimento dhe tjetra mendohet se është llaç gëlqereje i përzier me dhe. Mozaikët ishin të mbuluar me fleta polietileni të vendosura direkt mbi dysheme dhe me afërsi 5 cm rërë sipër. Një bordurë çimentoje u ndërtua për të mbajtur rërën të pa lëvizur dhe ka mundësi të jetë gërrshetur me një pjesë të shtresës së përgatitur të mozaikut opus signinum. Në dijeninë tonë, mbulesa daton nga vitet 1980 dhe që atëherë nuk është rinovuar ose mirëmbajtur. Në vitin 2007 është kryer një konservim paraprak i mozaikëve me disa mbushje të muraturës. Mozaiku më pas u mbulua.</p> <p>Gjendja aktuale: Shkallët nuk janë të qëndrueshme; gurët kanë të çarat dhe një është i copëtuar; shufrat e metalit që lidhin gurët janë të ndryshkura dhe ruhen vetëm me pjesë; muratura nuk ka probleme të mëdha. Vetëm në disa pjesë janë të dukshme të çarat dhe humbja e pjesshme e llaçit në fuga; Pjesa e brendshme e muraturës është e mbuluar me likene si dhe pjesa e pasme. Suvaja është në gjendje jo të mirë. Suvaja e ka fillimin nga dy periudha, pjesa e ruajtur është në anën e majtë të monumenteve, ndërsa strukturat e periudhave të mëvonshme janë në gjendje të prekshme.</p> <p>Rekomandimet/veprimet:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Menaxhimi i bimësisë - Studimi dhe kuptimi i strukturave pas murit të tempullit në anën e tij veriore - Pastrimi i muraturës nga likene dhe myshqe dhe konsolidim i saj - Pastrimi i dyshemeve me mozaikë - Konservimi i të dy mozaikëve - Konservimi i suvasë - Krijimi dhe vendosja e një replike fragmentesh e cila ka të hequr detajin e gjarprit në 90°2 - Heqja e mundshme e bordurave prej çimentoje në dyshemetë me mozaikë dhe përdorimi i materialeve më të përshtatshëm, ose ndërhyrje të ngjashme më të përshtatshme 		
<p>Kategoria 1 – e qëndrueshme dhe e mirëmbajtëshme</p>		


Muret rethuse



Mur 1 Nga Kulla Veneciane te Trikonka

Pozicioni

Planimetria



Përshkrim i shkurtër: Komponentët më të hershëm të kësaj pjese të mureve të poshtëm rrethues datojnë që prej periudhës së antikitetit të vonë dhe më herët, me shtesa të ndërtuara në fushata të mëvonshme fortifikimesh. Periudha e ndërtimeve të antikitetit të vonë integronte në mur ndërtime më të hershme.

Materialet dhe ndërtimi: Muratura i përket periudhave të ndryshme dhe kjo reflektohet në cilësinë e materialeve të përdorura dhe cilësinë e lidhjes dhe llojit të agjentit lidhës. Pjesët më të hershme të murit, të cilat janë në fakt rrënoja të ndërtesave më të hershme, janë ndërtime me tulla Romake. Pjesët e mëvonshme të murit përfshijnë një sërë llojesh ndërtimore, nga pjesë muresh me gur gëlqeror të lidhur mirë, katror dhe të punuar deri te mure me gurë të papunuar dhe lidhur keqas të cilët duket sikur janë ndërtuar në nxitim e sipër. Llaçi më i hershëm përfshin pluhur tjegullash ose tullash i bërë me gëlqere të djegur mirë dhe agregatë të shpëlarë. Llaçi i mëvonshëm përjashton agjentët pozolanik dhe ka një prani të madh humusi/lymi gjë e cila mund të tregojë ose gëlqere të djegur keq ose agregatë jo të shpëlarë. Në disa vende përgjatë murit është e mundur të shihen tre faza të dukshme ndërtimit. Gjenden vrima për skelat si katrore ashtu edhe të rumbullakëta si dhe përdorimi i tullave/plakave të ripërdorura është i zakonshëm.

Ndërhyrjet e konservimit: Në vitin 2007 është hequr bimësia që rritet në monument, si dhe bimësia deri në 5m nga muri në të dyja anët; rrënjët e pemës që penetruan muraturën janë trajtuar me herbicid për degradimin e tyre të ngadalhtë. Gjatë viteve 2009-2011 u hoqën rrënjët e vdekura dhe u konsolidua muratura në vendet e rrënjëve të hequra.


Gjendja aktuale: E qëndrueshme që ka nevojë për monitorim të vazhdueshëm

Rekomandimet/Veprimet:


- Duhet të kryhet heqja e dy pemëve që kanë mbetur
- Duhet të ndërmerret pastrimi i rregullt i bimësisë. Kjo duhet të përfshijë 'qethjen' e sipërfaqeve të buta të murit duke prerë bimësitë e përvitshme dhe hequr filizat e pemëve drusore shumëvjeçare. Qëllimi është të ruhet një qilim bari si dhe lule dhe myshqe të egra mbi sipërfaqet e sipërme të mureve të cilat ndihmojnë largimin e ujit dhe ndalojnë rritjen e çdo bime me sistem rrënjësh që rritet ose që penetron thellë.
- Vëmendje duhet t'i kushtohet menaxhimit të pemishteve që rrethojnë murin. Shkurret tejet të dendura pranë shtegut dhe murit në të dyja anët duhet të hiqen deri në një distancë prej dhjetë metrash për t'u mundësuar pemëve që të lulëzojnë
- Shtegu kryesor duhet të mbahet i pastër dhe pa bimësi që varet. Ana e kanalit të murit duhet të mbahet e pastër për të mundësuar aksesin për mirëmbajtje

Kategoria 1 – E qëndrueshme dhe e mirëmbajtëshme

Muri 2 Te Trikonka

Pozicioni	Planimetria
	
<p>Përshkrim i shkurtër: Muri i poshtëm rrethues kthehet beftas në Kanalin Vivari në fundin perëndimor të Pallatit të Trikonkës. Ai është pranë "banesës së tregtarit" përpara se të vijoje përgjatë anës së Kanalit në fundin lindor të zonës së Trikonkës ku edhe shpohet nga një kullë.</p> <p>Materialet dhe ndërtimi: Thuajse i gjithë muri është i ndërtuar nga blloqe gurësh gëlqeror të papunuar dhe përmasa të çrregullta, me disa ndryshime në përdorimin e mbushjes me tulla si dhe me forma të ndryshme të vrimave të skalës në varësi të peruldhës së ndërtimit.</p> <p>Ndërhyrjet e konservimit: Në vitin 2008 u hoq bimësia që rritej në monument si dhe bimësia deri në 5m larg nga muri në të dyja anët. Muratura u pastrua dhe konsolidua. Në vitet 2010-2011 muri u konservua dhe konsolidua edhe më shumë, muret u mbushën me llaç gëlqereje dhe pjesa e jashtme në drejtim të Kanalit të Vivarit u sheshua duke përdorur gurë të rrezuar dhe mbetje të gjetura në vend.</p> <p>Gjendja aktuale: Në shumicën e gjatësisë së tij muri anon nga jashtë si rrjedhojë e themeleve që janë në ujë dhe përkeqësohet nga rritja e pemëve të mëdha që varen sipër në mur.</p> <p>Rekomandimet/Veprimet:</p> <ul style="list-style-type: none">- Monitorimi dhe menaxhimi i bimësisë; heqja e të gjithë bimësisë në një zonë të mbrojtur prej 2 m duke përdorur herbicid në strukturat e murit; ndërsa zonat e jashtme kanë nevojë të pastrohen në mënyrë mekanike- Monitorimi periodik i murit- Përforcimi i mëtejshëm i bregut të jashtëm; për të parandaluar heqjen e mbushjes- Studim konservimi për të kuptuar arsyet përse muri anon nga jashtë- Ndërhyrje të mundshme që lidhen me rezultatet e studimeve të konservimit.	

Kategoria 2 – e qëndrueshme, ka nevojë për punime të vogla

Muri 3 Nga Trikonka për në Banesën Tregtare Veneciane	
Pozicioni	Planimetria
	
<p>Përshkrim i shkurtër: Muri 3 shtrihet nga këndi veri-lindor i Trikonkës deri te 'banesa tregtare' Veneciane. Në gjysmë të gjatësisë së tij gjenden rrënojat e një kulle e cila u parashikua të ishte nën kërcënimin e prishjes kur u ekzaminua në vitin 2007. Rrënojat e bedenave dhe rrugëve të murit janë të dukshme në disa pjesë. Muri edhe pse e ka origjinën në periudhën e antikitetit të vonë, në përgjithësi është një ndërtim mesjetar.</p> <p>Materialet dhe ndërtimi: Thua se i gjithë muri është i ndërtuar nga blloqe gurësh gëlqeror të papunuar dhe përmasa të çrregullta, me disa ndryshime në përdorimin e mbushjes me tulla si dhe me forma të ndryshme të vrimave të skelës në varësi të periudhës së ndërtimit.</p> <p>Ndërrhyrjet e konservimit: Nga viti 2007 deri në vitin 2009 është hequr bimësia që rritej në monument, si dhe e gjitha bimësia 5 m larg murit në të dy anët. Muratura ishte pastruar dhe konsoliduar.</p> <p>Gjendja aktuale: Në disa seksione, pjesët e mureve janë të paqëndrueshme dhe kanë rënë. Pemët janë ende të pranishme në disa pjesë të murit.</p> <p>Rekomandimet/Veprimet:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Heqja e kujdesshme e pemëve ekzistuese - Rivendosja (restaurimi) dhe konsolidimi i pjesëve të rëna - Monitorimi dhe menaxhimi i bimësisë; - Monitorim i rrënjëve të kalbura dhe heqja e tyre kur ato të jenë plotësisht të thata; kjo ka nevojë të ndiqet nga konsolidimi i pjesëve aty ku rrënjët janë nxjerrë jashtë - Monitorimi periodik i murit - Krijimi i një shtegu në pjesën e jashtme drejt Kanalit të Vivarit që të monitorohet gjendja e murit - Konsolidimi i të gjithë pjesës së murit nga ana e jashtme e kanalit 	
<p>Kategoria 3 – i qëndrueshëm, ka nevojë për punime madhore</p>	

Muri 4 Nga Banesa Tregtare Veneciane te Porta e Ligenit

Pozicioni

Planimetria



Përshkrim i shkurtër: Muri 4 zgjatet nga 'banesa tregtare' Veneciane deri në portën e Ujit. Në gjysmën e gjatësisë së tij mungon një pjesë e mirë e murit. Boshllëku në mur është krijuar me shumë mundësi për të zhvendosur dheun nga gjërmimi i Pagëzimores nga Ugolini. Vija e murit është e dukshme në pjesën tjetër dhe menaxhimi i mëvonshëm i bimësisë ka hapur një shteg në anën e murit nga qyteti për përdorim publik. Mbetjet e bedenave dhe shtigjeve të murit janë të dukshme në disa pjesë. Muri, edhe pse e ka origjinën etj në periudhën e antikitetit të vonë është një ndërtim kryesisht mesjetar.

Materialet dhe ndërtimi: Thuasje i gjithë muri është i ndërtuar nga bëloqe gurësh gëlqeror të papunuar dhe përmasa të çrregullta, me disa ndryshime në përdorimin e mbushjes me tulla si dhe me forma të ndryshme të vrimave të skelës në varësi të periudhës së ndërtimit.

Ndërhyrjet e konservimit: Gjatë viteve 2008 - 2009 është hequr bimësia që rritej në monument, si dhe bimësia 5 m nga muri në të dy anët. Muratura është pastruar dhe konsoliduar.

Gjendja aktuale: Në disa vende pjesët e murit janë të paqëndrueshme, veçanërisht pjesa me bedena;

Rekomandimet/Veprimet:


- Konsolidimi i pjesëve të paqëndrueshme të murit
- Monitorimi dhe menaxhimi i bimësisë
- Monitorimi i rrënjëve të thara dhe heqja e tyre pasi të jenë tharë plotësisht; Kjo duhet të ndiqet nga konsolidim i pjesëve ku janë hequr rrënjët
- Monitorimi periodik i murit
- Ruajtja e një shtegu në anën e jashtme drejt Kanalit të Vivarit
- Konsolidimi i të gjithë pjesës së murit nga ana e jashtme e kanalit

Kategoria 3 – e qëndrueshme, ka nevojë për punime madhore

Muri 5 Nga Porta e Ujit për te Porta e Liqenit

Pozicioni

Planimetria



Përshkrim i shkurtër: Muri 5 shtrihet nga Porta e Ujit deri të Porta e Liqenit. Pranë portës së ujit muri është i ashpër, i ndërtuar në të thatë duket sikur është bërë me nxitim, ndërsa në ekstremitetin tjetër nën kishën e vogël dhe ndërtesat helene muri përfshin pjesën e murit fillestar Helen dhe disa mure me mbushje të mirë mesjetare duke ripërdorur materiale Helene. Muri është më shumë i dukshëm nga ana e liqenit se nga toka. Si rrjedhojë, shumica e pjesës së brendshme të murit veçanërisht në lindje është mbushur me kalimin e kohës. Muri tani vepron si një mur mbajtës dhe ndoshta në shkallë më të vogël ose më të madhe ka qenë gjithmonë i tillë.

Ndërhyrjet e konservimit: Në vitin 2009 u hoq bimësia si dhe grumbulli me mbetje organike dhe muret u pastruan dhe u konsoliduan deri diku. Në vitin 2012, pjesa e murit në afërsi të Portës së Liqenit u konsolidua, dhe u krijua një platformë si pikë shikimi për vizitorët.

Gjendja aktuale: Cilësia e ndërtimit, periudha e ndërtimit si dhe metodat dhe materialet variojnë përgjatë Murit 5. Ka pjesë të murit që janë me muraturë Helene prej blloqesh të mëdha të rrethuara dhe mbushura me gurë mesjetar të punuar mirë. Pranë tyre mund të gjenden gurë në gjendje jo të mirë në të thatë që janë vendosur më vonë. Muri 5 është një rrënojë, por në pjesën më të madhe ai ka rrënoja të qëndrueshme që kanë nevojë për punime të mëdha por jo të pamundura për të stabilizuar të gjithë gjatësinë e murit.

Rekomandimet/Veprimet:


- Heqja e pemëve të mbetura;
- Monitorimi dhe menaxhimi i bimësisë;
- Monitorim i rrënjëve të kalbura dhe heqja e tyre kur të jenë plotësisht të thara; kjo duhet të ndiqet nga një konsolidim i pjesëve aty ku rrënjët janë nxjerrë jashtë
- Monitorimi periodik i murit; krijimi i një mbështetjeje për pjesët e gurit që anojnë nga ana e jashtme
- Rekomandohet krijimi i një platforme për monitorimin e murit dhe nga ana e jashtme të ujit;

Kategoria 2 – E qëndrueshme, ka nevojë për punime të vogla

Muri 6 Nga Porta e Liqenit për te Porta e Luanit

Pozicioni

Planimetria



Përshkrim i shkurtër: Muri 6 shtrihet nga Porta e Liqenit deri te porta e Luanit duke ndjekur vijën e murit rrethues Helen (shek. IV para Kr.) i cili ka lartësi të plotë në disa segmente, mungon tërësisht në disa dhe në të tjera është i përzier me muraturën mesjetare. Në njërin pjesë muri është i përforcuar me muraturë Romake. Shtegu kryesor turistik përreth kësaj pjese të qytetit shtihet përgjatë murit 6 gjë e cila është e dobishme për mjedisin përreth të murit duke qenë se mirëmbajtja e shtegut krijon një zonë pa bimësi deri në tre metra nga ana e Kanalit të murit. Zona me shkurre ndërmjet shtegut dhe bregdetit është shumë e dendur në disa vende dhe ka nevojë për prerje dhe rrallim. Pemët në pjesën e bregdetit kanë prirje të rriten mbi mur dhe ta prekin atë. Është i nevojshëm monitorimi dhe krasitja e magullt e pemëve, dhe prerja e pemëve të thara pranë shtegut.

Ndërhyrjet e konservimit: Përveç punimeve të dukshme që janë ndërmarë për rindërtimin e portës së Liqenit (nga Ugolini) dhe portës së Luanit (ndërtues të panjohur me shumë mundësi Ugolini) nuk ka të dhëna të dukshme të punimeve konservuese përgjatë gjatësisë së murit.

Gjendja aktuale: Muri gjendet në një zonë me hije në bregdetin e Butrintit përpara se toka të fillojë të ngrihet për në akropol. Ajo ka një pjerrësi të butë me drejtim lindje-perëndim përgjatë gjatësisë së murit. Ka pak të ngjarë që muri të jetë krijuar vetëm si një mur mbajtës, kështu që presioni i sasive të mëdha të dherave dhe muraturës që janë ndërtuar nga ana e qytetit të murit duhet të merret në konsideratë, si edhe rritja e rrënjëve dhe presioni i ujit që duhet të krijohet pas rënies së shirave. Pas shirave të shumta, ka rrjedhje të ujit përmes vrimave të skelave. Punimet mesjetare në disa pjesë kanë humbur ilaç nëpër fuga dhe ka gurë të lirë në skajet e prera; ndërsa disa pjesë janë zhdukur plotësisht. Të çarat duhet të mbushen dhe zonat e monitoruara ku gurët (më së shumti Helen) janë duke shfaqur të çara duhet të fotografohen dhe monitorohen.

Rekomandimet/Veprimet:


- Sugjerim për rindërtim të murit nga segmentet h te m, duke përdorur gabionë të mbushur me spofo pasi të ndërmerret një inspektim arkeologjik i plotë për të krijuar vijën e murit fillestar;
- Monitorimi dhe menaxhimi i bimësisë duke i mbajtur pemët 4m larg;
- Pastrimi i bimësisë nga pjesa e sipërme e mureve, dhe konsolidimi i mureve të lira; pastrim në thellësi i të gjithë humusit të lirë dhe pastrim i të gjitha boshllëqeve; rivendosja e gurëve të lirë; Muratura vertikale: heqja e dheut nga fugat dhe rimbushje; rivendosja e gurëve të lirë; skajet e prera duhet të pastrohen dhe të konsolidohen në mënyrë periodike
- Konsolidimi i Portës së Liqenit dhe Portës së Luanit (shihni rekomandimet për Portën e Liqenit dhe Luanit)
- Monitorim i të çarave pas konsolidimit të tyre

Kategoria 3 – i qëndrueshëm, ka nevojë për punime madhore

Muri 7 Nga Porta e Luanit për në Portën Veriore

Pozicioni

Planimetria



Përshkrim i shkurtër: Në pjesën më të madhe Muri 7 ndjek rrethimin më të ulët të shek. IV para Kr. dhe muratura e këtij muri antik është ende e pranishme në nivel të ulët (dhe në disa vende në një lartësi të madhe) përgjatë gjatësisë së këtij muri të madh. I madh pasi me shumë mundësi është segmenti më i lartë që ka mbetur nga muri i Butrintit. Muri përfshin ndërtesën e varrezës dhe portën e Veriut në skajet e gjatësisë së tij dhe kullën mbi nekropolin romak.

Ndërrhyrjet e konservimit: Në vitet 2007-2008 u ndërmorën disa konsolidime. Në vitin 2012, Parku lu nënshtrua një pastrimi të plotë të bimësisë së ulët në pjesët më të poshtme të mureve për të krijuar një kalim të sigurt për vizitorët.

Gjendja aktuale: Gjendja e segmenteve të muraturës varion nga e qëndrueshme në të qëndrueshme por e kërcënuar. Problemi më i madh me segmentin e poshtëm është bimësia dhe humusi i krijuar pas segmenteve, muratura e lirë dhe segmentet e munguara të murit. Në segmentet e larta dallohen të çarat, muratura e lirë dhe mbushja që mungon.

Rekomandimet/Veprimet:

- Segmentet a-d kanë nevojë të pastrohen, mbetjet dhe bimësia duhet të pastrohen dhe pjesët e murit të konsolidohen
- Sugjerohet rindërtim i murit nga segmenti e deri te l, duke përdorur gabion të mbushur me spoila pas një investigimi të plotë arkeologjik për të përcaktuar vijën e murit origjinal.
- Sugjerohen gërmime arkeologjike nga l deri të n; dhe nga ac deri te af; kuptimi i vijës së murit origjinal; pastrimi i bimësisë dhe mbetjeve; krijimi i gabionëve të mbushur me spoila;
- Sugjerohet heqja e bimësisë duke përfshirë pemët nga o deri te v; konsolidimi i rrënojave të brendshme , të rrezikshme për vizitorët nëse nuk hiqen
- Pjesa e Murit Helen në segmentin w është e kërcënuar; bimësia dhe mbetjet duhet të pastrohen dhe muri të rivendoset
- Segmentet x-y janë konsoliduar në vitet 2007 dhe 2008 dhe janë të vetme segmente që janë të qëndrueshme por që kanë nevojë për monitorim
- Segmenti ag është një mur i lartë; muraturë e lirë; të çarat janë të dukshme; bimësia ka nevojë të pastrohet dhe muri të konsolidohet

Kategoria 3- I qëndrueshëm, ka nevojë për punime të mëdha

Muri 8 Degëzimi Veri-Perëndimor

Pozicioni

Planimetria



Përshkrim i shkurtër: Një mur mesjetar i cili shtrihet nga veri-perëndimi në jug lindje nga myja e mureve 7 dhe 9 në bregdet. Ky mur është më pak i aksesueshëm sa më shumë t'i afrohesh ujit.

Ndërhyrjet e konservimit: Heqja e bimësisë është kryer në vitin 2007, ndërsa në vitin 2013 muri u konsolidua pjesërisht.

Gjendja aktuale: Gjysmë e qëndrueshme

Rekomandimet/Veprimet:


- Përfundimi i ndërhyrjeve të konservimit të filluara në vitin 2013
- Monitorimi i bimësisë

Kategoria 2- I qëndrueshëm, ka nevojë për punime të vogla

Muri 9 Nga Porta Veriore për te Porta Perëndimore

Pozicioni

Planimetria



Përshkrim i shkurtër: Muri 9 është i periudhave dhe materialeve të përziera si vazhdim i Murit 7. Muri i poshtëm rrethues e ka origjinën në shek. IV para Kr. Toka është mjaft e pjerrët duke filluar nga nyja me murin e degëzuar, murin 8 dhe vijon të ngjitet deri sa arrin zonën e Portës Perëndimore. Nga liqeni muri fshihet nga bimësia e dendur e cila rritet në bregun e pjerrët midis bregut dhe murit. Një shteg hyrës në tokë është duke u gërryer por aksesit në këtë mur është i vështirë dhe bimësia duke u shtrirë më tej.

Ndërhyrjet e konservimit: Në vitet 2007-2008 është kryer pastrimi bimësisë, por nuk është ndërmarrë asnjë konservim

Gjendja aktuale: I qëndrueshëm me pjesën e sipërme të muraturës të lirë; Terren shumë i vështirë

Rekomandimet/Veprimet:


- Segmentet 9a - 9b kanë nevojë për pastrim dhe konsolidim të të çarave
- Segmentet 9k-9g kanë nevojë të pastrohen nga bimësia në pjesët e sipërme dhe përgjatë sipërfaqes si dhe të konsolidohen
- Pastrim dhe monitorim i bimësisë

Kategoria 3 – I qëndrueshëm, ka nevojë për punime madhore

Muri 10 Muri Rrethues i Akropolit

Pozicioni

Planimetria



Përshkrim i shkurtër: Ndërtimi më i vjetër i murit në qytet varion nga muratura masive në atë mesjetare.

Ndërhyrjet e konservimit: Në vitin 2008 u krye pastrimi i bimësisë; në vitin 2010 u rindërtua një segment i shembur i murit; në vitin 2014 u pastrua bimësia në disa nga segmentet e murit; në vitin 2016 u zhvillua dhe zbatua programi i heqjes së pemëve.

Gjendja aktuale: Në pjesën më të madhe muri është i pastudiuar dhe i pa dokumentuar si rrjedhojë e terrenit të vështirë dhe bimësisë.

Rekomandimet/Veprimet:


- Bimësia ka nevojë të pastrohet me krijimin e një zone buferike prej 2 m në të dyja anët e monumentit
- Heqja e pemëve në dhe përreth mureve
- Nevojitet të krijohet një konservim i plotë.
- Konsolidimi duhet të kryhet sipas propozimeve të studimit të konservimit

Kategoria 4 – i paqëndrueshëm; shumë i rrezikshëm; fshehur nga bimësia

Muri 11 Fortifikimet Perëndimore

Pozicioni

Planimetria



Përshkrim i shkurtër: Ky mur është vazhdim i pjesëve perëndimore të murit me Kulla Fortifikuese. Muri është mesjetar në pjesën më të madhe.

Ndërhyrjet e konservimit: Muri u konsolidua në vitet 2003 dhe 2004 me ndërhyrje të mëtejshme në vitet 2013 dhe 2014;

Gjendja aktuale: Gjendja është e qëndrueshme

Rekomandimet/Veprimet:

- Menaxhimi i bimësisë dhe monitorimi i të dyja anëve të murit

Kategoria 1 – I qëndrueshëm dhe I mirëmbajtshëm

Muri 12 Nga Porta e Liqenit për te Akropoli

Pozicioni

Planimetria



Përshkrim i shkurtër: Ky mur është klasifikuar si një mur i ndërtuar në kohët e hershme Romake (N. Ceka); Në një pjesë të murit janë të dukshme dy teknika murature: opus quadratum me materiale të ripërdorura dhe një teknikë me gur të papunuar me fuga me llaç gëlqereje e cila konsiderohet mesjetare.

Ndërhyrjet e konservimit: Në vitet 2009/2010 bimësia u pastrua në dhe përreth pjesëve të murit; Në vitin 2014 një pjesë e murit u rrëzua dhe u restaurua në vitin 2017.

Gjendja aktuale: Muri është në gjendje jo të qëndrueshme. Muratura ka humbur mbushjet e saj në disa pjesë, ndërsa në disa të tjera është e dukshme muratura e lirë. Gurët janë të lirë veçanërisht në ato pjesë ku muratura është e shkëputur. Muri është duke mbajtur një ngarkesë nga shpati i kodrës e cila është e mbuluar me pemë, rrënjët e së cilave janë duke penetruar pjesët e murit. Restaurimi i murit nuk përfshiu të gjithë segmentin e rrezikuar.

Rekomandimet/Veprimet:

- Bimësia ka nevojë të pastrohet dhe të krijohet një zonë buferike prej 2 m në secilën anë të monumentit.
- Heqja e pemëve në dhe përreth mureve
- Duhet të zhvillohet një studim konservim
- Konsolidimi duhet të kryhet sipas propozimeve të studimit të konservimit

Kategoria 4 – i paqëndrueshëm; potencialisht i rrezikshëm;

Muri 13 Perimetri i Poshtëm Helenistik

Pozicioni

Planimetria



Përshkrim i shkurtër: Ky segment i murit është në afërsi të Portës së Kullës. Ai shtrihet përgjatë Bazilikës së Madhe dhe Banjave Romake duke ndjekur shtigjet turistike dhe më pas ndërpritet në pjesët ku filon muri mesjetar i Kanalit Vivari. Mendohet se muri daton në shek. IV, siç dëshmohet nga ndërtimi i tij me blloqe të mëdhenj guri në të thatë. Nuk është *in situ* përgjatë gjithë gjatësisë së tij. Në disa segmente vetëm një resht me gurë është ende në vendin e tij.

Ndërhyrjet e konservimit: Në vitin 2007 bimësi u pastrua përreth monumentit si pjesë e pastrimeve të mëdha

Gjendja aktuale: Muri është i qëndrueshëm.

Rekomandime/Veprime:

- Duhet të ndërmerret një vrojtim i plotë arkeologjik për të kuptuar reshtin e plotë të këtij muri
- Terreni pas murit duhet të ekzaminohet për të parë nëse ka ndonjë rrezik për segmentet e murit.
- Heqja e bimësisë në dhe përreth mureve
- Monitorimi dhe menaxhimi i bimësisë

Kategoria 2 – i qëndrueshëm, ka nevojë për punime të vogla

Muri 14 Nga Porta Perëndimore për te Fortifikimet Perëndimore

Pozicioni

Planimetria



Përshkrim i shkurtër: Muri 14 shtrihet përgjatë zonës së portës Perëndimore deri në veri të mbrojtëseve perëndimore. Muri është më së shumti nga faza II e ndërtimeve me disa tipare të veçanta si bastioni trekëndor që tregohet më poshtë. Kombinimi i blloqeve të mëdhenj me gurë, spoja dhe tullave pothuajse dekorative dhe mbushjes me gur gëlqeror është tepër mbresëlënëse.

Ndërhyrjet e konservimit: Muri është konservuar në vitin 2015;

Gjendja aktuale: Muri është i qëndrueshëm, me përjashtim të një segmenti i cili anohet nga jashtë






Rekomandimet/Veprimet:

- Bimësia ka nevojë për pastrim përmes krijimit të një zone buferike prej 3 m në të dyja anët
- Heqja e pemëve në dhe përreth mureve
- Duhet të ndërtohen përforcues për pjesën e anuar të murit.

Kategoria 2 – i qëndrueshëm, ka nevojë për punime të vogla



Sitet-Monumentet Jashtë Mureve të Qytetit Antik





-  Category 1 - Stone and masonry walls
-  Category 2 - Stone, in need of major work
-  Category 3 - Stone, in need of major work
-  Category 4 - Unstable, in need of major work
-  Category 5 - Unknown, obscured by vegetation

Copyright © 2010
All rights reserved. For more information, visit www.earthandfire.com

Kalaja e Ali Pashait- periudha e sugjeruar: fundi i shek. XVII- fillimi i shek. XVIII

Pozicioni	Planimetria	Fotografia 2018
		
<p>Përshkrim i shkurtër: Një fortesë e vogël në grykëderdhjen e Kanalit të Vivarit i është atribuar shpesh Ali Pashës, megjithëse ajo përmendet në hartën kadastrale Veneciane të vitit 1718. Fortesa në grykëderdhjen e kanalit, aktualisht është një strukturë e vogël katërkëndore (22 X30m) me mure të dëmtuara. Ndërtesa më e hershme brenda në fortesën e mëvonshme është një kullë e madhe katërkëndore e mbështetur nga tre dhoma me qemer cilindrik. Zona kryesore e banimit do të ketë qenë në katet e sipërme të kullës (tani të shkatërruara). Përreth kësaj kulle është një mur rrethues i mëvonshëm, i cili është paralel me një tjetër mur fortifikues i Ali Pashës me vende për topa që shikojnë detin, dhe ishullin Agios Georgios në Prevezë. Muri rrethues i Kanalit Vivari përfshin dy kulla të rrumbullakëta të prishura me frëngji për hapje zjarri nga ana e detit dhe dy kulla katrorë të prishura me përmasa jo të rregullta, edhe këto me dritare për hapje zjarri që shikojnë kanalin në drejtim të Butrintit.</p> <p>Hyrja kryesore e fortifikimit shtrihet nën banesën e dikurshme në veri, ku dhoma me qemer qendror, e mbrojtur nga frëngjitë për pushkët, shikonte drejtpërdrejtë në Kanalin e Vivarit. Mendohet se në këtë fazë, fortifikimi funksiononte si një bazë e vogël detare, me zonën e tij në qendër të mbushur me ujë dhe shkallë që të çonin në një parapet. Parapeti vazhdonte në të tria anët e fortifikimit dhe mundësonte platforma për topat. Muri jugor ka më pak frëngji për hapje zjarri se muret e tjera, më së shumti për shkak të dy tualeteve të harkuara, me ndarëse dhe kalime të poshtme për në zonën jashtë mureve dhe një qemer qendror i ulët me një kalim të ngjashëm, ndoshta për mbetjet. Pranë kullës këndore jugperëndimor është gjithashtu një frëngji rrethore për pushkët. (Andrew Crowson: <i>Venetian Butrint f. 85</i>)</p> <p>Ndërhyrjet e konservimit: Në vitin 2011 u ndërmoren masa të pjesshme konservimi, këndi verior i mureve kishte një të çarë e cila ishte gjithashtu e konsoliduar si dhe një segment i murit në veri. Pas vitit 2011 u ndërmoren pastrime të mëdha të bimësisë së bashku me konsolidime të muraturës përgjatë gjithë pjesës së plotë të kalasë.</p> <p>Gjendja aktuale: E qëndrueshme</p> <p>Rekomandimet/ veprimet</p> <ul style="list-style-type: none">- Pjesa jug-lindore e kalasë është në një gjendje jo të qëndrueshme- Duhet të ndërmerret një studim i përgjithshëm gjeofizik për të përcaktuar masat konsoliduese- Duhet të instalohen gabionë me gurë përreth mureve		
Kategoria 3 – E qëndrueshme, ka nevojë për punime të mëdha		

Fortesa Trekëndore- periudha e sugjeruar: fundi i shek. XV

Pozicioni	Planimetria	Fotografia 2018
		

Përshkrim i shkurtër: Ndërtimi fortifikues më i plotë jashtë fortifikimeve të vjetra të Butrintit, dhe dëshmia më e mirë e pushtimit Venecian është fortesa trekëndore madhështore në bregun e Kanalit Vivari. Duke mbuluar krahun e djathtë të Korfuzit, fortifikimi shërbente kryesisht për të mbrojtur vendet e çmuara për rritjen e peshkut në Butrint. Me një formë të pazakontë, me pak forma të ngjashme në Evropën mesjetare, forma e saj mund të ketë qenë diktuar nga forma e ishullit në të cilin u ndërtua. Mbrojtëset e fortifikimit përfshijnë teknologjitë e shigjetave dhe barutit, dhe mendohet se është ndërtuar gjatë fundit të shek. XV, pas vitit 1490, ose në pjesën e hershme të shek. XVI. Zbulimet qeramike brenda fortës Trekëndore duket sikur e mbështesin këtë interpretim. Fragmente poçarie me origjinë nga Venecia dhe Emilia Romagna të fundit të shek. XV dhe fillimit të shek. XVI mund të lidhen ngushtë me ndërtesën fortifikuese.

Fillimisht me një formë të parregullt trekëndore me frëngji pushkësh në nivelet e tokës dhe parapetit, fortesa kishte disa struktura modeste. E ndodhur në pikën e bashkimit midis Lumit Pavllas dhe Kanalit të Vivarit, fortesa ishte tërësisht e rrethuar nga uji. Hyrja kryesore ishte, dhe është ende sot, përmes një dërrë në faqen jugore, e cila zëvendësoi një hyrje më të vogël me hark (tani e bllokuar) në perëndim, me një hyrje të pasme (gjithashtu e bllokuar) nga ana e Kanalit.

Pas dekadash lufte me perandorinë Otomane, fortifikimet e Butrintit ishin kthyer në rrënoja dhe qyteti antik u braktis përfundimisht në vitin 1572, pas fitores në Lepanto nga aleanca Veneciane, në favor të fortës Trekëndore. Kulla rrethore në të cilat mund të hyhej si në nivelin e tokës dhe të parapetit, ishin shtuar të tria këndeve, së bashku me një sërë dhomash të brendshme me qemer në krahun perëndimor që mbante një platformë artilerie sipër për të mbrojtur hyrjen nga Kanali Vivari: një reliev i kokës së Luanit të Shën Markut, simboli i Venecias, dekoron gurin qendror në hyrjen në njërin prej dhomave. Dhomat me qemer me shumë mundësi përdoreheshin si magazina baruti, punishte, magazina dhe ndoshta si qeli.

Ndërhyrjet e konservimit: Në vitin 1974 u konsoliduan strukturat, ndërsa në vitin 2007 u ndërmorën konservime të mëtejshme.

Gjendja aktuale : E qëndrueshme me probleme në muraturë.



Rekomandimet / Veprimet:

- Brenda: heqja e të gjithë bimësisë nga sipërfaqet e muraturës dhe mbushje të fugave dhe të çarave, rivendosje e muraturës së lirshme në të njëjtën kohë
- Brenda: duhet të ketë një program të vazhdueshëm për menaxhimin e bimësisë me krasitje të paktën dy herë në vit
- Eksterieri: konsolidimi i murit me frëngji pushkësh në jug perëndim
- Krijimi i paneleve interpretuese

Kategoria 3 – E qëndrueshme, ka nevojë për punime madhore

Varri me Djegie		
Pozicioni	Planimetria	Fotografia 2018
		
<p>Përshkrim i shkurtër: 'Rrënojat e shumta të një varri prej muri mund të shihen ende në Fushën e Vrinës, e ndodhur në lartësinë 300m në lindje të qendrës së vendbanimit. Rrënoja u dokumentua në fillim nga Ugolini, së bashku me disa rrënoja funerale në Xarë në fund të viteve 1920 pak a shumë në gjendjen që mund të shihet sot. Varri i shpëtoi pastrimit të fushës në vitet 1960 dhe që prej zbulimit të tij ka qenë përdorur si një stallë për dele ose si një strehë për barinjte e fushës që në pjesën tjetër është e zbuluar. Degradimi i vijueshëm dhe shumë i dukshëm në pamjen fizike të varrit që prej mesit të viteve 1990 nxiti ndërmarrjen e një vrojtimi me anë të skicave, fotografive dhe matjeve, si pjesë e një ushtrimi për menaxhimin e trashëgimisë. Varri përbëhet nga dy elementë: një dhomë me qemer dhe një superstrukturë solide sipër në formën e një kulle. Çdo gjurmë e gurëve në fasadë ose sipërfaqen e jashtme të suvatuar ka humbur prej kohësh. Struktura që ka mbetur është 2.85 m e gjerë përgjatë qemerit dhe 1.80 m përgjatë gjatësisë së saj. Muret me qemer janë mesatarisht 0.57m të trashë dhe e gjithë pjesa e poshtme është 1.95 m e lartë. Mbi të, superstruktura ka diametër 1.40 m dhe është 1.24 m e lartë. Varri aktualisht është 3.19 m mbi nivelin e tokës. Nën tokë ai duket se është ndërtuar mbi themele shumë të cekëta.</p> <p>Dhoma e varrit është e ruajtur mirë. Kjo është një hapësirë me qemer 1.57 m e gjatë, 1.50 m e gjerë dhe 1.06 m e lartë. Në qendër të mureve lindore dhe perëndimore janë dy locufl gjysmë rrethorë për urnat e hirit. Secila prej tyre ka përmasa 0.44x 0.42 x 0.56 m. Baza e tyre është 0.15m mbi dyshemenë e dhomës. Të dy muret veriore dhe jugore janë dëmtuar në një masë të madhe për të mundësuar përdorimin e saj si një strehë, por të dhënat janë të mjaftueshme për të dalluar se muri jugor ishte dikur i vazhdueshëm. Rrjedhimisht, hyrja për në dhomën e varrit duhet të ketë qenë nga veriu, që do të thotë, nga ana përballë me liqenin. Sipërfaqja e brendisë (qemeri, dyshemeja dhe locufl) është tërësisht e mbuluar nga një shtresë suvaje deri në 20 mm e trashë. Skorja gëlqerore mbulon shumicën e suvasë që ka mbetur dhe mund të ketë kontribuar që ajo të ketë mbijetuar. Kjo gjithsesi e bën të vështirë për të kuptuar nëse brendia ka qenë ndonjëherë e pikturuar.' (1)</p> <p>Ndërrhyrjet e konservimit: Struktura u konservua nga viti 2007 në vitin 2009</p> <p>Gjendja aktuale : E qëndrueshme</p> <p>Rekomandimet /Veprimet:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Pastrimi i zonës përreth varrit nga bimësia dy herë në vit. Heqja e çdo bimësie që rritet në muraturë - Duhet marrë në konsideratë ndërtimi i një strehe për të shkruajuar barinjte që të përdorin varrin. 		
<p>Kategoria 1 – E qëndrueshme dhe e mirëmbajtshme</p>		

Trënojat e ujësjellësit me cisternën kryesore

Pozicioni	Planimetria	Fotografia 2018
		

Përshkrim i shkurtër: Ndërtimi i ujësjellësit përbënte një tjetër ndryshim të madh në topografinë urbane të Butrintit. Ujësjellësi është pothuajse me siguri pjesë e ndryshimeve që lidheshin me themelimin e kolonisë. Augusti (së bashku me Agrippan) ishte personi që qëndronte pas një numri të madh ujësjellësish. Edhe pse jo thelbësor për nevojat e përditshme të banorëve të Butrintit, të cilët furnizoheshin me ujë me anë të burimeve që dilnin në bazamentin e akropolit, furnizimi i sasive të mëdha me ujë për banja dhe shatërvanë ishte thelbësor për ideologjinë e shoqërisë urbane romake. Ujësjellësit ishin, kështu, të lidhur me krijimin e kolonive.

Burimi i ujësjellësit ishte me shumë mundësi një burim në afërsi të Çuka e Aitoit, 12 km në juglindje të Butrintit, me vijën e ujësjellësit që shkonte në një pikë pak më në juglindje të Xarës. Nga Xara, gjurma e ujësjellësit ndiqte një vijë në veriperëndim përgjatë Fushës së Vrinës. Një cisternë kryesore, afër me bregun në juglindje të Kanalit të Vvarit, shënon pikën e tij të kalimit mbi kanal' (Sally Martin 'The Topography of Butrint')

Ndërhyrjet e konservimit: Nuk ka


informacion

Gjendja aktuale : E qëndrueshme

Rekomandimet/ Veprimet

- E gjithë bimësia shumëvjeçare dhe e drunjtë, pemët, shkurret, fidanët etj. duhet të pastrohen plotësisht nga muratura dhe nga një zonë 4m përjashtuese përreth gjithë strukturës të ujësjellësit. Pemët e fikut të pranishme në dy grupe të mëdha këmbësh duhet të priten me kujdes dhe të spërkatën me helm për të parandaluar që sistemet e tyre të rrënjëve të dëmtojnë muraturën e brishtë;
- Vlerësim i gjendjes në çdo këmbë që ka ngelur: ndërmarrja e konsolidimeve të muraturës sipas nevojës
- Mbushje e thellë e të çarave ndërmjet strukturës kryesore dhe blloqeve të sipërme të lira
- Duhet parashikuar vendosja e gardheve për të mbrojtur kolonat e mbetura në këmbë


Kategoria 3 - E qëndrueshme, ka nevojë për punime madhore

Kalivo		
Pozicioni	Planimetria	Fotografia
		
<p>Përshkrim i shkurtër: Kalivo është një kodër e ulët e cila shikon mbi Liqenin e Butrintit, dhe është vendi ku ndodhen disa çifte hutash dhe skifterësh. Pjesa e sipërme e kodrës është përdorur si një vendbanim që nga koha e Epokës së Bronzit. Ka një mur të madh rrethues me blloqe të mëdha të cilat qëndrojnë ende në një lartësi të konsiderueshme. Porta Jugore e cila është restauruar së fundmi është ndoshta pjesa më e aksesueshme dhe më mbresëlënëse e murit rrethues.* (nga faqja e internetit <i>Butrint.org</i>)</p> <p>Ndërhyrjet e konservimit: Nuk ka informacion</p> <p>Gjendja aktuale : E qëndrueshme</p> <p>Rekomandimet /Veprimet: Pastrimi i shtigjeve të aksesit nga bimësia penguese. Rikrijimi i shtegut nga Butrinti në Kalivo dhe nëse është e nevojshme të ndryshohet rruga. Theksimi i shenjave të rrugës, urave etj. Pastrimi i mureve dhe portave nga e gjithë bimësia në ose brenda 4 metrave nga muratura.</p>		
Kategoria 1 – E qëndrueshme dhe e mirëmbajtshme		


Diaporit		
Pozicioni	Planimetria	Fotografia
		
<p>Përshkrim i shkurtër - Rrënojat që ruhen në këmbë, shumica mure të ulëta, në Diaporit, përbëhen nga një bazilikë e hershme kristiane, një vilë romake dhe një kompleks banjash romake. Të gjitha të gërmuara në dekadën e parë të shek. XXI, ato janë konservuar ndërmjet viteve 2005 dhe 2006, përgjatë dy sezoneve. Bazilika është ndërtesa më e ruajtur nga ndërtesat e tjera me një perimetër të plotë dhe me mure të brendshme të ruajtura. Vila dhe banja janë më pak të ruajtura dhe nuk paraqesin një imazh të qartë për vëzhguesin. Në dekadat e hershme të shek. I pas Kr., në fund të mbretërimit të perandor Augusti dhe ndërsa Butrinti përftoi investime të konsiderueshme perandorake, u ndërtua një vilë Romake. Shumica e kësaj ndërtese shtrihet sot nën ujërat e liqenit, të cilat janë rritur që nga periudha Romake, ose është shkatërruar nga aktiviteti i mëvonshëm ndërtimor, por kanë ngelur mjaft gjurmë që tregojnë se ajo ndiqte rreshtimin e vilave më të hershme Helene, me shikim nga Liqeni i Butrintit. Rreth viteve 40-80 pas Kr. një vilë shumë më e madhe dhe madhështore shtrihet përgjatë qytetit. E organizuar mbi një sërë taracash, ajo përfshinte një krah elegant lindor me dhoma të dekoruara me mozaik dhe suva muri të pikturuara. Krahu perëndimor i vilës përfshinte një nymphoëum monumental të vendosur afër buzës së ujit. Ajo mund të ketë qenë e lidhur me një shëtitore me portik, duke i dhënë vilës një aspekt dominues kur drejt saj shikohej nga bregu i liqenit dhe ofronte pamje mbresëlënëse në drejtim të Butrintit kur shikohej nga krahu perëndimor i ndërtesës. Krahu jugor dominohej nga një kompleks i madh banjash i cili nga fundi i shek. II përfshinte një dhomë me absidë dhe një banjë me ujë të ftohtë, një dhomë të madhe pesë-këndore me një oborr elegant të brendshëm. Një risi e dallueshme e kësaj vile të re ishte orientimi i saj i ndryshëm. Duke mos qenë më përballë liqenit, forma e vilës së re ishte e orientuar drejt Butrintit. Në nuk e dimë se kush mund të ketë qenë pronari i kësaj vile, por lidhjet e saj të dukshme me Butrintin çojnë në supozimin se mund të ketë qenë pronë e një prej elitave të reja vendase që dominonin jetën politike të qytetit. Kjo rezidencë luksoze nuk ishte pa defekte. Megjithatë me një formë të pasur, punët strukturore, veçanërisht rindërtimi i banjës në shek. II, duket se janë kryer pa kujdes dhe me nxitim. Është e mundur që vila gjatë periudhës së mëvonshme të jetës së saj të mos ketë qenë e banuar në mënyrë të përhershme, por të ketë qenë pronë e një personi i cili jetonte edhe diku tjetër dhe me raste vinte në Butrint. (një përshkrim i vilës nga faqja e internetit Butrint.org)</p> <p>Gjendja aktuale : E qëndrueshme</p> <p>Rekomandimet/ Veprimet:-</p> <ul style="list-style-type: none"> - Qyteti ka nevojë për pastrim të barërave dhe shkurreve. Për të paktën tre sezona rritja e hershme veçanërisht e gjembaçit duhet të trajtohet sistematikisht me helm barërash për të shmangur mbirjen e farërave dhe një përhapje më të madhe të tyre. Të gjitha shkurret dhe bimët në muraturë brenda katër metrave nga perimetri i ndërtesave duhet të shkulet ose priten, dhe rrënjët të spërkatën me helm. Sipërfaqet e sipërme të mureve në vilë duhet të mbillen me bar të fortë rezistent ndaj thatësisë. - Duhet të ndërtohet molë i Diaporitit për të lejuar vizitat me varkë. - Sinjalistika, urat etj. të cilat ekzistojnë dikur për të shënjuar shtegun nga Butrintit duhet të theksohen për të mundësuar vizita në këmbë. - Ekonomia vendase e kohës së lirë është dëmtuar nga rënia e pjesëve të munit të Diaporit. Plazhi me gurë është shumë i përdorur në verë nga njerëzit nga Xarra të cilët këtë vit e kishin të pamundur të shkonin në plazhin e tyre të zakonshëm me mjete normale. Duhet të merret parasysh, brenda rregullave të Parkut Kombëtar, riparimi i kësaj shtegu në përfitim si të vizitorëve për të rrënojat e Diaporitit ashtu dhe për ata që vijnë për vizita për arsye të tjera. 		
Kategoria 2 – e qëndrueshme dhe ka nevojë për riparime të vogla por të qëndrueshme		

Mozaiket

Gjithsej janë të dokumentuar 28 mozaikë brenda dhe jashtë zonës me mure



Sipërfaqet e Pikturuara dhe të Suvatuara



Kostot e Buxhetit

Çmimet dhe kostot për të gjitha vëllimet e punimeve bazohen në *Manualin Shtetëror* për restaurime.

Çdo njësi për çmim përfshin punën, taksat dhe të gjitha kostot përkatëse.

Megjithatë, duke qenë se nuk janë zhvilluar projekte konservimi të detajuara për secilin nga monumentet/muret/mozaikët/afresket, çmimet për njësi janë rritur pak për të mundësuar përfshirjen e ndërhyrjeve të ndryshme shtesë në çastin kur të zhvillohen propozime të plota konservimi për çdo monument/mur/mozaik/afresk.

Gjithsesi, buxheti i hartuar bazohet në të dhëna, vëllime dhe ndërhyrje realiste të cilat mundësojnë përfshirjen e rezultateve të paparashikuara si për veprimet konservuese ashtu edhe ato mirëmbajtëse.

Nga kjo analizë, buxhetet vjetore do të ishin si më poshtë:

Buxheti për 7 vjet punime konservuese	Viti 1	Viti 2	Viti 3	Viti 4	Viti 5	Viti 6	Viti 7	Totali
Punimet konservuese në sit duke përfshirë ato të prapambetura	381	508	508	381	381	381	376	2916
Buxheti për mirëmbajtjen dhe monitorimin vjetor	96	80	80	80	80	80	80	578
Totali \$	477	588	588	461	461	461	456	3494

Sigurisht pritet që këto shifra të rishikohen vit pas viti sipas progresit të punës.

Megjithatë, bindja mbetet se këto buxhete janë të arsyeshme, ndoshta pak më të larta duke pasur parasysh se kemi supozuar ekspertizën më të mirë si në konsultim ashtu edhe në zbatim.

Gjithashtu, duhet të merret në konsideratë që zëri kapital përfshin edhe 132.000 USD për ndriçimin dhe vrojtimin me kamera në të gjithë pjesën e Qytetit Antik të Zonës A3 që përfshihet në këtë Shtojcë duke qenë se instalimi i tij kërkon përjasje konservuese për vende specifike.

MIRËMBAJTJE DHE MONITORIM

1-7 VITE

Ndarja në Prioritete/MONUMENTE DHE MURE					
EMRI	KATEGORIA	PRIORITETI	KOSTOJA E MONUMENTEVE	KOSTOJA E MOZIKËVE	KOSTOJA E AFRESK
TE QENDRUESHME KANE NEVOJE PER PUNIME MADHORE					
Monumente					
Bazena Veneçiane	kategoria 1	B	20100		
Nisfeu 2	kategoria 1	B	8510		
TE QENDRUESHME KANE NEVOJE PER PUNIME TE VOCLA					
Monumente					
Ndërtesa Industriale (Mali)	kategoria 2	C	11900		
Kisha e vogël në Pogradec	kategoria 2	C	7330		
Porta e Ujit	kategoria 2	C	25900		
Kishat e Ujësjellësit	kategoria 2	C	3095		
Porta në Kulla	kategoria 2	C	24500		
Port i Kulla Rufinës	kategoria 2	C	9800		
Bazja Romake	kategoria 2	C	19105	38595	
Nisfeu e vogël	kategoria 2	C	1680		4000
Mure					
Mali 2 Mali i Tirkokës	kategoria 2	C	87380		
Mali 5 Nga Porta e Ujit deri në Porta e Ujësjellës	kategoria 2	C	43100		
Mali 8 Degjuarët Veriperëndimor	kategoria 2	C	6750		
Mali 11 Fortifikimet Perëndimore	kategoria 2	C	31800		
TE QENDRUESHME DHE TE MIRËMBALDITSHME - KAPËRMBAJTJE					
Monumente					
Bazja në Kulla Veneçiane	kategoria 1	D	15700	38675	
Çështja e Madhe	kategoria 1	D	11730	34400	
Port/Bazni i çarëjt	kategoria 1	D	5000		
TE QENDRUESHME DHE TE MIRËMBALDITSHME - KAPËRMBAJTJE					
Monumente					
Ndërtesat Historike	kategoria 1	D	7600		
Kisha e vogël në Verifashtë	kategoria 1	D	1000		
Stua	kategoria 1	D	13100		
Peristil	kategoria 1	D	43100		
Tempulli i Aulëpit	kategoria 1	D	13200	15355	
Mure					
Mali 1 Nga Kulla Veneçiane deri në Tirkokë	kategoria 1	D	25000		
Jashët Murave Rrëthuese					
Varti në Dëgje	kategoria 1	D	2500		
TOTALI			494000	89225	4000

MIRËMBAJTJE DHE MONITORIM

1-7 VITE

TË QËNDRUESHME, KANË NEVOJË PËR PUNIME TË VOGLA

Ndërtesa Industriale (Mulli)

Monitorimi i bimësisë të vogla, mbushje të tërë carave; pastimin e lëkëve dhe myshkut duke vjazar me konservimin e strukturave lidhëse; rivendosjen e gurëve të lirë ose të rëzuar

- Bimësi ka nevojë për mirëmbajtje dhe të ruhet minimalisht në larg strukturës

- Sistemi i gurëve përmes monumentit

PUNIME	Njësia	Nr. i njësisve	Kosto për një	Totali
heqje e bimësisë, së ulët/pemëve, injektim, heqje	m ²	160	50	8000
konsolidime të vogla, mermerim i gurëve të lirë; pastim për m ³		65	60	3900
Totali				11900

Kisha e Vogël te Pagëzimatorja

Monitorimi i bimësisë brenda dhe jashtë mureve të ndërtesave

- Konservimi dhe konsolidimi i sipërfaqeve të shtuar që kanë mbetur

- Monitorimi i pemëve në afërsi të strukturës, dhe secëndisht i atyre mbi mënajat e kumbanorës

- Pastimi i lëkëve dhe myshqëve dhe konsolidimi i materialeve lidhëse

- Rivendosja të gurëve të lirë

PUNIME	Njësia	Nr. i njësisve	Kosto për një	Totali
heqje e bimësisë, së ulët/pemëve, injektim, heqje	m ²	95	50	4750
konsolidime të vogla; rivendosje të gurëve të lirë; pastim për m ³		43	60	2580
Totali				7330

Porta e Ujit

Monitorimi i bimësisë brenda dhe jashtë mureve të ndërtesës

1410 - Livadhe të kripura mesdhetare (Juncetalia maritimi)
1420 - Formacione shkurrëzash halofitike Mesdhetare dhe Termo-Atlantike (Sarcocornetea fruticosi)
5230 *- Shkorretë me Laurus nobilis
91F0 - Pyje të përzier riparianë të Quercus robur, Ulmus laevis dhe Ulmus minor, Fraxinus excelsior ose Fraxinus angustifolia, përgjatë lumenjve të mëdhenj (Ulmenion minoris)
92D0- Galeri apo breza shkurre ripariane jugore (Nerio-Tamaricetea dhe Securinegion tinctoriae)

Numri i llojeve sipas grupeve kryesore (sipas listës së llojeve me rëndësi për komunitetin Evropian)

Grupi	Aneksi II ¹ *	Aneksi IV	Lista e Kuqe IUCN EU	Lista e Kuqe Shqipëri	Endemike
Bimë	0	2	0	0	0
Amfibë	2	6	5	0	0
Zvërranikë	8	25	16	0	0
Shpendë	73	0	60	0	0
Gjitarë	16	39	38	0	0

Llojet kryesore
Breshka detare kokemadhe (* Caretta caretta)
Lundërza (Lutra lutra)
Ujku (* Canis lupus)
(* Valencia letourneuxi (Valencia hispanica))
Pelikani kacurrel (Pelecanus crispus)
Foka e Mesdheut (* Monachus monachus)

Habitatet kryesore
1120 - * Livadhe të Posidonieve (Posidonium oceanicae)
1150 - * Laguna bregdetare
5230 *- Shkorretë me Laurus nobilis

¹ * Aneksi II i referohet Direktivës së Habitaveve, për Shpendët, referojuni Aneksit I të Direktivës së Shpendëve

Shtojca E Flora dhe fauna

1 Vlerat Natyrore

1.1 Fauna

Në brigjet e kanalit të komunikimit me detin janë gjetur 11 lloje molusqesh, nga të cilët 6 janë gastropodë dhe 5 bivalvë. Në tabelën 1 jepen llojet dhe statusi i popullatave të tyre.

	Lloji	Statusi
Gastropoda	<i>Rissoa labiosa</i>	C
	<i>Alvania lineata</i>	C
	<i>Pirenella conica</i>	B
	<i>Bittium reticulatum</i>	B
	<i>Cyclope neritea</i>	C
	<i>Nassarius reticulatus</i>	C
Bivalvia	<i>Cerastoderma glaucum</i>	B
	<i>Scrobicularia plana</i>	B
	<i>Dosinia lupinus</i>	C
	<i>Tapes decussatus</i>	D
	<i>Paphia aurea</i>	D

Nga gastropodët, dendësinë mesatare më të madhe e kanë *Bittium reticulatum* dhe *Pirenella conica*, ndërsa nga bivalvët *Cerastoderma glaucum* dhe *Scrobicularia plana*.

Llojet e tjerë paraqesin vlera shumë të vogla të dendësisë, frekuencës dhe konstantes. Në përgjithësi, dendësia dhe frekuenca më e lartë e molusqeve paraqitet në pjesët e substratit të pasura me makrofitobentos dhe sediment ranor-lymor. Prania e vogël e llojeve të molusqeve lidhet edhe me faktin se kanali i komunikimit me detin është një mjedis tranzitor, në të cilin, për shkak të dinamikës së lartë të rrymave dhe faktorëve abiotikë zvogëlohet mundësia e fiksimit dhe përshtatjes së organizmave bentonikë. Megjithatë, për nga përbërja llojore, karakteristikat e malakofaunës së kanalit të komunikimit të Lagunës së Butrintit me detin janë mjaft të ngjashme me atë të malakofaunës tipike lagunore, ndërsa karakteristikat sasiore të popullatave janë të ndryshme nga ato lagunore.

Malakofauna bregdetare

Llojet e gjetura në bregdet paraqiten në tabelën e mëposhtme për secilën zonë të monitorimit. Më të zakonshëm janë bivalvët *Donax*, *Tellina*, *Mactra* e *Chamelea*. Bie në sy sasia shumë e vogël e gastropodëve, përfshirë edhe llojet që konsiderohen si shumë të zakonshëm në brigjet ranore.

Tabela 2. Llojet e molusqeve të gjetur në bregdet

Lloji i moluskut	Butrint
<i>Alvania lineata</i>	
<i>Rissoa ventricosa</i>	+
<i>Hydrabia acuta</i>	+
<i>Ventrosia ventrosa</i>	+
<i>Cerithium vulgatum</i>	+
<i>Turritella comunis</i>	+
<i>Galeoda echinophora</i>	+

<i>Hexaplex trunculus</i>	+
<i>Murex brandaris</i>	+
<i>Fusinus rostratus</i>	+
<i>Nassarius mutabilis</i>	+
<i>Nassarius reticulatus</i>	
<i>Neverita josephinae</i>	+
<i>Naticarius hebraeus</i>	
<i>Naticarius stercusmuscaris</i>	+
<i>Aporrhais pespelecani</i>	+
<i>Columbella rustica</i>	+
<i>Pisania striata</i>	
<i>Conus mediterraneus</i>	+
<i>Arca noae</i>	+
<i>Glycymeris insubrica</i>	
<i>Mytilus galloprovincialis</i>	
<i>Chlamys varia</i>	+
<i>Ostrea edulis</i>	
<i>Anomia ephippium</i>	+
<i>Acanthocardia tuberculata</i>	+
<i>Cerastoderma glaucum</i>	+
<i>Mactra corallina</i>	+
<i>Solen marginatus</i>	
<i>Ensis minor</i>	+
<i>Tellina planata</i>	+
<i>Tellina pulchella</i>	+
<i>Tellina exigua</i>	
<i>Donax trunculus</i>	+
<i>Donax variegatus</i>	
<i>Pharus legumen</i>	+
<i>Lucinella divaricata</i>	+
<i>Loripes lacteus</i>	+
<i>Dossinia lupinus</i>	+
<i>Macoma cumana</i>	+
<i>Venerupis geographica</i>	+
<i>Chamelea gallina</i>	+
<i>Pholas dactylus</i>	+

Në tabelën e mëposhtme paraqiten llojet e molusqeve të rrezikuara, me statusin e kërcënimit (sipas IUCN) në nivel kombëtar dhe lokal për secilin ekosistem.

Lloji	Statusi kombëtar	Statusi Lokal
		Butrint
<i>Alvania lineata</i>	DD	DD
<i>Rissoa labiosa</i>	LRcd	DD
<i>Rissoa ventricosa</i>	LRcd	-
<i>Rissoa pulchella</i>	LRcd	-
<i>Pusillina marginata</i>	LRcd	-
<i>Pirenella conica</i>	-	LRlc
<i>Hinia reticulata</i>	LRnt	LRlc
<i>Abra segmentum</i>	DD	-

<i>Acanthocardia tuberculata</i>	LRlc	-
<i>Gari telinella</i>	DD	-
<i>Dosinia exoleta</i>	LRcd	-
<i>Dosinia lupinus</i>	LRnt	VU
<i>Loripes lacteus</i>	DD	-
<i>Lucinella divaricata</i>	DD	-
<i>Paphia aurea</i>	VUA1a	VUA1a
<i>Tapes decussatus</i>	VUA1a	VUA1a

Kërcënime. Sipas planeve të shfrytëzimit nga institucione dhe organizata që punojnë në fushën e akuakulturës ka një rritje interesi për tregëtimin e moluskëve bregdetarë dhe detarë. Nëse këto plane do të orientohen vetëm drejt interesave të ngushta ekonomike, për një kohë të shkurtër situata e malakofaunës detare e bregdetare do të përkeqësohet më tej. Peshkimi i vazhdueshëm me lëndë plasëse është një tjetër dëmtim i drejtpërdrejtë për malakofaunën. Dëmi i shkaktuar prej tij merr përmasa më të mëdha gjatë periudhës së riprodhimit të molusqeve. Gjithashtu, rjetat fundore të peshkimit shkaktojnë një tjetër dëmtim të konsiderueshëm për molusqët. Përveç dëmtimit mekanik, ato i zhvendosin molusqet nga kushtet specifike të habitatit të tyre. Shpesh sasi të mëdha molusqesh të ngecur në rrjetat e peshkimit lihen në breg dhe ngordhin. Ky fenomen takohet kryesisht tek moluskët e përmasave të mëdha. Ndotja e ujrave për shkak të derdhjeve të ujrave të zeza të fshatrave përreth, ujrave me përmbajtje detergjentësh dhe helmesh kimike bujqësore, si dhe nga karburantet, përbën një tjetër faktor dëmtues për malakofaunën bregdetare. Për malakofaunën e tokës dhe ujrave të ëmbla, dëmet vijnë kryesisht nga ndotjet me pesticide dhe lëndë të ndryshme helmuese që përdoren në bujqësi; punimi i tokës deri afër brigjeve; grumbullimi i kallamave (*Phragmites*), zhugës (*Juncus*) dhe shavarit (*Typha*) në pellgjet dhe ligatinat; prerje e marinave (*Tamarix*) të cilat formojnë habitate të rëndësishme për faunën ligatinore; grumbullimi i drejtpërdrejt i kërmijve të zakonshëm (*Helix*) për qëllime komerciale, si nga firma të licënuara, ashtu edhe nga grumbullues amatorë e spontanë.

Amfibët dhe reptilët (herpetofauna)

Një sërë monitorimesh janë realizuar ndër vite mbi habitatet ku gjenden amfibët dhe reptilët në Butrint dhe vihet re një përmirësim si në zonën kënetore (disa ha.) në Veri-Perëndim, të Liqenit Butrintit, pranë hidrovorit. Këto habitate janë shumë të rëndësishme, sidomos për llojin subendemik *Rana epeirotica* dhe hibridin që rrjedh nga kryqëzimi i *Rana balcanica* me *Rana epeirotica*. Në këtë habitat, ka rezultuar se gjendja e dy llojeve të mësipërme (*R. balcanica* e *R. epeirotica*) dhe hibridit të tyre paraqiten në gjendje të mirë; mandje numri i individëve të *R. epeirotica* është i lartë: (2-3 individë në 8 m²) në krahasim me shumë habitate të tjera (kanale, gryknderdhja lumenjësh, gropa me ujë, kënetë etj.).

Rana epeirotica (bretkosa Epirit), lloje subememike, me areal hapsinor shumë të kufizuar (Vetëm në Greqi e Shqipëri). Në veri-lindje të Liqenit Butrintit, në një habitat kënetor me kanale e gropa të shumta, me bimësi të dendur sidomos kashta e kënetës (*Typha sp.*). Ka rezultuar se denduria e *Rana epeirotica* në këto habitate ka qenë rreth 2 herë më e madhe sesa në vitin 2002. Kjo me sa duket është e lidhur me dëmtimin që është bërë kënetës në vitin 2002, bimësia e së cilës ka qenë djegur nga barinjët.

Testudo marginata lloj me areal hapsinor shumë të kufizuar (Vetëm në Greqi e Shqipëri), globalisht i rrezikuar. Vetëm 2 individë të këtij lloji janë takuar në zonë, shifër e cila tregon se sa e rrallë është *Testudo marginata* në këtë zonë. Ajo bashkëjeton në të njëjtët habitate me *Testudo hermanni*. Nga matjet e bëra në terren bie në sy denduria më e madhe e *Testudo hermanni* sesa *Testudo marginata*. Kështu numri është 12 herë më i madh se i *Testudo marginata*.

Eryx jaculus, gjarpri (boa) e rërës, reptili me i rrallë në Shqipëri, i cili është takuar vetëm një herë në këtë zonë, lloj globalisht i rrezikuar. Arealin hapsinor me verior i këtij lloji është Saranda.

Kërcënime: Përsa i përket kërcënimeve në raport me amfibët dhe reptilët janë identifikuar faktorët e mëposhtëm:

- Dëmtimi i habitateve natyrore nga kanali Cukës deri në Butrint;
- Ndërtime të shumta pa leje;
- Kullotje masive me bagëti e zonës në fjalë;
- Shtimi i banorëve sidomos, kjo më shqetësuese është për stinën e verës.
- Gjuetia pa leje e me mjete të ndaluara
- Zhurmat nga makinat, të cilat vrasin shumë lloje kafshësh nga që ecin me shpejtësi.
- Eutrfikimi i Lagunës

Shpendët

Pjesa kryesore e llojeve të vrojtuarra i përket grupit të shpendëve të ujit. Numri i llojeve folenizues (Tab. 4) është i pakët në krahasim me ligatinat e tjera. Komuniteti dominohet nga llojet territoriale si Gakthi i vogël *Ixobrychus minutus* dhe Pulujëza *Gallinula chloropus* të shpërndarë në tërësinë e kompleksit e sidomos në kallamishtet e pjesës veriore të Liqenit të Butrintit si dhe ato të Liqenit të Bufit (Rrezes). Shpendët koloniale janë të lokalizuar në ishujt bregdetare të Ksamilit dhe të Stillos. Kolonitë janë të vendosura në pjesët më pak të vizituara nga njerëzit dhe nën një mbulesë bimore të zhvilluar për tu fshehur në të për të shmangur ngacmimet e qëllimshme apo të paqëllimshme prej njeriut.

Tabele 4. Shpendët e ujit folenizues në Butrint gjatë vitit 2004 (Bino 2004)

Nr.	Llojet	2002
1	<i>Tachybaptus ruficollis</i>	5-6
2	<i>Ixobrychus minutus</i>	17-22
3	<i>Rallus aquaticus</i>	4-5
4	<i>Gallinula chloropus</i>	6-10
5	<i>Fulica atra</i>	1-3
6	<i>Charadrius alexandrinus</i>	3-6
7	<i>Charadrius dubius</i>	1
8	<i>Tringa totanus</i>	1-2
9	<i>Larus cochinnans</i>	58-75
TOTAL		96-130

Ndonëse më pak probleme se zonat e tjera edhe në Butrint vihet re se shpendët ujqorë folenizues vuajnë nga mungesa fizike e vendeve të pershtatshme për folenizim. Të vetmet vende të folenizimit mbeten kallamishtet (në veri të liqenit dhe liqeni i Bufit) si dhe ishujt e Ksamilit dhe Stillos. Kallamishtet e veriut dëmtohen nga djegiet e herëpashershme ndërsa ishujt e Ksamilit dhe të Stillos janë kthyer në qendra të zhvillimit të aktivitetëve turistike (plazh, koncerte, etj) duke sjellë shqetësimin e llojeve folenizues.

Llojet e rrezikuar në shkallë lokale në secilin prej zonave

Në Butrint ka vetem tre lloje që hasin në vështirësi për mbijetesë. Butrinti është dukshëm më i sigurtë për llojet e rrezikuara sesa zonat e tjera te monitoruara.

Llojet e rrezikuara në shkallë lokale

Nr.	Llojet	Butrint
	<i>Circus aeruginosus</i>	+
	<i>Circus cyaneus</i>	+
	<i>Larus cochinnans</i>	+

Llojet e Shpendëve të Rrezikuar në Shkallë Kombëtare të Vrojtura.

Llojet	Butrint	Statusi Kombëtar
Botaurus stellaris	+	VU
Nycticorax nycticorax	+	VU
Ardeola ralloides	+	VU
Egretta garzetta	+	VU
Egretta alba	+	EN
Ardea cinerea	+	VU
Ardea purpurea	+	EN
Circus aeruginosus	+	VU
Circus cyaneus	+	EN
Buteo buteo	+	VU
Falco naumanni	+	VU
Falco tinnunculus	+	VU
Haematopus ostralegus	+	VU
Himantopus himantopus	+	EN
Recurvirostra avosetta	+	EN
Glareola pratincola	+	VU
Larus cachinnans	+	EN
Sterna sandvicensis	+	VU
Sterna hirundo	+	EN
Total	19	

Kërcënimet ndaj shpendëve janë të lidhura me:

- Gjuetinë e paligjshme dhe perndjekjen e shpendëve
- Shqetësimin e vazhdueshëm prej njeriut
- Pëshkimin e paligjshëm
- Shkatërrimin e habitateve natyrore

Gjuetia e paligjshme dhe perndjekja e shpendëve

Gjuetia vazhdon të jetë faktori kryesor i dëmtimit të popullatave të shpendëve folenizues. Vazhdon të qendrojë në të njëjtat nivele me ato të viteve të mëparshme, çka do të thotë se presioni i saj është shumë i lartë. Përdoren të gjitha mjetet e paligjshme si pushkat automatike, imituesit e zërave të shpendëve, dritat etj.

Shqetësimi i vazhdueshëm prej njeriut

Shqetësimi nga njeriu sjell ndërprerjen e aktiviteteve jetike si të ushqyerit dhe riprodhimi. Ndërprerja e riprodhimit mund të jetë e pjesëshme ose e plotë. Pra mund të kemi largim të përkohshëm të të rriturve nga foleja dhe lënie pa kujdesje e vezëve apo të vegjëlve. Këto ndërprerje janë fatale për shpendët sepse vezët apo të vegjëlit rrezikohen të vdesin nga temperaturat e larta të ditës apo temperaturat e ulëta të natës. Nëse vezët apo të vegjëlit do të dështonin atëherë i tërë sezoni i riprodhimit duhet të quhet i humbur. Në këto kushte shpendët do të parapëlqenin zgjedhjen e një vendi folenizimi të sigurtë, pa nivele të larta të shqetësimit.

Pëshkimi i paligjshëm

Janë tejperhapur format ilegale të pëshkimit si ato me drita apo dinamit. Rrjetat e peshkatarëve qëndrojnë gjithë kohën në ujë duke bërë të pashfrytëzueshme pjesën më të madhe të sipërfaqes ujore. Anijet e pëshkimit krehin bregun e detit në zona të ndaluara duke shkatërruar gjithçka në fundin e tij. Ky aktivitet redukton rezervat ushqimore të shpendëve si dhe sjell shqetësimin e vazhdueshëm të tyre.

Gjitarët

Situata faunistike përse i përket gjitarëve në kompleksin ligatinor të Butrintit, paraqitet e stabilizuar, ndonëse nuk mungojnë problemet dhe shqetësimet, si: menaxhimi i aktiviteve rekreative, kullotja, gjuetia.

Emri shkencor	Emri ne Shqip	Indikatori/Treguesi		
		Abondanca	Statusi	Shkalla e Rrezikimit
<i>Lutra lutra</i>	Lundërza, vidra	3	3	VU
<i>Canis aureus</i>	Çakalli	3	3	
<i>Meles meles</i>	Baldosa	2	3	
<i>Mustela putorius</i>	Qelbësi	0	0	
<i>Lepus europaeus</i>	Lepuri i egër	2	3	
<i>Crocidura leucodon</i>	Hundëgjati i livadheve	3	3	
<i>Crocidura suaveolens</i>	Hundëgjati i zakonshëm	2	3	
<i>Suncus etruscus</i>	Hundëgjati "xhuxh"	4	3	
<i>Erinaceus concolor</i>	Iriqi	2	3	
<i>Apodemus silvaticus</i>	Miu bishtgjatë	2	3	
<i>Apodemus flavicollis</i>	Miu gushë-verdhë	2	3	
<i>Mus musculus</i>	Miu i shtëpisë	2	3	
<i>Pitymys thomasi</i>	Miu i Tomas-it	1	3	
<i>Pitymys felteni</i>	Miu i Felten-it	3	3	
<i>Microtus epiroticus</i>	Miu i Ondrias-it	3	3	
<i>Monachus monachus</i>	Foka e Mesdheut	4	5	CR
<i>Delphinus delphi</i>	Delfini	4	4	EN
<i>Tursiops truncatus</i>	Delfini turishkurtër	3	4	VU

1.2 Flora

Në Parkun Natyror të Butrintit dallohen disa lloje habitatesh të cilat variojnë nga detare dhe ligatinore në perëndim, në malore në lindje.

Ndër to dallohen sidomos Livadhe me Posidonia (*Posidonia oceanica*). Janë gjerësisht të përhapura në tabanin litoral detar, deri 30-40m thellësi. Më të zhvilluara janë përgjatë Kepit të Stillos. Në ujërat e cekëta litorale, midis derdhjes së lumit Pavllë dhe kanalit të Vivarit, livadhet me *Posidonia* zëvendësohen nga livadhe me *Cymodocea nodosa* dhe *Zostera noltii*, që tërheqin disa lloje peshq, si: *Pagrus pagrus*, *Serranus hepatus*, *Symphodus roissali* etj. Në ligatinat e kripura, të njelmëta apo të ëmbla, aq të shumta në park, gjenden shumë habitate me lloje dhe shoqërimi të larmishme bimësh. Ndër to përmendim: habitatit i baltinave dhe i ranishtave intertidale, shoqërimet e *Phragmites australis* dhe *Typha latifolia*, bimësia njëvjeçare e vijës bregdetare, bimësia endemike *Limonium* spp. në shkëmbinjtë detarë të bregdetit, livadhet kripura mesdhetare (*Juncetalia maritimi*), shkurreta halofile mesdhetare dhe termoatlantike

(*SarcoMiseretea fruticosi*), shkurreta halo-nitrofile (Pegano-Salsoletea), stepa të kripura mesdhetare (Limonietalia), ujëra të forta oligo-mezotrofike me vegjetacion bentic me *Chara* spp., liqene natyrore eutrofike me vegjetacion të tipit Magnopotamion ose Hydrocharition, pellgje të përkohshme, kënetat, lumenj me lloje të aleancës Paspalo-Agrostidion, shelgje degëvarur e plep të bardhë (*Salix* dhe *Populus alba*).

Pylli Butrintit. Pylli në këtë territor zë një sipërfaqe të konsiderueshme. Ai shtrihet brenda territorit të qytetit antik të Butrintit dhe pjesërisht gjatë kanalit që lidh liqenin e Butrintit me detin Jon. Në këtë teritor rritet një bimësi e tipit hidro- higrofil. Ky dallohet për një strukturë vertikale të përbërë nga 3 kate të bimësisë ku shoqërimi bimor kryesor është ai i përfaqësuar nga *Ulmus minor- Fraxinus angustifolia*. Kati drunor që i jep dhe fizionominë këtij habitati përfaqësohet nga speciet dominuese si : *Ulmus minor, Fraxinus angustifolia, Quercus robur, Populus alba*, dhe në raste të veçanta (Porta e Luanit) edhe të *Laurus nobilis* dhe *Quercus ilex*. Kati shkurret përfaqësohet nga specie prej të cilave vlerë me të lartë kanë: *Rubus ulmifolius, Crataegus monogyna, Rosa sempervirens, Periploca graeca, Hedera helix, Salix alba, Cercis siliquastrum, Clematis viticella* etj. Në katin barishtor speciet më të përhapura janë: *Asparagus acutifolius, Gallium mollugo, Ranunculus ficaria, Campanula rapunculus, Lythrum salicaria* etj.

Ligatinat përreth Qytetit antik të Butrintit dhe brenda Parkut. Këto habitate zënë një pjesë të konsiderueshme të parkut . Ato përfaqësohen kryesisht nga tokat e kripura ose ligatinat të përhapura kryesisht përreth liqenit të Butrintit (pjesa veriore, juglindore dhe jugore), përgjatë kanalit që lidh liqenin e Butrintit me detin Jon; zona midis kanalit dhe grykëderdhjes së lumit Pavllo, si dhe në pjesën perëndimore të liqenit të Bufit.

Shoqërimet bimore kryesore që takohen në këto habitate janë:

a- *Shoqërimet me mbizotërim të specieve të gjinisë Arthrocnemum.*

Sipërfaqet e mbuluara nga këto shoqërimet janë të konsiderueshme dhe i përkasin tipit shumë të kripura - livadhore. Ato qëndrojnë pothuajse gjatë gjithë vitit të përmbytura nga dukuritë e baticë zbaticës dhe ujërave të shirave. Vetëm në periudhën e nxehtë të verës këto sipërfaqe thahen plotësisht dhe plasariten në forma të ndryshme. Speciet mbizotëruese në këto shoqërimet janë: *Arthrocnemum fruticosum, A. perenne, A. glaucum, Salicornia europaea, Limonium vulgare, Inula crithmoides, Halimione portulacoides, Artemisia coerulescens* etj. Në përgjithësi këto shoqërimet karakterizohen nga një përbërje e varfër floristike dhe me një mbulesë të përgjithshme të vegjetacionit në masën 70-80% të sipërfaqes.

b- *Shoqërimet me mbizotërim të specieve të gjinisë Juncus.*

Këto shoqërimet ku speciet mbizotëruese janë *Juncus acutus* dhe *J.maritimus* i japin shpesh fizionominë këtyre habitateve. Ato formojnë shpesh një brez të vazhdueshëm, por herë-herë ato janë të alternuara me shoqërimet bimore të mësipërme. Edhe këto shoqërimet janë nën ndikimin e kushteve të mësipërme por ato dallohen për një amplitudë ekologjike më të lartë lidhur me shkallën e kripëzimit.

c- *Shoqërimet me mbizotërim të specieve të gjinisë Tamarix.*

Këto shoqërimet janë të përhapura kryesisht në zonën midis liqenit të Bufit dhe atij të Butrintit, rreth qytetit antik të Butrintit përgjatë kanalit që lidhet me detin Jon dhe në grykëderdhjen e lumit Pavllo. Speciet mbizotëruese në këto shoqërimet janë *Tamarix dalmatica* dhe në një shkallë më të vogël *T. hampeana*. Në fizionominë e këtyre shoqërimet kontribuojnë edhe specie të tjera si: *Vitex agnus-castus, Juncus acutus, Arthrocnemum sp.dv.* etj.

d- *Shoqërimet me mbizotërim të Phragmites australis.*

Ky shoqërim është gjërësisht i përhapur në pjesën veriore të Liqenit të Butrintit, në pjesën perëndimore të liqenit të Bufit dhe në grykëderdhjen e lumit Pavllo. Këto shoqërimet shquhen për një pasticitet ekologjik të jashtëzakonshëm. Ato përhapen si në mjedise me ujëra të ëmbla ashtu edhe në ato me shkallë kripëzimi disi të lartë. Qëndrueshmëria e kësaj specie me kondita shumë të ndryshme ekologjike është rezultat i formave të shumta poliploide të *Phragmites australis*. Në mjedise ujore këto shoqërimet kanë tendencë monofitike kurse në mjedise me shkallë të lartë

kripëzimi këto shoqërimet paraqesin vitalitet më të dobët. Kjo është edhe arsyeja e zvogëlimit të sipërfaqeve të mbuluara nga ky shoqërim në këto mjedise. Kjo dukuri është bërë më e evidente pas devijimit të lumit të Bisticës gjë që ka sjellë si pasojë rritjen e shkallës së kripëzimit dhe zvogëlimin e vitalitetit të shoqërimit të mësipërm.

e- *Shoqërimet me Typha angustifolia.*

Këto shoqërimet formojnë shpesh një faqe të vazhdueshme ngjitur me shoqërimet e dominuara nga *Phragmites australis*. Në dallim nga shoqërimi me *Phragmites australis*, shoqërimet me *Typha angustifolia* parapëlqejnë mjedise me ujëra krejtësisht të ëmbla (grykëderdhja e lumit Pavllo, liqeni i Bufit), si dhe buzë kanaleve në pjesën veriore të liqenit në drejtim të Çukës.

*Shoqërimet të tjera të evidentuara në mjedise të parkut të Butrintit janë edhe ato të përfaqësuara nga *Scripus lacustris* dhe *S. maritimus*. Këto shoqërimet, në sipërfaqe të vogla, takohen kudo (si psh; në pjesën veriore të Liqenit, në grykëderdhjen e lumit Pavllo etj.), në mjedise kryesisht me ujëra të ëmbla.*

Vegjetacioni i shkëmbinjve bregdetarë. Ka trajtën e një brezi të ngushtë në vendet shkëmbore të bregdetit nga Kepi i Stillos deri në Çukë. Ai shtrihet në një lartësi 2-3 m mbi nivelin e veprimt të dallgëve të detit. Kjo bimësi ka një shkallë të lartë qendrueshmërie ndaj kripshmërisë dhe veprimt shkatërrues të dallgëve. Speciet mbizotëruese në këtë shoqërim janë: *Crithmum maritimum*, *Limonium anfractus*. Nga speciet e tjera më të përhapura mund të përmendim: *Elymus pycnanthus*, *Desmazeria marina*, *Lotus cytisoides*, *Inula crithmoides* etj.

Vegjetacioni i pyjeve dhe shkorretave mesdhetare. Në parkun e Butrintit është i përhapur kryesisht në gadishullin e Ksamilit, (përfshirë këtu edhe ishujt e Ksamilit), si dhe kodrat në lindje dhe jug të liqenit të Butrintit. Si rezultat i ndikimit të faktorëve të ndryshëm në kohë të mëparshme por deri vitet e fundit, veçanërisht atij antropik ka bërë që ky formacion bimor aktualisht të përfaqësohet nga stadi të ndryshme degradimi të formacioneve pyjore të dikurshme me ilqe (*Quercus ilex*). Shkatërrimi i pyllit të lashtë me *Quercus ilex*, i cili përbën klimaxin autentik të masiveve kodrinore përreth Parkut, por edhe të një pjese të konsiderueshme të pellgut të Mesdheut, ka qenë pasuar nga një degradim i tokës. Nga analiza floristike që i është bërë këtij formacioni kemi arritur në përfundim që vegjetacioni i këtyre masiveve bën pjesë në brezin e dominuar nga shoqërimet e klasës *Quercetea ilicis* me disa grupime, mikrogrupime apo variante që përfaqësojnë stadi të ndryshme të degradimit të shoqërimeve të klasës së mësipërme.

a- *Shoqërimet me ilqe (Quercus ilex).* Këto shoqërimet në Parkun e Butrintit përhapen në ishujt e Ksamilit dhe në trajtë njollash me përmasa jo shumë të mëdha edhe në masivet kodrinore përreth parkut. Këto shoqërimet të rralla edhe në Shqipëri janë të ruajtura relativisht mirë, për vete pozicionin e tyre të izoluar. Por vitet e fundit ato po rrezikohen nga zhvillimet e vullshme të turizmit në këtë zonë me tendencë për përfshirjen edhe të katër ishujve të Ksamilit në këtë veprimtari. Ata përfaqësohen pak a shumë nga një mbulesë e dendur drunore ku *Quercus ilex* dhe *Fraxinus ornus* etj, përfaqësojnë llojet dominante, dhe nga një shtresë shkurre e dendur shpesh herë e pakalueshme si rezultat i pranisë së lianeve të ndryshme. Ndërmjet specieve më të përhapura janë: *Phillyrea angustifolia*, *Pistacia lentiscus*, *Arbutus unedo*, *Ruscus aculeatus*, *Asparagus acutifolius*, *Myrtus communis*, *Juniperus oxycedrus*, *Juniperus phoenicea*, *Olea sylvestris* etj. Nga lianet mund të përmendim: *Smilax aspera*, *Clematis viticella*, *Rubus ulmifolius* etj.

b- *Shoqërimet me prall (Quercus coccifera).* Këto shoqërimet kanë një përhapje të konsiderueshme në masivet kodrinore të parkut ndonëse shpesh me një areal të ndërprerë si rezultat i ndërhyrjes së dikurshme antropike për kthimin e këtyre sipërfaqeve në kullota kryesisht nëpërmjet djegies apo shkuljes së *Quercus coccifera*. Elemente mbizotëruese në këtë shoqërim është pralli (*Quercus coccifera*) që mbulon 50-60 % të sipërfaqes totale në këto shoqërimet. Në përbërjen e këtyre shoqërimeve përveç prallit marrin pjesë edhe *Pistacia lentiscus*, *Phlomis fruticosa*, *Colutea arborescens*, *Phillyrea media* etj.

c- Shoqërimet me *Phlomis fruticosa*. Këto shoqërimi përfaqësojnë në këtë zonë një nga tipet e vegetacionit të degraduar të klasës *Quercetea ilicis* të vendosura kryesisht mbi formacione gëlqerore. Aspekti i këtyre shoqërimeve përcaktohet nga *Phlomis fruticosa*, shkurrëz 60-70 cm dhe më pak nga *Urginea maritima*, *Pistacia lentiscus*, *Pyrus amigdaliformis*, *Quercus coccifera*, *Paliurus spina-christi*, *Brachipodium ramosum*, *Chrysopogon grillus*, *Crepis ruber*, *Malcolmia maritima*, *Saponaria calabrica*, *Asparagus acutifolius* etj. Në toka me shtresë humusi më të pasur dhe në vende më pak të ekspozuara nga dielli vihen re dhe specie të tilla si *Ceterach officinarum*, *Vallantia muralis*. Këto shoqërimi paraqesin ndryshime të vogla në përbërjen e tyre floristike si rezultat i variacioneve të shumta ekologjike të shkaktuara nga veprimtaria antropike. Kështu në kodrat e Manastirit, si rezultat i ndërhyrjes nëpërmjet kultivimeve vihen re sipërfaqe të dominuara nga specie të gjinisë *Trifolium* dhe në një sipërfaqe të konsiderueshme edhe nga *Agave americana*. Gjithashtu "përmirësimet" e kullotave të mëparshme me anë të shkuljes së çfakës apo të djegjeve kanë qenë të gabuara pasi luajnë një rol negativ në humbjen apo shkatërrimin e tokës, erozionin e saj etj. Në mjaft raste mbas këtyre proceseve "përmirësuese" është vënë re mbirja e vrullshme e fiershqipes duke prishur atë ekuilibër natyror për vendosjen e të cilit janë dashur mijëra vjet.

d- Shoqërimet me *Euphorbia dendroides*. Shoqërimet me *Euphorbia dendroides*, që janë edhe më interesantet, aktualisht mbulojnë një sipërfaqe relativisht të vogël në kodrat e Ksamilit. Këto shoqërimi përfaqësojnë një stad degradimi të parë të shoqërimeve me *Quercus ilex* të vendosura mbi formacione gëlqerore dhe në vende shumë të ekspozuara nga dielli. Përgjithësisht këto shoqërimi përfaqësohen nga shkurre dhe shkurrëza përherë të blerta ku roli kryesor i përket *Euphorbia dendroides*, dhe më pak *Pistacia lentiscus*, *Phillyrea angustifolia*, *Olea sylvestris*, *Prasium majus*, *Salvia officinalis*, *Salvia triloba* etj.

LLOJET E RREZIKUARA.

Nga analiza që i është bërë florës së Parkut Natyror të Butrintit rezulton se aty ndodhen rreth 19 lloje me status të veçantë prej të cilave 13 janë lloje të rrezikuara, 5 lloje janë të rralla, 1 e rrezikuar në mënyrë kritike dhe 4 lloje të propozuara për përfshirje në Librin e Kuq.

Bimë të rrezikuara (E).

1. *Capparis spinosa* L. -Evropiane-Aziate.

E rrallë në vende shkëmbore bregdetare të Parkut (S-M: +). Aktualisht në vendet e përhapjes nuk vihet re ndonjë rritje e shkallës së rrezikut.

2. *Colchicum autumnale* L. -Evropiano qendrore

Shumë e rrallë në masivet kodrinore të Parkut (S-M: +). Aktualisht në vendet e përhapjes nuk vihet re ndonjë rritje e shkallës së rrezikut.

3. *Desmazeria marina* (L.) Druce -Mesdhetare-atlantike.

E rrallë në vende shkëmbore bregdetare të Parkut (S-M: + rrallëherë deri 1). Aktualisht në vendet e përhapjes vihet re një rritje e shkallës së rrezikut për zhdukje si pasojë e zhvillimit të turizmit Vitet e fundit zonat ku përhapet kjo specie kanë tendencë intensifikimin e shfrytëzimit të tyre si zona plazhi për shkak të virgjërisë së tyre dhe pastërtisë së ujrave të detit.

4. *Ephedra distachya* L. -Mesdhetare Veriperendimore

E rrallë në vende shkëmbore të thepisura bregdetare dhe shpeshherë edhe në thellësi të Parkut (S-M: + deri 1). Aktualisht në vendet e përhapjes nuk vihet re ndonjë rritje e shkallës së rrezikut.

5. *Hypericum perforatum* L. -Paleotemp.

E rrallë në masivet kodrinore të Parkut (S-M: +). Në vendet e përhapjes vihet re një rritje e shkallës së rrezikut si rezultat i grumbulimit të saj si bimë mjekësore.

6. *Laurus nobilis* L. -Stenomesdhetare.

E rrallë në masivet kodrinore dhe në pyllin e Parkut (S-M: + deri 1). Në vendet e përhapjes në masivet kodrinore vihet re një rritje e shkallës së rrezikut si rezultat i grumbullimit të saj si bimë mjekësore ndërsa në pyllin e Parkut ruajtja e saj është e mirë si rezultat i masave të ndërmarra nga autoritetet e Parkut.

7. *Lotus cytisoides* L. -Stenomesdhetare.

E rrallë në vende shkëmbore bregdetare të Parkut (S-M: + rrallëherë deri 1). Aktualisht në vendet e përhapjes vihet re një rritje e shkallës së rrezikut për zhdukje si pasojë e zhvillimit të turizmit Vitet e fundit zonat ku përhapet kjo specie kanë tendencë intensifikimin e shfrytëzimit të tyre si zona plazhi për shkak të virgjërisë së tyre dhe pastërtisë së ujrave të detit.

8. *Origanum vulgare* L. -Evroaziatike.

Me përhapje të kënaqshme në masivet kodrinore të Parkut (S-M: 1 deri 2), por shpeshherë e rrezikuar si rezultat i grumbullimit të saj si bimë mjekësore.

9. *Prunus äbbii* (Spach) Vierh. -Mesdhetare.

E rrallë në masivet kodrinore të Parkut (S-M: +). Aktualisht në vendet e përhapjes nuk vihet re ndonjë rritje e shkallës së rrezikut.

10. *Quercus ilex* L. -Stenomesdhetare.

E rrallë në masivet kodrinore të Parkut, pyllin e Butrintit dhe me përhapje të mirë në ishujt e Ksamilit (S-M: 1 rrallëherë deri 2, në ishujt e Ksamilit shkon deri në 3). Ruhet mirë në masivet kodrinore të Parkut, pyllin e Butrintit. Në ishujt e Ksamilit vihet re një rritje e shkallës së rrezikut për zhdukje si pasojë e zhvillimit të turizmit (vitet e fundit ishujt e Ksamilit ku përhapet kjo specie kanë tendencë intensifikimin e shfrytëzimit të tyre si zona plazhi për shkak të virgjërisë së tyre dhe pastërtisë së ujrave të detit).

11. *Salvia officinalis* L. -Stenomesdhetare lindore.

Me përhapje të kënaqshme në masivet kodrinore të Parkut (S-M: 1 deri 2), por shpeshherë e rrezikuar si rezultat i grumbullimit të saj si bimë mjekësore.

12. *Satureja montana* L. -Orofite -Mesdhetare.

Me përhapje të kënaqshme në masivet kodrinore të Parkut (S-M: 1 deri 2), por shpeshherë e rrezikuar si rezultat i grumbullimit të saj si bimë mjekësore.

13. *Viburnum tinus* L. -Stenomesdhetare.

Shumë e rrallë në masivet kodrinore të Parkut (S-M: +). Aktualisht në vendet e përhapjes nuk vihet re ndonjë rritje e shkallës së rrezikut.

Bimë të rralla.

1. *Colchicum cupanii* Guss. -Stenomesdhetare.

Shumë e rrallë në masivet kodrinore të Parkut (S-M: +). Aktualisht në vendet e përhapjes nuk vihet re ndonjë rritje e shkallës së rrezikut.

2. *Crocus boryi* Gay. -Gati endemike (Al.,Gr.)

Shumë e rrallë në masivet kodrinore të Parkut (S-M: +). Aktualisht në vendet e përhapjes nuk vihet re ndonjë rritje e shkallës së rrezikut.

3. *Daphne gnidium* L. -Stenomesdhetare.

Shumë e rrallë në masivet kodrinore të Parkut (S-M: +). Aktualisht në vendet e përhapjes nuk vihet re ndonjë rritje e shkallës së rrezikut.

4. *Euphorbia dendroides* L. – Mesdhetare

E rrallë në masivet kodrinore të Parkut (S-M: +). Aktualisht në vendet e përhapjes nuk vihet re ndonjë rritje e shkallës së rrezikut.

5. *Limonium anfractum* (Salmon) Salmon. - Gati endemike (Al., Ju.)

E rrallë në vende shkembore bregdetare të Parkut (S-M: +). Aktualisht në vendet e përhapjes vihet re një rritje e shkallës së rrezikut për zhdukje si pasojë e zhvillimit të turizmit. Vitet e fundit zonat ku përhapet kjo specie kanë tendencë intensifikimin e shfrytëzimit të tyre si zona plazhi për shkak të virgjërisë së tyre dhe pastërtisë së ujrave të detit.

Bimë të rrezikuara në mënyrë kritike

1. *Quercus robur* L. Shumë e rrallë në pyllin e Parkut (S-M: +). Aktualisht në vendet e përhapjes nuk vihet re ndonjë rritje e shkallës së rrezikut, përkundrazi me masat e ruajtjes në forcim këto vitet e fundi vihet re një shtim i filizërisë.

Kërcënimet

Faktori antropogjen në të kaluarën jo shumë të largët ka dëmtuar rëndë biodiversitetin e këtij parku duke bërë një ndërhyrje të tejskajshme në hidrografinë e kësaj zone duke tharë me qindra ha ligatina dhe kthimin e tyre në toka bujqësore. Kështu u devijuan të gjithë lumenjtë e këtij rrethi nga rrjedha e tyre normale (Bistrica), u thanë rreth 3000 ha me kënetë, u hap një sistem i tërë kanalesh kulluese e hidrovoresh etj. Nga kjo ndërhyrje është ulur se tepërmi sipërfaqia e ligatinave me bimësinë e tyre karakteristike dhe veçanërisht sipërfaqet e mbulura nga llojet *Phragmites australis* dhe *Typha angustifolia* e për rrjedhojë pakësimin e specieve të faunës që kishin strehën e tyre në këto mjedise. Devijimi i lumit të Bistricës dhe derdhja e tij në det, thellimi i kanalit komunikues midis liqenit të Butrintit dhe detit Jon ka sjellë si pasojë ngritjen e shkallës së kripëzimit të ujrave të këtij liqeni dhe një ndikim përsëri negativ mbi shoqërimet bimore të mësipërme. Veçanërisht më "e eger" kjo ndërhyrje ka qenë në masivet kodrinore të parkut të dominuara nga shoqërimet bimore të pyjeve dhe shkorretave mesdhetare. Gjurmë të pyllit "primitiv" me *Quercus ilex*, në zonën e Parkut të Butrintit mund të gjejmë vetëm në ishujt e Ksamilit. Shkatërrimi i pyllit me *Quercus ilex* nëpërmjet djegjeve të herëpashërëshme, prerjeve, shkuljeve apo praktikave të ndryshme bujqësore (taracimi i kodrinave të Ksamilit) ka ndryshuar shumë fizionominë e tij natyrore. Kjo ka bërë që formacionet bimore aktuale të përfaqësojnë stadi degradimi të formacioneve pyjore të dikurshme me *Quercus ilex*. 10 – 15 vjet më parë në këto zona ishte normale praktika e shkuljeve dhe djegjeve të formacioneve me *Quercus coccifera* dhe *Phlomis fruticosa* për "shndërrimin" e tyre në kullota, veçanërisht në zonën e Manastirit, praktike shumë e gabuar sepse krahas degradimit të bimësisë, pakësimit të faunës, çon edhe në shkatërrimin e tokës dhe rritjen e shkallës së erozionit. Gjithashtu shumë e gabuar ka qenë edhe mbulimi i sipërfaqeve të konsiderueshme në zonën e Manastirit me specie jo autoktone siç është rasti i *Agave americana* e kultivuar vite më parë për qëllime industriale. Përhapja dhe zhvillimi i kësaj specijeje invazive ka çuar në rritjen e shkallës së konkurrencës ndaj specieve të florës autoktone. Vëzhgimet tona konfirmojnë një presion të fortë e të vazhdueshëm të njeriut në këtë park dhe veçanërisht në zonat pranëbregdetare, si rezultat i zhvillimit të turizmit të pakontrolluar dhe ndërtimeve të paligjshme. Aktualisht më të kërcënuara janë llojet dhe habitatet që përhapen në këto zona.

Shtojca F Censusi mbi shpendët e ujit të regjistruar në Shqipëri gjatë IWC 2020

Shpendët e ujit të regjistruar në Shqipëri gjatë IWC 2016

Butrint	3002 individe	31 lloje
---------	---------------	----------

Nr	Species (Latin)	Species (Albanian)	Numri i individeve
1	<i>Tachybaptus ruficollis</i>	Kredharaku i vogel	10
2	<i>Podiceps cristatus</i>	Kredharaku i madh	168
3	<i>Podiceps nigricollis</i>	Kredharaku gushezi	9
4	<i>Phalacrocorax carbo</i>	Karabullaku i detit	240
5	<i>Egretta garzetta</i>	Cafka e vogel	18
6	<i>Ardea alba</i>	Cafka e madhe	9
7	<i>Ardea cinerea</i>	Cafka e perhime	31
8	<i>Platalea leucorodia</i>	Capka sqepluge	18
9	<i>Phoenicopterus roseus</i>	Lejleku krahekuaq	1
10	<i>Mareca penelope</i>	Kryekuqe e madhe	25
11	<i>Mareca strepera</i>	Rosa e perhime	8
12	<i>Anas crecca</i>	Rosa kere	170
13	<i>Anas platyrhynchos</i>	Kuqlla qafegjelber	468
14	<i>Aythya ferina</i>	Kryekuqe e mjeme	50
15	<i>Mergus serrator</i>	Zhytesi me callme	12
16	<i>Gallinula chloropus</i>	Puleza e ujit	2
17	<i>Fulica atra</i>	Bajza	1202
18	<i>Pluvialis apricaria</i>	Gjelaci ngjyre ari	100
19	<i>Numenius arquata</i>	Kojliku i madh	9
20	<i>Tringa totanus</i>	Qyryl. kembeqirize	6
21	<i>Tringa nebularia</i>	Qyrylyku i madh	1
22	<i>Tringa ochropus</i>	Qyr. kembepershime	1
23	<i>Actitis hypoleucos</i>	Qyrylyku i vogel	2
24	<i>Croicocephalus ridibundus</i>	Puleb. e zakonshme	327
25	<i>Larus michahellis</i>	Puleb. kembeverdhe	29
26	<i>Thalasseus sandvicensis</i>	Sterni dimerak	70
27	<i>Buteo buteo</i>	Huta	4
28	<i>Accipiter gentilis</i>	Gjeraqina	1
29	<i>Circus aeruginosus</i>	Shqipja e kenetes	6
30	<i>Falco tinnunculus</i>	Skifteri ktherazi	3
31	<i>Hirundo rupestris</i>	Dallendyshe e gureve	2
Total			3002

Shpendët e ujit të regjistruar në Shqipëri gjatë IWC 2017

Butrint 2017	6113	34
--------------	------	----

Nr.	Emri shkencor	Emri shqiptar	Numri i individeve
1	<i>Tachybaptus ruficollis</i>	Kredharaku i vogël	48
2	<i>Podiceps cristatus</i>	Kredharaku i madh	25
3	<i>Podiceps nigricollis</i>	Kredharaku gushëzi	22
4	<i>Phalacrocorax carbo</i>	Karabullaku i detit	648
5	<i>Microcarbo pygmeus</i>	Karabullaku i vogël	9
6	<i>Egretta garzetta</i>	Capka e bardhë e vogël	16
7	<i>Ardea alba</i>	Capka e madhe e bardhë	14
8	<i>Ardea cinerea</i>	Capka e përhime	19
9	<i>Platalea leucorodia</i>	Capka sqeplugë	42
10	<i>Cygnus olor</i>	Mjelma me xhungë	3
11	<i>Tadorna tadorna</i>	Laroshja	6
12	<i>Mareca penelope</i>	Kryekuqe e madhe	110
13	<i>Mareca strepera</i>	Rosa e përhime	17
14	<i>Anas crecca</i>	Rosa kërre	224
15	<i>Anas platyrhynchos</i>	Kuqlla qafëgjelber	1727
16	<i>Anas acuta</i>	Rosa bishtgjelë	1
17	<i>Aythya ferina</i>	Kryekuqe e mjeme	154
18	<i>Aythya fuligula</i>	Rosa laramane me cafkë	14
19	<i>Mergus serrator</i>	Zhytësi i mesëm me callmë	31
20	<i>Anatidae sp.</i>	Rosa	600
21	<i>Rallus aquaticus</i>	Gjeli i ujit	3
22	<i>Gallinula chloropus</i>	Pulëza e ujit	32
23	<i>Fulica atra</i>	Bajza	1547
24	<i>Vanellus vanellus</i>	Gicvilja	230
25	<i>Recurvirostra avosetta</i>	Sqepbiza	5
26	<i>Pluvialis apricaria</i>	Gjelaci pikalosh ngjyrë ari	19
27	<i>Calidris minuta</i>	Gjelaci i vogël	15
28	<i>Calidris alpina</i>	Gjelëza gushëzezë	110
29	<i>Numenius arquata</i>	Kojliku i madh	7
30	<i>Tringa erythropus</i>	Qyrylyku i murrmë	3
31	<i>Tringa ochropus</i>	Qyrylyku këmbëpërhimë	5
32	<i>Croicocephalus ridibundus</i>	Pulëbardha e zakonshme	262
33	<i>Larus michahellis</i>	Pulëbardha këmbëverdhe	129
34	<i>Thalasseus sandvicensis</i>	Sterni dimërak	16
Total			6113

Shpendët e ujit të regjistruar në Shqipëri gjatë IWC 2018

Nr.	Species/Counting points	Numri i individeve
1	<i>Podiceps nigricollis</i>	64
2	<i>Tachybaptus ruficollis</i>	0
3	<i>Podiceps cristatus</i>	6
4	<i>Pelecanus crispus</i>	0
5	<i>Phalacrocorax carbo</i>	623
6	<i>Phalacrocorax aristotelis</i>	0
7	<i>Phalacrocorax pygmeus</i>	0
8	<i>Bubulcus ibis</i>	0
9	<i>Egretta garzetta</i>	3
10	<i>Egretta alba</i>	12
11	<i>Ardea cinerea</i>	15
12	<i>Platalea leucorodia</i>	9
13	<i>Phoenicopterus roseus</i>	37
14	<i>Cygnus olor</i>	0
15	<i>Tadorna tadorna</i>	0
16	<i>Anas platyrhynchos</i>	65
17	<i>Anas strepera</i>	4
18	<i>Anas acuta</i>	0
19	<i>Anas clypeata</i>	0
20	<i>Anas penelope</i>	0
21	<i>Anas crecca</i>	155
22	<i>Aythya ferina</i>	0
23	<i>Aythya fuligula</i>	0
24	<i>Anas sp</i>	40
25	<i>Melanita fusca</i>	0
26	<i>Bucephala clangula</i>	0
27	<i>Mergus serrator</i>	12
28	<i>Rallus aquaticus</i>	0
29	<i>Gallinula chloropus</i>	0
30	<i>Fulica atra</i>	185
31	<i>Recurvirostra avosetta</i>	0
32	<i>Charadrius alexandrinus</i>	0
33	<i>Pluvialis squatarola</i>	0
34	<i>Pluvialis apricaria</i>	0
35	<i>Vanellus vanellus</i>	0
36	<i>Arenaria interpres</i>	0
37	<i>Calidris alpina</i>	0
38	<i>Calidris minuta</i>	0

39	<i>Actitis hypoleucos</i>	0
40	<i>Tringa glareola</i>	0
41	<i>Tringa ochropus</i>	0
42	<i>Tringa totanus</i>	18
43	<i>Tringa erythropus</i>	0
44	<i>Tringa nebularia</i>	0
45	<i>Numenius arquata</i>	21
46	<i>Larus genei</i>	0
47	<i>Larus ridibundus</i>	87
48	<i>Larus michahellis</i>	216
49	<i>Larus sp</i>	0
50	<i>Sterna sandvicensis</i>	58
51	<i>Alcedo atthis</i>	1
52	<i>Pandion haliaetos</i>	0
53	<i>Circus aeroginosus</i>	2
54	<i>Circus cyaneus</i>	0
55	<i>Buteo buteo</i>	5
56	<i>Accipiter nissus</i>	0
57	<i>Falco tinnunculus</i>	0
58	<i>Falco peregrinus</i>	0
59	<i>Parus lugubris</i>	1
60	<i>Parus major</i>	0
61	<i>Fringilla coelebs</i>	0
62	<i>Saxiola rubicola</i>	0
63	<i>Gallinago gallinago</i>	0
<i>Total</i>		1639

Shpendët e ujit të regjistruar në Shqipëri gjatë IWC 2019

Nr.	Scientific name	Numri i individeve
1	<i>Tachybaptus ruficollis</i>	38
2	<i>Podiceps cristatus</i>	505
3	<i>Podiceps nigricollis</i>	50
4	<i>Phalacrocorax carbo</i>	152
5	<i>Microcarbo pygmeus</i>	22
6	<i>Egretta garzetta</i>	11
7	<i>Ardea alba</i>	64
8	<i>Ardea cinerea</i>	10
9	<i>Platalea leucorodia</i>	30
10	<i>Phoenicopterus roseus</i>	23
11	<i>Mareca strepera</i>	98
12	<i>Anas crecca</i>	150
13	<i>Anas platyrhynchos</i>	135

14	<i>Anas acuta</i>	7
15	<i>Spatula clypeata</i>	36
16	<i>Aythya ferina</i>	12
17	<i>Mergus serrator</i>	19
18	<i>Anatidae sp.</i>	41
19	<i>Gallinula chloropus</i>	8
20	<i>Fulica atra</i>	986
21	<i>Vanellus vanellus</i>	282
22	<i>Charadrius hiaticula</i>	28
23	<i>Charadrius alexandrinus</i>	36
24	<i>Pluvialis apricaria</i>	86
25	<i>Pluvialis squatarola</i>	5
26	<i>Calidris alpina</i>	32
27	<i>Gallinago gallinago</i>	8
28	<i>Numenius arquata</i>	6
29	<i>Tringa totanus</i>	15
30	<i>Tringa nebularia</i>	1
31	<i>Tringa ochropus</i>	1
32	<i>Croicocephalus ridibundus</i>	558
33	<i>Larus genei</i>	1
34	<i>Larus michahellis</i>	543
35	<i>Thalasseus sandvicensis</i>	22
<i>Total</i>		4021

Shpendët e ujit të regjistruar në Shqipëri gjatë IWC 2020

Nr.	Llojet	Numri i individeve
1	<i>Alcedo atthis</i>	1
2	<i>Anas acuta</i>	0
3	<i>Anas clypeata</i>	0
4	<i>Anas crecca</i>	124
5	<i>Anas platyrhynchos</i>	91
6	<i>Anas strepera</i>	124
7	<i>Ardea alba</i>	5
8	<i>Ardea cinerea</i>	108
9	<i>Aythya ferina</i>	4
10	<i>Bubulcus ibis</i>	6
11	<i>Calidris alpina</i>	0
12	<i>Calidris canutus</i>	0
13	<i>Calidris minuta</i>	0

14	<i>Charadrius alexandrinus</i>	2
15	<i>Egretta garzetta</i>	89
16	<i>Falco tinnunculus</i>	0
17	<i>Fulica atra</i>	393
18	<i>Gallinago gallinago</i>	8
19	<i>Gallinula chloropus</i>	17
20	<i>Larus genei</i>	17
21	<i>Larus michaellis</i>	509
22	<i>Larus ridibundus</i>	142
23	<i>Larus melanocephalus</i>	1
24	<i>Limnocyptes minimus</i>	3
25	<i>Mareca penelope</i>	0
26	<i>Microcarbo pygmaeus</i>	0
27	<i>Mergus serrator</i>	15
28	<i>Numenius arquata</i>	18
29	<i>Pelecanus crispus</i>	0
30	<i>Phalacrocorax carbo</i>	224
31	<i>Phoenicopterus roseus</i>	29
32	<i>Philomachus pugnax</i>	0
33	<i>Platalea leucorodia</i>	16
34	<i>Pluvialis apricaria</i>	118
35	<i>Pluvialis squatarola</i>	4
36	<i>Podiceps nigricollis</i>	153
37	<i>Podiceps cristatus</i>	64
38	<i>Recurvirostra avosetta</i>	0
39	<i>Tachybaptus ruficollis</i>	10
40	<i>Tadorna tadorna</i>	1
41	<i>Tringa erythropus</i>	0
42	<i>Tringa nebularia</i>	0
43	<i>Tringa ochropus</i>	1
44	<i>Tringa stagnatilis</i>	0
45	<i>Tringa totanus</i>	16
46	<i>Thalasseus sandvicensis</i>	16
47	<i>Vanellus vanellus</i>	181
48	<i>Anas sp</i>	25
TOTALI		2535

Shpended grabiteqare

Nr	Lloji	Numri i individeve
1	<i>Accipiter nisus</i>	1
2	<i>Circus cyaneus</i>	1
3	<i>Circus aeruginosis</i>	11
4	<i>Falco tinnunculus</i>	3
5	<i>Pandion haliaetus</i>	1
<i>Totali</i>		17